

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI”- PRISHTINË

KDU: 94 (05)

K O S O V A

43
2018

**PRISHTINË
2018**

KRYEREDAKTOR

Prof. asoc. dr. Sabit SYLA

SEKRETAR I REDAKSISË

Prof. asoc. dr. Gjon BERISHA

REDAKSIA

Prof. asoc. dr. Sabit SYLA

Akademik Beqir META

Akademik asoc. Marenglen VERLI

Prof. dr. Pëllumb XHUFI

Prof. dr. Frashër DEMAJ

Prof. dr. Hamit KABA

Prof. asoc. dr. Gjon BERISHA

Prof. asoc. dr. Bedri MUHADRI

Prof. asoc. dr. Teuta SHALA-PELI

THE INSTITUTE OF HISTORY “ALI HADRI” - PRISHTINA

K O S O V A

43
2018

PRISHTINA
2018

PËRMBAJTJA-CONTENTS

Exhlale DOBRUNA-SALIHU

Lidhjet e Dardanisë me Lidinë në fushat e tregtisë, mitologjisë dhe skulpturës gjatë antikitetit.....	9
Coonnection of Dardania with Lydia in the fjeeld of trade, mythology and sculptural art during Antiquity.....	18

Emine KALAJA-HAJDARI

Kulti i Jupiter Dolichenus në Dardani.....	19
Juputer Dolichenus cult in Dardania.....	24

Qerim DALIPI

Dardania ndërmjet Bizantit dhe sulmeve të jashtme gjatë shek. XI.....	25
Dardania between Byzantine empire and foreign attacks during the 11th century.....	39

Teuta SHALA-PELI

Qyteti i Drishti parë nën prizmin e studimeve të Kostandin Jireçekut.....	41
The first city of Drishtit at the prizm of studies of Costantin Jirecek's.....	51

Nuri BEXHETI - Selver ISLAMAJ

Situata politike dhe përshtypjet e të huajve mbi vilajetin e Kosovës gjatë viteve 1880-ta.....	53
The political situation and the impressions of foreigners about the Vilayet of Kosova in the 1880-ies.....	69

Hasan BELLO

Kryengritja e vitit 1910 sipas disa raporteve konsullore.....	71
Rebellion of the year 1910 in the optical of diplomacy.....	79

Fitim RIFATI

Vështrime demografike, ekonomike dhe të komunikacionit në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 1914 (<i>Politika shtetërore për serbizim</i>).....	81
Demographic, economic and communications surveys in Kosova during the first half of 1914(<i>State policy for Serbianisation</i>).....	93

Sali KADRIA

Çështja e princit të Shqipërisë dhe kontributi i Austro-Hungarisë për rrjetin e komunikacionit në viset shqiptare gjatë viteve 1916-1918.....	95
The question of Albania's prince and the contribution of Austro-Hungary to the communication network in albanian lands during 1916-1918.....	115

Frashër DEMAJ

Kërkesa e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dërguar ministrisë së punëve të jashtme të Italisë, më 1918, për bashkimin e Kosovës dhe viseve tjera me Shqipërinë.....	117
The request of the Kosovo National Defense Committee sent to the ministry of foreign affairs of Italy in 1918 for the union of Kosovo and other areas with Albania.....	128

Halim PURELLKU

Komiteti i Kosovës (1924-1936) Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" (1924 - prill 1926).....	129
Kosovo Committee (1924-1936).....	141

Mrika LIMANI-MYRTAJ

Një vështrim mbi përzgjedhjen gjenetike të popullit në nacionalsocializëm dhe shqiptarët brenda këtij botëkuptimi gjatë Luftës së Dytë Botërore.....	143
An overview on national-socialist genetic selection and Albanians within this worldview during the Second World War.....	159

Erjon PAPAGJONI

Shteti komunist dhe institucionet fetare në Shqipëri	
--	--

1944-1949.....	161
The communist state and the religious institutions in Albania	
1944-1949.....	181

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Alban DOBRUNA

Tarikati islam Saadi në qytetin e Gjakovës.....	185
---	-----

Kosovar BASHA

Dokument mbi bashkëpunimin ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës gjatë viteve 1981-1982.....	203
--	-----

RECENSIONE

Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore - Arkivat Kombëtarë Britanikë , përgatitur nga studiuesit: Prof. dr. Hamit Kaba dhe Prof. asoc. dr. Sabit Syla , Instituti i Historisë “ <i>Ali Hadri</i> ”-Prishtinë, 2018, 532 f., (Ibrahim GASHI).....	213
---	-----

Epoka e lavdishme e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut parë nën prizmin e fondeve të Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut, <i>Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut: dokumente.</i> Hulumtoi dhe përgatiti, Prof. asoc. dr. Gjon Berisha , Instituti i Historisë “ <i>Ali Hadri</i> ”-Prishtinë, 2018, 433 f., (Teuta SHALA-PELI).....	219
--	-----

Franziska A. Zaugg, Albanische Muslime in der Waffen-SS: Von “Großalbanien” zur Division “Skanderbeg” , Ferdinand Schöningh: Paderbon, 2016, 346 f., (Mrika LIMANI-MYRTAJ).....	225
--	-----

AKTIVITETE

Aktivitetet e Institutit të Historisë “ <i>Ali Hadri</i> ”- Prishtinë gjatë vitit 2018 (Teuta SHALA-PELI).....	231
--	-----

Exhlale DOBRUNA-SALIHU

**LIDHJET E DARDANISË ME LIDINË NË FUSHAT E TREGTISË,
MITOLOGJISË DHE SKULPTURËS GJATË ANTIKITETIT**

Dardania, edhe pse bënte pjesë në trevat e brendshme të territorit ilir, kishte një pozitë të volitshme gjeografike, meqë përmes luginave të lumenjve Dri, Vardar dhe Moravë, lidhej me tri botëra të rëndësishme: në perëndim me bregdetin ilir të Adriatikut, në jug me botën e Egjeut, dhe në lindje me trevat e Detit të Zi. Rrjedhat e tyre, që herët, në parahistori, kanë diktuar edhe drejtimin dhe karakterin e rrugëve kryesore, nëpërmes së cilave ka vënë kontakte me trevat e cekura. Këto komunikime botën e Egjeut, përkatësisht me atë të Mesdheut, që nga Bronzi i Mesëm dhe i Vonë, ndikuan në procesin e mëtutjeshëm të tyre, duke filluar nga shekulli VIII me lidhje më të ngushta, për t'u intensifikuar më tej në shekullin VII dhe për t'u bërë më intensive tregtare nga shek. VI. Kështu, materiali arkeologjik edhe nga koha helenistike, dokumenton lidhjet e mëtutjeshme, të cilat vazhdojnë edhe në shekujt e ardhshëm¹.

Në kuadër të Azisë së Vogël, në këtë rast, këto lidhje do t'i trajtojmë me trevën e Lidisë, meqë deri më tani nga ky aspekt kjo trevë është trajtuar shumë pak. Aq më shumë kur Lidia përbën një trevë shumë të rëndësishme. Ajo, me gjuhë dhe alfabet të vetin, gjatë shek. VII dhe VI ishte shtet, përkatësisht një mbretëri e fortë dhe e pasur me burime natyrore, gjatë së cilës kohë shënoi edhe zhvillim të fortë të artit. Duke u shtrirë në pjesën perëndimore të Azisë së Vogël, ku përfundonte me detin Egje, falë këtij pozicioni si një pikë takimi mes Lindjes dhe Perëndimit, u bë një rajon i rëndësishëm tregtar, që e dokumenton edhe farkimi i parave

¹Exhlale Dobruna-Saliu, "Viticulture on the basis of images and inscriptions on stone monuments of Dardania", *HistoriaAntiqua* 15, Pula 2007, 252.

të para të njohura, të cilat ishin të punuara në elektron (përzierje e arit dhe argjendit)². Në brendi qytetet më të njohura ishin Sardi, kryeqytet dhe Tiatura, të cilat përbënin qendrat e farkimit të parasë dhe ku kanë qenë të zhvilluara shumë artizanatet, si dhe përpunimi i mineraleve, kurse në bregdet gjendeshin kolonitë mirë të njohura greke, jonike: Smirna, Efesi, Fokeia dhe Eritrea. Pas humbjes së pavarësisë, në çerekun e fundit të shek. II përfundon si pjesë e provincës romake të Azisë (“Asia”), për t’u bërë nga Diokleciani provincë më vete dhe për të vazhduar këtë veprimtari edhe gjatë kohës romake.

Materiali i pranishëm arkeologjik këto lidhje gjatë antikitetit i dokumenton në tri fusha: tregtare, mitologjike, dhe skulpturore. Për lidhjet në fushë të tregtisë e një rëndësie të veçantë është gjetja e kahershme e një monedhe në pjesën jugore të Dardanisë, në Tetovën e sotme, nga një mbledhës amater i monedhave, i cili na ofroi për ta deshifruar, për çka i jam mirënjohës. Me paraqitje në të dy anët: bustin e hyjneshës Artemis në faqe (*aversum*) dhe sëpatën e dyfishtë (*labrys*) me mbishkrimin “Thyateirenon” (emrin e qytetit të Lidisë) në shpinë (*reversum*) - në formën THYATEI lartë dhe REN ON poshtë - na tregoi për prejardhjen e saj. Kështu, me hulumtim në literaturën e prerjeve të Lidisë, ku na u ofrua mundësia ta gjejmë analogjinë me këtë monedhë, që moti konstatuam se ky ekzemplar u farkua në Tiaturë (*Thyatira*) në fillim të shek. II para Kr.,³ duke dëshmuar lidhjet hershme tregtare të Dardanisë me Lidinë. Sa u takon këtyre paraqitjeve, vlen të theksohet se Artemisi përbën hyjneshën kryesore të Efesit, ku edhe gjendet Artemizioni, kurse labrisi paraqitet në disa nga prerjet e monedhave në qytetet e shumta greke, trakase dhe të Azisë së Vogël. Pasi fotografimi i monedhës nuk u lejua, atëherëpo e ilustruam me një ekzemplar të këtij tipi nga ky publikim (fig. 1).

²Jean Babelon, *La numismatique antique* (Paris: Presse universitaires de France 108, 1949) 21.

³Khr. Barclay, V. Head, *Catalogue of the Greek coins of Lydia* (London: British Museum. Department of Coins and Medals (22.), 1901), 292, n. 7. Për ofrim të kësaj literature dhe të ndihmës në këtë konstantim i jam falenderues numizmates dr. Z. Dukat nga Muzeu Arkeologjik i Zagrebit.



Fig. 1

Gjatë periudhës romake, lidhjet e Dardanisë me Azi të Vogël janë më të pranishme. Kështu që edhe me Lidinë intensifikohen, ku një rol të rëndësishëm e kanë luajtur të ardhurit, vendosja e të cilëve ka qenë e lidhur me statusin e qendrës urbane, praninë e kampeve ushtarake dhe resurset natyrore. Prandaj, këto lidhje më së shumti janë ndjerë në pjesën jugore me qendrën e saj kryesore në koloninë e *Scupi*-t, kurse pjesërisht në pjesën veriore, në dy qendrat: municipin e *Naissus*-it dhe në *Timacum minus*, ndërsa shumë pak në pjesën qendrore, Kosovën, përkundër dy qendrave të njohura urbane dhe të pasura minerare: Ulpiana dhe Municipium DD, që ka të bëjë me konservatizmin e kësaj pjese të Dardanisë.



fig. 2

Lidhjet në fushën e mitologjisë me Lidinë i dëshmon altari votiv nga gjysma e dytë e shek. II, i gjetur në fshatin Lece, te Leskovci, në territorin e municipit të Naisit (fig. 2)⁴, i cili i kushtohet personit të quajtur

⁴Petar Petrović, "Epigrafska saopštenja", *Starinar* 19 (1969), 225 e tutje, fig. 1; *Niš u antičko doba* (Niš, 1976), 141; *Naissus-Remisiana-Horreum Margi, Inscriptions de la Mésie Supérieure* (IMS) vol. IV. (Beograd, 1979), 121-122, n. 110; Zef Mirdita, "Prisutnost orijentalnij kultova na području Dardanije", *Vjesnik Arheološkog muzeja u Zagrebu*, 3. s., XXXIV (2001), 45; Exhlale Dobruna-Salih, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit ne Dardani gjate kohes romake – Sepulkrale dhe e kultit 1-2* (Prishtine: Instituti Albanologjik,

Omfala (*Omphale*), e njohur si mbretëreshë e Lidisë, miti i së cilës është i lidhur ngushtë me shërbimin e Herakliut për tre vjet⁵. Përkushtuesi itij është një person i quajtur *Aelius Saturninus*, kognomeni i të cilit, edhe pse është i përhapur në shumë treva të Perandorisë⁶, bazuar në gjentilicin perandorak *Aelius*, ky përkushtues është nga radhët e vendasve⁷. Nga ana epigrafike ky altar paraqet një veçanti jo vetëm në Dardani, por edhe në të gjitha provincat danubiane-ballkanike dhe më gjerë në provincat e tjera perëndimore, meqë në mbishkrimet latine edhe të trevave të tjera Omfala nuk përmendet, pos në dy raste: një relievi të mermertë nga shekulli II që ruhet në Museo Nazionale të Napolit, në të cilin emri i saj dhe i Herkulit janë skalitur përfundi paraqitjes së tyre figurative⁸, sidhe të një përkushtimi nga Verona⁹. Duket qartë se vet fakti i adhurimit të këtij kulti lidias nga ana e një vendasi flet mjaft për këto lidhje.

Në fushë të skulpturës këto lidhje, të cilat janë shumë më evidente, shihen në motivet e stelavembivarrore nga fundi i shek. I deri në fund të shek. III, të cilat në Dardani paraqesin monumentet më të shumta të skulpturës në gur. Këto motive të trajtuara nën ndikimin e Azisë së Vogël dhe, në këtë rast, në veçanti nën ndikimin e Lidisë, në pjesën më të madhe janë të skalitura në stelat nga territori i Skupit dhe në numër të vogël në ato nga Timak minusi. Ato u përkasin të tri llojeve: elementeve dekorativo-arkitektonike, motiveve dekorativo-simbolike dhe figurative.



fig. 3

2003-2005), 839, n. 367, T. 169, fig. 315.

⁵Gertrud Herzog-Hauzer, *Realencyclopädie der classischen Altertumswissenschaft* (Stuttgart, 1939), col. 386.

⁶Géza Alföldy, *Die Personennamen in der römischen Provinz Dalmatia* (Heidelberg, 1969), 188.

⁷Petrović, "Epigrafska saopštenja", 226.

⁸Bernard Andreae, *Studien zur römischen Grabkunst* (Heidelberg, 1963), T. 38.

⁹Hermann Dessau, *Inscriptiones Latinae selectae*, 1-3 (Berlin, 1892-1916), n. 3462.

Në elementet dekorativo-arkitektonike bëjnë pjesë gjysmështylla dhe arkadat¹⁰. Gjysmështylla ose imitimi i saj në mes të fushës mbishkrimore haset që nga shek. I, me ç'rast ajo ndahet në dy pjesë, duke fituar trajtë të



Fig. 4

së Vogël, ku stelat me këtë element në mes të fushës mbishkrimore ose relievore janë të pranishme në Lidi¹², si dhe në Frigji¹³ dhe Liki¹⁴. Prandaj, prejardhjen e këtij tipi stelash në Dardani më parë duhet kërkuar në këtë anë. Arkadat në varg janë të pranishme te tre ekzemplarë: dy nga territori i Skupit, ku kemi të bëjmë me dy-tri sosh të mbështetura në gjysmështylla të rrumbullakëta, apo këndore në fushën kryesore relievore¹⁵ (fig.4) dhe një nga Timak minusi¹⁶(fig. 5), ku janë skalitur tri harqe në friz pa elemente mbajtëse. Edhe ky element, i cilipo ashtu në stelat e trevave dhe provincave të afërta me trevën dardanenuk ka hasur në përdorim, ndërsa në numër më të madh sidomos haset në Azinë e Vogël, duke u paraqitur si motiv dominant në stelë, ose duke zënë vend në pjesë të ndryshme të saj, për ç'arsye edhe konsiderohet si një motiv tipik

¹⁰Dobruna-Salihu, "The influence of the newcomers from Asia Minor in the form and motifs of the sepulchral stelae from Dardania during the Roman Period", Mihailescu-Bîrliba (Hg.) *Migration, Kolonisierung, Akkulturation im Balkanraum und im Osten des Mittelmeerraumes* (3. Jh. v. Chr. - 6 Jh. n. Chr.), Akten der Tagung in Iași, 3.-7. Oktober 2007 (Hartung-Gorre Verlag, 2017), 64-66.

¹¹Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative*, 633-634, n. 9, T. 4, fig. 9 nga Llopati te Kumanova.

¹²Josef Keil – Anton v. Premerstein, *Bericht über eine zweite Reise in Lydien*, DkAk 54, (Wien, 1911), 86, n. 172, fig. 45.

¹³*Monumenta Asiae Minoris Antiqua* (MAMA) I (Manchester, 1928), 23, n. 33.

Ernst Berger, *Das basler arztrelief. Studien zum griechischen Grab und Votivreliefum 500 v. Chr. und zur vorhippokratischen Medizin* (Mainz, 1970), 135, fig. 152.

¹⁵Borka Dragojević-Josifovska, *Scupi et la region de Kumanovo*, IMS vol. VI (Beograd, 1982), 108-109, n. 98; Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative*, 646, n. 32, T. 16, fig. 28 nga Matka.

¹⁶Petar Petrović, *Timacum Minus et la vallée du Timok*, IMSvol. III /2 (Beograd, 1995), 101, n. 55; Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative*, n. 191, T. 90, fig. 171 nga Knjazhevci.

po ashtu i Lidisë¹⁷, e që gjithashtu është i pranishëm edhe në dy treva të tjera¹⁸. Veçanërisht për ndikimet nga Lidia, flasin edhe pajimet e gruas të skalitura në këto arkada, të cilat janë po ashtu të pranishme në një rën stelë të Skupit (fig. 4).




Fig. 5



Fig. 6

Motivet dekorative-simbolike janë më të numërta. Në mesin e tyre një vend me rëndësi e zënë pajimet personale të gruas, të cilat gjithashtu janë karakteristikë e pjesës jugore, meqë, përveç dy rasteve nga Timak minusi, gjenden vetëm në stelat e territorit të Skupit, duke filluar nga shek. II deri në kapërcyellin e shek. III. Ato përbëhen prej dy llojeve të objekteve të përdorimit të përditshëm: mjeteve të tualetit (pasqyra dhe krehri) dhe të punëdore (shporta, boshti dhe furka), të cilat në disa raste paraqiten së bashku¹⁹. Më të shumta janë mjetet e tualetit, ku paraqiten në kombinime të ndryshme me motive të tjera, kryesisht së bashku²⁰ (fig.6). Kurse mjetet

¹⁷Keil -Premmerstein, *Berichtüber*, 139, nn. 261-263, fig. 84-86, ku vet stelat kanë trajtë të dy arkadave.

¹⁸MAMA 5 (1937), T. 22, fig. 44(1), T. 30, fig. 89 në Frigji; MAMA 8 (1962), fig. 65, 109 në Likaoni.

¹⁹Dobruna-Salihu, Exhlale, "Everyday motifs and occupations depicted on Dardanian steles", *Iconographie du quotidien dans l'art provincial Romain: Modeles regionaux*, Actes du XIV Congrès International d'Art Provincial Romain, Dijon, 1-6 juin 2015, (Dijon, 2017), 218-223

²⁰Dragojević-Josifovska, *Scupi et la region de Kumanovo*, 105, n. 91; Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative*, 659, n. 53, T. 26, fig. 47 nga Draçeva.

e punëdores janë të pranishme në numër më të vogël stelash, ku gjenden të kombinuara me mjetet e tualetit dhe vetëm (fig. 4, 5).

Në provincat e afërta të Dardanisë dhe në ato perëndimore të largëta stelat dhe monumentet e tjera mbivarrore me këtë grup motivesh janë mjaft të rralla. Përkundrazi, shumë shpesh i hasim në Azi të Vogël, ku janë përdorur gjatë shek. II dhe III. Këtu paraqiten të gjitha elementet që i hasim në stelat tona, por në numër shumë më të madh, në kombinime të ndryshme dhe në pjesë të ndryshme të stelës. Në mesin e tyre mund të gjejmë edhe analogji me ekzemplarët tanë. Kështu, në Lidi mjetet e tualetit, po ashtu më së shumti së bashku, zakonisht janë të paraqitura edhe me motive të tjera²¹. Kurse te punëdorja, shporta ka formë të afërt me shportën në stelat e Dardanisë dhe është e dekoruar ngjashëm me atë në stelën nga Matka (fig. 4), ku, ngjashëm me stelën e Timak minusit, gjendet edhe si motiv i vetëm në fronton²². Njëherësh paraqitet edhe së bashku me mjetet e tualetit²³. Prandaj origjinën e tyre në trevën dardane, krahas trevës së Frigjisë, ku po ashtu janë mjaft të pranishme²⁴, do kërkuar edhe nga kjo trevë përmes të ardhurve. Në të mirë të kësaj flasin edhe bartëset e këtyre stelave, të cilat, qoftë me emra grekë, qoftë latinë, në shumicën e



Fig. 7

tasteve janë të prejardhjes orientale (fig.4, 5,6), ndërsa shumë pak janë me prejardhje vendase. Krahas këtij grupi motivesh, është e mundur që prejardhje nga Azia e Vogël të ketë pasur gjithashtu një vegël që paraqitet në dy stela vetëm në territorin e Skupit: kosorja e cila ka shërbyer në vreshtari²⁵. Nënjerën stelë²⁶(fig.7), ku është paraqitur me pajimet e gruas dhe të

²¹Josef Keil - Anton v. Premmerstein, *Bericht über eine zweite Reise in Lydien und der südlichen Aiolis mit einem Beitrag von Paul Kretschmer*, DkAk 53 (Wien, 1910), 79, n. 169, fig. 74; Keil.-Premmerstein, *Bericht über*, 1911, 139, figg. 84, 86.

²²Keil -Premmerstein, *Bericht über* (1911), 86, n. 172, fig. 45.

²³Peter Herrmann, *Tituli Lydiae, Tituli Asiae Minoris antiquae* V, 1 (Vindobonae, 1981), T. XIV, n. 175.

²⁴Krh. shën. 19.

²⁵Gjerësisht për veglat e punës khr. Dobruna-Saliu, ““Everyday motifs”, 223-227.

²⁶Dragojević-Josifovska, *Scupi et la region de Kumanovo*, 115-115, n. 110; Dobruna-Saliu, *Plastika dekorative*, 667-668, n. 68, T. 32, fig. 61 nga Shkupi.

një vegleje tjetër, në të mirë të prejardhjes orientale të saj dhe bartësit të stelës flet edhe fusha mbishkrimore me shtyllën në mes.



Fig. 8

Skupit³⁰ (fig. 8), ku i ndjeri meveshje vendase është paraqitur si bari me qenin pranë dhe shkopin e bariut në dorë. Në fakt skena e të ndjerit në profesionin e tij gjatë jetës është e njohur në artin provincial romak në tërë Perandorinë. Prandaj, ajo është e pranishme edhe në trevat e tjera ilire, ku të ndjerët janë paraqitur gjithashtu në profesionin e tyre me kostume ilire³¹. Mirëpo, duke u nisur nga fakti se numri më i madh i tyre është nga Azia e Vogël³², ku kemi hasur edhe në shembuj të afërt, siç është rasti me dy stela: një nga Frigjia³³ dhe një nga Lidia³⁴, atëherë, përkundër

Në stelën tjetër, nga çereku i parë i shek. II²⁷, megjithëse kemi të bëjmë me një veteran me prejardhje nga Italia Veriore, nxitjen për paraqitjen e kësaj vegle duhet kërkuar në Azi të Vogël. Aq më shumë, në të mirë të ndikimeve në paraqitjen e kësaj vegle nga kjo anë, e në këtë rast nga Lidia, flet fakti i paraqitjes së saj së bashku me mjetet e tualetit dhe të një vegleje tjetër në këtë trevë²⁸. Motivet figurative të kësaj prejardhje janë shumë të pakta²⁹.

Fjala është për një stelënga territori i

²⁷Koračević, Dušanka, "Nadgrobná ploča posvećena veteranu legije VII Claudia", *Živa antika* 33/2, (Skopje, 1983), 215-218, fig. 1-2; Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative*, 652-653, n. 41. T. 21, fig. 37 nga Bardovci

²⁸Keil -Premerstein, *Bericht über*(1911), 139, fig. 86.

²⁹Dobruna-Salihu, "The influence", 70-71.

³⁰Dragojević-Josifovska, *Scupi et la region de Kumanovo*, 137, n. 145; Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative*, 669-670, n. 71, T. 33, fig. 63 nga Pobuzhja.

³¹Irma Čremošnik, „Nošnja na rimskim spomenicima u Bosni i Hercegovini“, *Glasnik ZemaljskogMuzeja u Sarajevu*, n. s. 18 (1963), 105, 108, 109, fig. 2 nga provinca e Dalmacisë në Bosnjën e sotme; Andromaçi Gjergji, "Elemente të përbashkëta të veshjes së fiseve të ndryshme ilire dhe vazhdimësia e tyre në veshjet tona popullore", Sesion shkencor, Tiranë, March 3-4, 1969. *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve* (Tiranë, 1969), 154, fig. 2-3; Damjan Komata, "Veprat e artit provincial ilir në ekspozitën e Hildeshajmit", *Iliria* 2 (1989), 226-227, fig. 3, 7 nga provinca Maqedonisë në Shqipërinë e sotme.

³²E. Pfuhl - H. Möbius, *Die östgriechische Grabreliefs*, 2, (Mainz, 1979), T. 72, figg. 1143, 1146, T. 175, fig. 1169, T. 177, fig. 1175 etj.

³³Pfuhl - Möbius, *Die östgriechische Grabreliefs*, T. 175, fig. 1168.

elementeve vendase në ekzemplar in tonë, siç është veshja dhe antropomorfia, të cilat kanë të bëjnë me një vendas, inspirimi për një skenë të tillë, është e mundur të ketë ardhur nga kjo trevë. Në të mirë të kësaj flet edhe vet prania e stelës mu në territorin e Skupit, si i vetmi ekzemplar me një paraqitje të tillë në të gjithë Dardaninë.

* * *

Është karakteristike se këto motive dekorative arkitektonike dhe simbolike të gjysmështyllës, arkadave dhe të pajimeve të gruas, këto stela i bëjnë shumë të veçanta jo vetëm në rajonin e provincave ballkaniko-danubiane, por edhe më gjerë, në ato të perëndimit latin.

Përkitazi me ndikimet, duhet të theksohet se për të gjitha këto ndikime në stela, pos rolit primar të legjioneve, veçanërisht të legjionit VII të Klaudit, qoftë ushtarë aktivë qoftë veteranë kolonizatorë, kanë kontribuar gjithashtu edhe civilët e ardhur (tregtarë dhe skllevër), të cilët u vendosën kryesisht në koloninë deduktive të Skupit dhe në qendrën minerare të Timak minusit. Këto lidhje të Dardanisë me Lidinë gjithsesi flasin në të mirë të trevës dardane për lidhjet e saj me rajone të njohura, siç ishte Lidia. Është për t'u besuar se hulumtimet e mëtejshme të trevës së Dardanisë, e sidomos të pjesës qendrore të saj, Kosovës, do të qesin në dritë material të ri arkeologjik për të dëshmuar më tej lidhjet e Dardanisë me Lidinë.

³⁴Herrman, *Tituli Lydiae*, T. XIV, nn. 164, 190.

Exhlale DOBRUNA-SALIHU

SUMMARY

COONNECTION OF DARDANIA WITH LYDIA IN THE FJELD OF TRADE, MYTHOLOGY AND SCULPTURAL ART DURING ANTIQUITY

Even though it forms part of the Illyrian interior, the territory of Dardania was situated on an important geographic position, considering that the river valleys of the Drinus, Axius and Margus connected it with the Illyrian coast of the Adriatic Sea, the Aegean world of the south and the Pontic areas and thus with Asia Minor. The course of those rivers from very early dictated the direction and character of the main routers, through which it established contacts with the mentioned areas. In the context of Asia Minor with Lydia that until now from this aspect it is treated vaguely.

Similar as with other areas of Asia Minor, and with Lydia these contacts mostly are felt on the southern part with its main center in Scupi, while partly on the northern part in Naissus and Timacum minus, and only slightly on the central one, today's Kosovo. Regarding the connections in the field of trade particularly important is coin from the beginning of the 2nd century B.C. from Thyatira, found on the southern part, in the today's city of Tetova, testifying the early trade contacts of Dardania with Lydia. While the connections in the field of mythology from this area testifies the votive altar from the 2nd/3rd century found on the northern part, in municipium Naissus, that is devoted to a mortal person Omphale, the queen of Lydia, that represents in particular the provinces of the Latin west. In field of sculptural art this link, which is more evident, it is seen best in the motifs of sepulchral steles from the end of 1st century until the end of 3rd century. They are present with three types: decorative-architectural elements, decorative-symbolic motifs and figural motifs. These steles, treated under the influence of Lydia, mainly are from the territory of the colony of Scupi and on a smaller scale from Timacum minus.

Emine KALAJA-HAJDARI

KULTI I JUPITER DOLICHENUS NË DARDANI

Në territorin e Dardanisë, përmes burimeve epigrafike është dëshmuar prania e imigrantëve nga provincat lindore, të cilët përveçse si përfaqësues të ushtrisë, si ndërmjetës të traditave orientale në zonën e artit dhe kulturës në përgjithësi, duhet parë edhe si tregtarë, skllevër, dhe mjeshtrë të përpunimit të metaleve të ndryshme, me të cilat shquhet Dardania. Janë këto mënyrat, njerëzit dhe rrugët përmes të cilave kanë ardhur dhe janë përhapur edhe kultet e ndryshme në këtë rajon, në kohën kur ndikimi i orientit filloi të jetë i dukshëm pas krijimit të principatit dhe zgjerimit të territoreve të pushtuara nga Perandoria Romake. Në mesin e këtyre kulteve është ai i Jupiter Dolichenus, i cili ishte i ngjashëm me Jupiterin romak. Ai adhurohej jo vetëm në Dardani, por edhe në Mezinë e Epërme¹ dhe më gjerë.

Origjina e këtij kulti mendohet të jetë Dülük-Baba, afër Dolichea, qytet i vjetër sirian (provinca Comagene), në kufi të Azisë së Vogël dhe Sirisë,² respektivisht në pjesën juglindore të Turqisë së sotme, ku nderohej një hyjni lokale Baal, e i cili më vonë ndërlidhet me Dolichenus. *Baal* fillimisht ishte hyjni i fenomeneve natyrore, për t'u bërë më pastaj zotërues i botës.³ Kështu, nga një hy krahinor i quajtur Baal, me origjinë

¹ Vladimir P. Petrović, "The cult of Jupiter Dolichenus in Moesia Superior: mining aspects", *Romanisation des dieux orientaux, Proceedings of the international symposium*, Skopje, 18-21 September 2013, (Skopje 2015), 321-332.

² Mladen Jovičić, "The cult of the Jupiter Dolichenus along of the serbian part of the limes in Moesia Superior and Panonia Inferior", *XVII Roman military equipment conference*, 24-27 may, 2010, (Zagreb, 2010), 537.

³ Naser Ferri, "Besimi dhe kultet në Dardaninë e parakrishtere", *Dardania Sacra*1,

nga lindja, pas kontakteve me kulturën romake lidhet dhe identifikohet me Jupiterin, që më pas njihet si Jupiter Dolichenus⁴, emër ky me të cilin bëhet pjesë e panteonit romak. Atributet e tij ishin: rrufeja të cilën e mbante në dorën e majtë e cila simbolizonte fuqinë e zotit mbi motin dhe forcën e saj shkatërruese, pastaj sëpatën, simbolika e së cilës lidhej me fuqinë dhe superioritetin hyjnor si dhe demin i cili simbolizonte pjellorinë dhe forcën. Pothuajse çdo herë Jupiter Dolichenus paraqitej i shoqëruar me këto attribute.⁵

Rol të madh në përhapjen e këtij kulti luajtën ushtarët romakë, që shërbyen në lindje, të cilët e pranuan dhe përshtatën këtë kult, pastaj ushtarët e rekrutuar sirianë, e në një masë influencuan edhe tregtarët.⁶ Sipas studiuesit Jovičić⁷, ky kult ka qenë i përhapur më së shumti në mesin e ushtarëve, të cilët e konsideruan atë mbrojtës të fushës së betejës, hekurit dhe armëve të bëra nga hekuri, mendim ky i mbështetur edhe nga studiuesit Calin Timoc dhe Imola Boda.⁸

Referuar numrit të tempujve, altarëve dhe veprave të artit kushtuar këtij perëndie, kulti i tij del të jetë ndër më popullorët në Perandorinë Romake gjatë shekujve II dhe III. Megjithatë, kultin e tij burimet e shkruara literare nuk e përmendin fare.⁹ Adhurimi dhe nderimi i kutit të tij është dëshmuar edhe në hapësirën Dardane. Në territorin e Dardanisë ky kult kishte arritur që në kohën e perandorit Septim Severit,¹⁰ dhe është dëshmuar në monumente epigrafike, të zbuluara në Ulpianë¹¹, Prizren¹²

(Prishtinë, 1999), 40.

⁴ G. R. Veston, *The Roman Soldier*, (London, 1969), 132.

⁵ Catherine R.K. Leisser, *The Cult of Jupiter Dolichenus on the Outer Limits of the Roman Empire: A Comparison Study of Dolichena*, A Thesis in the INDI Program, Concordia University Montreal, (Quebec, Canada, 2015), 121.

⁶ Anna Collar, "Military networks and the cult of Jupiter Dolichenus", *Asia Minor Studien*, (Boon, 2011), 218.

⁷ Mladen Jovičić, "The cult of the Jupiter Dolichenus", 537.

⁸ Calin Timoc; Imola Boda, "Notes on the Dolichenian monument from Pincum/Veliko Gradište", *Starinar* LXVI/2016, (Beograd, 2016), 123.

⁹ Michael Speidel, *The religion of Jupiter Dolichenus in the roman army*, EPRO 63, Leiden, 1978, f. II 95.

(<http://booksandjournals.brillonline.com/content/books/b9789004295452s016>).

¹⁰ Naser Ferri, *Mythologia viva*, Prishtinë, 2012, 45.

¹¹ *I(om) O(ptimo) M(aximo) / D[ol]i[ch]eno(?) / IV(?) [-] L Cele[r?] / [...]R Mis[...]* *[v(otum) s(olvit) l(ibens) [m(erito) [CIL III, 08171]; I(ovi) O(ptimo) M(aximo) D(olicheno) / pro salute d(ominorum) n(ostrorum) Imp(eratorum) Augg(ustorum). /*

dhe Kumanovë.¹³ Kurse, figurativisht është dëshmuar në Timacum Minus, ku janë zbuluar disa fragmente të plastikës, ku shihet ky hy i ulur mbi dem,¹⁴ të dhëna këto që mund të na shpien drejt konstatimit se, në këtë vendbanim mund të ketë ekzistuar edhe një tempull kushtuar atij.

Njëri nga altarët e gjetur në Ulpianë është ngritur për nderë të perandorëve, por pa përmendur emrat e tyre. Ai është ngritur nga priftërinjtë Victor dhe Demetrius. Fakti që nderimi i kultit të tij në Ulpianë është bërë nga këta priftërinj, lë të hamendësohet për mundësinë e pranisë së një tempulli kushtuar kultit të tij në këtë vendbanim. Në anën tjetër altari nga Prizreni, pos kultit të tij, ishte ngritur edhe në nderim të kultit të Asklepit, Telesforit, Hygias dhe Gjenive. Monumenti ishte ngritur nga ushtari Surus, i biri i Heraklitit, me origjinë nga lindja, i cili sipas V. P. Petrović,¹⁵ mund të kishte qenë pjesëtar i Cohors I Aurelia Dardanorum, e vendosur në Mezinë e Epërme. Gjithashtu, edhe altari i zbuluar në Kumanovë kushtuar këtij hyji, është ngritur në nderim të perandorëve, respektivisht për shëndetin e perandorit M. Aurel Antoninit. Për ngritjen e këtij monumenti ishte përkujdesur Achilleus, i cili me gjasë ishte skllav.

Mbishkrimet e zbuluara deri më tani në Dardani, i takojnë shek. II-III, dhe janë të lidhura me kohën e sundimit të perandorëve nga dinastia e Severeve, kohë kjo e përfundimit të luftërave civile dhe e vendosjes së përkohshme të paqes. Sa i përket statusit të personave të paraqitur në

Victor Demetri (filius) et De/metrius Ambibi (filius), sac[er]dotes eiusdem deis s(oluerunt) u(otum). [AE, 1966, 340; Nikola Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", *Spomenik LXXI*, Beograd, 1931, 192, 510; Zef Mirdita, "Antroponimia e Dardanisë në kohën romake, 1981, 248, 219; Emine Kalaja-Hajdari, *Shndërrimet në Dardani gjatë periudhës romake (Proceset ekonomike, social-politike dhe kulturore)*, Prishtinë, 2017, 243, 277].

¹² *As/clep[i]o // [Teles]/[phoro] // [Hy]/[giae] // So[...] // Heracliti Su/rus et pro / Genio Dolic(h)eni / paterno Deo et Geni(io) / co(ho)rtis votum libies(!) f(ecit).* [N. Vulić, 1931, 133, 322; AE 1981, 0739; M.P. Speidel, *Aarch Slov* 31, 1980, 182-185; *ILJug*, 1438; Zef Mirdita, 1981, 261, 297; Emine Kalaja-Hajdari, 2017, 326, 613].

¹³ *I(ovi) O(ptimo) M(aximo) D(olicheno) / pro salute / Im(peratoris) M(arci) Aureli / Antonini Pii / Aug(usti) et Iuliae Aug(ustae) matri kast(rorum), / Achilleus, eor/undem servus, pos(uit) / Kal(endis) Novembri[bus], / Sabino II et Anu(lino) / co(n)s(ulibus).* [CIL III, 8243; Nikola Vulić, "Antički spomenici naše zemlje", 1941-1948, 97, 214; Zef Mirdita, 1981, 241, 170; Emine Kalaja-Hajdari, 2017, 231, 224].

¹⁴ Nikola Vulić, 1941-1948, 93, 201.

¹⁵ Vladimir P. Petrović, "The cult of Jupiter Dolichenus in Moesia Superior: mining aspects", (Skopje 2015), 329.

cilësinë e dedikuesve apo të dedikuarve, njëri nga ta i paraqitur në monumentin nga Prizreni shfaqet një *cohortis*.

Shumë studiues këtë kult mundohen ta lidhin me një grupacion të caktuar, veçanërisht me ushtrinë, gjë që nuk mund të bëhet, sidomos jo në territorin e Dardanisë, sepse në monumentet epigrafike të zbuluara në hapësirën dardane të provincës së Mezisë, asnjë individ i paraqitur aty nuk është i ndërlidhur me ushtri. Atë mund ta ndërlidhim më shumë me minierat dardane, meqë mbishkrimet dhe materiali arkeologjik kushtuar këtij hyji na vinë nga distriktet xehetare.

Përkundër faktit se në Dardani deri më tani nuk janë zbuluar tempuj kushtuar Jupiter Dolichenus, gjetja e disa mbishkrimeve, sado të pakta në numër, si dhe paraqitja figurative e tij, le të kuptohet se në këtë territor ka pasur admirues dhe priftërinj të këtij kulti, origjina orientale e të cilëve tanimë është e përcaktuar, prezenca e të cilëve ndërthuret ndër të tjera, edhe me eksplotimin e xeheroreve dardane.



Foto 1. Mbishkrimi nga Ulpiana¹⁶



Foto 2. Monumenti nga Prizreni¹⁷

¹⁶ Arben Hajdari, *Ulpiana et la romanisation*, (Tezë doktorate), (Grenoble, 2013).

¹⁷ <https://edh-www.adw.uni-heidelberg.de/home> (Ortolf Harl, 2017).



Foto 3. Monumenti nga Kumanova¹⁸



Foto 4. Paraqitja figurative e Jupiter Dolichenus¹⁹

¹⁸ <https://edh-www.adw.uni-heidelberg.de/home> (Ortolf Harl, 2017).

¹⁹ Nikola Vulić, 1941-1948, 92, 201.

Emine KALAJA-HAJDARI

SUMMARY

JUPITER DOLICHENUS CULT IN DARDANIA

Upon Roman invasion, Dardania faced several changes, including those of a spiritual nature. Epigraphic and iconographic data allow us to follow the spread of various cults in the Dardanian territory. Inscriptions allow us to identify a group of eastern deities brought to this part of the Empire, as a result of the specific political and economic circumstances, brought over by soldiers, tradesmen, travellers and adventurers of all walks of life.

Part of such unofficial cults was that of the Jupiter Dolichenus, which was similar to the Roman Jupiter. It was worshiped in the whole of the territory of Upper Moesia, including Dardania. Based on epigraphic data, such a cult has appeared in Ulpiana, Prizren, Kumanovo and Timacum Minus, in the form of figurative material, where some plastic fragments have been discovered, where this Deity appears sitting on a bull. The discovered inscriptions in Dardania belong to the second and third centuries, and fall in the period of emperors from the Sever Dynasty.

Qerim DALIPI

DARDANIA NDËRMJET BIZANTIT DHE SULMEVE TË JASHTME GJATË SHEK. XI

Mbi bazën e burimeve bizantine dhe të literaturës relevante bëhet përpjekje që të nxirret në pah pozita e Dardanisë nën Bizantin dhe rreziku që i erdhi asaj nga jashtë. Në këtë kuadër trajtohet konflikti bizantino-bullgar dhe rivendosja e administratës bizantine, përmes krijimit të temës së Shkupit. Në rrafshin kishtar hidhet një vështrim mbi dioqezat e Dardanisë dhe shtrirjen e tyre territoriale. Duke vënë theksin në rrethanat e brendshme, nëpër të cilat kalonte Perandoria Bizantine, trajtohen dy kryengritjet që përfshinë Dardaninë, njëra prej të cilave shpërtheu në territorin e kësaj të fundit. Në kontekst të rrethanave të jashtme trajtohen sulmet plaçkitëse të fiseve të ndryshme ndaj Dardanisë, kundrejt të cilave, përkundër vështirësive të shumta, Perandoria Bizantine reagoi me vendosmëri.

Aty nga viti 279, kur u formua provinca romake e Dardanisë, me qendër Shkupin,¹ në kuadër të saj hynte i gjithë territori i sotëm i Republikës së Kosovës dhe viset në periferi të saj. Gjatë mbretërimit të perandorit bizantin Justiniani I (527-565), brenda kufijve administrativë të Dardanisë hyri edhe treva e Nishit.² Më pas, në shek. X, provinca e Dardanisë, me tre qytete, përmendet nga perandori dhe shkrimtari bizantin Konstandin Porfirogjeneti.³ Rrjedhimisht, meqë Dardania përmendet edhe

¹ Edi Shukriu, "Mbretëria Dardane", *Kosova*, nr. 22/23 (2000/2001), Prishtinë, 2003, f. 9.

² Zef Mirdita, *Studime dardane*, Prishtinë, 1979, në më shumë vende; I njëjti, *O južnoj granici Dardanaca i Dardaniye u antici*, in: "Vjesnik arheološkog muzeja u Zagrebu", 3. Serija, XXXII-XXXIII (1999-2000), Zagreb, f. 63-93; Kristo Frashëri, *Trojet e shqiptarëve gjatë mesjetës së hershme*, "Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij", Tiranë, 2-5 korrik 1982, Tiranë, 1988, f. 48.

³ *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. X-XV)*, përgatitur për

në shumë njoftime tregimtare në kontekst me Betejën e Kosovës (1389),⁴ mund të thuhet se ajo i kishte rezistuar kohës, duke mbijetuar si koncept gjeografiko-historik, ndërsa hapësirën e saj qendrore duhet ta ketë përbërë, ashtu si në antikë, Kosova dhe krahina e Shkupit.⁵ Nga ana tjetër, Dardania, sipas studiueses Fanula Papazoglu, ishte njëra nga krahinat më pak të romanizuara të Gadishullit Ballkanik, kurse vendi dhe populli e kishin ruajtur emrin e tyre deri në antikën e vonë. Më tej ajo thekson se popullsia dardane e mbijetoi dyndjen e madhe të popujve barbarë dhe hyri në mesjetë me emrin e ri *arbër*.⁶ Së këtejmi, studiues të huaj me relevancë nga fusha e historisë, duke u mbështetur në burimet e shek. XIII-XIV, argumentojnë praninë e vazhdueshme të arbërve në Dardani,⁷ që për mendimin tonë ka një vazhdimësi të pandërprerë dardano-arbërore.

Të një rëndësie të veçantë për autoktoninë e arbërve në Dardani janë edhe rezultatet e arritura nga fusha e gjuhësisë. Në këtë kuadër po përmendim konkludimet e studiuesit P. Skok, i cili konstaton: “Shqiptarët e kanë ruajtur emrin e vjetër për vendbanimin e varoshit të Shkupit saktësisht sipas ligjeve të gjuhës së tyre. Emërtimi i tyre Shkup germë pas germe mbulohet me *Skupis*-in latino-dardan dhe assesi nuk përkon me format sllave ose turke”. Ky fakt i rëndësishëm, thekson më tej ai, e bënë të besueshme hipotezën e Joklit se qendra më e lashtë e shqiptarëve ka qenë Dardania.⁸ Një qëndrim të ngjashëm mban edhe studiuesi H. Bariq, i cili thotë: “Një shembull i sigurt i prejardhjes së *Sh*-së shqipe nga *S*, gjendet në Dardaninë antike dhe në emrin shqiptar të qytetit të Shkupit, ku *u*-ja dëshmon se shqiptarët e kanë marrë drejtpërdrejt trajtën antike

botim nga Koço Bozhori - Filip Liço, Tiranë, 1975, f. 20.

⁴ Jahja Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës*, Zagreb, 2008, f. 27, 61-93, 203. Kronisti i shek. XV-XVI nga Athina, Jeraku, logohet i madhi i patrikut të Kostandinopojës, në kronikën e tij ka shënuar se në Betejën e Kosovës (1389) morën pjesë edhe sundimtarë të Arbërisë nga “Dardania” (Jerakos, *Hronikon peri tes ton Turkon basileias*, në: C. Sathas, Bibliotheca Graeca, I, Venetüs, 1872, f. 247-248, Pëllumb Xhufi, “Shqiptarët e Jugut në Betejën e Fushë-Kosovës”, *Beteja e Kosovës 1389*, Përmbledhje studimesh, Tiranë, 2005, f. 110-111, shën. 18).

⁵ *Historia e popullit shqiptar*, I, Tiranë, 2002, f. 143.

⁶ Фанула Папазоглу, *Илирска и Дарданска кралевина*, in: “Илири и Албанци”, САНУ (одеље историјских наука), XXXIX/10, Београд, 1988, f. 169.

⁷ Noel Malcolm, *Kosova - Një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë, 2001, f. 55-58.

⁸ Петар Скок, *Из топономастике јужне Србије – Скопска котлина*, in: “Гласник Скопског научног друштва”, одеље друштвених наука, XV-XVI/9-10, Скопје, 1936, f. 103.

Skupi”.⁹ Rrjedhimisht një pjesë e studiuesve ndan mendimin se emri i shqiptarëve rrjedh nga kryeqendra e Dardanisë antike - Skupi (Shkupi).¹⁰

Për shkak të mungesës së burimeve historike, historia politike e Dardanisë midis viteve 600-1018 është pak e njohur. Nuk dihet asgjë mbi grupet e vogla sllave, të cilat depërtuan në mesjetën e hershme, ndërsa dihet pak mbi përfshirjen e Dardanisë në kuadër të Perandorisë Bullgare në shek. IX e deri në fillim të shek. XI.¹¹ Në të vërtetë, në fillim të shek. XI, Perandoria Bizantine me në krye perandorin Vasilin II (976-1025), me qëllim që t’i rikthente territoret e humbura, i intensifikoi sulmet ushtarake kundër Bullgarisë. Për t’i bërë ballë rrezikut, perandori bullgar Samuili (976-1014) u përqendrua në rrethinat e qytetit të Shkupit. Vasili II, pasi iu afrua qytetit, mësoi se në anën tjetër të lumit Vardar, niveli me ujë i të cilit ishte rritur bukur shumë, fushonte ushtria e Samuilut. Megjithatë, Vasili II, përmes një vendi të cekët, kaloi Vardarin, ndërsa Samuili i çoroditur nga befasia ua mbathi këmbëve për mos u kthyer më. Bizantinët pushtuan kampin dhe tendën e tij, ndërsa nga Romani morën në dorëzim Shkupin (1004). Për këtë veprim, perandori bizantin e gradoi Romanin me titullin e *patricit* dhe të *prepozitit* dhe e dërgoi të qeverisë si strateg në Abidos.¹² Në vitet në vijim, konflikti bizantino-bullgar mori përmasa të gjera dhe u përmbyllë me fitoren e Perandorisë Bizantine, ndërsa Perandoria Bullgare pushoi së ekzistuari (1018).¹³ Pas rivendosjes së pushtetit bizantin (1018), territori i dikurshëm i Perandorisë Bullgare në pjesën më të madhe u nda në tema. Viset kufitare që më parë Bullgaria i kishte pushtuar nga Bizanti iu bashkëngjitën temave ekzistuese fqinje. Në viset e tjera të ish-

⁹ Henrik Bariq, “Disa mendime mbi vendbanimin e hershëm të shqiptarëve në Gadishullin Ballkanik”, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë, 1990, f. 69.

¹⁰ Зеф Мирдита, *Илири и етногенеза Албанаца*, in: “Из историје Албанаца”, Београд, 1969, f. 14.

¹¹ Oliver Jens Schmitt, *Kosova - Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë, 2012, f. 37.

¹² *Burime tregimtare*, f. 33; *Византиски извори за историју народа Југославије*, том III, обрадили: Јадран Ферлуга et al., Београд, 1966, f. 102 (në tekstin e mëtejme: *Византиски извори*, III). Mbreti i Hungarisë, Stefani (997-1038), lidhi aleancë me Vasilin II kundër bullgarëve dhe në vitin 1004 forcat hungareze u ndihmuan bizantinëve që Samuilin t’ia merrnin Shkupin (Димитри Оболенски, *Византијски комонвелт - Источна Европа 500-1453*, Скопје, 2002, f. 163). Romani ishte djali i perandorit bullgar Pjetër (927-969), ndërsa qeveritar të Shkupit e kishte emëruar Samuili (*Burime tregimtare*, f. 33; *Византиски извори*, III, f. 102).

¹³ Gjerësisht mbi konfliktin bizantino-bullgar shih: *Burime tregimtare*, 34-38; *Византиски извори*, III, f. 103-140.

Perandorisë Bullgare u krijuan këto tema: e Paristrionit, respektivisht e Paradanubit (midis Danubit të Poshtëm dhe malit Ballkan), me gjasë ajo e Sirmiumit (përgjatë rrjedhës së mesme të Danubit dhe rrjedhës së poshtme të Savës) dhe e “Bullgarisë” (e Shkupit - Q. D.). Kjo e fundit, që u ngrit në rang të lartë të *katepanatit*, kishte një shtrirje të gjerë. Në kuadër të saj bënin pjesë Maqedonia e sotme dhe, me gjasë, pjesërisht Maqedonia e Egjeut, viset perëndimore të Bullgarisë dhe viset në veri të Shkupit drejt Danubit dhe rrjedhës së poshtme të Savës,¹⁴ përfshirë këtu edhe Dardaninë.

Në krye të temës së Shkupit, respektivisht në cilësinë e *katepanit* dhe të *strategut autokrator*, Vasili II emëroi të parin e familjes feudale arbërore të Arianitëve, *patricin* David Arianitin.¹⁵ Konsiderohet se strategu autokrator ishte mëkëmbës i perandorit në një krahinë, pra në temën e Shkupit, e cila ndahej në krahina më të vogla me në krye strategët ose arkondët. Përndryshe, mendohet se David Arianiti kishte nën komandën e tij një sërë arkondësh, dukësh dhe strategësh në krahinat përreth qyteteve të rëndësishme të temës-katepanatit të Shkupit. Në ndonjë rast tjetër, meqë katepanati konsiderohet si rang më i lartë i organizimit administrativo-ushtarak se tema, pretendohet se në krye të tij qëndronte mëkëmbësi suprem (strategu autokrator), pastaj ishin temat në krye të të cilave mund të ishte i njëjti strateg autokrator, dhe si njësi më të ulëta ishin krahinat ose kështjellat me në krye “gjeneralët” (me gjasë strategët).¹⁶ Pavarësisht këtyre pikëpamjeve, strategu autokrator dhe katepani i temës bizantine “Bullgaria” me seli në Shkup, David Arianiti, qëndroi në këtë post deri në vdekjen e Vasilit II, më 1025. Në vitet që pasuan në krye të kësaj teme erdhën qeveritarë të tjerë bizantinë,¹⁷ ndërsa aty nga fundi i

¹⁴ *Историја српског народа*, I, Београд, 1994, f. 172; Димитри Обеленски, v. c., f. 211-212; Милан Бошкоски, *Македонија во XI и XII век - Надворешни упади на територијата на Македонија*, Скопје, 1997, f. 36. Emërtimi “Bullgari” për temën e Shkupit me gjasë u përdor në kontekst të traditës historike, meqë viset që bënin pjesë në kuadër të temës së “Bullgarisë” më parë i kishin takuar Perandorisë Bullgare.

¹⁵ *Burime tregimtare*, f. 34-35; *Византиски извори*, III, f. 125-127, shë. 165; *Historia e popullit shqiptar*, I, 297. Për përkatësinë arbërore të David Arianitit shih: Allain Ducellier, *L' Arbanon et le albanais au XI^esiècles*, in: “L'Albanie entre Byzance et Venise, X^e-XV^e siècles”, London, 1987, f. IV/359-360; Dhimitër Shuteriqi, “Arianitët - emri dhe gjenealogjia”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, I, Tiranë, 1989, f. 39-45, 79; *Historia e popullit shqiptar*, I, f. 220, 297.

¹⁶ *Византиски извори*, III, f. 125-127, shën. 165.

¹⁷ Gjatë viteve 1026-1028 në krye të temës së “Bullgarisë” (Shkupit - Q. D.) qëndroi Konstandin Diogjeni (1026-1028). Se kush e trashëgoi postin e qeveritarit të kësaj teme gjatë viteve 1028-1048, nuk ka të dhëna të sigurta. Në vitin 1048 në krye të saj ishte

shek. XI, respektivisht pas ardhjes në pushtet të perandorit bizantin Niqifori III Botaniat (1078-1081), dukë i Shkupit ishte Aleksandër Kabasilla (1079-1080),¹⁸ të cilin historiografia shqiptare e nxjerrë me përkatësi etnike arbërore.¹⁹ Deri kur Aleksandri qëndroi në këtë post nuk dihet. Po ashtu, nuk ka ndonjë informacion të sigurt për ndonjë qeveritar tjetër të Shkupit. Kjo ishte si rrjedhojë e dobësimit të rolit të temave në llogari të eprorëve ushtarakë me kompetenca më të gjera, varësisht nga krahina që ishte e rrezikuar nga armiqtë e jashtëm ose të brendshëm. Në rrethana të këtylla, tema e Shkupit u shndërrua në *dukat* të qytetit dhe të rrethinës së tij, me kompetenca më të vogla. Gjatë viteve 1098-1101 në postin e dukës së Shkupit qëndroi Niqifor Brieni. Nga ana tjetër, në dy decaeniet e fundit të shek. XI u rrit roli i temës së Durrësit si mbrojtëse nga rreziqet e jashtme, siç qe rreziku norman dhe ai i kryqtarëve. Madje, në decaenien e fundit të shek. XI, kur rashanët ndërmorën veprime luftarake kundër zotërimeve bizantine në Dardani, atyre iu kundërvu, jo duka i Shkupit, por duka i Durrësit, Gjon Komneni.²⁰

Pas rënies së shtetit bullgar (1018), kryepeshkopata e Ohrit u ndodh në kuadër të shtetit bizantin. Vasili II i dhuroi asaj tri diploma (më 1019, 1020 dhe 1020-1025), përmes së cilave u rregulluan: pozita juridike, territori kishtar dhe numri i dioqezave të saj. Në planin juridik, kryepeshkopata e Ohrit i ruajti privilegjet e vjetra dhe u njohë si kishë autoqefale, d.m.th. e pavarur nga patrikana e Kostandinopojës; territori i saj kishtar shtrihej nga Danubi deri në Thesali dhe nga mali Rilë i Bullgarisë deri në detin Adriatik; ajo numëronte tridhjetetë dioqeza.²¹

Vasil Monaku. Pas vdekjes së tij, më 1053, në krye të temës qëndroi Niqifor Proteoni (1053-1055). Për shkak të mungesës së burimeve të shkruara, nuk dihet cili ishte në krye të kësaj teme gjatë viteve 1056-1058. Konsiderohet se gjatë sundimit të perandorit bizantin Konstandin X Duka (1059-1067), në postin e *katepanit* të "Bullgarisë" (Shkupit - Q. D.) ishte Andronik Filokela. Emri i tij në këtë post përmendet në vitin 1066 dhe besohet se e ushtroi postin e tij deri në vitin 1067. Gjatë sundimit të perandorit bizantin, Romani IV Diogjen (1068-1071), detyrën e dukës të temës së përmendur e ushtroi Niqifor Karantini (1068-1072). Në vitet që pasuan në krye të temës qëndruan: Damian Dalaseni (1072), Mihail Saroniti (1072-1073) dhe Niqifor Brieni (1073-1075 ose deri më 1077?) (Милан Бошкоски, *Скопје и скопската област од VI до крајот на XIV век*, Скопје, 2009, f. 126-133).

¹⁸ *Византиски извори*, III, f. 186-187, shën. 45.

¹⁹ *Historia e popullit shqiptar*, I, f. 226; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit - Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, Tiranë, 2006, f. 42.

²⁰ Милан Бошкоски, *Скопје ...*, f. 133.

²¹ *Историја српског народа*, I, f. 176-177; Јован Белчовски, *Охридската архиепископија – Од основањето до паѓањето на Македонија под турска власт*,

Midis tyre, tri ndodheshin në Dardani: dioqeza e Shkupit, dioqeza e Prizrenit dhe dioqeza e Lypjanit.²²

Peshkopi i Shkupit, sipas diplomës së parë të Vasilit II për kryepeshkopatën e Ohrit, mund të kishte në Shkup, në Binçë, në Premor, në Lukovë dhe në Prinip 40 klerikë dhe 40 parikë. Në të kaluarën Shkupi kishte qenë seli e mitropolisë së Dardanisë, ndërsa Binça mendohet se ndodhej përgjatë rrjedhës së epërme të Moravës së Binçës, që nga Gjilani në jug, respektivisht fshati Budrigë, deri në burimet e saj. Premori konsiderohet se ishte krahinë përgjatë rrjedhës së poshtme të Moravës, nga fshati Budrigë deri në fushën e Bujanocit. Për Lukovën mendohet se ndodhej përgjatë luginës së Lukovës, në juglindje të Vranjës, ose ndoshta bëhet fjalë për fshatin Lukovë të Kratovës. Sa i përket Prinipit ekziston mendimi se ndoshta ai ndodhej në juglindje të Vranjës, në pjesën e Pçinjës. Nga sa më sipër, mund të thuhet se në jug dioqeza e Shkupit shtrihej në tërë fushën e Shkupit, respektivisht deri në vendin ku Vardari hyn në grykën e Taorit. Në veriperëndim ajo shtrihej deri në burimin e Moravës së Binçës, kurse në verilindje deri në Vranjë.²³

Sipas diplomës së sipërpërmendur, ipeshkvi (peshkopi) i Prizrenit mund të kishte në Prizren, në Hvosnë, në Leskosc dhe në Vret 15 klerikë dhe 15 parikë. Përderisa Prizreni është qytet i njohur i Kosovës, për Hvosnën mendohet se ishte territori midis Pejës dhe Deçanit. Për Leskoscin supozohet se ndodhej në rrjedhën e sipërme të lumit Klinë, mbi lokalitetin mesjetar Knincë, që ndodhej në grykëderdhjen e lumit të përmendur në Drin. Në të vërtetë, ajo është krahina e sotme e Dukagjinit, e cila shtrihet midis Pejës në veri dhe Prizrenit në jug. Afër vendit ku bashkohen Drini i Bardhë dhe i Zi ndodhet fshati Brut, ndërsa në verilindje lart përgjatë Drinit të Bardhë gjendet edhe fshati Vërmicë. Aty, diku në bjeshkët veriperëndimore të Koritnikut, do të duhej të kishte qenë vendi Vret. Mbi bazën e këtyre lokaliteteve mund të konkludohet se dioqeza e Prizrenit shtrihej nga Prizreni në jug deri në Pejë në veri, dhe nga vendi ku bashkohen Drini i Bardhë dhe i Zi në perëndim deri te

Скопје, 1997, f. 114-117; 140, 155, 160. Gjerësisht për diplomën e parë dhe e të dytë shih: *Одбрани текстови за историјата на македонскиот народ*, Скопје, 1959, f. 67-72 (në tekstin e mëtejme: *Одбрани текстови ...*, 1959); *Одбрани текстови за историјата на македонскиот народ*, I, Скопје, 1975, f. 70-74 (në tekstin e mëtejme: *Одбрани текстови ...*, 1975). Rreth dilemave që ekzistojnë për autenticitetin e tri diplomave të Vasilit II për kryepeshkopatën e Ohrit shih: Јован Белчовски, v. c., f. 118-120.

²² *Одбрани текстови ...*, 1959, f. 69; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 72.

²³ *По ату*; Јован Белчовски, v. c., f. 151-152.

lumenjtë Klinë dhe Sitnicë në lindje.²⁴ Në diplomën e parë të Vasilt II për kryepeshkopatën e Ohrit përmendet edhe peshkopi i Lypjanit, i cili në tërë dioqezën e tij mund të kishte 15 klerikë dhe 15 parikë. Selia e kësaj dioqeze ndodhej në Lypjan,²⁵ por në mungesë të të dhënave burimore, territori i saj nuk mund të përkufizohet. Rivendosja e pushtetit bizantin, pas vitit 1018, u shoqërua edhe me marrjen e masave në rrafshin fiskal, ku popullsia u detyrua të shlyente taksa të caktuara. Në situatë të vështirë, sipas një burimi bizantin, u ndodhën sidomos të varfrit, të cilët gjatë dy viteve të fundit të mbretërimit të Vasilit II dhe tri vite pas vdekjes së tij, nuk kishin paguar taksa, por në vitin 1028 detyroheshin t'i shlyen ato për pesë vjet në një vit. Madje perandori bizantin Romani VIII Argjir (1028-1034) e ndihmoi ekonomikisht kishën, duke rritur shfrytëzimin e të varfërve.²⁶ Në të vërtetë, popullsia ishte e detyruar të paguante tri lloje rentash feudale: në punë, në natyrë dhe në para. Rentat në punë dhe në natyrë shlyheshin si ndaj shtetit ashtu dhe ndaj zotërinjve feudalë. Popullsia u paguante taksa në natyrë edhe feudalëve kishtarë. Pas aprovimit të reformës fiskale në vitin 1040, taksat e rregullta shtetërore që deri në këtë vit ishin paguar në natyrë, filluan të paguheshin në para. Kjo e përkeqësoi gjendjen e fshatarëve, të cilët për të siguruar para duhej të shisnin një pjesë të madhe të prodhimeve në treg. Pra, duhej të shitej mall për të paguar taksat. Me këtë filloi një etapë e re e feudalizmit bizantin, ajo e zhvillimit të marrëdhënieve mall-para.²⁷

Kërkesa e pushtetit bizantin që taksat të paguheshin në para, shkaktoi shpërthimin e një kryengritjeje me përmasa ballkanike (1040).²⁸ Kryengritja shpërtheu në viset kufitare me Hungarinë, në rrethinën e Beogradit dhe në rrjedhën e poshtme të Moravës. Në krye të saj qëndronte Pjetër Deliani, i cili u shpall perandor në Beograd. Kryengritja u përhap shpejt në jug drejt "Nishit dhe Shkupit, metropol i Bullgarisë" (i Dardanisë - Q. D.), ku gjatë marshimit kryengritësit vranë pa mëshirë çdo bizantin që gjetën përpara. Nuk dihet nëse kryengritësit arritën të vendosnin pushtetin e tyre në Shkup. Pavarësisht kësaj, kryengritja u përhap në viset e tjera

²⁴ *Одбрани текстови ...*, 1959, f. 69; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 72; Јован Белчовски, v. c., f. 152-153.

²⁵ *Одбрани текстови ...*, 1959, f. 69; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 72; Јован Белчовски, v. c., f. 153.

²⁶ *Burime tregimtare*, f. 132.

²⁷ *Историја на македонскиот народ*, I, Скопје, 1969, f. 155-156.

²⁸ Георги Острогорски, *Историја на Византија*, Скопје, 1992, f. 390.

bizantine, por, përkundër disa sukseseve të përkohshme, ajo përfundoi me disfatë (1041).²⁹

Disa dekada më vonë, pas disfatës që Bizanti pësoi kundër selxhukëve në betejën e Mancikertës (1071), u rrit pakënaqësia ndaj qeverisjes së perandorit Mihaili VII Duka (1071-1078), në veçanti ndaj politikës fiskale të logotetit të tij, Niqiforit.³⁰ Kjo pakënaqësi rezultoi me shpërthimin e një kryengritjeje antibizantine (1072), e cila përfshiu një pjesë të konsiderueshme të Dardanisë. Kryengritja, me sa duket, shpërtheu në Shkup dhe përfshiu edhe regjionin e Prizrenit. Sipas kronistit bizantin Vazhduesi i Skilicës, paria e Shkupit i kërkoi ndihmë mbretit të Zetës, Mihailit. Mbreti iu përgjigj pozitivisht kërkesës, duke dërguar djalin e tij, princin Bodin me 300 veta. Ky i fundit mbërriti në Prizren, ku ishte mbledhur paria e Shkupit me në krye Gjergj Vojtehu. Kryengritësit e shpallën Bodinin perandor me emrin Pjetër. Në këtë kohë, Shkupi ndodhej nën pushtetin bizantin, duka i të cilit, Niqifor Karantini, në krye të ushtrisë së tij, marshoi drejt Prizrenit. Mirëpo, për shkak se kishte lejuar që në krahinën e tij të shpërthente kryengritje, perandori Mihaili VII Duka e shkarkoi Niqiforin nga posti që mbante. Pavarësisht kësaj, forcat e bashkuara bizantine që i kishte mbledhur Niqifori, dhe ushtria e dukës të ri të Shkupit, Damian Dalaseni, u drejtuan kundër kryengritësve. Mirëpo, në betejën e përgjakshme të Prizrenit, kryengritësit shënuan fitore ndaj ushtrive bizantine, kurse Damiani dhe shumë komandantë bizantinë u zunë robër.³¹

Pas fitores së arritur, ushtria kryengritëse u nda në dy pjesë. Njëra me në krye vetë Bodinin iu drejtua Nishit, kurse tjetra, me në krye Petrilon, Ohrit. Ndërkohë, Shkupi ishte marrë nga kryengritësit dhe qeverisej nga Gjergj Vojtehu. Në rrethana të këtilla, perandori Mihaili VII Duka dërgoi një ushtri të madhe kundër kryengritësve, me në krye Mihail Saronitin. Përballë rrezikut, Gjergj Vojtehu ia dorëzoi qytetin Saronitit, por më pas, në një moment të përshtatshëm, i bëri thirrje Bodinit që të

²⁹ Gjerësisht për kryengritjen e Pjetër Delianit shih: *Burime tregimtare*, f. 39-41, 56-58; *Византиски извори*, III, f. 141-156, 220-224; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 79-82; *Документи за борбата на македонскиот народ за самостојност и за национална држава*, I, редакција: Христо Андонов-Полјански et. al., Скопје, 1981, f. 97-102 (në tekstin e mëtejme: *Документи*); *Историја на македонскиот народ*, I, 1969, f. 159-165; *Историја на македонскиот народ*, I, Скопје, 2000, f. 429-438; Бранко Панов, *Средновековна Македонија*, III, Скопје, 1985, f. 51-60.

³⁰ *Историја српског народа*, I, f. 190.

³¹ *Burime tregimtare*, f. 64; *Византиски извори*, III, f. 177-181; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 85-86; *Документи*, f. 106-107.

vinte e ta kthente Shkupin sërish në duart e kryengritësve. Saroniti ra në gjurmë të këtyre planeve dhe në krye të një ushtrie të madhe u nis kundër Bodinit, të cilin e takoi te vendi Taonion (sot Paun në Fushë-Kosovë). Ushtria e Bodinit pësoi disfatë, kurse vetë ai dhe ndërkohë dhe Gjergj Vojtehu u zunë robër. Ky i fundit vdiq nga torturat gjatë rrugës për në Kostandinopojë, kurse Bodini u burgos në një kishë të kryeqytetit bizantin. Pas njëfarë kohe, sundimtari i Zetës, Mihaili, arriti ta çlironte Bodinin nga robëria. Në rrethana të këtilla, në vitin 1073, Bizanti i dha fund kryengritjes së Gjergj Vojtehut,³² duke konsoliduar pushtetin e tij në Dardani.

Gjatë shek. XI, pushteti bizantin i temës së Shkupit, ku bënte pjesë edhe Dardania, duhej t'u bënte ballë edhe rreziqeve që i vinin nga jashtë. Në këtë kuadër, burimet e shkruara japin njoftime mbi sulmet e peçenegëve (me origjinë turke), të cilët, gjatë shek. XI, në pjesën më të madhe ishin vendosur në anën e majtë të rrjedhës së poshtme të Danubit, kurse një pjesë e vogël ende ndodhej në stepat e Rusisë Jugore.³³ Në një njoftim të kronistit bizantin Gjon Skilica thuhet se peçenegët depërtuan në "Bullgari dhe vranë e zunë robër shumë popuj dhe strategë" (1026). Më tej, sipas kronistit në fjalë, atyre iu kundërvu arkondi i Sirmiumit, Konstandin Diogjeni, të cilin, për t'i drejtuar më mirë sulmet ndaj peçenegëve, perandori bizantin Konstandini VIII (1025-1028) e vu në postin e dukës të temës së "Bullgarisë" (Shkupit - Q. D.). Pas plaçkitjes që bënë, peçenegët u tërhoqën në veri, ndërsa si rrjedhojë e disa aksioneve ushtarake të dukës së Shkupit, qenë detyruar të ktheheshin përtej Danubit.³⁴ Nga informacionet e prezantuara shihet se ata kishin kryer plaçkitje në temën e "Bullgarisë", gjë që nuk e përjashton mundësinë që nga sulmi i tyre të ketë pësuar edhe Dardania, si pjesë përbërëse e kësaj teme. Në vitin 1034, sipas një njoftimi të shkurtër të Gjon Skilicës, peçenegët, pasi kaluan Danubin, e plaçkitën tërë Mezinë deri në Selanik.³⁵ Nga ky përshkrim mund të supozohet se peçenegët gjatë marshimit drejt Selanikut duhet të kenë ndjekur rrugën nëpër fushëgropën e Shkupit dhe përgjatë luginës së Vardarit, që nënkupton se kjo fushëgropë nuk ishte kursyer nga ky depërtim.

³² *Burime tregimtare*, f. 65; *Византиски извори*, III, f. 182-185; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 86-87.

³³ Милан Бошкоски, *Скопје ...*, f. 141.

³⁴ *Византиски извори*, III, f. 162-163.

³⁵ *По аty*, f. 163.

Sulmi tjetër i peçenegëve ndaj temës bizantine të Shkupit u ndërmor në vitin 1048. Për t'i bërë ballë rrezikut që angazhuar duka i kësaj teme Vasil Monaku, i cili, pas fitores ndaj peçenegëve, zuri robër një pjesë të madhe prej tyre dhe e vendosi në territorin midis Serdikës, Nishit dhe Ovçe Poles.³⁶ A pati reperkusione Dardania nga ky sulm i peçenegëve, është vështirë të supozohet.

Pas disa vitesh, më 1064, në anën e majtë të rrjedhës së poshtme të Danubit, ndodhej fisi turk i uzëve. Sipas kronistit bizantin të shek. XI, Mihail Ataliati, uzët, gjatë atij viti, e kapërcyen Danubin dhe u shkaktuan disfatë “bullgarëve” dhe “ushtarëve të tjerë” që përpqeshin të pengonin depërtimin e tyre. Nga atje (Bulgaria Veriore - Q. D.) “një njësit shumë i madh i tyre depërtoi nëpër tërë Ilirikun, deri në Selanik dhe në vetë Heladën dhe duke bërë plaçkitje të tmerrshme mbledhi plaçkë të madhe”.³⁷ Vazhduesi i Skilicës vë në pah se uzët pasi kaluan Danubin, u pozicionuan në rrjedhën e tij të djathtë, kurse një njësit i tyre i madh u veçua dhe depërtoi “deri në Selanik dhe në vetë Heladën”. Edhe autori tjetër bizantin, Gjon Zonara, thotë se uzët depërtuan deri “në Heladë”.³⁸ Siç mund të shihet të tre autorët bizantinë janë të njëzëri për sa i përket depërtimit të njërës pjese të uzëve që u shkëput dhe depërtoi deri në “Heladë”. Ky depërtim ka gjasa të jetë bërë përmes luginave të lumenjve Moravë dhe Vardar. Ky supozim mund të gjejë mbështetje në një të dhënë burimore, sipas së cilës, një karvan prej 12 000 pelegrinësh të varrit të Jezu Krishtit, duke kaluar Moravën ratisën plaçkitës që quheshin uzë.³⁹ Rrjedhimisht, një pjesë e Dardanisë, respektivisht Shkupi dhe rrethina e tij, duke u ndodhur në pozicionin nëpër të cilin depërtuan uzët, duhet të ketë pësuar nga ekspedita e tyre plaçkitëse.

Në vitin 1080, Perandoria Bizantine sërish u ndesh me invadimin e peçenegëve në Dardani. Sipas njoftimeve të Niçifor Brienit, Aleks Komneni, u nis nga Kostandinopoja për të vëzhguar krahinat perëndimore. Në Adrianopojë u informua se peçenegët përgatiteshin të depërtounin në “krahina kufitare bullgare”. Kur mbërriti në Plovdiv, mësoi se peçenegët kishin depërtuar dhe po shkretinin vendbanimet midis Nishit dhe Shkupit, për ç'arsye marshoi kundër tyre. Mirëpo, kur Aleks Komneni mbërriti në Sofje, peçenegët, meqë kishin marrë vesh për ekspeditën, u tërhoqën në

³⁶ *Po aty*, f. 163-164.

³⁷ *Po aty*, f. 227, 230-231.

³⁸ *Po aty*, f. 255.

³⁹ Милан Бошкоски, *Скопје ...*, f. 143.

shpejtësi (drejt veriut - Q. D.). Aleksi, pasi vuri rendin në viset përreth Plovdivit u kthye në Kostandinopojë, ku perandori Niqufor II Botaniati (1078-1081) i organizoi pritje solemne.⁴⁰

Gjatë ekspeditës së sipërpërmendur, peçenegët dëmtuan rëndë edhe manastirin e *Shën Gjergjit*, që ndodhej në kodrinën e Virgjinës, në perëndim të Shkupit. Manastiri për një kohë të gjatë mbeti i rrënuar, deri në vitin 1093, kur u rindërtua nga perandori bizantin Aleksi I Komneni (1081-1118), me rastin e qëndrimit në Shkup, i cili ia vërtetoi atij pronat e vjetra dhe i dha të reja.⁴¹ Pa kaluar shumë kohë nga largimi i rrezikut peçeneg, Perandoria Bizantine u ndesh me një rrezik tjetër që i erdhi nga perëndimi, nga normanët e Italisë Jugore. Pasi aty nga viti 1081 pushtuan Durrësin,⁴² normanët ndërmorën edhe ekspedita të tjera pushtuese ndaj zotërimeve bizantine në trevat arbërore.⁴³

Në këtë kuadër, aty nga fundi i vitit 1082 dhe fillimi i vitit 1083, një pjesë e normanëve nën komandën e Pjetrit të Alifës pushtoi Dy Pollogjet, ndërsa pjesa tjetër nën komandën e Puntosit Shkupin. Përkundër faktit se Ana Komnena që hedh dritë për pushtimin e Shkupit nuk thotë gjë për ndonjë rezistencë eventuale, pushteti norman nuk pati jetë të qetë aty. Perandoria Bizantine arriti të fuste përçarjen në mesin e udhëheqësve ushtarakë normanë. Kështu Puntosi, Ronaldi dhe Vilhelmi, të tërhequr me siguri pas premtimesh të ndryshme, përgatitën komplot kundër Boemundit dhe planifikonin të hynin në shërbim të Bizantit. Mirëpo, Boemundi i zbuloi shumë shpejt komplotistët. Ronaldi dhe Vilhelmi u arrestuan, ndërsa Puntosi, meqë në kohë kishte marrë vesh se komploti ishte zbuluar, ia doli të ikte te perandori bizantin.⁴⁴ Rasti i Puntosit provon se pushteti norman në këtë qytet mori fund, por kur ndodhi kjo është vështirë të precizohet. Mund të supozohet që Shkupi të ketë mbetur nën zotërimin e normanëve deri në fund të tërheqjes së tyre nga Ballkani më 1085.⁴⁵ Sido që të jetë në këtë pjesë të Dardanisë u rivendos pushteti bizantin. Pasi u çlirua nga rreziku norman, Aleksi I Komneni u detyrua të hynte në luftë kundër peçenegëve, të cilët kishin depërtuar thuajse deri në muret e Kostandinopojës (1090). Emiri i Smirnës, Çaha, njëri nga emirët selxhukë,

⁴⁰ *Византиски извори*, III, f. 247-248; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 88.

⁴¹ Милан Бошкоски, *Македонија ...*, f. 57, 183, shën. 460.

⁴² *Burime tregimtare*, f. 99; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 216, 226.

⁴³ Gjerësisht mbi ekspeditat pushtuese të normanëve në trevat e tjera arbërore shih: *Burime tregimtare*, f. 100-103.

⁴⁴ *Po aty*, f. 103; *Византиски извори*, III, f. 380-381; *Одбрани текстови ...*, 1975, f. 88-89.

⁴⁵ *Историја на македонскиот народ*, I, 2000, f. 449; Бранко Панов, v. c., f. 51-60.

që pas vdekjes së Sylejmanit (1085) e kishin ndarë trashëgiminë e tij, lidhi aleancë me peçenegët dhe me flotën e tij iu drejtua kryeqytetit bizantin. E rrethuar nga toka dhe deti, Kostandinopoja gjatë dimrit të viteve 1090-1091 shpëtoi me sakrificë të mëdha. Kësaj radhe, Aleksi I, kërkoi ndihmën e kumanëve (me origjinë turke), të cilët mbërritën në pranverë të vitit 1091. Aty nga fundi i prillit të atij viti forcat e bashkuara bizantino-kumane u shkaktuan disfatë peçenegëve, ndërsa më pas flota bizantine korri fitore edhe ndaj emirit të Smirnës. Në këtë mënyrë Kostandinopoja shpëtoi nga rreziku, gjë që i mundësoi Aleksit I të merrej me një rrezik tjetër që i vinte nga zhupani i Rashës, Vukani (rreth viteve 1083-1114), i cili trazonte viset kufitare të Bizantit⁴⁶ në Dardani.

Me gjasë në gjysmën e dytë të vitit 1091, sipas kronistes bizantine, Ana Komnena, perandori Aleksi I Komneni, në krye të ushtrisë së tij, u nis nga Kostandinopoja dhe mbërriti në Filipopol (Plovdiv), prej nga planifikonte të vazhdonte marshimin drejt viseve që rrezikoheshin nga sulmet e rashanëve. Nga Filipopoli, Aleksi I i shkroi një letër dukës së Durrësit, Gjon Komnenit, të cilin e njoftonte se, meqë “barbarët” kishin depërtuar nëpër grykat e Perandorisë, ai ishte nisur për të siguruar kufijtë e shtetit bizantin. Më tej ai i shkruante dukës së përmendur që ta informonte për veprimet e Vukanit, respektivisht se a i respektonte ky i fundit marrëveshjet e arritura. Nëse do të mësonin diç të sigurt, theksonte Aleksi I, do të përgatiteshin më mirë kundër intrigave të Vukanit.⁴⁷ Siç mund të shihet, Perandoria Bizantine kishte arritur një marrëveshje paqësore me Vukanin për mos trazimin e territorit bizantin në Dardani, por marrëveshja nuk respektohej nga zhupani rashan.

Në një letër tjetër që, siç njofton Ana Komnena, Aleksi I ia drejtonte pushtetit të Durrësit, thuhej se meqë “Vukani sërish punonte kundër nesh” u nisëm nga Kostandinopoja me qëllim që të fortifikonim grykat që ndodheshin midis Bizantit dhe Dalmacisë (Rashës - Q. D.) dhe nga afër të njoftoheshim mbi veprimet e tij.⁴⁸ Më pas Aleksi I Komneni personalisht e kontrolli kufirin bizantin me Rashën në rrethinën e Zigonit [?]. Me këtë rast urdhëroi të ndërtoheshin kulla prej druri dhe prej tulle ose guri, duke matur personalisht largësinë midis tyre dhe madhësinë e tyre. Po ashtu, ai me sytë e tij pa se mos vallë kishte mbetur ndonjë vend i pambrojtur nëpër të cilin armiqtë shpesh kalonin, dhe urdhëroi që aty-këtu të priteshin drunjte e lartë. Pas këtyre masash të ndërmarra u kthye në

⁴⁶ Георги Острогорски, *v. c.*, f. 432-433.

⁴⁷ *Византиски извори*, III, f. 384-385.

⁴⁸ *Po aty*, f. 385.

Kostandinopojë.⁴⁹ Nga këto informacione del se kufiri bizantino-rashan ndodhej në krahinën e Zigonit, të cilën do ta zëmë në gojë më poshtë.

Masat e ndërmarra nga perandori bizantin nuk i dhanë rezultatet e pritura. Në vitin 1093, Vukani, në krye të njësiteve të tij, sipas Ana Komenës, depërtoi në territorin bizantin (në Dardani - Q. D.), dogji Lypjanin, ndërsa viset nëpër të cilat kaloi i plaçkiti. Ana Komnena më tej thekson se qyteza e Lypjanit dhe ajo e Zveçanit ndodheshin në “shpatet e Zigonit”.⁵⁰ Informacioni i Komnenës lidhur me këto qyteza është bërë objekt diskutimi nga studiues të caktuar, të cilët konsiderojnë se, meqë Lypjani dhe Zveçani janë larg njëri-tjetrit dhe nuk mund t’i takonin një masivi malor, kufiri midis Bizantit dhe Rashës duhet të ketë qenë rreth Goleshit, midis qytezave në fjalë.⁵¹ Ndryshe nga kjo pikëpamje, ne konsiderojmë se kufirin bizantino-rashan të masivi malor i Zigonit duhet kërkuar në pjesën më veriore të Dardanisë. Këtë supozim mund ta mbështesim në informacionet që i jep vetë kronistja bizantine. Ajo, midis tjerash, thekson se Aleksi I Komneni meqë nuk mundej ta ecte me kalë atë qafë mali në rrethinën e Zigonit, sepse e pamundësonte terreni “i rrëpirë” dhe “i rrëmihur” e i mbuluar me drurë, e eci atë në këmbë.

Siç mund të shihet, bëhet fjalë për terren të thyer malor, i cili mund të kërkohej në pjesën veriore dhe veriperëndimore të Dardanisë, ku ka një masiv malesh të larta, aty-këtu edhe me terren të thyer malor. Pra, kur përmendet Zigoni, respektivisht kufiri bizantino-rashan, mund të mendohet se ai ndodhej në masivin malor në veri dhe në veriperëndim të Zveçanit, respektivisht të Dardanisë, ku bëjnë pjesë malet e larta të Kopaunikut, të Rogoznës, të Moknës dhe më në perëndim Bjeshkët e Nemuna.⁵² Po ashtu “rrëmihja” në atë qafë mali të çon të mendosh se mos vallë bëhet fjalë për xeheroren e Kopaunikut, e cila është eksploatuar në periudhën romake,⁵³ ndërsa në shek. XIV në malin Kopaonik kishte një sërë xeherorësh.⁵⁴ Njëherësh, kronistja bizantine mund ta ketë vendosur Lypjanin gabimisht në Zigon. Tani le t’i kthehemi konfliktit bizantino-rashan të vitit 1093. Ana Komnena thekson se perandori bizantin Aleksi I Komnen kur mësoi për djegien e Lypjanit nga Vukani, vendosi të marshonte kundër tij me qëllim që të kthente nën pushtetin e tij këtë

⁴⁹ *Po aty*, f. 385-386.

⁵⁰ *Po aty*, f. 386.

⁵¹ *Po aty*, f. 385-386, shën. 32.

⁵² *Fjalor enciklopedik shqiptar*, II, Tiranë, 2008, f. 1294.

⁵³ *История сръбского народа*, I, f. 87.

⁵⁴ Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë, 1982, f. 115.

qytezë dhe viset e tjera të pushtuara. Në lajmin se perandori bizantin ishte nisur kundër tij, Vukani u tërhoq në Zveçan, që ndodhej në krahinën malore kufitare të Zigonit. Kur u informua se perandori Aleksi I kishte mbërritur në Shkup, Vukani propozoi të arrihej paqja. Njëherësh ai u shfajësua për shpërthimin e konfliktit dhe fajin ua hodhi qeveritarëve bizantinë se kishin qenë ata që kishin ndërmarrë sulme ndaj Rashës. Ai premtoi se do t'i dorëzonte Aleksit I Komnen pengje nga farefisi i tij, dhe se nuk do ndërmernte sulme ndaj viseve bizantine. Perandori bizantin e pranoi propozimin e sundimtarit rashan dhe, pasi la atje (në Dardani - Q. D.) njerëz të tij për të rindërtuar qytetet e shkatërruara dhe për të pranuar pengjet e premtuara, u kthye në Kostandinopojë. Mirëpo, Vukani shpejt hoqi dorë nga marrëveshja. Ai nuk i dorëzoi pengjet dhe filloi sulmet plaçkitëse ndaj territoreve bizantine. Në një situatë të këtillë, Aleksi I Komnen dërgoi kundër princit rashan dukën e Durrësit, Gjon Komnenin, i cili pasi kaloi lumin Sitnicë, respektivisht Ibër, i rrënoi gjerdhet në shpatet e Zigonit, përballë Zveçanit. Vukani u kundërpërgjigj me një sulm të befasishtëm, me ç'rast i shkaktoi disfatë të plotë Gjon Komnenit, ku pjesa më e madhe e ushtarëve bizantinë humbi jetën. Kështu sundimtari rashan duke mbledhur ushtarët e tij dhe duke kapërcyer Zigonin (nga veriu në drejtim të jugut - Q. D.) u ndal në Zveçan.⁵⁵ Ky njoftim i Ana Komnenës e përforcon edhe më shumë insistimin tonë se kufiri bizantino-rashan ndodhej në veri të Zveçanit, ndërsa Zigoni me gjasë ishte Kopaoniku.

Pas fitores ndaj Gjon Komnenit (1093), Vukani depërtoi thellë në zotërimet bizantine (në Dardani - Q. D.) dhe plaçkiti shumë vendbanime e qytete. Midis tyre ishte edhe rrethina e Shkupit, ndërsa Pollogu qe pushtuar (1093). Situata e krijuar e vuri në lëvizje Aleksin I Komnen, i cili marshoi kundër princit dinak, duke marrë Lypjanin. Kur princi në fjalë mësoi se Aleksi I ndodhej në këtë qytezë dhe nuk mund t'u bënte ballë ushtrive të mëdha bizantine propozoi të lidhej paqja, duke dhënë garanci se nuk do të organizonte më veprime armiqësore ndaj territorit bizantin. Perandori, duke dashur të evitonte konfliktet e brendshme në Bizant, e pranoi ofertën dhe lidhi paqe me sundimtarin rashan. Ky i fundit, si garanci për paqen e arritur, i dorëzoi perandorit dy nipat prej vëllai, Uroshin dhe Stefanin, dhe njëzet të tjerë.⁵⁶ Në këtë mënyrë, Vukani vihej në pozita vasale ndaj Perandorisë Bizantine, e cila rivendosi qetësinë në viset që pak më parë kishin qenë të trazuara.

⁵⁵ *Византиски извори*, III, f. 386-387.

⁵⁶ *По ату*, f. 388-389.

Qerim DALIPI

SUMMARY

DARDANIA BETWEEN BYZANTINE EMPIRE AND FOREIGN ATTACKS DURING THE 11TH CENTURY

At the beginning of the 11th century, the Byzantine Empire, managed to restore its administration in Skopje (1004), after the defeat it caused to the Bulgarian Empire. Subsequent to the fall of the Bulgarian state (1018), Byzantium restored its power in Dardania as well, which became part of the newly-formed theme of Skopje, with headquarters in this city. The head for a while was the arbanon patrician David Arianites. In the ecclesiastical domain, the Ohrid archdiocese maintained the internal autonomy, and Dardania dioceses, the one of Skopje, Prizren and Lipjan were also under its jurisdiction. On the other hand, in the economic domain, when Byzantium began to implement the monetary reform, Pjetër Deliani's uprising (1040-1041) occurred, which expanded in Skopje as well.

Many years later, another uprising (1072-1073) burst and was lead by chiefs of this city, with Gjergj Vojtehu as a leader. It also included other regions of Dardania, up to Prizren. Both uprisings were suppressed by Byzantine Empire. The latter one, in external plan, was endangered in Dardania, in different periods of the 11th century, from plunder attacks of various tribes: peçenege, uze and norman, which were repelled through great efforts. Another danger with greater repercussions came to Byzantine Empire from the zupan of Raska, who tried to conquer the whole Dardania. Relevant resources of time shed light on the fact that the Byzantine Empire reacted resolutely, forcing the zupan of Raska to retreat to his territories, beyond Zvečan, as a Byzantine vassal. Consequently, Dardania will still remain under the Byzantine administration.

Teuta SHALA-PELI

QYTETI I DRISHTI PARË NËN PRIZMIN E STUDIMEVE TË KOSTANDIN JIREÇEKUT

Në radhën e studiuesve të huaj, që kontribuan për historinë e popullit shqiptar, padyshim se studimet e Kostandin Jirečekut shquhen për vlerën dhe rëndësinë që kanë për trajtimin dhe ndriçimin e problemeve të shumta. Duke pasur një interesim dhe pasion të veçantë për historinë e popujve të Ballkanit, Kostandin Jireček arriti që në këtë kuadër të botoj edhe punime të shumta në të cilat trajtohej drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte, historia e popullit tonë. Për historinë e popullit shqiptar në përgjithësi, e veçanërisht për historinë mesjetare shqiptare rëndësi të veçantë paraqesin këto studime të Kostandin Jirečekut: *“Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters: historisch-geographische Studien”*¹; *“Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters: historisch-geographische Studien”*²; *“Das Gesetzbuch des Serbischen Caren Stephan Dušan”*³; *“Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters I,*

¹ Konstantin Jireček, *Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien während des Mittelalters: historisch-geographische Studien*, Prag: Verlag der Königlich Böhmisches Gesellschaft der Wissenschaften, 1879; (më tej: Jireček, *Die Handelsstrassen*); Константина Јуричека, “трговачки путеви и рудници србије и босне у средњем вијеку”, *Зборник Константина Јуричека I, Српска академија наука, посебна издања књига CCCXXVI, одељење друштвених наука, нова серија књига 33, београд 1959*, 205-301 (më tej: Јуричека, “трговачки путеви”).

² Konstantin Jireček, *Das christliche Element in der topographischen Nomenclatur der Balkanländer* (Sitzungsberichte der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien; Philosophisch-Historische Klasse, XI), Wien : Gerold, 1897 (më tej: Jireček, *Das christliche*).

³ Konstantin Jireček, “Das Gesetzbuch des Serbischen Caren Stephan Dušan”, *Archiv für slavische Philologie* XXII, Berlin 1900, 144-214 (më tej: Jireček, *Das Gesetzbuch*).

II,III”⁴; “Geschichte der Serben, I-II”⁵; “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”⁶; “Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien. Studien zur Kulturgeschichte des 13.-15. Jahrhunderts”⁷; “Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia I-II”(bashkautor)⁸; “Албанија у прошлости”⁹; “Die Lage und Vergangenheit der Stadt Durazzo in Albanien”¹⁰; “Valona im Mittelalter”¹¹; “Zwei Urkunden aus Nordalbanien”(bashkautor)¹²; “Mbi shqiptarët e trevave veriore dhe

⁴ Konstantin Jireček, *Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters I* (Denkschriften der Kaiserlichen adkademie der wissenschaften, Philosophisch-historische classe. XLVIII. bd., abh. III), Wien: Gerold, 1901 (më tej: Jireček, *Die Romanen I*); Konstantin Jireček, *Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters II* (Denkschriften der Kaiserlichen adkademie der wissenschaften, Philosophisch-historische classe. XLIX. bd., abh. I), Wien: Gerold, 1903 (më tej: Jireček, *Die Romanen II*); Konstantin Jireček, *Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters III* (Denkschriften der Kaiserlichen adkademie der wissenschaften, Philosophisch-historische classe. XLIX. bd., abh. II), Wien: Gerold, 1904 (më tej: Jireček, *Die Romanen III*).

⁵ Konstantin Jireček, *Geschichte der Serben*, Bd.1 Bis 1371 (Allgemeine Staatengeschichte. 1. abt.: Geschichte der Europäischen Staaten), Gotha: F.A. Perthes, 1911; (më tej: Jireček, *Geschichte I*); Konstantin Jireček, *Geschichte der Serben*, Bd.2, Bis 1371-1537 (Allgemeine Staatengeschichte. 1. abt.: Geschichte der Europäischen Staaten), Gotha: F.A. Perthes, 1918; (më tej: Jireček, *Geschichte II*); Константин Јиречек, *Историја Срба I-II* (прев. Ј. Радонић), Београд: Књижевница Геце Кона, 1922-1952 (më tej: Јиречек, *Историја I-II*); Konstantin Jireček, *Historia e serbëve I-II*, Tiranë: Shtëpia Botuese: “55”, 2010 (më tej: Jireček, *Historia I-II*).

⁶ Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, *Illyrisch-albanische Forschungen*. Bd. 1, Wien 1916, 94-124 (më tej: Jireček, “Skutari”).

⁷ Konstantin Jireček, *Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien. Studien zur Kulturgeschichte des 13.-15. Jahrhunderts* (Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, Philosophisch-historische Classe, 56,2-3,58,2), Wien: A. Hölder, 1914 (më tej: Jireček, *Staat und Gesellschaft*).

⁸ *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, college Tholloczy, L.-Jiriček, C. - Sufflay, E., vol. I-II, Vindobonae, 1913-1918 (më tej: Acta. Alb.).

⁹ Константин Јиречека, “Албанија у прошлости”, српски књижевни гласник, књига тридесет друга, београд, 1914, 683-691; Konstantin Jireček, Albanien in der Vergangenheit, *Illyrisch-albanische Forschungen*. Bd. 1, Wien 1916, 63-93.

¹⁰ Konstantin Jireček, “Die Lage und Vergangenheit der Stadt Durazzo in Albanien”, *Illyrisch-albanische Forschungen*. Bd. 1, Wien 1916, 152-167.

¹¹ Konstantin Jireček, “Valona im Mittelalter”, *Illyrisch-albanische Forschungen*. Bd. 1, Wien 1916, 168-187.

¹² Thalloczy, Ludwig; Jireček, Konstantin, - “Zwei Urkunden aus Nordalbanien”, *Illyrisch- albanische Forschungen*. Bd. 1, Wien 1916, 125-151.

verilindore në kontakte me popullsitë sllave”¹³, në të cilat studiuesi Kostandin Jireçeku, elaboroi segmente të rëndësishme nga historia e popullit shqiptar, e me theks të veçantë nga mesjeta shqiptare.

Në studimet e Kostandin Jireçekut, kemi hasë të dhëna të bollshme edhe për qytetin e Drishtit. Studiuesi Jiriček, duke shkruar për Shqipërinë gjatë mesjetës, konkretisht për veriun e Shqipërisë, në të njëjtën kohë na ofron të dhëna edhe për qytetin e Drishtit, duke përfshirë gjendjen ekonomike, shoqërore, fetare, politike, kulturore etj., të këtij qyteti gjatë mesjetës, të dhëna të cilat janë të mbështetura në burime arkivore.

Nga të dhënat për qytetin e Drishtit, të cilat i hasim në veprat e Konstandin Jiričekut po fillojmë me ato të cilat i referohen emrit të qytetit. Sipas Jiričekut, emri i këtij qyteti ishte *Drivasto*, në latinisht *Drivastum*, ndërsa *Drieuesto* në hartën e fratit Mauro në shek. XV në Venedik.¹⁴ Në serbishten e vjetër e hasim në trajtat: *Drivost*, *Drevost*,¹⁵ në shqip ky vend sot quhet *Drishti*,¹⁶ pohon studiuesi Jiriček. Drishti sipas Jiričekut gjendet mbi një kodër afro 150 metra të lartë, e cila nga veriu dhe perëndimi kufizohet prej luginës së thellë të Kirit, ndërsa nga jugu prej honit të Prronit të Drishtit.¹⁷ Në kuadër të këtyre të dhënave Jiričeku shkruan edhe për Kalanë e Drishtit, për të cilën thotë se ndodhet 10 kilometra në lindje të Shkodrës, dhe se origjinën e ka ndoshta nga koha romake ose koha ilire.¹⁸

Në studimet e Jiričekut nuk mungojnë të dhënat as për monedhat e qytetit të Drishtit, sipas tij qyteti i Drishtit priste monedha bakri shumë primitive, mbi këto monedha shihet një qytet me kulla dhe me një portë mbi të cilën është gdhendur një zambak, kurse mbishkrimi *civitas Drivasti* mezi lexohet.¹⁹ Lidhur me monedhat e qytetit të Drishtit në librin “Historia e serbëve”, pjesa e dytë, botuar më 1918, hasim këto të dhëna: “Monedha të bronzta ka në komunat e Ulqinit, Tivarit, Svaç dhe *Drivasto* (me muret

¹³ Konstantin Jireček, “Mbi shqiptarët e trevave veriore dhe verilindore në kontakte me popullsitë sllave”, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë: ASHRPSSH, Instituti i Historisë, 1990, 133-135.

¹⁴ Jiriček, “Skutari”, 111.

¹⁵ константин Јиречека, “Романски називи места и земљишта”, *Зборник Константина Јуричека II, Српска академија наука, посебна издања књига CCCLVI, одељење друштвених наука, нова серија књига 42, београд 1962*, 68.

¹⁶ Jiriček, “Skutari”, 111.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Po aty*, 114.

dhe kullat),²⁰ ndërsa në pjesën e dytë të librit “Historia e serbëve”, botuar më 1952 në gjuhën serbe, hasim këto të dhëna: “në paratë primitive nga *Drivosta*, mund të shihni një qytet me kulla të vogla dhe një portë qyteti, ku pikturohet një zambak, me mbishkrimin shpesh të paqartë “*civitas Drivatr*” ose “*Driavsti*”.”²¹

Konstandin Jeriçeku, në studimet e tij gjithashtu vë në pah edhe sfidat përballë të cilave kaloi qyteti i Drishtit gjatë ekzistencës së tij si qytet. Duke filluar që nga shekulli IX, Jeriçeku vë në dukje se me krijimin e Themës së Durrësit, edhe Drishti u përfshi brenda territorit të kësaj Theme, ku kufiri i saj kalonte përmes liqenit të Shkodrës gjer në Drisht.²² Pastaj, studiuesi në fjalë pohon se qyteti i Drishtit i ka përkitur për një kohë të gjatë bizantinëve, derisa e pushtoi Nemanja.²³ Gjithashtu, ai përmend edhe sulmin e tatarëve të cilët në vitin 1242, e shkatërruan qytetin e Drishtit.²⁴ Sipas Jeriçekut, Helena gruaja e Uroshit I, restauroi Drishtin bashkë me qytetet tjera, të cilat ishin shkatërruar gjatë invazionit të tatarëve.²⁵ Në studimet e Jeriçekut për më tepër është trajtuar edhe periudha e sundimit venedikas në Shqipëri ku janë përfshirë dhe trajtuar segmente të rëndësishme nga periudha në fjalë të cilat lidhen edhe me qytetin e Drishtit duke filluar që nga vendosja e sundimit venedikas në Drisht dhe qytete të tjera në Shqipëri për të vazhduar deri të rënia e tyre në sundimin osman.

Të dhënat të cilat i hasim në veprat e Jeriçekut gjatë kohës sa qyteti i Drishtit ishte nën sundimin venedikas i referohen përpjekjeve të Balshajve, konkretisht Balshës III, për çlirimin e këtij qyteti nga venedikasit. Lidhur më këtë, Jeriçek përqendrohet tek viti 1418 kur Balsha III arriti që ta merr kështjellën e Drishtit.²⁶ Po ashtu, studiuesi Jeriçek, flet edhe për pushtimin e Drishtit nga trupat e despotit serb, Stefan Lazareviqit, në vitin 1421, duke potencuar se për venedikasit ishte një humbje mjaft e rëndë, “sepse pa Drishtin qyteti i Shkodrës vlente pak”

²⁰ Jireček, *Geschichte II*, 67.

²¹ Јиречек, *Историја II*, 193.

²² Jireček, *Die Handelstrassen*, 15; ²²костантин Јиречека, “византинска тема дирахион”, *Зборник Константина Јиричека I, Српска академија наука, посебна издања књига CCCXXVI, одељење друштвених наука, нова серија књига 33, београд 1959*, 224.

²³ Jireček, “Skutari”, 111.

²⁴ Jireček, *Geschichte I*, 308; *Acta Alb.*, I/175: “*Hoc ipse tempore, sicut Thomas archidiaconus Spalatensis narrat Suacium et Drivastum a Tataris deletum est*”.

²⁵ Jireček, *Geschichte I*, 318.

²⁶ Jireček, “Skutari”, 112.

(*quia sine Drivasto civitas Scutari parum valet*).²⁷ Gjithashtu, Konstandin Jriçeku flet edhe për Stefan Maramonte si pretendent për të trashëguar zotërimet e Balshajve.²⁸

Konstandin Jriçek në shkrimet e tij na ofron të dhëna edhe për rënien e Drishtit nën sundimin osman, duke vënë në dukje se: "...në vitin 1478 gjatë rrethimit të fundit të Shkodrës, turqit e pushtuan Drishtin dhe në kampin turk sollën 300 drishtjanë..."²⁹, "...Sulltan Mehmeti II u preu kokën të gjithëve para mureve të Shkodrës me qëllim që t'u kallte frikën venedikasve dhe t'i detyronte të dorëzoheshin..."³⁰. Në veprat e tij Konstandin Jriçeku shkruan edhe për zhvillimin ekonomik të Drishtit. Ai përmend sidomos doganat e këtij qyteti, duke theksuar se për nevoja dhe interesa të bashkisë së Drishtit doganat në disa raste edhe janë shitur për një kohë të caktuar tek persona të caktuar.³¹ Nga fusha e religjionit, në shkrimet e Jriçekut, e veçanërisht në përmbledhjet dokumentare "*Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustranti*", në dy vëllime (bashkautorë: L. Tholloczy - C. Jeriček- E. Sufflay), hasim informata të rëndësishme për organizimin kishtar në qytetin e Drishtit gjatë mesjetës, sidomos për priftërinjtë drishtas, kishat, katedralet, si dhe juridiksionin kishtar të këtij qyteti karshi Raguzës, Tivarit dhe Kotorrit. Në dokumentet në fjalë, në qytetin e Drishtit përmendet kisha katedrale e Shën Marisë,³² kisha e Shën Gjergjit,³³ si dhe ajo e Shën Françeskut,³⁴ e gjithashtu përmendet dhe manastiri i Shën Benediktit (1356).³⁵

Sa i përket juridiksionit kishtar të Drishtit hasim këto të dhëna: në shek. XI, përkatësisht në një dokument të vitit 1089, me vendim të papës Klementit III, krahinat veriore shqiptare si të Ulqinit, të Shasit, të Shkodrës, të Drishtit dhe të Pultit kalojnë nën argjipeshkvinë Diokle-Tivar.³⁶ Në vitin 1120, shohim se Papa Kaliksi II, ja konfirmon

²⁷ *Po aty*.

²⁸ Jriçek, *Historia II*, 198.

²⁹ Jriçek, *Die Romanen I*, 6.

³⁰ Jriçek, "Skutari", 114.

³¹ *Acta Alb.*, II/729: "...Cum quidam nomine Bonushomo Zaon de Drivasto fidelis noster exposuerit narrando multa que fecit in honorem et conservatiōnem status: nostril dominii in illis partibus Albanie, quod comunitas Drivasti..."

³² *Acta. Alb.*, II/ 99: "...sancte Marie de Driuasto..."; dok. 252: "...ecclesie sancte Marie de Driuasto"; dok. 615: "...sancta Maria de Driuasto; dok. 656: "...sancta Maria de Driuasto ..."; dok. 745: "...sancta Maria, de Driuasto..." ; Jriçek, "Skutari", 112.

³³ *Acta. Alb.*, II/ 745: "...sancto Gorgy de Driuasto..."

³⁴ *Acta. Alb.*, II/ 47; Jriçek, "Skutari", 112.

³⁵ *Acta. Alb.*, II/119: "...S. Benedicti Drivastensis..."

³⁶ *Acta. Alb.*, I/ 68.

kryepeshkvit të Raguzës juridiksionin e dikurshëm, ku së bashku me Tivarin, Shkodrën, përmendet edhe Drishtit.³⁷ Edhe Papa Anastasi IV, në një dokument që mban datën 24 dhjetor 1153, kërkoi nga ipeshkvijtë e Drishtit që të njohin parësinë e Raguzës.³⁸ Edhe Papa Aleksandri III në vitin 1167, iu përsërit krerëve të ipeshkvijve të Dioklesë, mes të cilëve edhe të Drishtit, porosinë e paraardhësve të tij, që ata t'i bindeshin eprorit të tyre, argjipeshkvit të Raguzës.³⁹ Po ashtu, edhe Papa Urbani III, në vitin 1187 konfirmon juridiksionin e dikurshëm të kishës së Raguzës, me këtë rast, ai i konfirmon argjipeshkvit të Raguzës famullitë që i përkasin tagrit të kishës së besuar atij, duke përmendur edhe Drishtin.⁴⁰ Të njëjtin konfirmim e bën edhe Papa Klementi III, në vitin 1188, ku përsëri në mesin e ipeshkvijve që i përkasin argjipeshkvit të Raguzës, përmend edhe atë të Drishtit.⁴¹ Një gjendje e këtillë vazhdoi deri në fund të shek. XII, gjegjësisht në vitin 1199 kur kisha e Romës vendos që ipeshkvijtë e Shqipërisë së Veriut, si: Shkodra, Drishti dhe Pulti, të kalojnë nën Tivarin.⁴² Edhe pas këtij vendimi dokumentet e botuara në kuadër të "*Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*", tregojnë se edhe pas vitit 1199, Ragusa herë pas here bëri përpjekje që të ketë ndikim tek ipeshkvijtë e sipërpërmendura, në rastin tonë edhe në ipeshkvinë e Drishtit.⁴³

Ndërsa, për ipeshkvijtë e Drishtit hasim këto të dhëna: në vitin 1166, si ipeshkëv i Drishtit përmendet Martini, i cili mori pjesë në shugurimin e kishës katedrale të Shën Trifonit të Kotorrit në vitin 1166.⁴⁴ Përsëri në vitin 1167, hasim në të dhëna për Martinin ipeshkvin e Drishtit, fjala është për bulën e Papës Aleksandri III, drejtuar ipeshkvijve të Shqipërisë, ku jep urdhër të rreptë që ipeshkvijtë e Shqipërisë, në mesin e të cilëve përmendet edhe ipeshkvi i Drishtit, t'i binden Tribunit, argjipeshkvit të Raguzës.⁴⁵ Po këtë vit, ai së bashku me ipeshkvijtë e ipeshkvive të Shqipërisë së Veriut, merr pjesë në koncilin kishtar të Tivarit, vendimet e të cilit i nënshkroi edhe Pjetri II, ipeshkv i Drishtit.⁴⁶

³⁷ Acta. Alb., I/82; 83.

³⁸ Acta. Alb., I/88.

³⁹ Acta. Alb., I/95.

⁴⁰ Acta. Alb., I/103.

⁴¹ Acta. Alb., I/104.

⁴² Acta. Alb., I/116.

⁴³ Acta. Alb., I/118: "*Johanes episcopus Drivastensis...*"; Acta Alb., I/162; 171.

⁴⁴ Acta. Alb., I/93: "... Martino Drivastensi...".

⁴⁵ Acta. Alb., I/95.

⁴⁶ Acta. Alb., I shën. n.2, dok.

Në një dokument që mban datën 14 prill 1199, ndeshim në të dhëna ku thuhet se ipeshkvi i Drishtit në ndërtesën e argjipeshkvit të Raguzës e përforcon bindjen ndaj Raguzës.⁴⁷

Krahas të dhënave të cilat i trajtuam deri më tani, shkrimet e Jeriçekut ngërthejnë në vete të dhëna me rëndësi edhe për familjet feudale nga Drishti. Të dhëna me interes për familjet drishtase në studimet e Konstantin Jireček kemi hasur në: *“Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters I, II, III”*, e në veçanti vëllimi III. Në studimin në fjalë Jeriçeku thekson se janë të përfshirë 2 293 emra, të cilat i referohen familjeve ose personave të ndryshëm. Nga këta emra, 13 i atribuohen Drishtit.⁴⁸ Krahas këtij vëllimi, shkrimet e Jeriçekut përmbajnë në vete të dhëna me rëndësi për këto familje feudale nga Drishti: *Barbabanicha, Bariloch, Belli, Berivoj, Calageorgii, Columba (Palombo), Jonima, Leporibus, Palombo, Precalo, Preda, Predimir, Scapuder, Spani, Summa, Ungri (Hungarus, Ungaro), Zogu*, për të cilat ndanë mendimin se në Drisht gjatë shek. XIV-XV, disa emra të familjeve pjesërisht i ndeshim në latinisht, si: *Palombo* ose *Colomba, de Leporibus, Barbabanicha, Summa, Bello*, krahas disa të tjerëve që ndeshen në trajtën shqip, si: *Bariloth, Precalo, Scapuder*,⁴⁹ ose grekë: *Calageorgii, Spano*.⁵⁰

Për familjen Spani thotë se ishin familje fisnike nga Drishti.⁵¹ Nga kjo familje, ai na ofron të dhëna për Pjetër Spanin për të cilin thotë se përmendet në regjistrat e arkivave të Raguzës 1430-1456 dhe se ishte shqiptar katolik.⁵² Ai gjithashtu shton se Pjetër Spani më 1441, ka depozituar në Dubrovnik pasurinë e tij.⁵³ Po ashtu, Jeriçeku përmend edhe djemtë e Pjetër Spanit: Bozhidarín, Hërvojën dhe Aleks Spanin, për këtë të

⁴⁷ Acta. Alb., I/118.

⁴⁸ Jireček, *Die Romanen III*, 1; I njëjti, *Bel, Belli, Bello*, 6; *Berivoy*, 7; *Cossil*, 20; *Leporibus, Lieouor, Leuere, Lepporo*, 35; *Palombo*, 47; *Precalo*, 52; *Preda*, 52; *Scapuder*, 58; *Span, Ispanus, Yspanus*, 61; *Sporo*, 62, *Summa*, 63; *Ungaro*, 66; *Zogi*, 70.

⁴⁸ Acta. Alb., I/50; 63; 68; 77; 81; 82; 83; 84; 87; 88; 91; 98;

⁴⁹ Jireček, *Die Romanen I*, 97-98.

⁵⁰ Jireček, “Skutari”, 113.

⁵¹ Jireček, *Die Romanen II*, 61: “*Span, latinisht auch Yspanus, Adelsfamilie von Drivasto*”; Константи́на Јури́чека, “Породична имена и надимци из староримских градова Далмације у годинама 1000-1500”, *Зборник Константина Јуричека II, Српска академија наука, посебна издања књига CCCLVI, одељење друштвених наука*, нова серија књига 42, београд 1962, 340 (мë teј: Јури́чека, “Породична имена”)

⁵² Jireček, “Skutari”, 113.

⁵³ Jireček, *Staat und Gesellschaft im mittelalterlichen Serbien*, 45.

fundit thotë se në vitin 1454 ishte vojvodë i qytetit të Novobërdës.⁵⁴ Nga kjo familje ndeshim të dhëna edhe për Nikolla Spanin⁵⁵ dhe Pjetër Spanin.⁵⁶

Kur jemi tek familjet feudale drishtase, me mjaft interes janë të dhënat që na ofron studiuesi Jeriçek për familjen Schipudari, emrin e të cilës ky studiues e lidh me gjurmën e parë të emrit shqiptar. Në përmbledhjen e burimeve “*Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustranti*”, vol. II, në treguesin e emrave e hasim këtë të dhënë për mbiemrin *Schipudar*: *Schipudar*, *Schepuder*, *Schapadur*, *Scapuder*, cf. alb. šk'ip: tar, pra mbiemrin *Schipudar*, studiuesi Jeriçek e krahason me fjalën shqipe shqiptar.⁵⁷ Ndërsa, në veprën “*Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters III*”, Jeriçeku thotë se në Drisht ka pasur një familje emrin e së cilës e përmend në këto trajta: *Schepuder 1368*, *Skapuder 1370*, *Schipudar*, *Schibudar 1372*, *Schipudar 1383*, *1392*, *Schapudar 1402*.⁵⁸ Nga kjo familje në shkrimet e Jeriçekut përmendet edhe Pjetër Schipudari (Petrus Schepuder)⁵⁹, Andrea Schipudari, vajza e tij Vlasna.⁶⁰ Një familje tjetër e njohur drishtase e cila përmendet në shkrimet e Jeriçekut është edhe familja *Ungri* (*Hungarus*, *Ungaro*). Nga kjo familje studiuesi në fjalë na ofron të dhëna për një nga pjesëtarët e kësaj familjeje Pal Ungri (*Paulus Ungaro 1403*), i cili dëshmohet të ketë qenë fisnik i Drishtit.⁶¹ Jeriçeku në studimet e tij na ofron të dhëna edhe

⁵⁴ Po aty; Jireček, “Skutari”, 113.

⁵⁵ Jireček, *Die Romanen III*, 43; Acta. Alb., II, 291: “*Span (Spano, Yspanus) Nicolaus, nobilis Drivastensis († ante 1401, eius memoria)*”; Acta. Alb., II /701: “*Vidua Nicolai Span Drivaslensis filio suo presbytero Petro bona sua Drivasti posita donat*”.

⁵⁶ Acta. Alb., II, 291: “*Petrus, nobilis Drivastensis*”; “*Petrus, filius Nicolai presbyter etiam Ragusi vivens*; Acta. Alb., II/615, n.2: “*Die 22. martii 1400 „dompnus Petrus Span*”; Acta. Alb., II /681: “*Petro Yspano presbytero de dicto loco Driuesti*”; Acta Alb., II/692: “*... dompnus Petrus Yspanus...*”; Acta. Alb., II /674: “*Petrus Spano fidelis noster de Drivasto*”.

⁵⁷ Acta. Alb., II, 289: “*Schipudar: Schipudar, Schepuder, Schapadur, Scapuder, cf. alb. šk'ip: tar*”.

⁵⁸ Jireček, *Die Romanen III*, 43.

⁵⁹ Acta. Alb., II/252: “*Presbyter Petrus Schepuder canonicus Driustensis...*”; Acta. Alb., II/269: “*...presbitero Petro Schipudar de Drivasto...*”; Acta. Alb., II/385: “*presbytero Petro Schipudar de Drivasto*”, Acta. Alb., II/482: “*... presbytero Petro Schipudar de Drivasto...*” Acta. Alb., II/ 545, shën. nr. 1: “*...don Petrus Andrea... alias Petrus Schipudar...*”; Acta. Alb., II/ 615: “*Testamentum presbiteri Petri Schipudar de Drivasto*”.

⁶⁰ Jireček, *Die Romanen III*, 43; Acta. Alb., II/ 701: “*Ego Vlasna, filia condam Andree Schapudar...*”.

⁶¹ Jireček, *Die Romanen III*, 66: “*Nobiles von Drivasto: Paulus 1403*”; Acta. Alb.,

për këto familje fisnike nga Drishti si për familjen Jonima, përkatësisht për Vladislav Jonimën, i cilit në vitet 1303-1319 përmendet si, *comes maritimae Albaniae*,⁶² familjen Lepore, për të cilën studiuesi në fjalë thotë se në librat e Dubrovnikut zakonisht e hasim në këto trajta: *Lieuor* 1370, 1372, *Leuere* 1369, *Lepporo* 1402,⁶³ po ashtu këtë emër e ndeshim edhe në këto trajta: *Leporibus*,⁶⁴ *Lievor*.⁶⁵ Nga kjo familje mund të veçojmë Domenik Lepore,⁶⁶ Pjetër Lepore,⁶⁷ pastaj kemi familjen *Bariloch*,⁶⁸ si dhe familjen Zogu. Për mbiemrin e kësaj familje të cilën siç e cekëm edhe më lartë, Jeriçek thotë së është karakteristik shqiptar. Mbiemrin në fjalë, në studimet e Jeriçeku e ndeshim jo vetëm në trajtën *Zochi*,⁶⁹ por edhe në atë Zogu.⁷⁰ Nga kjo familje të dhëna hasim për Nikollë Zogun.⁷¹ Krahaskëtyrë kemi ndeshur edhe familje tjera drishtase si atë Serpentinin, "...*Dominçe Serpentinide Driuasto...*",⁷² *Capudalbus*,⁷³ *Bonushomo*,⁷⁴ *Columba (Palombo)*,⁷⁵ nga kjo familje përmenden Dhimitër Palombo dhe Martin Polombo,⁷⁶ pastaj familjet: *Suini*,⁷⁷ *Cossili*,⁷⁸ *Belli(Bellus)*,⁷⁹

II/728: "...*Paulus Ungaro nobilis de Drivasto...*"

⁶² Acta. Alb., I/547, n. 2; Acta. Alb., I / 650.

⁶³ *Јуричека*, "Породична имена", 296.

⁶⁴ Jireček, *Die Romanen I*, 98, I njëjti, Constantin Jireček, *Die Romanen*, III, f.35: "*De Leporibus, Nobiles von Drivasto im XIV-XV*".

⁶⁵ Në një dokument të vitit 1372, mbiemrin Lepore e ndeshim në trajtën *Lievor*: Acta Alb., II/303: "*Marinçe de Modroculo, Mençe frater eius de Antibari, Johannes Lievor de Drivasto, Basse Tichoevich de Antibaro*".

⁶⁶ Acta. Alb., II/ 257.

⁶⁷ Acta. Alb., II/ 745 (shënimet). Acta Alb., II/ 745.

⁶⁸ Acta. Alb., II/377; I njëjti, 267, Mbiemrin Bariloch(Bariloku) e krahason me fjalën shqipe bari: Bariloch = alb, bari "pastor", lak, "laqueus".

⁶⁹ Acta. Alb., II/ 745, shën. 2.

⁷⁰ Në trajtën Zogi, këtë mbiemër e ndeshim tek: Constantin Jireček, *Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters.III*, Wien 1904, 70: "Zogi. 1) Dompno Petro Lepporo f. q. Nic. Çoghi de civitate Drivasti.

⁷¹ Acta. Alb., II/ 745: "...*dompnus Petrus Lepore filius Nicholay Zoch de Driuasto...*".

⁷² Acta. Alb., II/269.

⁷³ Acta. Alb., II/109: "...*Marinus de Driuasto, filius Dimitri Capudalbus...*".

⁷⁴ Acta. Alb., II/729: "...*Bonushomo Zaon de Drivasto...*".

⁷⁵ Constantin Jireček, *Die Romanen in den städten Dalmatiens während des mittelalters.III*, Wien 1904, f. 47: "...*Palombo, auch Columba, Familie von Drivasto im XIV...*"; *Јуричека*, "Породична имена", 316.

⁷⁶ Acta Alb., II/376: "...*Demetrius Palombo...*"; "... *presbytero Martino Palombo de Driuasto ...*".

⁷⁷ Acta Alb., II/472: "...*Petrum de Suinis de Drivasto*".

⁷⁸ Acta Alb., II/254: "*Ego quidem presbyter Michael filius condam Alexii Cossil de Driuasto...*"; *Јуричека*, "Породична имена", 270.

Berivoy,⁸⁰ *Precalo*,⁸¹ *Preda (Predimir)*,⁸² *Summa*.⁸³ Nga analiza e veprave të Jeriçekut të bëra në kuadër të këtij punimi, rezulton se studimet e tij paraqesin ndihmesë të madhe për të krijuar një tablo për qytetin e Drishit gjatë mesjetës, ngase në vete ato ngërthejnë segmente të rëndësishme që ndërlihdën me historinë e këtij qyteti duke filluar nga rrafshi ekonomik, politik, historik, shoqëror, për të vazhduar me të dhënat për familjet fisnike të këtij qyteti, rolin diplomatik, kulturor të këtyre familjeve jo vetëm brenda Drishtit por edhe më gjerë.

Këndvështrimi i Jeriçekut për mesjetën shqiptare ndikon që ne sot të disponojmë një literaturë dhe disa vëllime dokumentare të cilat na ofrojnë ndihmesë të madhe në studimin dhe trajtimin e problemeve të shumta nga periudha në fjalë.

⁷⁹ Jireček, *Die Romanen I*, 25: “*Bellus. In Drivasto: Paulus filius Georgii Belli 1365-1369. Paulus Bel de Driuasto, 1372*”; Jireček, *Die Romanen III*, 6: “*Bel, Belli, Bello, Nobiles von Drivasto im XIV-XV. Jahrhundert*”; Acta. Alb., II/262: “*...Ego quidem Paulus confiteor Georgii Belli de Driuasto confiteor...*”; Јиричека, “Породична имена”, 244.

⁸⁰ Jireček, *Die Romanen II*, 7: “*Berivoy. Dompnus Nicola B. De Driuast 1350*”; Јиричека, “Породична имена”, 246.

⁸¹ Jireček, *Die Romanen III*, 52: “*Precalo. In Drivasto Ser Bellus P. 1442*”.

⁸² Jireček, *Die Romanen II*, 45: “*...In Drivasto: presbiter Margaricius notarius 1372; olim domnus Margaricus Preda 1408...*”; Jireček, *Die Romanen II*, 74: “*Predimir. Andreas Predimir de Driuasto 1381*”; Jireček, *Die Romanen III*, 52: “*Preda. In Drivasto diaconus Petrus f. Duche Preda, olim domnus Margaricus P., barbanus eius 1408... Andreas Predimir de Driuasto 1381...*”; Acta. Alb., II/376: “*Nos quidem Andréas Predimiri et Demetrius Palombo, ambo de Driuasto Confitemur...*”.

⁸³ Jireček, *Die Romanen III*, 63: “*Nobiles von Drivasto im XIV-XV*”; Јиричека, “Породична имена”, 345.

Teuta SHALA- PELI

SUMMARY

THE FIRST CITY OF DRISHTIT AT THE PRIZM OF STUDIES OF COSTANTIN JIRECEK'S

In the line of foreign scholars who have contributed to the history of our people, Constantin Jirecek's studies are obviously of value and importance for the treatment and illumination of numerous problems. Having a special interest and passion for the history of Balkan peoples, Kostandin Jirecek managed to publish in this framework many works in which the history of our people was directly or indirectly treated. Researcher Kostandin Jirecek, apparently from his writings, showed an interest in the history of our people at the beginning of his career. In the context of dealing with the history of the Albanian people, Kostandin Jirecek has shown great interest especially for medieval Albanian history.

In Costandin Jirecek's studies, we have extensive information for the town of Drishti. Researcher Jirecek, writing about Albania during the Middle Ages, concretely for the North of Albania, at the same time provides us with information about the town of Drishti, including the economic, social, religious, political, cultural, etc, of this city during the Middle Ages, information that are backed up in archive resources. Jirecek perspective for the Albanian Medieval affects us today to have a literature and some documentary volumes that provide us with great help in studying and addressing the many problems from the period in question.

Nuri BEXHETI - Selver ISLAMAJ

**SITUATA POLITIKE DHE PËRSHTYPJET E TË HUAJVE MBI
VILAJETIN E KOSOVËS GJATË VITIEVE 1880-ta**

Duke pasur parasysh rrethanat politike të kohës në vilajetin e Kosovës pas kryengritjes së madhe shqiptare të Lidhjes së Prizrenit, shihet se asgjë nuk ka qenë e sigurt brenda kësaj hapësire. Nuk të garantohej jeta nëse ishte një personazh i fuqishëm i politikës së përditshme të kohës, ashtu siç ishte Ali Pashë Gusia, i cili e humbi jetën për shkaqe të konflikteve politike me “aleatë” të tij. Në anën tjetër na pasqyrojnë tregimet dhe udhërrëfyesit e kohës gjendjen dhe rrethanat se si jetonin njerëzit dhe në cilin nivel ishte gjendja e sigurisë. Ata jepnin përshtypjet e tyre në detaj, që na mundëson të shohim edhe jetën sociale të kohës.

Tregimet dhe raportet e konsujve të huaj adresojnë çështje të ndryshme, të cilat përfshijnë politikën ditore, jetën sociale, tregtinë, sigurinë në vend, e shumë aspekte tjera të cilat ishin me rëndësi për qeveritë e tyre, dhe që mund të na lehtësojnë qasjen më të detajuar të aspekteve të ndryshme të vilajeteve shqipfolëse, për të kuptuar edhe më mirë gjendjen politike dhe jetën sociale.

Situata politike e viteve 1880 në vilajetin e Kosovës

Pak kohë para Kongresit të Berlinit, u krijua Lidhja e Prizrenit¹, e cila bëri fushatë për një pandryshueshmëri të kufijve të katër vilajeteve me shumicë shqiptare. Këtu u takuan për herë të parë shumë individë shqiptarë dhe disa sllavofolës dhe turkofolës që protestuan kundër koncesioneve territoriale ndaj Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Këtu, u

¹ Elsie, Robert, *Historical Dictionary of Kosovo*, (Scarecrow Press 2010), f. 105.

miratua një program katërpikësh, i cili deklaroi se do ta njeh autoritetin e Sulltanit dhe në anën tjetër kërkoi kthimin e territoreve.² Në vjeshtë të të njëjtit vit, u miratua një program i ri, i cili kërkonte autonomi të gjerë dhe gjithashtu bashkimin e trojeve shqiptare të udhëhequr nga institucionet shqipfolëse.³ Sipas historiografisë serbe, gjatë Kongresit të Berlinit, popullata serbe e vilajetit të Kosovës ka dërguar një peticion me kërkesën që vilajeti i Kosovës t'i bashkëngjitet Serbisë.⁴ Delegacioni shqiptar në anën tjetër dëshironte arritjen e bashkimit të të gjitha viseve shqiptare, edhe pse një autonomi e gjerë do të ishte garancia më e mirë për mbijetesën shtetërore.⁵

Duke qenë se Lidhja e pa se Qeveria osmane nuk ishte në gjendje për të mbrojtur kufijtë, ajo filloi një nismë dhe u përpoq t'i siguroj kufijtë dhe për të rimarrë gjithashtu disa pjesë të territoreve të humbura. Në njërën anë kishte pjesërisht sukses kundër Malit të Zi, por në anën tjetër, me këtë veprim, humbën Tivarin. Lidhja mori përsipër administrimin e vilajetit duke shfrytëzuar mungesën e shtetit dhe duke forcuar strukturat e saj. Deri në vitin 1881 Lidhja ishte në gjendje të mbroj territorin e vilajetit të Kosovës, deri kur Sulltani ndërmori një kundërmasë për të shkatërruar Lidhjen e Prizrenit. Më 23 prill, Prizreni u mor nga trupat osmane dhe deri më 8 maj 1881, u arrit edhe pushtimi dhe dorëzimi i Gjakovës.⁶ Rezistenca ishte thyer dhe shumë udhëheqës u dëbuan në Anadoll. Vala e refugjatëve të viteve 1877-78 ka nxitur konfliktet ndëretnike, duke pasur parasysh numrin e madh të njerëzve që vinin nga Nishi, Bosnje e Hercegovina, Mali i Zi dhe Piroti, të cilët gjetën strehim në vilajetin e Kosovës. Veçantia e vilajetit të Kosovës ishte se ky rajon gjendej në vijën e parë të frontit, i cili

² Chiari, Bernhard dhe Keßelring, Agilolf, *Wegweiser zur Geschichte des Kosovo*, (München/Wien, 2006), f. 46.

³ Hösch, Edgar, *Geschichte der Balkanländer*, (München, 1988), f. 157.

⁴ Delegatët e rajoneve të Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe Vushtrisë kanë dërguar një peticion tek pjesëmarrësit e Kongresit me 272 nënshkrime, të vulosura me 126 vula e qarqeve dhe manastireve. Më 28 qershor, serbët e Gjilanit, Shkupit dhe Tetovës i dërgojnë carit të Rusisë dhe delegatit britanik në Berlin një ankesë me rreth 400 nënshkrime. Vojvodiq, M., Zivojinoviq, D. R., A. Mitrovic dhe Samardziq, R., *Srbija 1878, Documents*, (Beograd 1978), f. 322-327, si dhe "Sava Decanac u nis për në Berlin me një peticion të nënshkruar nga rreth 2 000 përfaqësues kombëtarë - priftërinj, shërbëtorë, tregtarë dhe mjeshtër. Ai ia ka paraqitur peticionin kancelarit gjerman Princit Otto von Bismarck, i cili premtoi se pjesëmarrësit e Kongresit do të informohen në lidhje me kërkesat", *Srbija 1878*, 503; *Istoriya srpskog naroda*, VI/1, f. 291.

⁵ Vickers, Miranda, *Between Serbs and Albanians. A History of Kosovo*, (London, 1998), f. 45.

⁶ Hösch, f. 157.

duhej të përballonte cunamin e refugjatëve potencialisht të rrezikshëm, që u regjistruan në këtë provincë. Edhe pse ky rajon ka pasur përvojë me refugjatë, ky rast ishte krejtësisht ndryshe, duke pasur parasysh se rreth 50 000 shqiptarë⁷ përmbytën vilajetin e Kosovës, një rajon i cili atëkohë kishte mbi 800 000 banorë.⁸ Gjatë luftës së viteve 1877-78, autoritetet e vendit janë përpjekur për të zgjidhur përkohësisht çështjen e muhaxhirëve, duke pasur parasysh se trojet e tyre ishin në një distancë e cila arrihet në këmbë. Përfundimisht dukuria e komuniteteve të refugjatëve, të cilët i kanë ngritur kampet jo larg tokave të tyre, shfaqti probleme të ndryshme për zyrtarët e ngarkuar me kujdesin për ta. Si i tillë, vendimi fatal për të mbajtur shumicën e refugjatëve të Nishit relativisht afër në rajonin e Drenicës dhe të Gjakovës ndezi një stuhinë të konfliktit.⁹

Pasi situata u qetësua pjesërisht dhe Qeveria osmane ka marrë nën kontroll situatën, ajo fillon në vitet e para të 1880 ndërtimin dhe krijimin e institucioneve kulturore për të fituar popullatën në anën e saj. Megjithatë, këto nuk u mbajtën të hapura gjatë, për shkak të frikës se mund të krijohej një nacionalizëm shqiptar.¹⁰ Rreth fundit të vitit 1884, shpërtheu një kryengritje e re nga ana e popullsisë shqiptare e cila ishte e koncentruar në rajonin e Prizrenit. Arsyeja për këtë kryengritje gjendej tek një rritje e tatimit në vilajetin e Kosovës, e cila filloi zbatimin e saj në Prizren.¹¹ Pas këtyre trazirave, rajoni i Prizrenit ishte klasifikuar si i pasigurt dhe organet administrative nuk dilnin jashtë qytetit të sigurt për të mbledhur taksat. Edhe udhëtarët ishin të vetëdijshëm për ndërmarrjet e pasigurta të tyre në këtë rajon. Në raste konkrete edhe mytesarifi i Prizrenit nuk mund të

⁷ Prifti, Kristaq, *Popullsia e Kosovës 1831-1912*, (Tiranë, 2014), bëhet e ditur se Nishi më 1873, kishte 92 024 banorë shqiptarë që ai e përshkruan në f. 379, si dhe largimi i rreth 100 000 shqiptarëve myslimanë nga trevat e aneksuara prej Serbisë, nga të cilët rreth 65 000 u vendosën në Kosovë, f. 405-407.

⁸ Konsulli Lippich përshkruan përbërjen e popullsisë së provincës së Kosovës, duke dhënë detaje të strukturës etnike dhe numrit të banorëve. Sipas këtij raporti sanxhaku i Prishtinës kishte 221 900 banorë, i Prizrenit 295 500 banorë, i Nishit 156 800 banorë, i Shkupit 227 500 banorë, i Novi Pazarit 136 100 banorë dhe i Pirotit 75 700 banorë. Ndërsa, Kosova si provincë kishte rreth 1 113 500 banorë prej të cilëve ishin 404 000 me përkatësi shqiptare. Nga Bevölkerungstabelle der Kossovoprovinz (sq: *Tabela e popullsisë së Provincës së Kosovës*) nga Haus-, Hof- und Staatsarchiv, Politisches Archiv XXXVIII, Karton 219, Raport nga Prizreni, më 17 mars 1877, f. 2-3.

⁹ Blumi, Isa, *Ottoman Refugees, 1878-1939: Migration in a Post-Imperial World*, (A&C Black, 2013), f. 45.

¹⁰ Chiari, f. 49.

¹¹ Vickers, f. 49.

marrë asnjë përgjegjësi për aventuristët, të cilët kishin dëshirë për të udhëtuar në këto kohë të rrezikshme, duke iu thënë,

*“Nuk kam fuqi për t’ju ndaluar juve të shkoni, dhe asnjë pretendim për të kërkuar një favor nga ju, por megjithatë, unë do ta merrja si një mirësi shumë të madhe në qoftë se ju do të hiqnit dorë nga ky udhëtim. Thjesht në këtë moment rreziku për të shkuar atje është i madh, dhe nëse ndodh diçka, faji do të bjerë mbi mua”.*¹²

Nga këto rrethana të përshkruara bëhet e qartë se situata në këtë kohë nuk mund të konsiderohet e sigurt, por më tepër duhej konsideruar e paparashikueshme.

Roli i Qeverisë osmane në vilajetin e Kosovës dhe intervenimi në konflikte lokale

Duke u nisur nga gjendja e Qeverisë osmane dhe autoriteteve lokale në rajon, jepet në shikimin e parë një përshtypje shumë konfuze. Autoritetet osmane ishin të interesuar që të mbanin situatën e qetë në rajon duke mos bërë përpjekje të mëdha në luftimin e parregullsive të vogla, siç ishin sulmet e herëpashershme nga malet dhe viset e izoluar. Pra, prezenca e ulët ushtarake në këto vilajete ishte e lidhur edhe me sigurinë e ushtarëve dhe personelit administrativë dhe ua kufizonte mundësitë për të ndërhyrë në konflikte lokale. Kjo mosndërhyrje në punët lokale duhej se shtyhej për aq kohë deri kur rritej rreziku i një përshkallëzimit të konfliktit dhe kështu që ndërhyrja u bënte e pashmangshme për të ndaluar konfliktin. Roli i qeverisë si ndërmjetësues nuk ishte vetëm në raste armiqësie apo probleme të tjera lokale, por edhe në raste të tilla si çështja e demarkacionit të viteve të para pas Kongresit të Berlinit. Pra, kishte njerëz të cilëve iu është marrë gjithë pasuria dhe tokat e tyre dhe që duhej të sistemoheshin diku në vilajetin e Kosovës në mënyrë që të garantohej besnikëria e tyre edhe më tej ndaj Perandorisë Osmane. Megjithatë, qeveria në Kostandinopojë u përpoq që ta kalojë përgjegjësinë tek autoritetet lokale që mos të merret me konfliktet kufitare. Rasti kur delegacioni nga Shkodra shkoi tek mytesarifi i Pejës për të përshkruar problemet e pranishme dhe për të kërkuar mbështetje nga ai, mund të

¹² “I have no power to forbid you going, and no claim to ask a favour from you, nevertheless, I should take it as a very great kindness if you would give up this journey. Just the present moment the risk of going there is enormous, and if anything happens, the blame will fall on me”, Brown, H. A., *A Winter in Albania*, (London, 1888), f. 251.

shihet si një nga shumë raste të tilla. Mytesarifi i Pejës nuk ishte aspak i kënaqur me këtë kërkesë dhe e udhëzoi delegacionin për në Prishtinë, ku ata duhej të kërkonin audiencë me valiun e Kosovës. Megjithatë, edhe ky i dyti nuk dukej se donte të angazhohet me entuziazëm të madh ndaj lutjes së delegacionit të Shkodrës.

*“Ky i fundit, nga cili delegacioni dëshironte një rekomandim ose ndonjë përkrahje tjetër tek Sulltani në Kostandinopojë, duke u munduar për të ndryshuar mendjen e kërkuësve që të heqin dorë nga qëllimet e tyre, sqaronte se Sulltani për momentin është duke u marrë me shqetësime të ndryshme serioze, dhe i këshilloi ata, që t’i shprehin shqetësimet e tyre personalisht pranë Pashait, i cili është i ngarkuar me rregullimin e çështjes kufitare; ky është i mirënjohuri Mustafa Asim Pasha në Shkodër”.*¹³

Delegacioni pranoi argumentet e valiut të Prishtinës pasi ishte i bindur se Sulltani ballafaqohej tërësisht me sfida më shumë të komplikuar se rastin që e prezantonte delegacioni. Për këtë arsye ata vizituan Pashain e propozuar të Shkodrës, ku mund t’i adresonin problemet e tyre, sepse këto kërkesa mund të përpunohen vetëm nga ai. Për shkak të situatës së pasigurt të procesit të përcaktimit të kufijve apo demarkacionit, u bënë shpallje në Pejë dhe Gjakovë për shërbimin ushtarak, por pa përcaktuar numrin e rekrutëve. Çdo shtëpi ishte e detyruar për të vënë në dispozicion njerëzit e tyre që ishin të aftë për luftë. Si arsye për këtë veprim është dhënë lufta kundër Greqisë, por në fakt kjo duhej ta tërhiqte vëmendjen nga vështirësitë me Malin e Zi. Ky grumbullim ishte më shumë i natyrës ushtarake se sa i një bashibozukut normal, i cili klasifikohet si kategori e një ushtrie të fshehtë. Si rezultat, bëhet më e qartë ideja e pasigurisë së rajonit kufitar me Malin e Zi. Megjithatë, ky veprim duket se është kryer për një arsye të thjeshtë, meqenëse frika ishte prezentë që nga ana e Malit të Zi do të ndërmerrej ndonjë sulm kundër Pejës dhe Gjakovës, pasi u zhvilluan takime të rregullta në mes të

¹³ “Dieser letztere, von welchem die deputation eine Recommendation oder sonstige Befürwortung bei dem Großherrs in Constantinopel begehrte, bemühte sich die Bittsteller von ihrem Vorhaben abzubringen, indem er ihnen vorstellte, daß im gegenwärtigen Momente der Sultan anderweitig ohnehin von schweren Sorgen in Anspruch genommen sei, er rieth ihnen aber, ihre Anliegen bei dem Pascha persönlich vorzubringen, welcher ja eben mit der Regelung der delimitationsfrage beauftragt sei; dieß sei bekanntlich Mustapha Assim Pascha in Scutari”, *HHSIA*, PA XXXVIII, Karton 260, Prizren, më 5 prill 1886, f. 2-3.

Qeverisë së Malit të Zi dhe drejtuesve të fiseve shqiptare të Malësisë dhe të rajonit të Pejës dhe Gjakovës.¹⁴

Edhe pse nuk janë mbajtur shumë takime, pavarësisht nga kjo, ndikimi i Qeverisë malazeze nuk duhet të injorohet, pasi kjo mund të mbizotërojë lehtësisht te fiset afër kufirit. Sidomos tek fisi Gruda dhe Klementi është forcuar ndikimi, pasi që këto fise ishin në afërsi të kufirit. Mjetet që i shërbenin Malit të Zi ishin të natyrës së thjeshtë, pasi ky shtet kishte në dispozicion fonde dhe armatim kryesisht për fiset malore, në mënyrë që ata të zgjeronin pushtetin e tyre mbi fiset tjera të rajonit. Vëmendja kryesore drejtohej gjithnjë e më shumë tek fiset krishtere duke krijuar një dioqezë për katolikët shqiptarë në Malin e Zi, nga që, nëpërmjet koncesioneve të ndryshme për fiset krishtere bëheshin përpjekje të shumëllojshme për të siguruar një bashkëpunim me ta.¹⁵ Për habi të qeverisjes lokale u arrit një shkallë e panjohur, deri më parë në rekrutimin e vullnetarëve, të cilët kishin gatishmëri të madhe për të mbrojtur territorin dhe pasurinë e tyre. Përveç kësaj, autoritetet lokale kishin një ndikim të fortë në vendimet e rëndësishme politike dhe sociale, një gjë që mund të shihej edhe në procesin e demarkacionit ndërmjet Malit të Zi dhe vilajetit të Kosovës. Mytesarif i Pejës, Ali Pasha, arriti një armëpushim me rreth 50 bajraqe nga Gjakova, Peja, Reka dhe Malësia. Ai dha garanci se nga pala osmane nuk do të ketë shkelje të marrëveshjes së armëpushimit deri në datën e caktuar.¹⁶

Por edhe në rastet të gjakmarrjes dhe përplasjeve të brendshme qeveria lokale nuk rrinte indiferente kur ishte i kërcënuar ndikimi i saj. Në rast se bëhej i qartë rreziku i përhapjes së konfliktit në rajonet tjera, ndërhynin sipas nevojës edhe me forcë ushtarake. Pra, konfrontimi në Malësi është përcjellë me vëmendje të madhe, deri në çastin kur qeveria lokale merr vendim për të përfunduar konfliktin në fjalë, pasi këtu nuk kishte më asnjë kontroll të duhur. Për të frenuar këtë gjakmarrje, Qeveria është e detyruar të shpallë një paqësim të përgjithshëm, duke deklaruar se zbatimi i saj do të arrihet edhe me prani ushtarake nëse është e nevojshme.¹⁷ Bëhet e qartë se interesat e Perandorisë Osmane janë zbatuar në situata të jashtëzakonshme me forcë të armëve. Në disa pjesë të vilajetit

¹⁴ *Po aty*, f. 1.

¹⁵ Baxhaku, Fatos dhe Kaser, Karl, *Die Stammesgesellschaften Nordalbanien. Berichte und Forschungen österreichischer Konsuln und Gelehrter 1861-1917*, (Wien/Köln/Weimar, 1996), f. 103. Dokumenti 44.

¹⁶ *HHSIA*, PA XXXVIII, Karton 260, Prizren, më 5 gusht 1886, f. 2.

¹⁷ *HHSIA*, PA XXXVIII, Karton 260, Prizren, më 3 shtator 1886, f. 6.

të Kosovës, kjo dukuri e trazirave ishte e veçantë dhe për këtë arsye nevojitej një goditje e ashpër për të shtypur kryengritjet dhe trazirat. Natyrisht kishte tentativa nga ana e qeverisë lokale në mënyrë paqësore për të fituar dashamirësinë apo miqësinë e fiseve dhe udhëheqësve lokalë. Ata shfrytëzuan edhe njerëz me ndikim të cilët gëzonin një reputacion të lartë në mesin e popullatës. Kjo formë e afrimit dhe rivendosjes së marrëdhënieve miqësore është zgjedhur për arsye, sepse në këto raste nuk do formohej pothuajse asnjë rezistencës dhe suksesi mund të arrihej më lehtë. Kështu iu mundësua Ali Pashës që të arrij një marrëveshje dhe një Besë të përkohshme për të ndaluar një gjakmarrje midis një fisit shqiptar dhe një malazez.¹⁸

*“Por me këtë rast dhe përfundimin relativisht të shpejtë, edhe se u arrit vetëm besa e përkohshme nga Ali Pasha, më duket gjithashtu edhe njëherë e dëshmuar se vetëm me pak aftësi, qëndron ende në duart e qeverisë për të udhëhequr këto fise rurale në bazë të vullnetit të saj”.*¹⁹

Kjo tregon se populli kishte ende një besim të madh ndaj Qeverisë osmane, sepse në raste të vështira nga të cilat nuk shihej ndonjë rrugëdalje, bëhej kërkesa ndaj kësaj qeverie për të ndërhyrë në paqësimin e konfliktit.

Rasti i Ali Pashë Gusisë dhe dilemat politike të qeverisë lokale të asaj kohe

Edhe pse Ali Pashë Gusia gëzonte një reputacion të lartë politik, ai nuk arriti të bënte me politikën e tij të ashpër miq në mesin e popullatës së rajonit dhe për këtë arsye nuk ishte aspak i pëlqyer si person.²⁰ Kjo çoi në mënyrë të pashmangshme që armiqtë e tij, si Mullah Zeka²¹, të shfrytëzojnë rastin e kohës dhe të fitojnë njerëz nga populli për kauzën e tyre. Këta duhej të merreshin me Ali Pashën²² dhe të eliminonin atë,

¹⁸ HHSIA, PA XXXVIII, Karton 260, Prizren, më 5 gusht 1886, f. 3.

¹⁹ “Aber dennoch scheint mir auch dieser Fall der verhältnißmäßige raschen Abschlusses der, wenn auch nur provisorischen Bessa durch Ali Pascha neuerdings zu beweisen, daß es, bei nur weniger Geschicklichkeit, noch immer in der Hand der Regierung liegt, die hier ländlichen Stämme nach ihrem Willen zu leiten”, HHSIA, PA XXXVIII, Karton 260, Prizren, më 5 gusht 1886, f. 3.

²⁰ HHSIA, PA XXXVIII, Karton 263, Prizren, më 5 dhjetor 1887, f. 4-5.

²¹ Po aty, f. 7.

²² Sipas raportit HHSIA, PA XXXVIII, Karton 270, të Prizrenit, më 5 mars 1888, f. 7 dhe atij të 16 mars 1888, f. 5, bëhet e ditur se Ali Pashë Gusia ndërroi jetë, më 5 mars 1888, pasi mund t’u mbijetonte plagëve të shkaktuara.

nëpërmjet një tentative vrasjeje që ndodhi, më 29 nëntor 1887.²³ Dyshohej se vrasësi ishte një përkrrahës i Mullah Zekës, pasi një gjë të tillë duket se e ka perceptuar edhe përfaqësuesi austriak duke dhënë këto dyshime. “Dua të konstatoj me siguri se i njëjti, Mullah Zeka, kishte dorë në lojën e tentativës për vrasje”.²⁴

Interesi i tij kryesor nuk ishte për t’i ndihmuar popullatës duke eliminuar Ali Pashën, por për të eliminuar një kundërshtar të fort politik. Edhe pse qeveria ishte në dijeni për vendndodhjen e kryesit të veprës, nuk kishte guxim të merrte hapa konkrete kundër shtëpisë strehuese, pasi një vepër e tillë do të cenonte traditën e mikpritjes dhe do të krijonte një armiqësi apo grindje. Atentatori për vrasje, Adem Guska, ishte strehuar tek familja Selmani në Belopë e cila kujdesej për mirëqenien dhe sigurinë e tij dhe nuk mendonte në asnjë rrethanë të dorëzonte atë.²⁵

Kjo tregon se ndërhyrja në punë të brendshme nga anëtarët e Qeverisë mund të ketë pasojë fatale, edhe në qoftë se ata ishin shumë të respektuar dhe populli ua kishte frikën. Një gjë e tillë mund të ndodhte vetëm për arsye të ndikimit të madh të fiseve që kishin në rrethinën e tyre dhe kështu u sigurohej në raste të ndryshme mbrojtje personave të cilët ishin duke u persekutuar nga pushteti me ndihmën e qeverisë lokale. Pra, ndërhyrja në çështje të brendshme siç ishin edhe gjakmarrja në mes fiseve mund të ndodhte nga ana e qeverisë lokale vetëm me pëlqimin e palëve që gjendeshin në konflikt për të arrit një marrëveshje paqësore.

Ndërhyrje nga ana e qeverisë lokale me pëlqimin e palëve

Kërkesat për ndërhyrje të qeverisë lokale ishin të shpeshta, pasi në rajonet malore kishte konflikte të shumta ndërfamiljare të cilat arrinin përmasa të ashpra që dëlnin jashtë kontrollit dhe kishin nevojë për një ndërmjetësues të pavarur dhe të paanshëm. Një gjë e tillë ka ndodhur edhe në rajonin e Pejës, ku palët që gjendeshin në konflikt, dhe mosmarrëveshjet e tyre nuk mund t’i përfundonin pa ndihmë nga jashtë, gjë që i detyroi ata të dërgonin një delegacion, i cili do të bënte kërkesë ndaj qeverisë lokale për të intervenuar në këtë konflikt.²⁶ Kështu që nuk

²³ *HHSIA*, PA XXXVIII, Karton 263, Prizren, më 5 dhjetor 1887, f. 1.

²⁴ “Ich möchte nun bestimmt annehmen, daß eben dieser Mollah Zeka bei dem Mordversuche die Hand im Spiel hatte” *HHStA*, PA XXXVIII, Karton 263, Prizren, më 5 dhjetor 1887, f. 7.

²⁵ *HHSIA*, PA XXXVIII, Karton 270, Prizren, më 16 mars 1888, f. 6.

²⁶ *HHSIA*, PA XXXVIII, Karton 270, Prizren më 30 prill 1888, f. 1-2.

ishte e rrallë që qeveria lokale të kishte edhe ndikim në vendimmarrje, edhe se duhej të priste ftesën për të ndërhyrë në mosmarrëveshjet fisnore apo ndërfamiljare. Më një gjest të tillë qeveria respektonte traditat dhe rregullat vendore për të lënë zgjidhjen e çështjeve konfliktuale në duart e partive që gjendeshin në konflikt, gjë që e forconte pozitën e qeverisë lokale kur e kërkonte ndihma e saj. Përveç kësaj, qeveria në këtë formë nuk e rrezikonte veten të bëhej pjesë e konfliktit të palëve. Një shembull tjetër tregon rëndësinë e qeverisë, ku në rajonin e Lumës konflikti kishte marrë përmasa të një lufte të vogël, dhe popullata e shihte se ky konflikt nuk kishte mundësi të zgjidhej vetë nga palët në mënyrë paqësore. Për këtë arsye ishte ftuar Mytessarif Hamid Beu, për të vlerësuar gjendjen e mosmarrëveshjes dhe për t'i dhënë fund gjakderdhjes.²⁷

Edhe pse interesi i qeverisë dhe roli i saj në zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve duket të jetë tepër i madh, mund të arsyetohet me faktin se Sulltani nuk dëshironte një përshkallëzim të konfliktit i cili mund të ndezte një zjarr të madh në vilajetin e Kosovës. Kjo frikë nuk ishte e pabazë, nga që trazirat në këtë rajon ishin një dukuri e zakonshme. Një ngjarje e tillë që ishte duke ndodhur në Prishtinë, u bë test sfidues për qeverinë, ku pakënaqësia e popullit arriti kulmimin dhe pas Festes së Bajramit, të cilët mbloodhën disa krerë të deleguar nga populli i pakënaqur në Prishtinë. Ata ishin në përcjellje prej rreth 100 personave të armatosur duke protestuar dhe kërkuar kushte më të mira për qytetarët e vilajetit. Qeveria osmane ishte e shqetësuar dhe u përpoq fillimisht që të qetësojë delegacionin e ardhur përmjet kanaleve diplomatike, duke premtuar se Sulltani do të kujdeset për shqetësimet e tyre sapo ta arrijnë dëshirat e shprehura të delegacionit. Përpjekjet për bindjen e kësaj turme dështuan, sepse premtimet të tilla kishte edhe më herët që nuk ishin plotësuar, andaj nga ana e qeverisë lindi nevoja për një zgjidhje të re. Kjo zgjidhje ishte e natyrës ushtarake dhe do të shërbente si një sinjal paralajmërues, ku Sulltani dërgoi një batalion të ushtrisë kundrejt Prishtinës për të shpartalluar apo shpërndarë delegacionin.²⁸

Nëpërmjet këtij formacionit ushtarak, delegatët mund të bindeshin që të tërhiqen nga Prishtina, para se të arrinte ushtria në qytet. Por, ata nuk reaguan ndaj kërkesës së Rexhep Pashës që i kishte ftuar për një audicion personal, mbase ky veprim i qeverisë është parë nga udhëheqësit e fiseve si fyerje dhe njëkohësisht si dobësi diplomatike.²⁹ Pasi udhëheqësit u

²⁷ *Po aty*, f. 3.

²⁸ *HHStA*, PA XXXVIII, Karton 270, Prizren, më 25 qershor 1888, f. 10.

²⁹ *Po aty*, f. 11.

kthyen në fshatrat e tyre, Qeveria osmane ka dërguar trupa në rajonin e Pejës dhe Gjakovës për t'u siguruar se nuk do të ketë trazira të mëtejshme. Këto trupa shërbenin si përforsim të trupave të stacionuara atje.³⁰ Duke pasur parasysh se pas vdekjes së Ali Pashës ishte e pritshme, që një konflikt i armatosur mund të ndodhte ndërmjet përkrahësve dhe kundërshtarëve të Ali Pashës, nevojitej ky përforsim ushtarak. Përveç kësaj, ekzistonte edhe një ankth më i madh për shkak se qeveria e Malit të Zi bënte përpjekje për të shkaktuar trazira në mes fiseve shqiptare dhe për të krijuar kështu një konflikt të ri. Prania e fortë e qeverisë nga ana e ushtrisë në rajon, tregon gjithashtu edhe interesimin e madh nga kjo e fundit që të mund ketë, kështu që e gjithë energjia të përqendrohet në mbrojtjen e kufijve kundër Malit të Zi.

Udhëtarët dhe përvojat e tyre në vitet 1880 në vilajetin e Kosovës

Nëse një person nga Evropa e asaj kohe udhëtonte në zonat shqiptare, ai e konsideronte këtë si një udhëtim i cili ishte i pajisur me të gjitha rreziqet dhe surprizat të cilat i premtan një aventurë që ndërmerret në zona të panjohur. Këta njerëz i vizituan këto hapësira për t'u përballur me një aventurë e cila u premtonte që të fitonin njohuri mbi tradita dhe rregulla që mbizotëronin aty dhe nuk ishin më të njohura për Evropën "moderne" të asaj kohe. Mbi të gjitha, gjakmarrja dhe kanuni ishin magjepsë për aventurierët perëndimorë. Në anën tjetër, është për t'u habitur që njerëzit kishin aq pak dijeni mbi këtë rajon, edhe pse afërsia e saj shërbente pothuajse për t'u zbuluar.

Duket se edhe atëherë dukuria e aventurës ka qenë tejet e theksuar te evropianët dhe është perceptuar si detyrim për të bërë një udhëtim në të panjohurën. Dhe çfarë ishte më e dukshme se ndërmarrja e një aventurës në një rajon për të cilin shumë pak evropianë dinin të tregonin diçka, pasi Shqipëria ato kohë konsiderohej si vend i egër dhe i prapambetur, qoftë ekonomikisht ashtu edhe kulturor. Vetëm disa nga vetitë e shoqërisë shqiptare kishin depërtuar në pjesën e Evropës Perëndimore të cilat nuk hodhën asnjë imazh pozitiv mbi popullsinë shqiptare. Kështu, që aventurierët u befasoneshin me gjërat dhe traditat që i takonin në trevat shqiptare. Përshtypjen kryesore e fitonin ata lidhur me kanunin dhe rregullimin e jetës nga ky ligj i cili ishte i pashkruar. Rregullat e kanunit që përcaktonin jetën sociale, punën, obligimet familjare dhe shoqërore,

³⁰ *HHSIA*, PA XXXVIII, Karton 263, Prizren, më 21 dhjetor 1887, f. 2-3.

parashihnin gjithashtu edhe çështje më të rëndësishme, siç është gjakmarrja dhe hakmarrja. Kur dhe si lejohet gjakmarrja duhej të kalonte një procedurë e gjatë që mund të shihet si paraardhës i drejtësisë moderne, pasi kishe dhe ka një karakter gjyqësor, ku palët janë të detyruar që të marrin nga një përfaqësues të cilët duhet të mbrojnë interesin e palës së tyre para pleqësisë. Përveç kësaj, gratë kanë një rol të veçantë të paraparë, siç e konstatonte Mary Edith Durham.³¹

Tani shtrohet pyetje pse njerëzit vinin në një rajon të tillë, pasi nuk kishte pothuajse asnjë fjalë të mirë mbi këtë vend në Evropën e “kulturuar”. Për aventurierët tregimet që i dëgjonin në vendlindjet e tyre mbi këtë vend të panjohur, bëheshin faktorë të rëndësishëm për të marrë një udhëtim në drejtim të të panjohurës. Premtohej të jetë një udhëtim ngazëllues duke pasur parasysh tregimet e bëra mbi një rajon i cili kishte më shumë një karakter mistik se sa një pasqyrim të vërtetë. Udhëtarët ishin në dijeni se kjo aventurë mund të jetë e rrezikshme, pasi ata e dinin se ndodheshin në një zonë mbi të cilën vetëm pak njerëz mund të përshkruanin përshtypjet e veta. Për këtë arsye, ata merrnin nga rrafshi bashkuudhëtarë shqiptarë me vete, të cilët mund të garantonin për mbrojtjen e tyre, sepse ata kishin njohuri të mirë mbi mentalitetin dhe gjithashtu edhe mbi territorin e vendit. Me përcjelljen e këtyre ishte e mundur që të fitohej një pasqyrë e jetës së përditshme të këtij populli, duke trashëguar përshtypjet e tyre përmjet kujtimeve të shkruara të udhëtimeve që i bënin në trevat shqiptare. Por, duhet të jemi edhe të kujdesshëm me leximin e këtyre shkrimeve dhe kujtime udhëtimesh pasi kishte edhe ekzagjerime në tregimet e tyre. Nga raportet konsullore dhe monografi të udhëtarëve, mund të shihet se situata ishte pak e pasigurt për udhëtarët për shkak se ata në çdo kohë mund të bëheshin viktimë e intrigave politike apo rrethanave të tjera.

Keqtrajtimi i udhëtarëve dhe përvoja e një diplomatit austriak

Pas Kongresit të Berlinit situata mes Austro-Hungarisë dhe Perandorisë Osmane ishte mjaft e ndejshme dhe çdo dyshim i vogël mund të shkaktonte probleme të mëdha politike. Se sa i rrezikshëm mund të ishte një udhëtim në pjesën evropiane të territorit të Perandorisë Osmane, e kishin përjetuar në trupin e tyre edhe disa shtetas të Austro-Hungarisë më 1886, pasi ishin arrestuar për shkaqe spiunazhi në zonën kufitare mes

³¹ Durham, Edith, *High Albania*, (London, 1909), f. 38.

Bullgarisë dhe Perandorisë Osmane. Gjatë kthimit të konsullit austro-hungarez, Hickels, nga Shkupi për në Prizren, personi në fjalë i takoi tre udhëtarët nga Vjena të cilët ishin burgosur mbi akuzën për spiunazh dhe po dërgoheshin drejt Prishtinës për t'u ekstraduar.

“Me kthimin tim dje në mëngjes, kam qenë në stacionin hekurudhor të Ferizajt, dëshmitar, se si tre persona ishin përjashtuar nga treni të mbyllur me pranga dore. Gjatë udhëtimit prej Kaçanikut, kam mësuar se këta tre individë duhet të ishin shtetas austriakë, dhe se stafi i trenit në Kaçanik, për të huaj, ka ofruar mjetet për të blerë biletat e reduktuara prej Kaçanikut deri në Ferizaj për të shoqëruarit.”³²

Duke u nisur nga e drejta e konsullit për të folur me qytetarët e vet, ai kishte mundësi të bënte një bisedë të shkurtër dhe ishte kështu në gjendje të fitojë dijeni mbi rrethanat e arrestimit. Ata treguan se kanë qenë në kërkim për punësim dhe janë arrestuar nga autoritetet turke afër kufirit të bullgarisë vetëm për shkak të mungesës së dokumenteve të rregullta. Pastaj, ishin transportuar prej Hadımköy përmjet Kostandinopojës dhe Selanikut, duke u keqtrajtuar për më shumë se 10 ditë, gjë që nuk është më e lejuar për ta trajtuar një njeri në këtë mënyrë edhe për krimin më të rënd. Gjatë bisedimit bëhet e qartë se trajtimi ishte si në burg ashtu edhe gjatë udhëtimit, jo i lakmueshëm, pasi edhe njërit nga të arrestuarit i janë marrë edhe rrobat në burg, i cili tani ishte i veshur vetëm me brekë dhe këmbishë. Por, edhe pasaportat iu ishin konfiskuar nga autoritetet turke. Ata gjithashtu pohuan se nuk kishin bërë asnjë vepër penale dhe se u ishte mohuar kategorikisht që të takonin autoritetet konsullore në Kostandinopojë dhe Selanik.³³

Përveç situatës së vështirë në të cilën gjendeshin të arrestuarit, nuk ishte e mirëpritur ndërhyrja dhe angazhimi i një përfaqësuesi diplomatik për të drejtat e tyre. Autoritetet e Perandorisë Osmane nuk dëshironin që të jenë të shqetësuar dhe të penguar në punën e tyre. Në mungesë të drejtorit (Müdür) të Ferizajt, konsulli austriak ishte i detyruar që të takonte shefin e

³² “Bei meiner Rückkehr gestern Vormittag war ich auf der Bahnstation Verissovich Zeuge, wie drei Individuen in Handeisen geschlossen aus dem Train auswaggoniert wurden. Schon während der Fahrt von Kačanik herauf brachte ich in Erfahrung, daß diese drei Individuen österreichische Staatsangehörige sein sollen, und daß Bahnbedienstete in Kačanik, Ausländer, durch eine Kollekte die Mittel aufgebracht hatten, um die ermäßigten Fahrбилете von Kačanik bis Verissovich für die also Escortierten zu lösen“, *HHStA*, PA XXXVIII, Karton 260, Prizren, më 11 qershor 1886, f. 2.

³³ *HHStA*, PA XXXVIII, Karton 260, Prizren, më 11 qershor 1886, f. 3.

policisë, një toger (Mulazim) të thjeshtë për të kërkuar që të arrestuarve t'iu hiqen të paktën prangat. *“Me siguri që kjo ishte shumë e pakëndshme për atë, që unë isha duke kërkuar për t'u informuar në lidhje me këtë rast dhe kështu ai nxitoi me transferimin e të burgosurve pas pak minutash për të penguar planin tim”*.³⁴

Aventurierët dhe përvojat e tyre

E kam zgjedhur një vepër që është shkruar nga një udhëtar anglez në vitin 1888, pasi ai kishte bërë një udhëtim në dimrin e vitit të kaluar në trevat shqiptare. Si çdo udhëtar, edhe ky erdhi në Shqipëri për të përjetuar dhe për të mësuar diçka të re. Ai ishte i shoqëruar nga një shqiptar i mirinformuar mbi rajonin gjatë gjithë udhëtimit të tij. Ai vuri re se veshjet e njerëzve ishin të njëjta si shoqëruesi i tij dhe i bënte përshtypje forma e bartjes së armëve.

“Ndërsa ai po bisedonte me Frana, pjesa tjetër e kompanisë së tij hipi lart, tre ose katër kafshë të ngarkuar, si dhe tre shokët e tjerë të mirarmatosur dhe të mirëpërgaditur; një përcjellje jashtëzakonisht e madh për një tren kaq të vogël. Ata na kaluan me një përshëndetje analizuese, dhe duke kaluar, kam vënë re se të gjithë ata mbanin karabinat mbi kofshët e tyre në vend se të vendosur mbi shpatull, edhe pse, për të qenë i sigurt, natyra e kësaj pjese të këtij vendi justifikon çdo masë paraprake”.³⁵

Udhëtarët duket se kanë fituar shpejt një përshtypje në jetën e përditshme dhe sjelljen e njerëzve, pasi ata ishin shumë më ndryshe se nga format e njohura të jetesës nga vinin ata. Një jetë e tillë nuk shihej si diçka negative, pasi njerëzit i ishin përshtatur një forme të jetesës, e cila ka lindur për shkak të rrethanave të ndryshme për të siguruar mbijetesën e tyre. Kështu që, aventurierët mësuan shpejt të përshtateshin në rrethanat e reja dhe ecnin ashtu si vendasit e armatosur, dhe i kishin në konsideratë që

³⁴ “Sicherlich war es ihm aber höchst unangenehm, daß ich mich über diesen Fall informieren suchte, und er drängte durch Abführung der Gefangenen schon nach wenigen Minuten auf Vereitlung meines Vorhabens”. *Po aty* f. 4.

³⁵ “While he was conversing with Frana, the rest of his company rode up - three or four pack animals, and three other well-armed and well-mounted fellows; an unusually large escort for so small a train. They passed us with a mustered salute, and as they passed I noticed that all of them carried their carbines across their thighs instead of on the shoulder, though, to be sure, the nature of this bit of the country justified every precaution”. Brown, f. 200.

armët e tyre të jenë të gatshëm në çdo kohë për zjarr. *“Megjithatë, kemi shkuar bashkë me një sasi të caktuar të kujdesit, me armët tona të gatshme për përdorim të menjëhershëm”*.³⁶

Gjatë kryerjes së udhëtimit në këtë rajon duhej kushtuar kujdes i madh, i cili paraqiste hapësira të mira për një pritë, në mënyrë që të mos bëheshin viktimë të grabitësve dhe vrasësve. Durham e përshkruan përvojën e saj, e cila përvojë ka dallime të mëdha nga kolegët e saj mashkullor. Në njërën anë i bie në sy që njerëzit ankoreshin ashpër mbi kushtet të cilat bënin gjëra të tilla të mundshme, duke pasur parasysh mungesën e një qeverie të denjë dhe sasinë e parave që duhej shpenzuar në armë për vetëmbrojtje,³⁷ dhe në anën tjetër, ajo ndihej shumë e sigurt në trevat shqiptare, pasi konstaton se: *“për veten time, unë kam udhëtuar lehtësisht kudo pa armë apo përcjellje në ato pjesë”*.³⁸

Rajonet që gjendeshin nën gjakmarrje, nuk ishin të preferuar për një kalim transit apo ndonjë vizitë, pasi mund të ndodhte që të vritej rastësisht një i pafajshëm. Por, edhe rajonet e mirënjohura për plaçkitje ishin të rrezikshme për t’u kaluar, nga që këtu nuk bëhej dallimi mes katolikëve apo myslimanëve, kështu që feja nuk kishte rëndësi, duke pasur parasysh vetëm vlerën e plaçkitjes.³⁹ *“Sa herë që kemi kaluar një vend, Frana do të lëshonte ndenja të hidhura me fjalë kundër Lumës dhe mbi gjithë banorët e saj, dhe më bënte thirrje për të vëzhguar çdo tipar të një vjedhësit dhe një vrasësi tek krijesa me dukje të egër pranë nesh”*.⁴⁰

Për ta ilustruar gjendjen e rrezikshme në zonat e caktuara, u është dëftuar udhëtarëve gjatë rrugës historia e rajonit me njohurit më të mira të mundshme. Bashku dhëtarët nuk harruan asnjë detaj që ishte i nevojshëm për t’u treguar, pasi ishte e rëndësishme që të dihen incidentet fatale dhe vendndodhjet e tyre. Kështu, rreziqet dhe vendet e ngjarjeve tragjike janë ilustruar në mënyrë më të mirë të mundshme për të qenë më të kujdesshëm kur të kalonin andej.⁴¹ Përveç kësaj, për të pasur një udhëtim të qetë dhe të sigurt ishte me përparësi dukja e një të rrezikshmi. Kjo nënkuptonte në një

³⁶ “However, we went along with a certain amount of caution, with our weapons handy for instant use”, Brown, f. 202.

³⁷ Durham, f. 178.

³⁸ “For myself, I have travelled everywhere without arms or escort in those parts without difficulty”, Durham, f. 418.

³⁹ Durham, f. 362.

⁴⁰ “As often as we passed a native, Frana would give vent to a philippic against Ljuma and all the inhabitants thereof, and beseech me to observe every trait of a robber and a murderer in the wild-looking creature beside us”, Brown, f. 213.

⁴¹ Brown, f. 194-95.

mënyrë që një person i cili dukej i butë nuk tërhoqi asgjë tjetër përveç telasheve dhe gjithashtu nuk është perceptuar si burrë.⁴² Udhëtimi gjatë natës ose gjatë muzgut nuk ishte i rekomanduar, përveç në raste urgjente. Duke pasur parasysh këtë rrezikshmëri, do të nevojitej një skuadër tepërt e madhe mbrojtëse për të garantuar një udhëtim të sigurt. Askush nuk guxonte të fillonte udhëtimin e tij gjatë agimit, pasi kjo kohë konsiderohej ende si shumë e pasigurt. Brown, dëshironte të dilte në mëngjes të hershëm për të vazhduar udhëtimin, por ishte penguar nga përcjellësi i tij, mbase ky e bëri të kuptojë se ata duhet të presin deri në daljen e rrezeve të plotë të diellit. *“Askush nuk shkon këtu derisa të ketë dritë të mjaftueshme për të parë kokën e një njeriu në mesin e shkurreve”*.⁴³

Për shkak të pranisë së vazhdueshme të pasigurisë dhe frikës së madhe në rajonet malore dhe fshatrat e tyre, njerëzit ishin të detyruar që të siguronin mbrojtjen e familjes së tyre, e cila u mundësua vetëm me pajisjen e armëve. Për udhëtarët, ky fakt shpeshherë del shpejt në pah, sepse dashuria e armëve këtu duket të jetë më e theksuar se që e kishin takuar në ndonjë udhëtim tjetër. Kështu që, nuk ishte e pazakonshme që njerëzit të vriteshin për shkak të armës së tyre apo bëheshin objekt i dëshirës së ndonjë dashamirit të armëve.⁴⁴ Armët e veçanta ishin shumë të çmuara dhe nuk mund të kalonin pa u vënë re nga një sy i trajnuar. Në rast të zbulimit të një arme të veçantë, ishte e natyrshme që kjo të kalonte nëpër duart e gjithë mysafirëve me një respekt të jashtëzakonshëm. *“Aktualisht një nga burrat e shtriu dorën e tij me një kërkesë të murmuritur që t’i lejohet shqyrtimi i pistoletës sime. Arma është përcjell në raund nga dora në dorë dhe u takua me lavdërimet më të ngrohta”*.⁴⁵

Ata e trajtuan revolverin si një thesar të vogël të cilin do të preferonin që ta përvetësonin aty për aty për ta shkrepuar së paku një plumb me atë, e cila na çon tek një tjetër dukuri. Është e habitshme se sa shumë qëllohet drejt qiellit dhe askush nuk shqetësohet në lidhje me këtë dukuri, duke mos u interesuar se ku bien plumbat dhe kë mund ta qëllojnë.⁴⁶ Gjatë udhëtimit, kjo u interpretua si një paralajmërim për t’u shmangur çdo lloj

⁴² Brown, f. 213.

⁴³ “No one goes out here till it is light enough to see a man’s head among the bushes”, Brown, f. 220.

⁴⁴ Durham, f. 64.

⁴⁵ “Presently one of the men stretched out his hand with a muttered request to be allowed to examine my revolver. The weapon was handed over round from hand to hand and met with the warmest praise”, Brown, f. 215.

⁴⁶ Brown, f. 216.

takimit me njerëz të paftuar. Të shtëna drejt qiellit shpeshherë nuk kishin asnjë arsye, por janë bërë thjesht për kënaqësi.⁴⁷

Megjithatë, nuk ishin vetëm zakonet e habitshme risi, por edhe ato të strukturës familjare dhe traditat. Ndikimi i familjes ishte gjithmonë më së fortë i pranishëm dhe përcaktonte jetën e anëtarëve. Për këtë arsye, duke pasur parasysh besën dhe mikpritjen, ishin të lidhur me detyra të larta të cilat nuk mund të shkelen. Një mysafir që ka kaluar natën te një familje është parë si një anëtar i familjes dhe më tej mund të bënte gjumë në dhomën e përbashkët, por kjo nuk që edhe aq shumë mbështetëse nga udhëtarët për arsye të higjienës, ku Durham konstaton se, në një shtëpi flinin në të njëjtën dhomë rreth tridhjetë persona.⁴⁸

Zakonet dhe ritet e dasmave dhe festave të tjera ishin me të vërtetë të çuditshme, por në mënyrën dhe formën e tyre ishin të bukura për të parë. Forma se si është marrë nusja nga shtëpia e saj dhe është prurë te shtëpia e burrit, bëhej përmjet një delegacionit të dërguar. Pritja e nuses bëhej me shumë këndim dhe vallëzim. Por, në anën tjetër ishin edhe disa tipare negative që edhe familjet mbretërore evropiane i kishin të përbashkëta.

*“Martesa është rregulluar tërësisht nga kreu i shtëpisë. Fëmijët janë fejuar në foshnjëri apo në barkun e nënës. Edhe më herët. Një njeri do t’i thoshte një tjetrit me të cilin ai dëshiron të jetë aleat: “Kur gruaja juaj ka një vajzë unë e dua atë për djalin tim”. Gruaja është blerë gjithmonë”.*⁴⁹

Mbasi aventurierët largoheshin nga ky rajon, iu mbeteshin në kujtesë disa ngjarje dhe gjëra të reja që i kishin mësuar dhe takuar në këtë vend. Ky imazh zakonisht ishte në kundërshtim me paragjykimet dhe me atë që kishin dëgjuar më parë, ose që besonin se do ta gjenin këtu.

⁴⁷ Durham, f. 279.

⁴⁸ Durham, f. 124.

⁴⁹ “Marriage is arranged entirely by the head of the house. The children are betrothed in infancy or in utero. Even earlier. A man will say to another with whom he wishes to be allied, "When your wife has a daughter I want her for my son", *A wife is always bought*, Durham, f. 47.

Nuri BEXHETI & Selver ISLAMAJ

SUMMARY

THE POLITICAL SITUATION AND THE IMPRESSIONS OF FOREIGNERS ABOUT THE VILAYET OF KOSOVA IN THE 1880-IES

Given the political circumstances of the time in the Vilayet of Kosova after the great Albanian uprising of the League of Prizren, shows that nothing is safe and secure in this area. It does not guarantee your life even if you were a powerful personage of everyday politics of that time, as was Ali Pasha Gusia who died due to political conflicts with his "allies". On the other hand, memoirs and narratives from adventurers of that time reflect the situation and the circumstances how people lived and at what level the security situation was. They give their impressions in detail, enabling us to see the social life of that time.

Stories and reports of foreign diplomats, address various issues, which include daily politics, social life, trade, security in the country, and many other aspects that were important to their governments, and that can facilitate us a more detailed approach of various aspects of the Albanian speaking Vilayets, to better understand the political and social life.

Hasan BELLO

KRYENGRITJA E VITIT 1910 SIPAS DISA RAPORTEVE KONSULLORE

Në muajt e parë të vitit 1910 pasi xhonturqit konsoliduan pushtetin e tyre politik, menduan se kishte ardhur koha për ta eliminuar një herë e mirë nacionalizmin shqiptar. Kjo u vu re me miratimin e një sërë ligjesh, të cilat synonin rekrutimin e përgjithshëm në malësitë shqiptare; vendosjen e taksave të reja, mbledhjen e taksave të prapambetura; ligji për çetat dhe klubet kombëtare, etj., reforma me karakter centralizues.¹ Një politikë e tillë ngjalli pakënaqësi të madhe në mesin e popullsisë shqiptare, ndërsa Qeveria osmane i konsideroi këto si reagime kundërrevolucionare, të cilat synonin rikthimin e Abdylhamidit II. Por, situata e krijuar nuk lidhej aspak me një kërkesë të tillë. Ajo kishte lidhje me gjendjen e vështirë ekonomike dhe mungesën e vëmendjes së qeverisë xhonturke ndaj viseve shqiptare.²

Raportet shqiptaro-xhonturke u acaruan edhe për shkak të qëndrimit ndaj alfabetit latin. Pikëpamjet e partisë “Bashkim dhe Përparim” (“İttihat ve Terakki”), të cilat ajo i bëri të njohura rreth një muaji, përpara se të shpallej Kushtetuta, lidhur me çështjen e përdorimit të gjuhës, ishin se: në shkollat fillore shtetërore mësimi përveç se në turqisht do të zhvillohej edhe në gjuhën që flitej nëpër vilajete; në shkollat e ndërmjetme zhvillimi i mësimit në gjuhën turke ishte i detyrueshëm, ndërsa gjuha lokale do të lihej me zgjedhje; hapja e shkollave private do të ishte e lirë, me kusht që ato të ishin nën kontrollin e shtetit.³ Por, kjo politikë hasi në kundërshtimin e plotë

¹ Şeyhülislam Cemaleddin Efendi, *SiyasiHaturalar (1908-1913)*, Istanbul: Tercüman, 1978, s. 58-61.

² Ahmet Bedevi Kuran, *İnkılap Tarihimiz ve Jön Türkler*, Istanbul: Kaynak Yayınları, 2000, s. 367.

³ Tarık Zafer Tunaya, *Türkiye`de Siyasal Partiler*, c.I, Istanbul: İletişim, 2015, s. 34-35.

të popujve të ndryshëm në Perandorinë Osmane. Ajo u konsiderua si një politikë e cila synonte haptazi turqizimin e kombësive joturke.⁴ Mosmbajtja e premtimit nga xhonturqit për vendosjen e gjuhës amtare nëpër shkolla, shkaktoi zhgënjim të madh tek shqiptarët. Situata u acarua sidomos pas vendosjes së detyrueshme të gjuhës osmane në shkollat e ciklit të ndërmjetëm. Ky akt, u perceptua nga etnitë e ndryshme si faza e parë e procesit të turqizimit dhe shkaktoi një valë të madhe zemërimi.⁵

Kjo politikë bazohej në një dhunë të strukturuar që në themel të saj kishte si objektiv kryesor procesin e unifikimit dhe të nënshtrimit të të gjithë popujve të Perandorisë Osmane. Mirëpo, këto masa me karakter centralizues ngjallën kundërshti tek shqiptarët, të cilëve u ishte premtuar se pas Revolucionit Xhonturk do të gëzonin një status të avancuar. Kjo pakënaqësi fillimisht u shpreh nga deputetët shqiptarë në Parlamentin osman. Por, elita politike xhonturke, në vend që të merrte në konsideratë problemet e parashtruara nga këta deputetë, ndoqi taktikën e dhunës. Ajo ngarkoi disa nga komandantët më të njohur të ushtrisë osmane për të shtypur dhe çarmatosur popullsinë shqiptare. Një ekspeditë e tillë hasi në qëndresën e shqiptarëve. Brenda një kohe të shkurtër kryengritja përfshiu të gjitha trevat. Arsye kryesore e kësaj kryengritje sipas konsullit bullgar në Shkup, ishte shpërfillja e kërkesave të paraqitura nga shqiptarët nëpërmjet delegatëve të tyre. Ato kishin të bënin me mospagimin e taksave dhe rekrutimin e detyrueshëm.⁶ Në disa qytete u shpall gjendja e jashtëzakonshme. Një numër i konsiderueshëm forcash osmane u transportua me tren nga Selaniku dhe Shkupi në drejtim të Kosovës dhe Shqipërisë së Veriut.⁷ Një nga komandantët e ekspeditës, Xhavit Pasha, i cili në këtë periudhë ndodhej për inspektim në qarkun ushtarak të Shkupit, kërkoi nga komanda dërgimin e 30 batalioneve, të cilat sipas tij duheshin dislokuar në Kosovë të paktën për dy vite. Ai kërkoi gjithashtu t'u jepej e drejta për të shtypur kryengritjen me çdo mjet, duke rivendosur qetësinë.

⁴ İlay İleri, "Batı Gözüyle Meşrutiyet Döneminde Osmanlı Hükümetlerinin Dil ve Eğitim Politikalarına Karşı Tepkiler", *OTAM* (Ankara Üniversitesi, Osmanlı Tarihi Araştırma ve Uygulama Merkezi Dergisi), sayı: 18, 2005, s. 214.

⁵ Mustafa Ergün, *II. Meşrutiyet Devrinde Eğitim Hareketleri, 1908-1914*, Ankara: Ocak Yayınları, 1996, s. 483-484.

⁶ Centralen Derzhaven Istoriceski Arhiv, (më tej: *CDIA*) Dokumente bullgare, (sipas përkthimeve që ndodhen në *AIH*), H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 21.03.1910.

⁷ *CDIA*, në *AIH*, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 22.03.1910.

Në komitetin xhonturk të Shkupit mbizotëronte pikëpamja se tani ishte momenti më i përshtatshëm për shtypjen e kryengritjes shqiptare.⁸ Por, kjo fushatë nuk rezultoi aq e lehtë për forcat osmane. Kjo u vu re edhe nga fakti se brenda një kohe të shkurtër kryengritësit arritën të thyenin disa batalione osmane dhe të kapnin si trofe një numër të konsiderueshëm topash. Ndërkohë në ndihmë të ekspeditës ndëshkuese vazhdimisht mbërrinin përforcime dhe furnizime (ushqime, armë dhe municione).⁹ Në Kosovë dërgoheshin reparte të tilla ushtarake, në të cilat nuk kishte ushtarë me kombësi shqiptare, sepse sipas konsullit bullgar në Shkup, ata paraqisnin rrezik të kalonin në anën e kryengritësve.¹⁰

Ndërsa, humbjet e ushtrisë osmane ishin evidente për diplomatët e huaj, ato të kryengritësve shqiptarë ishin krejtësisht të pakuptueshme. Kjo, sipas tyre, vinte për shkak se kryengritësit si të vrarët ashtu edhe të plagosurit i merrnin me vete, duke ngjallur panik dhe mungesë informacioni tek forcat kundërshtarë.¹¹ Numri i ushtarëve osmanë me origjinë shqiptare që kishin kaluar në krahun e kryengritësve kapte shifrën e 160 personave. Kjo tregon se në radhët e ushtrisë osmane diversioni dhe dezertimi përbënte një problem shqetësues dhe, njëkohësisht një avantazh të madh për kryengritësit shqiptarë.¹² Sipas konsullit bullgar të Shkupit, ndryshimi radikal i ligjeve në trevat shqiptare e kishte bërë Qeverinë osmane të reflektonte. Kryengritja kishte shërbyer si një përvojë negative për ta detyruar Stambollin që të gjente rrugët më të përsosura për zbatimin e ligjeve dhe reformave centralizuese për Shqipërinë.¹³ Sidoqoftë, Qeveria osmane kishte hyrë në një spirale nga e cila nuk po dinte që të dilte dot. Kjo vihej re edhe nga fakti se pavarësisht humbjeve të mëdha, çdo ditë nga Shkupi në drejtim të Kosovës transportoheshin trupa të shumta osmane. Përqendrimi i tyre bëhej në Ferizaj dhe në Prizren, me qëllim që rrezja e

⁸ *CDIA*, në *AIH*, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 23.03.1910.

⁹ *CDIA*, në *AIH*, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 25.03.1910.

¹⁰ *CDIA*, në *AIH*, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 26.03.1910.

¹¹ *CDIA*, në *AIH*, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 29.03.1910.

¹² *CDIA*, në *AIH*, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 31.03.1910.

¹³ *CDIA*, në *AIH*, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 02.04.1910.

kryengritjes të mbahej nën kontroll dhe e dyta, të mbrohej Gryka e Kaçanikut e cila lidhte Fushë Kosovën me Shkupin.¹⁴

Pasi mbërriti në Prishtinë kryekomandanti i trupave osmane Shefqet Turgut Pasha, u drejtoi shqiptarëve një thirrje ku vinte në dukje se ushtarët osmanë po vinin në viset shqiptare jo si armiq, por si vëllezër për të vendosur rendin dhe sigurinë publike. Ai ftoi të gjithë shqiptarët që të mos dëgjonin agjitorët dhe armiqtë e Perandorisë, por të ulnin armët dhe t'u bindeshin ligjeve të shtetit. Në këtë thirrje nuk flitej aspak për çështjen e mbledhjes së armëve, taksave apo rekrutimit të detyruar ushtarak. Kjo, sipas konsullit bullgar në Shkup, ishte një taktikë e Shefqet Turgut Pashës,¹⁵ por që për fat të keq, të Perandorisë Osmane e të kryengritësve, nuk pati asnjë efekt. Përkundrazi, tregoi hapur se Stambolli dhe Komiteti Xhonturk, nuk kishte nxjerrë konkluzionet e duhura për zgjidhjen e çështjes shqiptare.¹⁶ Ndërkohë aksionet e kryengritësve shqiptarë të drejtuar nga Idriz Seferi, të mbledhur në Kaçanik, vazhduan pandërprerë goditjen e trupave osmane. Dështimet e njëpasnjëshme e detyruan Shefqet Turgut Pashën që t'i drejtohej Stambollit për ndihmë. Ndërsa, Shtabi i Përgjithshëm e udhëzoi kategorikisht, që për momentin, të manovronte me trupat që kishte në dispozicion. Një qëndrim i tillë e vendosi në pozitë tepër të vështirë ekspeditën osmane. Kryengritësit shqiptarë kishin kapur Grykën e Kaçanikut dhe pikat strategjike, duke ndërprerë lidhjet e Korpusit III osman me shtabin dhe duke penguar depërtimin dhe transportimin e trupave osmane në drejtim të zonave kryengritëse. Ky pozicionim tregoi aftësitë luftarake dhe organizative të Idriz Seferit e të drejtuesve të tjerë shqiptarë. Ai bëri që zhgënjimi i komandantëve të shkolluar osmanë, se kryengritësit shqiptarë do t'i shtypnin brenda vetëm pak ditëve, të konfirmohej plotësisht.¹⁷

Në funksion të mbledhjes së ndihmave dhe forcave kryengritëse, një grup shqiptarësh nga Gjilani në ditët e para të prillit 1910 u nisën drejt

¹⁴CDIA, në AIH, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 05.04.1910.

¹⁵CDIA, në AIH, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 09.04.1910.

¹⁶ Thirrja drejtuar popullit shqiptar përmbante edhe një dozë të konsiderueshme "religjioze". Aty theksohej se disa individë kishin guxuar të ngriheshin "kundër ligjeve të Zotit, predikimeve dhe ligjeve të profetit, kundër ligjeve që ekzistojnë sot në shtetin tonë", CDIA, në AIH, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 10.04.1910.

¹⁷CDIA, në AIH, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 12.04.1910.

Shkupit. Një aspekt tjetër i këtij misioni ishte puna agjitative që ata duhej të zhvillonin. Kjo për shkak se në mesin e popullsisë, për ta sabotuar, nga autoritetet lokale osmane, kryengritja ishte interpretuar si e nxitur nga jashtë dhe antikushtetuese.¹⁸

Diplomatët austro-hungarezë konstatonin se lëvizja kryengritëse në Kosovë ishte konsekuencë e politikës xhonturke kundrejt shqiptarëve dhe zinte fill që në Kuvendin e Ferizajt të vitit 1908, në të cilin u ishte njohur privilegji i çlirimit nga të gjitha taksat shtetërore, me përjashtim të katër tatimeve kryesore që parashikonte sheriatin. Një rol po aq negativ kishin luajtur ekspeditat e dështuara të Xhavit Pashës, të cilat kishin forcuar unitetin ndërmjet shqiptarëve dhe kishin zgjuar tek ata ndjenjën e hakmarrjes. Ndërsa, autoritetet lokale osmane me qëndrimin e tyre të papajtueshëm kundrejt alfabetit shqip me germa latine, nuk kishin bërë gjë tjetër veçse e kishin ndezur zjarrin e kryengritjes akoma dhe më shumë. Një element tjetër i rrezikshëm që ndikoi në acarimin e situatës në viset shqiptare ishte represioni i pamëshirshëm i oficerëve osmanë. Me të drejtë, diplomatët austro-hungarezë theksonin se konceptet osmane të së drejtës nuk pajtoheshin me të drejtën zakonore shqiptare. Ndjekjet dhe gjyqet ushtarake drejtoheshin kundër krerëve me influencë dhe çarmatimit të popullsisë.¹⁹

Më 13 maj 1910, zëvendëskonsulli francez në Shkup, Kalvini, i raportoi Ministrisë së Punëve të Jashtme se pas tre ditë luftimesh me forcat shqiptare, ushtarët e Shefqet Turgut Pashës kishin arritur të pushtonin grykat e Shtimes dhe Carralevës që kontrollonin rrugën kryesore nga Ferizaj në Prizren. Ndërsa, kryengritësit shqiptarë ishin tërhequr në luginën e ngushtë malore të Drenicës. Numri i saktë i tyre mbetej i pakonfirmuar për diplomatin francez, por duke marrë në konsideratë 20 batalione dhe bateri të Shefqet Turgut Pashës, ai duhej të ishte tepër i madh. Pavarësisht taktikave dhe disproporcionit të forcave, ushtarët osmanë kishin hasur në vështirësi të jashtëzakonshme. Kjo, jo vetëm për shkak të terrenit të thyer malor. Kështu, një oficer osman i shkruante një shokut të tij në Shkup se ata

¹⁸CDIA, në AIH, H-10, Raport i konsullit bullgar të Shkupit për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Sofje, Shkup, 13.04.1910.

¹⁹Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSt.A.P.A.A.), në AIH, Vj. 20-5-528, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 16.04.1910.

luftonin kundër një armiku të padukshëm që shfaqej në një pikë, sulmonte, pastaj zhdukej menjëherë dhe shfaqej në një pikë tjetër. Kjo bëri që në mesin e ushtarëve të plagosur osmanë të përhapej legjenda, për shkak të disfatave të shkaktuara nga kryengritësit, se ata ndihmoheshin nga oficerë të huaj. Por, kjo hipotezë hidhej poshtë nga zëvendëskonsulli francez në Shkup. Ai e pranonte se kryengritësit luftonin sipas një plani të paracaktuar, sipas një taktike shumë të ngritur, e cila presupozonte një drejtim të mençur. Megjithatë, nuk kishte asnjë të dhënë se kjo realizohej nga drejtues të huaj, por nga vetë drejtuesit shqiptarë të kryengritjes.

Kryengritësit ishin të vendosur për t'i rezistuar forcave osmane. Ata kishin zhvilluar mbledhje në të gjitha anët dhe kishin dhënë besën për të hequr dorë nga gjakmarrja deri në muajin tetor. Ndërsa, morali i trupave osmane, si rezultat i kësaj qëndrese, vinte duke rënë. Oficerët ishin të pakënaqur me Shefqet Turgut Pashën dhe midis tyre kishte mospajtime të shumta.²⁰ Serbia e inkurajoi Qeverinë osmane lidhur me masat ushtarake që po ndërmerre në drejtim të inkursioneve dhe ekspeditave ndëshkuese ndaj kryengritësve shqiptarë. Ajo i premtoi xhonturqve mbështetje të plotë dhe se nuk do të bënte qoftë edhe lëvizjen më të vogël të trupave në kufi me krahinat shqiptare.²¹ Komandanti i ekspeditës ndëshkuese osmane Shefqet Turgut Pasha i deklaroi konsullit austro-hungarez të Shkupit se kishte ardhur koha që stabilizimi i situatës politike në viset shqiptare të Kosovës, i shtyrë disa herë, të merrte fund. Për këtë ishte mobilizuar një numër i konsiderueshëm forcash, të cilat do të marshonin në mbarë Kosovën. Ndërsa, me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme do të ngriheshin gjykata ushtarake, për të ndëshkuar kryengritësit. Ai planifikonte se luftimet mund të zgjasnin 15 ditë dhe pastaj situata do të stabilizohej. Kjo do t'i hapte rrugën edhe çarmatimit të popullsisë. Shefqet Turgut Pasha mendonte se jo një popull që mban armë, por një popull i stërvitur për përdorimin e tyre mund ta garantonte Perandorinë Osmane nga jashtë. Ndërsa, vjelja e tatimeve të prapambetura do të bëhej hap pas hapi, pasi situata e rëndë ekonomike, nuk e favorizonte një masë ekstreme. Në funksion të kësaj politike, Qeveria osmane, kishte planifikuar të hapte në Kosovë dhe Shqipërinë e Veriut, 200 shkolla. Ajo mendonte se konsolidimit të ndjenjës fetare të popullsisë shqiptare i duhej kushtuar rëndësi më e madhe. Oficerë

²⁰ *Archiv du Ministere des Affaires Etrangeres*, Paris, (më tej: *AMAE*), në *AIH*, F.71. Raport i zëvendëskonsullit francez në Shkup, Kalvini, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkup, 13.05.1910, fl.73-75.

²¹ *AMAE*, në *AIH*, F.71. Raport i ministrit francez në Beograd për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Beograd, 25.05.1910, fl.7.

të shkolluar nga korpusi I dhe II do të silleshin për të shërbyer në viset shqiptare. Kjo do t'i shërbente stabilizimit të situatës dhe krijimit të raporteve më të mira mes popullsisë vendase dhe ushtrisë. Në gjykimin e Shefqet Turgut Pashës revolucionarët e djeshëm ishin dhe revolucionarët e sotëm. Prandaj, sipas tij, energjia e autoriteteve ushtarake duhej të drejtohej kundër parisë, që nën maskën e nacionalizmit, ndiqte interesat e veta personale. Këta, sipas Shefqet Turgut Pashës, ishin edhe shkaktarët kryesorë të kryengritjes. Ai mendonte se paria e viseve shqiptare e cila kishte gëzuar një status të privilegjuar në periudhën e Abdylhamidit II, tani duhej eliminuar dhe barazuar në aspektin social-politik me popullin e thjeshtë. Kjo tregon se drejtuesit xhonturq kishin mangësi të theksuara për sa i përket njohurive mbi strukturën sociale të popullit shqiptar.

Nga ana tjetër sipas konsullit austro-hungarez të Shkupit, Shefqet Turgut Pasha kërkonte të hynte në kontakt me disa prijës lokalë për t'i bindur ata se zbatimi i reformave i shërbente njësoj si Perandorisë ashtu edhe vetë shqiptarëve. Në vlerësimin e diplomatëve austro-hungarezë mbizotëronte pikëpamja se interesat vitale të Perandorisë Osmane nuk ishin në Azi, por në Evropë. Prandaj, stabiliteti dhe qetësia e kësaj zone do t'i jepte shtetit osman mundësinë për t'u zhvilluar në paqe. Kjo vihet re edhe në deklaratën që Shefqet Turgut Pasha i bëri konsullit austro-hungarez se “një prishje e hapur me shqiptarët duhet evituar me të gjitha mjetet”. Por, në praktikë ai ndoqi një qëndrim të kundërt. Shefqet Turgut Pasha bëri të gjitha përpjekjet, duke përdorur dhunën, me qëllim për të vendosur autoritetin e munguar të Qeverisë osmane, para se shqiptarët të bashkoheshin në rezistencën e përbashkët.²² Ai ishte i vendosur të zbatonte me çdo kusht direktivat e marra nga Stambolli për të nënshtruar kryengritjen, duke shpresuar që brenda një kohe të shkurtër të fuste në dorë Idriz Seferin dhe Isa Boletinin. Por, në bisedat e zhvilluara me diplomatët austro-hungarezë, Shefqet Turgut Pasha deklaronte gjithashtu se dinte ta çmonte mirë vlerën e madhe të popullit shqiptar.²³

Shefqet Turgut Pasha u largua nga Kosova pasi trupat osmane morën Gjakovën dhe Pejë. Kjo u shoqërua me çarmatosjen e popullsisë shqiptare dhe vendosjen e rendit publik. Kurse organizimi dhe nënshtrimi i

²²HHSt.A.P.A.A., në AIH, Vj. 20-7-799, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 10.05.1910.

²³HHSt.A.P.A.A., në AIH, Vj. 20-15-1515, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 05.06.1910.

zonave malore u vendos që të bëhej vitin e ardhshëm.²⁴ Shtypja e kryengritjes së vitit 1910 krijoi një situatë të qetë, por të demoralizuar në mesin e popullsisë shqiptare. Kjo për shkak se drejtuesit e kryengritjes u nënshtruan, një pjesë u arrestua, ndërsa pjesa tjetër u dërgua në Shkup për t'u internuar në krahina të largëta të Anadollit. Kështu, një nga krerët kryesorë të Pejës, Zenel beun, e arrestuan në Stamboll dhe e dërguan në Prizren ku u gjykua nga Gjyqi Ushtarak, pastaj e dërguan në Shkup si të internuar. Kryetari i fisit të Berishës, Ahmet bej Gjakova, u arrestua, pastaj u lirua pasi pranoi të nënshtrohej. Rasim agai nga Luma me gjithë familjen prej 18 personash u dërgua i lidhur në Shkup; e njëjta gjë i ndodhi edhe Mustafa Litës. Kryetarin e fisit të Kabashit, në sanxhakun e Prizrenit, Rustem Kabashin, e varën. Sulejman Batusha, kryetari i fisit të Gashit, në krahinën e Gjakovës, nuk mundën ta arrestonin për shkak se së bashku me një numër luftëtarësh u arratis në zonat e thella malore ku forcat osmane e kishin të pamundur të depërtonin. Isa Boletini, i krahinës së Mitrovicës, u arratis në Podgoricë të Malit të Zi. Hasan Hysen Budakova, i krahinës së Prizrenit së bashku me 6 luftëtarë u arratis në Leskovc të Serbisë. Ndërsa, një nga drejtuesit kryesorë të kryengritjes, Idriz Seferi, u arratis në zonat malore dhe kërkoi të nënshtrohej, me kusht që t'i garantohej jeta.

Në raportet e diplomatëve francezë konfirmohet fakti se kontradikta kryesore e parisë shqiptare me Qeverinë osmane ishte politika centralizuese e regjimit xhonturk. Prandaj, kërkohet që këto masa të shoqëroheshin me investime publike siç ishte ndërtimi i rrugëve, shkollave dhe hekurudhave të cilat mungonin plotësisht. Nga diplomatët francezë Kosova konsiderohej si një vend i pasur me pyje dhe minerale, por që fatkeqësisht shfrytëzimi i tyre ishte lënë pas dore.²⁵

²⁴AMAE, në *AIH*, F.71.Raport i zëvendëskonsullit francez në Shkup, Kalvini, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkup, 15.06.1910, fl. 88.

²⁵AMAE, në *AIH*, F.71.Raport i zëvendëskonsullit francez në Shkup, Kalvini, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkup, 26.10.1910. fl.84-85

Hasan BELLO

SUMMARY

REBELLION OF THE YEAR 1910 IN THE OPTICAL OF DIPLOMACY

The uprising of 1910 was the result of repressive politics that the Ottoman government, led by the Union of Forces and Progress, attended the Albanian population. This policy was based on a structured violence that at its core had the main objective of the process of unification and subordination of all peoples of the Ottoman Empire. But these measures of central character stirred up controversy with the Albanians, who were promised that after the Revolution Xhonturk would enjoy an advanced status. This dissatisfaction was initially expressed by the Albanian MPs in the Ottoman Parliament. But the Jewish political elite, instead of considering the problems posed by these deputies, followed the tactic of violence. For this task, she commissioned some of the most well-known Ottoman Army commanders, for the purpose of suppressing and disarming the Kosovo Albanian population. Such an expedition encountered the resistance of the Albanian population. Serious battles took place between the two sides, among which the famous figures of the time emerged.

The Albanian-Ottoman confrontation did not go unnoticed by the diplomacy of European and Balkan countries. In their archives there is a considerable amount of documentation that allows us to shed light on various aspects of the 1910 Uprising. Certainly in this documentation is noticed the subjectivity, the bias, but there is also lack of abundant information or cold analysis of the eye of diplomacy. What characterizes these sources is the fact that in all the reports prevails the conclusion that what pushed Albanians toward the uprising was xhundur repression.

Fitim RIFATI

**VËSHTRIME DEMOGRAFIKE, EKONOMIKE DHE TË
KOMUNIKACIONIT NË KOSOVË GJATË GJYSMËS SË PARË
TË VITIT 1914**

(Politika shtetërore për serbizim)

Pushtimi dhe aneksimi i Kosovës nga Mbretëria e Serbisë dhe e Malit të Zi, më 1912-1913, veç tjerash u ndje edhe në strukturën demografike, në fushën ekonomike dhe të komunikacionit. Qenësia e strukturës demografike, zhvillimi dhe stabiliteti ekonomik në Kosovë u tronditën, sepse ruajtja e bërthamës etnike e përparimi ekonomik vareshin veçanërisht nga rrethanat politike dhe qëndrimi i Qeverisë e administratës serbo-malazeze ndaj shqiptarëve. Në fillim të vitit 1914, Mbretëria e Serbisë dhe pjesërisht ajo e Malit të Zi, nisën zbatimin e projekteve demografike, ekonomike dhe të komunikacionit në Kosovë e më gjerë, që i përshtateshin interesave politike.

Që në fillim vlen të theksohet se strukturën kombëtare dhe etnike të popullsisë në Kosovën historike, e përbënin kryesisht shqiptarët, ndërsa kombësitë dhe etnitë tjera ishin pakica, si: serbët, bullgarët, turqit, boshnjakët, hebrejët, romët e vllahët, kurse atë fetare, myslimanët dhe të krishterët. Shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë në Kosovë si para dhe pas pushtimit serb e malazez. Mirëpo, për shkak të vrasjeve e shpërnguljeve gjatë dhe pas luftërave ballkanike, popullsia e Kosovës pësoi rënie të konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të saj.¹ Sipas të dhënave

¹ Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi: Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, nr.446, viti 1913, dosja 62, fl.1, Rezume e statistikës së banorëve të krahinave shqiptare të vilajetit të vjetër të Kosovës, që i janë aneksuar Serbisë

statistikore serbe të publikuara në fillim të vitit 1914, numri i përgjithshëm i popullsisë në “Serbinë e Re”^{*} arrinte në 1 489 386 frymë. Në mesin e kësaj shifre *qarku i Zveçanit* kishte 81 643 frymë, *qarku i Kosovës* 193 337 frymë, *qarku i Kumanovës* 144 983 frymë, *qarku i Prizrenit* 124 101 frymë dhe *qarku i Shkupit* 157 078 frymë. Në këto statistika, organet administrative serbe përpiqeshin të zvogëlonin numrin e popullsisë etnike shqiptare.² Këto të dhëna statistikore përputhen edhe me të dhënat që kishte në dispozicion konsullata austro-hungareze në Shkup, e cila numrin e përgjithshëm të popullsisë në viset e reja të Mbretërisë së Serbisë e shifronte në 1 490 000 frymë.³ Edhe në qarkun e Pejës, nën administrimin malazez, popullsia shqiptare ishte shumicë absolute krahas një përqindjeje fare të vogël serbe. Sipas komandantit të Divizionit Lindor të ushtrisë malazeze, Janko Vukotiq, në qytetin e Pejës kishte 16 000-20 000 shqiptarë, ndërsa së bashku me rrethinën e saj kishte 50 000 frymë.⁴ Prej tyre kishte vetëm 480 banorë me përkatësi kombëtare serbe dhe fetare ortodokse.⁵ Ndërkaq në Gjakovë,

dhe Malit të Zi, më 1913; Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, Prishtinë: 1981, f. 11; Eqrem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Botim i tretë, Përktheu nga gjermanishtja Afrim Koçi, Tiranë: “IDK”, 2010, f.340; Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovës 1831-1912*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2014, f.889-896; Justin McCarthy, *Vdekje dhe dëbim - spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922*, Tiranë: “Alsar”, 2015, f.167.

^{*} Në qarqet politike, diplomatike dhe opinioniste serbe e ndërkombëtare të kohës, viset e pushtuara dhe aneksuara Mbretërisë së Serbisë më 1912-1913, njiheshin me emërtimin gjeopolitik “Serbia e Re” (“Nova Srbija”).

² *Политика*, “Нова Србија.”, Београд, 7 фебруара 1914. Године, страна 2; Instituti i Historisë i Kosovës, *Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995)*, Prishtinë: Qendra për Informim e Kosovës, 1997, f.34; Sabri Rexha, “Të dhënat statistikore për shqiptarët nga mesi i shek. XIX deri në fund të luftërave ballkanike”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, nr.35/2005, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2005, f.279-280.

³ *Arkivi i Institutit të Historisë - Tiranë* (më tej: *AIHT*), Fondi: Arkivi i Vjenës, Dokumente të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë të përkthyer në gjuhën shqipe, Vj.24-35-3526, Rezervat i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 19 mars 1914.

⁴ *Arkivi i Institutit të Historisë - Prishtinë (AIHP)*, Fondi: Dokumente nga Arkivi Shtetëror i Malit të Zi, Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Brendshme 1912-1914, kutia nr.6, Телеграм од Јанко Вукотић од Пећ послао Краљ у Подгорица, 19.X.1912; *AIHT*, dosja: A-IV-365, Branko Babiq, *Shpërngulja e myslimanëve nga krahinat e reja të Malit të Zi në pranverën e vitit 1914*, f. 1; *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (dokumente)*, Përgatiti dhe redaktoi: Zekeria Cana, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1997, f.103, Njoftim i J. Vukotiq nga Peja dërguar Mbretit, Pejë, 1 nëntor 1912.

⁵ Haki Kasumi, *Segmente të gërshetuara historike*, Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2011, f. 114.

në fillim të dhjetorit të vitit 1912, ushtria malazeze, sipas regjistrave osmanë, gjeti një popullsi prej 71 839 banorësh, prej të cilëve 10 554 ishin shqiptarë të besimit katolik të vendosur kryesisht rreth Gjakovës, 687 të besimit ortodoks me përkatësi kombëtare serbe, kurse pjesa tjetër ishin shqiptarë myslimanë.⁶ Sipas një raporti të Mitropolisë Ortodokse të Pejës, dërguar Cetinës, më 28 shkurt të vitit 1914, në Pejë, Gjakovë e viset përreth, kishte 13 240 shtëpi, ku secila familje kishte nga 5 deri në 76 anëtarë.⁷

Paralelisht me ndryshimet demografike, që në ditët e para kur ushtritë serbo-malazeze pushtuan fshatrat dhe qytetet e Kosovës, dhjetëra ndërmarrje, njësi të vogla zejtaro-tregtare e mijëra dyqane u paralizuan, u shkatërruan ose u mbyllën.⁸ Në pranverë të vitit 1914, për të studiuar gjendjen dhe nivelin e ekonomisë në Kosovë dhe në vise të tjera të pushtuara dhe aneksuara, Qeveria serbe me anë të Ministrisë së Ekonomisë Popullore dërgoi tri komisione të ndryshme profesionale, të cilat studimin e tyre e paraqitën në botimin me titull: “Ekonomia popullore në rajonet e bashkëngjitura”, që më pas iu prezantua deputetëve, politikanëve dhe opinionit serb. Në këto komisione morën pjesë edhe ekspertë të huaj për çështje të bujqësisë, blegtorisë dhe pylltarisë. Studimi vlerësoi tokën cilësore, potencialet bujqësore dhe të tregtisë së jashtme në Kosovë. Aty u konstatua se ekonomia e saj ishte shumë e pazhvilluar. Ky studim kërkonte në mënyrë urgjente të ndërmerreshin hapat e duhur teknik për ngjalljen dhe përparimin ekonomik të Kosovës dhe viseve të tjera.⁹

Një ndër degët kryesore të ekonomisë në Kosovë ishte bujqësia. Brenda kufijve të sotëm administrativ të Kosovës, gjatë administrimit serbo-malazez kishte rreth 400 hektarë tokë bujqësore.¹⁰ Toka pjellore e Kosovës favorizonte zhvillimin e kulturave bujqësore. Kushtet klimatike ndikonin që bimët prodhuese të grurit, elbit e tërshërës të nxirrnin rendiment të pasur në stinën e pranverës dhe të verës. Viti 1914, në kujtime të bashkëkohësve serbë, konsiderohet si i pëlleshëm në kuadër të zhvillimit të ekonomisë bujqësore.¹¹ Mirëpo, sado që pozita gjeografike dhe kushtet

⁶ Limon Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë, “Rilindja”, 1986, f. 38.

⁷ *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar...*, f. 321, Raport i Mitropolisë Ortodokse nga Peja dërguar Mbretit në Cetinë, Pejë, 17 mars 1913.

⁸ Marenglen Verli, *Kosova - sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: “Botimpex”, 2007, f.59-60.

⁹ Политика, "Привреда у Новој Србији.", Београд, 28 април 1914. Године, страна 1.

¹⁰ M. Verli, *Kosova - sfida shqiptare...*, f.56.

¹¹ *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës* (më tej: *ASHAK*), Fondi: Koleksioni - lënda memoare, kutia nr.2, Kujtime të Gjoke Pantiq, f.20.

klimatike mundësonin zhvillimin e bujqësisë, rendimenti bujqësor në Kosovë ishte në shënjestër të shfrytëzimit nga administrata serbo-malazeze. Organet serbe mbanin regjistra të zotërimeve të gjedhit (kuaj, qe, dele, dhi, derra), rezervave të elbit, ushqimeve të kafshëve si dhe pasurive të patundshme, të cilat më pas i uzurponin e rekuizonin, ndërsa detyrimet në të holla nuk i shlyenin fare.¹² Ato prekën edhe shtresën e pronarëve të pasur e të mëdhenj të tokave (bejlerëve), pronat e të cilëve shfrytëzoheshin për nevoja të ushtrisë. Një ndër këta pronarë të mëdhenj tokash, që u bë pikësynim i presionit të politikës shfrytëzuese serbe, ishte Danish Beu nga rrethina e Prishtinës. Në pamundësi sigurie për të shfrytëzuar dhe punuar tokat e tij, ai u detyrua të largohej nga Kosova, sikurse ishin detyruar ta bënë të njëjtën gjë shumë pronarë të tjerë të mëdhenj që u larguan në Shqipëri e vende të tjera.¹³ Vështirësitë ekonomike shkakttoheshin edhe si pasojë e dimrit të ftohtë, ku mungesa e bukës e bënte edhe më të rëndë jetesën e shqiptarëve. Kësisoj, rreth 20 fëmijë e të rritur vdisnin në ditë, për shkak të mungesës së bukës dhe acarit të fillimvitit 1914.¹⁴

Qytetet e Kosovës kishin tregjet e tyre, ku tregtoheshin mallra të ndryshme, si tekstil, punim dore etj.,¹⁵ por niveli i zhvillimit tregtar ishte i dobët. Lidhjet ekonomike ndërmjet qyteteve dhe zonave të Kosovës pothuajse ishin ndërprerë fare. Qyteti i Prizrenit, i cili para pushtimit serbo-malazez të Kosovës mbante lidhje ekonomike me qytetin e Pejës dhe të Gjakovës, ndërpreu këto kontakte për shkak se Peja dhe Gjakova në këtë kohë administroheshin nga Mbretëria e Malit të Zi.¹⁶ Kështu, tregtia e cila një pjesë të popullsisë i siguronte mjetet dhe artikujt elementarë të jetesës, mori tatëpjetën e rrjedhimisht u ngritën edhe çmimet në mallra e artikuj të ndryshëm.¹⁷

¹² *AIHT*, Vj.24-40-4041, Raport i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ në Vjen, Prizren, 27 shkurt 1914; Dimitrije Tucović, *Serbia dhe Shqipëria*, Prishtinë: “Zëri”, 2010, f.105-106.

¹³ *AIHT*, Vj.24-35-3546, Raport i konsullit të përgjithshëm dhe drejtuesit provizor austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 3 maj 1914.

¹⁴ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (janar-dhjetor 1914) II*, Përgatiti: Valentina Duka, Tiranë: “Toena”, 2012, f.312, Raport i Peckham për Crackanthorpe, Shkup, 4 prill 1914; *Taraboshi*, “Martizimet e Kosovës”, Shkodër, 24-25 kallnuer 1914.

¹⁵ *Политика*, “Од Скопља до Призрена.”, Београд, 16 марта 1914. Године, страна 1.

¹⁶ *AIHT*, nuk ka Vj., nr.45/P, Raport i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 9 mars 1914.

¹⁷ *AIHT*, Vj.24-38-3867, Relacion i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Umlauf, dërguar MPJ në Vjenë, Mitrovicë, 10 janar 1914; *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët... II*, f. 306, Raport i Peckham për Crackanthorpe, Shkup, 3 prill 1914.

Një degë e veçantë e ekonomisë bujqësore, që u prek ndjeshëm nga politikat e pushtuesve të rinj, ishte kultivimi i duhanit, i cili përbënte sektorin më prodhues të ekonomisë në Kosovë.¹⁸ Industria e duhanit kishte marrë relativisht përkujdesje shtetërore, ku Drejtoria e Monopolit në Beograd bënte pjesërisht blerjen dhe shitjen e sasisë së përgjithshme të duhanit që prodhohej në Kosovë dhe vise të tjera.¹⁹ Mirëpo, në gjysmën e parë të vitit 1914, blerja e prodhimeve të duhanit bëhej me një çmim e sasi fare të vogël nga shteti dhe atë vetëm sa për nevoja eksporti.²⁰ Kjo politikë ekonomike në Kosovë pati pasoja negative për kultivuesit e kësaj bime, sepse e bënte të paleverdishëm kultivimin e duhanit dhe e dëmtonte rëndë sektorin prodhues, që rrjedhimisht përhapte varfërinë e popullsisë. Faktorë të tjerë, që çuan në përkeqësimin e gjendjes ekonomike të popullsisë në Kosovë, ishin taksat e gjobat në të holla, të cilat caktoheshin e vileshtin arbitrarisht nga administrata e korruptuar serbe. Ndër këto taksa ishte edhe ajo e “ndihmës” (“pomoq”), e cila përpos të rriturave përfshinte edhe fëmijët, ndërsa vlera e saj arrinte shifrën e 24 dinarëve për çdo person.²¹ Veç kësaj, autoritetet administrative serbe në Kosovë kërkonin nga të gjithë kryepleqtë e fshatrave shlyerjen e një tatimi të jashtëzakonshëm, i cili arrinte një shumë prej 152-500 dinarë. Ky tatim iu ngarkua edhe popullsisë së qyteteve.²² Ato vunë taksa edhe për artikujt si kafeja e deri te shkrepëset që futeshin në territorin e Kosovës.²³

Në shkurt të vitit 1914, mbi bazën e këtij sistemi tatimor, Qeveria serbe planifikonte të realizonte mbi 50 milionë dinarë të ardhura vjetore nga viset e aneksuara. Nga tatimet e drejtpërdrejta (tatimi personal, tatimi për zanatçinjtë, tatimi nga puna vetjake), parashihej të realizoheshin 20 milionë dinarë, ndërsa 30 milionë dinarë nga tatimet indirekte. Qarqet e Kosovës paguanin disa lloje tatimesh, si: tatimin invalidor, tatimet proporcionale, taksat nga akciza e birrës, akciza e sheqerit, doganat, monopoli i kripës, monopoli i naftës, ekonomia

¹⁸ *AIHT*, Vj.24-35-3539, Rezervat e konsullit të përgjithshëm dhe drejtuesit provizor austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 20 prill 1914.

¹⁹ *Политика*, “Дуван у Новој Србија.”, Београд, 29 јануара 1914. Године, страна 3.

²⁰ *Политика*, “Буџет нови области.”, Београд, 8 фебруара 1914. Године, страна 1.

²¹ *AIHT*, Vj.24-35-3539, Rezervat i konsullit të përgjithshëm dhe drejtuesit provizor austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 20 prill 1914.

²² *AIHT*, Vj.24-40-4045, Informacion i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ Në Vjenë, Prizren, 26 shkurt 1914.

²³ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët... II*, f.312, Raport i Peckham për Crackanthorpe, Shkup, 4 prill 1914.

shtetërore, posta, telegrafi dhe telefoni.²⁴ Kësisoj, në mars 1914, Qeveria serbe caktoi këtë skemë tatimesh për Kosovën dhe vise të tjera të pushtuar dhe aneksuara:

Emri i qarkut	Banorë	Shuma e tatimit për kokë banori	Gjithsej
Shkupi	157.070	15,59 dinarë	2,449.500 dinarë
Tetova	146.805	14,64 dinarë	2,150.090 dinarë
Kumanova	144.983	14,33 dinarë	2,077.620 dinarë
Kosova	193.337	13,83 dinarë	2,673.850 dinarë
Prizreni	124.101	13,50 dinarë	1,675.380 dinarë
Zveçani	81.643	13,20 dinarë	1,077.690 dinarë ²⁵

Kjo skemë taksash e tatimesh ishte e papërbalueshme për popullsinë e varfër të Kosovës dhe nivelin e ulët të ekonomisë së saj. Rrjedhimisht, në rrethin e Mitrovicës, prej 1 460 000 dinarë taksa vjetore, vetëm 5 500 dinarë ishte shifra e përgjithshme e derdhur në arkën e këtyre taksave²⁶, një pjesë e të cilave destinoheshin në llogari të funksionarëve administrativë, të cilët ishin zhytur në korrupsion të thellë. Trajtimi diskriminues i pushtetit mbretëror serb në Kosovë, u tregua edhe në aspektin e vjeljes së taksave, që bëhej mbi baza kombëtare dhe fetare. Shqiptarët myslimanë dhe katolikë paguanin me të njëjtën shumë vlerën e taksave, ndërsa elementi serb ortodoks, ndonëse paguante në masë më të vogël, njëkohësisht nuk ishte i kënaqur me ngarkesat ekonomike që i shtoheshin nga taksat. Autoritetet e qarqeve dhe rretheve në rajonet e pushtuara peshën kryesore të veprimtarisë së tyre e koncentronin në vjeljen arbitrare të tatimeve të caktuara, taksave e gjobave në të holla. Ato kishin lejuar fenomenin e korrupsionit deri në atë shkallë sa nuk ishte parë ndonjëherë.²⁷

²⁴ *Политика*, “Буџет нови области.”, Београд, 8 фебруара 1914. Године, страна 1; *Политика*, “Нови порез.”, Београд, 2 марта 1914. Године, страна 1.

²⁵ *Политика*, “Распоред порезе.”, Београд, 5 марта 1914. Године, страна 2.

²⁶ *АИТ*, Vj.24-38-3887, Referat i përgjegjësit austro-hungarez në Mitrovicë, Umlauf, dërguar MPJ në Vjenë, Mitrovicë, 9 maj 1914.

²⁷ *АИТ*, Vj.24-38-3867, Relacion i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Umlauf, dërguar MPJ në Vjenë, Mitrovicë, 10 janar 1914; Vj.24-40-4032, Rezervat i zëvendëskonsullit austro-hungarez në Prizren, Kohlrus, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 27 janar 1914; *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët... II*, f. 306; Dimitrije Tucović, *Serbia dhe Shqipëria*, Prishtinë: “Zëri”, 2010, f.105-106.

Qeveria serbe, ndonëse e kishte lejuar rikthim në Kosovë të shqiptarëve të arratisur në Shqipëri, përmes organeve administrative në qarkun e Prizrenit, hartoi lista të hollësishme mbi dhënien e lejeve të posaçme për personat e interesuar në punimin e tokave të tyre në Kosovë. Mirëpo, paralelisht me këtë, për vise të caktuara si Luma dhe Hasi, në fund të marsit 1914, u ndalua frekuentimi i pazarit të Prizrenit.²⁸ Në një gjendje të rëndë ekonomike e financiare ishin pllakosur edhe familjet e kërërve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që vepronin në territorin e Shqipërisë politike. Në rrethana të vështira po jetonte edhe familja e Isa Boletinit. Nëna e tij u detyrua të kërkonte ndihmë materiale tek konsullata austro-hungareze në Mitrovicë.²⁹

Gjendja ekonomike e popullsisë shqiptare u vështirësua edhe më tej kur kafshët bartëse dhe qerret rekuizoheshin nga ana e ushtrisë, për t'i shërbyer nevojave të saj përgjatë kufirit me Shqipërinë. Vetëm më 16 dhe 17 maj 1914, mbi 260 kafshë nga Kumanova dhe mbi 130 nga Veleshi, ishin rekuizuar dhe destinuar në drejtim të Ferizajt dhe viseve perëndimore të Kosovës. Veç tyre, organet ushtarake rekuizonin edhe sasi drithi, sanë, kashtë e karroca.³⁰ Bazuar në politikat asimiluese, transformuese dhe shfarosëse ndaj shqiptarëve, që zbatonte administrata serbe në Kosovë, mund të konstatohet se pretendimet për ndryshime të thella ekonomike ishin të pabaralizuara, ndërsa investimet në infrastrukturë nuk kishin për qëllim mirëqenien e popullsisë vendëse, por nënshtrimin politik dhe socio-ekonomik të saj.

Në mars të vitit 1914, në qarqe ekspertësh agrarë serbë nisi të diskutohej edhe reforma agrare në Kosovë. Dr. Aleksandar Iliq, ekspert i çështjeve agrare, në një ligjëratë publike paraqiti rekomandimet e tij për zhvillimin e hovshëm bujqësor të Kosovës dhe viseve të tjera, duke sugjeruar që një bankë agrare serbe të bënte blerjen e pronave nga pronarët e mëdhenj të tokave, ndërsa Qeveria serbe jo vetëm që ishte e nevojshme të merrte pjesë në këtë projekt, por njëkohësisht kërkohej të bënte pagesën e

²⁸ *AIHT*, Vj.24-40-4054, Informacion i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 26 mars 1914.

²⁹ *AIHT*, Vj.24-38-3860, Urdhër nga Vjena drejtuar përgjegjësit të konsullatës në Mitrovicë - sekretarit Umlauf dhe konsullit të Përgjithshëm Petroviq në Vlorë, Vjenë, 10 shkurt 1914.

³⁰ *AIHT*, Vj.24-35-3554, Telegram i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 18 maj 1914; Vj.24-35-3556, Raport i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, 22 maj 1914; Vj.24-35-3559, Raport sekret i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 1 qershor 1914.

një shume të caktuar.³¹ Në të vërtetë, pasuritë e paluajtshme të bejlerëve e spahinjve në Kosovë arrinin me dhjetëra e qindra hektarë, prandaj ekspertët agrarë vlerësonin se një reformë për shpërndarjen e pasurive të tyre, në mënyrë proporcionale me shumicën e popullsisë, ishte e nevojshme. Mirëpo, një projekt i tillë nuk mund të finalizohet me sukses, sepse pothuajse të gjithë përfaqësuesit shtetërorë e intelektualë serbë, që bënë thirrje për reforma të tilla, praktikisht ishin shpërdoruesit më të mëdhenj. Si gjatë pushtimit të Kosovës dhe pas aneksimit të saj, pothuajse brenda një dite, çdo ministër, delegat popullor, profesor universiteti, gjyqtarë e kryetarë të qarqeve dhe të rretheve ishin bërë zotërues pronash të mëdha. Sekuestrimi e veçanërisht logjika e uzurpimit të tokave të mëdha në Kosovë kishte kaluar çdo limit saqë vetëm një delegat popullor kishte uzurpuar deri në 3 mijë hektarë ara.³² Kryeministri Nikolla Pashiq, e deputeti Jakov Corliq, në partneritet, kishin uzurpuar toka të gjera në fushën veriperëndimore të Prishtinës, e cila përfshinte edhe fshatrat Babin Moc e Mazgit, me 100 përkatësisht 180 shtëpi të banuara me shqiptarë. Kjo tokë e pasur dhe pjellore për kultura bujqësore, iu pagua emigrantëve shqiptarë nga partnerët Pashiq e Corliq jo më shumë se 90 dinarë për hektarë.³³

Në gjysmën e parë të vitit 1914, shteti serb i kushtoi vëmendje edhe çështjes së komunikacionit në “Serbinë e Re”. Niveli i dobët ekonomik, industrial e tregtar³⁴, përfshirë infrastrukturën rrugore dhe atë të ndërtimeve, nuk plotësonin nevojat themelore të administratës ushtarake, policore dhe shtetërore.³⁵ Qeveria serbe nisi punët në ndërtimin e rrugëve për të lidhur qytetet e Kosovës, si: rruga Pejë-Mitrovicë dhe rruga Prizren-Gjakovë. Në ndërtimin e këtyre rrugëve dhunshëm ishin angazhuar edhe një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve, të cilët administrata serbe para faktorit ndërkombëtar i deklaronte si anëtarë të xhandarmërisë, por në të vërtetë ata

³¹ *Политика*, “Аграрно питање у Новој Србије.”, Београд, 3 марта 1914. Године, страна 1.

³² *Политика*, “Против спахилука.”, Београд, 7 јуна 1914. Године, страна 1; Marenglen Verli, *Kosova në fokusin e historisë (Studime, analiza, dokumente)*, Vëllimi i Parë, Tiranë: “Botimpex”, 2000-2002, f. 106.

³³ *АИИТ*, Vj.24-35-3555, Njoftim i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 21 maj 1914; Milovan Obradović, *Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941)*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2005, f. 106.

³⁴ *АИИТ*, Vj.24-35-3526, Rezervat i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 19 mars 1914.

³⁵ *Политика*, “Велика радови у новим крајевима.”, Београд, 7 марта 1914. Године, страна 2.

bënin punë angari nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të forcave ushtarake. Qeveria serbe bënte edhe shtrimin e zgjerimin e rrugëve ekzistuese, emërtimin e tyre dhe vendoste numra identifikues nëpër shtëpi.³⁶

Hapja e arterieve rrugore gjatë stinës së verës dhe të vjeshtës së vitit 1913, kishte nxitur edhe qarkullimin e komunikacionit. Kështu, në shkurt të vitit 1914, nisi të funksiononte transporti automobilistik i udhëtarëve dhe sendeve përmes kamionëve dhe automjeteve në vijën Prizren-Ferizaj e anasjelltas, si dhe midis qyteteve të tjera. Për transportin e mallrave ishin sjellë nga Gjermania dy makina të mëdha.³⁷ Ndërtimeve të reja rrugore iu shtua edhe ajo e Suharekës (rruga Prizren-Ferizaj), në Pirana (rruga Prizren-Gjakovë), që ishte shumë e rëndësishme si në aspektin e zhvillimit ekonomik, por edhe në atë strategjik, për qarkullimin e trupave ushtarake.

Kontribut në ndërtimin e këtyre rrugëve jepte edhe popullsia e fshatrave përreth këtyre rrugëve të reja, duke bërë punë angari. Vetëm në ndërtimin e një rruge në veriperëndim të Prizrenit, që përshkonte drejtimin Vlashnje-Goricë-Nashec-Landovicë, punonin çdo ditë 50-100 shqiptarë të fshatrave në fjalë e atyre përreth, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të forcave ushtarake serbe.³⁸ Veç lidhjeve rrugore, Qeveria serbe e konsideronte të rëndësishëm hapjen e arterieve dhe njejeve të reja hekurudhore³⁹, të cilat e lidhnin territorin e saj në të gjitha drejtimet me Kosovën dhe përpos qarkullimit të njerëzve dhe forcave ushtarake nxisnin edhe zhvillimin e tregtisë.

Në mars 1914, Qeveria serbe, veç tjerash vendosi ndërtimin e hekurudhave të reja edhe në drejtimet: Merdar-Prishtinë-Prizren; Shkup-Tetovë-Gostivar-Kërçovë-Prilep-Manastir; Rashkë-Pazar i Ri-Senicë-Priboj-Uvac.⁴⁰ Në fund të muajit prill 1914, nisën punimet për ndërtimin e

³⁶ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët (tetor-dhjetor 1913) I*, Përgatiti: Valentina Duka, Tiranë: "Toena", 2012, f.116, Raport i Peckham për Crackanthorpe, Shkup, 22 shtator 1913.

³⁷ *AIHT*, Vj.24-40-4040, Raport i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 26 shkurt 1914; *Политика*, "Аутомобили за нове крајеве.", Београд, 2 март 1914. Године, страна 3.

³⁸ *AIHT*, Vj.24-40-4048, Raport i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 10 mars 1914; Vj.40-4051, Informacion i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 21 mars 1914.

³⁹ Српска Академија Наука и Уметности - Одељење Историјских Наука, *Документи о Спољној Политички Краљевине Србије 1903-1914*, Књига V, Свеска 3, 5/18. Октобар - 31 Децембар 1912/13. Јануар 1913. Ириредно Михаило Војновић, Београд: 1984, f.675, Telegram i N. Pashiq dërguar ambasadës serbe në Petrograd, Beograd, 20 dhjetor 1912.

⁴⁰ *Политика*, "Нове пруге.", Београд, 9 марта 1914. Године, страна 1.

hekurudhës në vijën Nish-Prokuple-Kurshumli-Merdar-Prishtinë, trase e cila parashihej të përfundonte brenda tre vitesh. Kontratën për ndërtimin e saj e fitoi një kompani franceze.⁴¹ Për këtë çështje Kosovën e vizitoi edhe ministri i Ndërtimeve, i cili më 2 maj 1914, me automobil arriti në Mitrovicë dhe udhëtoi me tren deri në Prishtinë, ku kishte qëndruar atje për 1 orë. Qëllimi i vizitës së tij ishte studimi nga afër i planit për trasenë e re të hekurudhës Rashkë-Mitrovicë-Nish-Prishtinë.⁴² Më 26 qershor 1914, Dhoma e Tregtisë në Shkup, në Shtëpinë e Oficerëve, i shtroi darkë pune disa tregtarëve boshnjakë. Në fjalimet që u mbajtën gjatë kësaj darke, tregtarët boshnjakë konsideruan se marrëdhëniet tregtare ndërmjet serbëve dhe boshnjakëve do të zhvilloheshin e forcoheshin edhe më shumë pas zgjerimit të rrugës hekurudhore Uvac-Mitrovicë.⁴³

Me ndërtimet dhe linjat e reja hekurudhore, Qeveria serbe synonte të ndërkombëtarizonte hekurudhat e saj⁴⁴ dhe të tërhiqte prodhimet e Kosovës drejt Serbisë. Ajo pretendonte po ashtu t'i atribuonte pushtimit dhe aneksimit të Kosovës një përparim të hovshëm ekonomik e shoqëror dhe njëkohësisht t'i krijonte faktorit ndërkombëtar përshtypjen e një situatë politike të ekuilibruar dhe të sigurt për të gjithë popullsinë e saj. Ndërkohë, gjendja ekonomike dhe e komunikacionit në zonën e pushtimit dhe administrimit malazez, u përcoll me probleme njësoj sikurse në zonën e pushtimit dhe administrimit serb. Që në ditët e para të pushtimit malazez, shtëpitë e shqiptarëve ishin të shkatërruara, të shembura ose të dëmtuara si pasojë e operacioneve ushtarake gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Mungonte zhvillimi normal i kulturave bujqësore dhe ndjehej mungesa e rezervave ushqimore.⁴⁵ Pazari i Gjakovës kohë pas kohe mbahej në embargo për shqiptarët e Malësisë së Gjakovës, ndonëse pati përpjekje nga kancelaritë evropiane për ta zhblllokuar atë për nevoja të shqiptarëve.⁴⁶

⁴¹ *Политика*, "Ниш - Мердаре.", Београд, 13 април 1914. Године, страна 1.

⁴² *АИHT*, Vj.24-38-3885, Referat i përgjegjësit austro-hungarez në Mitrovicë, Umlauf, dërguar MPJ në Vjenë, Mitrovicë, 3 maj 1914.

⁴³ *АИHT*, Vj.24-35-3569, Njoftim sekret i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez në Shkup, Jelička, dërguar MPJ në Vjenë, Shkup, 27 qershor 1914.

⁴⁴ *ASHAK*, Fondi: Јован Јовановић - Пижон, N o t e übergeben den Wiener Bank-Verein im Name nder österreichisch-ungarischen Bankengruppe, кутија бр. 13.

⁴⁵ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët... I*, f.425, Ekstrakt nga letra private dërguar nga koloneli Phillips, 10 nëntor 1913.

⁴⁶ *АИHT*, Vj.24-5-510, Raport i ambasadës austro-hungareze në Londër, dërguar MPJ në Vjenë, Londër, 22 maj 1914; Vj.24-7-800, Urdhër i Vjenës dërguar kontit Mensdorf në Londër, Vjenë, 4 qershor 1914; *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët... II*, f.386, Njoftim i Edward Grey për F. Bertie, Forin Ofis, 5 maj 1914.

Krahas zhvillimit të dobët ekonomik, Mbretëria e Malit të Zi përballej me një buxhet vjetor të vogël (4 milionë dinarë), i cili nuk mjaftonte për ngritjen ekonomike të shtetit malazez. Në vitin 1914, si rezultat i pushtimit dhe aneksimit të viseve shqiptare dhe një politike tatimore në kurriz të tyre, ky buxhet u trefishua, duke arritur shumë mbi 12 milionë dinarë.⁴⁷ Mirëpo, rritja e këtij buxheti varej nga tatimet në viset e pushtuara prej të cilave Qeveria e Malit të Zi planifikonte të grumbullonte 7 034 500 dinarë, ndërsa nga ekonomia shtetërore 930 814 dinarë dhe nga të ardhurat e ndryshme 224 800 dinarë. Ky buxhet nënkuptonte se qëndrueshmëria ekonomike e Malit të Zi varej nga të ardhurat e tatimeve (të dhjetat, taksa dhe mbitaksa, dogana, akcizat, monopoli).⁴⁸ Të gjitha këto masa rëndonin popullsinë shqiptare nën pushtimin dhe administrimin malazez.

Ndër format më të përhapura të shfrytëzimit ekonomik të shqiptarëve në këtë zonë, ishin: taksa të ndryshme e jashtëzakonisht të papërbalueshme, vjelja e të dhjetave, sekuestrimi i bagëtisë, drithit, pronave e pasurive të tjera, puna angari dhe gjobitje të ndryshme. Organet administrative malazeze formuan një Komision për Pajtimin e Gjaqeve, i cili u përdor për të ndëshkuar shqiptarët me dëmshpërblime, për gjoja veprat penale të tyre kundër elementit serb në Rrafshin e Dukagjinit, si në kohën e Perandorisë Osmane dhe në kohën e pushtimit malazez.⁴⁹ Në këto rrethana, familjeve të arratisura u konfiskohej pasuria e tundshme (bagëtia, drithi), e cila më pas shitej ose përdorej për nevoja të ushtrisë dhe administratës malazeze.⁵⁰ Kështu, grabitja e tokës kishte marrë formë të institucionalizuar. Në Pejë e Deçan, Qeveria malazeze përmes aparatit administrativ i largonte pronarët me forcë nga tokat e tyre, të cilat më pas i konfiskonte.⁵¹ Me gjithë buxhetin e dobët të vitit 1914, u përmirësua dhe u rindërtua rruga Pejë-Gjakovë, nga puna e detyrueshme e shqiptarëve dhe nën masa dhune e abuzimi psiko-fizik ndaj tyre.⁵² Për pasojë, u thellua edhe

⁴⁷ *Политика*, “Црногорски буџет.”, Београд, 1 фебруара 1914. Године, страна 1.

⁴⁸ *Политика*, “Црногорски буџет.”, Београд, 1 маја 1914. Године, страна 1

⁴⁹ *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar...*, f. 45.

⁵⁰ *Po aty*, f. 208-209, Telegramë të R, Veshoviq për ministrin Gojnik, Pejë, 20-21 maj 1913.

⁵¹ *Dokumente britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët... I*, f. 123, Raport i Peckham për Crackanthorpe, pa datë.

⁵² *AIHT*, Vj.24-36-3661, Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, dërguar MPJ në Vjenë, 30 shtator 1914; *Taraboshi*, “Mizorrinat në Kosovë”, Shkodër, 21-22 prill 1914.

më tej hendeuku i varfërisë dhe u ngritën çmimet e drithit dhe mallrave të tjera.⁵³

Për sa më sipër, mund të përfundojmë se: *së pari*, strukturën demografike të Kosovës dhe viseve të tjera të pushtuara dhe aneksuara Mbretërisë së Serbisë dhe Malit të Zi, e përbënin kryesisht shqiptarët dhe se pushteti i ri synonte minimizimin e përqindjes së tyre, duke i mohuar përkatësinë kombëtare; *së dyti*, zbatimi i politikave ekonomike në Kosovë, që në përgjithësi synonin ndryshimin e fizionomisë pronësore e agrare dhe rëndonin popullsinë shqiptare me taksa e tatime të papërballueshme, kishin për qëllim nxitjen e shqiptarëve për t'i braktisur vendbanimet e tyre dhe për t'u shpërngulur jashtë kufijve shtetërorë serbë e malazezë; *së treti*, politikat për zhvillimin e komunikacionit rrugor dhe atij hekurudhor në zonën e pushtimit dhe administrimit serb, në mënyrë ekskluzive i përshtateshin synimeve shtetërore të Mbretërisë së Serbisë, për të tërhequr prodhimet nga Kosova dhe për t'i dhënë këtyre trevave pamjen dhe tiparet e një territori serb.

⁵³ *AIHT*, Vj.24-40-4063, Informacion i konsullit austro-hungarez në Prizren, Lejhanec, dërguar MPJ në Vjenë, Prizren, 21 prill 1914.

Fitim RIFATI

SUMMARY

DEMOGRAPHIC, ECONOMIC AND COMMUNICATIONS SURVEYS IN KOSOVA DURING THE FIRST HALF OF 1914

(State policy for Serbianisation)

The conquest and annexation of Kosova from Kingdom of Serbia and Montenegro in 1912-1913, among other things had an impact in the demographic structure, economic and communication areas. The essence of demographic structure and economic development and stability in Kosova were shaken because preservation of the ethnic core, economic development dependent strongly on the political circumstances and the attitude of Serbian-Montenegrin administration towards the Albanians. In the first half of 1914, population censuses were undertaken as well as economic projects aiming the reformation of the issues regarding land and other property ownership and started projects for the repairing of road and railway infrastructure.

However, in general, demographic structure of Kosova and other areas conquered and annexed by Serbian and Montenegrin Kingdom, was mainly composed of Albanians. The new government tried minimizing their percentage by denying their national identity. Implementation of economic policy in Kosova, which mainly aimed at changing the physiognomy of property and agricultural property by burdening Albanian population with unaffordable taxes. Hence, encouraging Albanians reluctantly to abandon their settlements and migrate outside Serbian and Montenegrin borders. Policies for the railway and road communication in the Serbian occupied and administrated zone were adjusted exclusively to the state goals of the Kingdom of Serbia, to extract products from Kosova and to give these areas appearance and features of a Serbian territory.

Sali KADRIA

**ÇËSHTJA E PRINCIT TË SHQIPËRISË DHE KONTRIBUTI I
AUSTRO-HUNGARISË PËR RRJETIN E KOMUNIKACIONIT NË
VISET SHQIPTARE GJATË VITEVE 1916-1918**

Marrëdhëniet e Austro-Hungarisë me Shqipërinë dhe shqiptarët janë të hershme për nga shtrirja kohore, por edhe të gjera për sa i përket kontributit dhe intensitetit të tyre. Megjithëkëtë, në këtë artikull do të përqëndrohem në trajtimin e disa aspekteve historike që lidhen me të ardhmen e çështjes së Princit të Shqipërisë si dhe kontributin e Austro-Hungarisë për ndërtimin e sistemit të transportit dhe të komunikacionit në Shqipëri gjatë viteve 1916-1918.

Çështja e Princit të Shqipërisë

Pas fillimit të “Luftës së Madhe”, një nga çështjet që shqetësonte së tepërmi shqiptarët ishte se çfarë do të ndodhte me fatin e tyre në të ardhmen. Krahas problemeve të tjera, ekzistenca e shtetit shqiptar ishte vënë në pikëpyetje edhe për shkak të mungesës së kryetarit të shtetit shqiptar. Problemi e kishte zanafillën në periudhën gusht-shtator 1914, kur Princ Vidi u gjend në pozitë mjaft të vështirë, për shkak të trysnisë së lëvizjes kryengritëse dhe mungesës së burimeve financiare të Principatës së Shqipërisë. Drejtuesit e qeverisë austro-hungareze kushtëzuan dhënien e kredisë së premtuar për Princ Vidin, vetëm nëse ai i shpallte luftë Serbisë¹. Ministri austro-hungarez i Punëve të Jashtme, Berthold, u përpoq të

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 75.

tundonte Princ Vidin, me perspektivën e rritjes së autoritetit të tij, duke shfrytëzuar “dëshirën e zjarhtë të shqiptarëve për bashkim kombëtar”².

Princ Vidi nuk preferoi t’i hynte një aventure të tillë, së cilës nuk i dihej fundi. Ai hodhi poshtë këtë ofertë, mbështetur në dy argumente kryesore. *Së pari*, hyrja e shtetit shqiptar në luftë me Serbinë, ishte jashtë mundësive reale të tij, pasi vendi ishte mbërthyer nga një lëvizje e gjerë kryengritëse. *Së dyti*, përfshirja e shtetit shqiptar në luftë, shkelte parimin e neutralitetit të Shqipërisë të sanksionuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913, duke vënë në pikëpyetje të ardhmen e shtetit shqiptar, e cila përbënte arritjen më të madhe kombëtare të shqiptarëve deri në këtë periudhë. Mirëpo, kjo përgjigje i kushtoi shumë Princ Vidit, pasi që nga ky moment, Austro-Hungaria mbështetësja kryesore e tij, i ktheu shpinën. Meqenëse Princ Vidit nuk i mbeti rrugë tjetër, më 3 shtator 1914, ai vendosi të largohej përkohësisht nga Shqipëria, duke ia besuar administrimin e vendit Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK)³. Në këto rrethana, gjykojmë se aktet e fundit ishin ndër veprimet më të mirëmenduara nga ana e Princ Vidit, gjatë periudhës së shkurtër të qëndrimit të tij në Shqipëri.

Qëndrimi i shqiptarëve ndaj çështjes së caktimit të një princi në krye të shtetit shqiptar u orientua në dy drejtime. *Drejtimi i parë*, lidhej me përpjekjet e një numri shqiptarësh për caktimin e një princi osman në krye të shtetit shqiptar. *Drejtimi i dytë*, kishte të bënte me synimin e shqiptarëve për rikthimin e Princ Vidit në krye të fronit shqiptar. Më 26 shtator 1914, Këshilli i Përgjithshëm i Shqipërisë së Mesme ngarkoi Haxhi Aliun nga Elbasani me detyrën e delegatit që do t’i propozonte Portës së Lartë ndër të tjera edhe kërkesën për caktimin në krye të shtetit shqiptar të një princi nga dinastia osmane⁴. Në tetor të vitit 1914, Esat Pashë Toptani hyri nga Serbia në krahinën e Dibrës, duke deklaruar se Shqipëria ishte një mbretëri asnjane⁵. Këshilli i Përgjithshëm ose siç njihej me emrin Senati i Durrësit nën drejtimin e Esat Pashës shpalli në gjuhën turke se do të përpiqej për të

² Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, përkthyer nga Korab Hoxha dhe Fatmir Mborja, Tiranë: “Ideart”, 2004, f. 77.

³ “Proklamata q’e dha Mbreti ynë para t’a lerë Durrësin”, në *Atdheu*, nr. 63, Shkodër, 30 gusht-12 shtator 1914, f. 1.

⁴ *Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë*, (më tej: *AQSH*), Viti (më tej: V.) 1914, Fondi (më tej: F.) 32, Dosja (më tej: D.) 173, fl. 113, Telegram i Prefektit t’Elbasanit, drejtuar Kryesisë së Këshillës së Përgjithshme, 15 Vjeshtë III, 1330; J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 196.

⁵ P. Ndoci Nikaj, *Historija e Shqypniës. Ç’më kohë t’vjetra e deri m’tashmet*, Shkoder: “Nikaj”, f. 210.

siguruar bashkimin kombëtar deri në bashkimin me Perandorinë Osmane ose nëse kjo nuk ndodhte, deri në caktimin e një princi nga dinastia osmane⁶. Esat Pashë Toptani përhap fjalë te kryengritësit se pas tij do të vinte Princi Burhanedin i Stambollit, për të marrë në dorë sundimin e Shqipërisë. Në fund të vitit 1914, në afërsi të Krujës u thirr një mbledhje e delegatëve nga të gjitha krahinat, që kishin ngritur krye kundër Esat Pashë Toptanit. Delegatët u thirrën nën kryesinë e Mehmet Gjinalit në çifligun e Abdi Toptanit. Lidhja e formuar mori emrin “Bashkimi i Krujës” [Itifak - S.Kadria]. Vendimet e mbledhjes u pasqyruan në shpalljen e lëshuar më 29 dhjetor 1914, në të cilën kërkohej “bashkim me Turqinë ose një princ mysliman të shpallë mbret i Shqipërisë”⁷.

Faik Konica një nga kundërshtarët e vendosur të caktimit të një princi mysliman për Shqipërinë gjatë vitit 1913, ndryshoi krejtësisht qëndrimin e tij, pasi tashmë kërkonte që të braktisej Princ Vidi dhe në vend të tij të caktohej një princ i derës osmane. Në funksion të këtij qëllimi, ai hyri në bisedime me Ali bej Bashllamba dhe Arif Tahsim Bej, përfaqësues të shtetit osman përmes një personi të tretë në hije⁸, i cili ishte sponsorizues financiar i këtij projekti politik. Gjatë bisedimeve dypalëshe u trajtuan dy çështje kryesore: 1. Hartimi i një programi politik, me synim vendosjen në krye të fronit shqiptar të një princi osman; 2. Gjetjen e mjeteve praktike për realizimin e programit të caktimit të princit osman në krye të Shqipërisë⁹.

Në këndvështrimin e Faik Konicës, ndryshimi i qëndrimit të tij politik u përcaktua nga disa rrethana dhe faktorë të rëndësishëm politikë në plan afatgjatë. Gjermania dhe Austro-Hungaria kundërshtonin me ngulm restaurimin e Princ Vidi, për shkak se Princ Vidi nuk arriti të siguronte simpatinë dhe mbështetjen e shqiptarëve. Dinastia Wied konsiderohej e falimentur plotësisht ndërkohë që fronti i Shqipërisë kishte mbetur vakant. Meqenëse çështja shqiptare kërkonte një zgjidhje serioze dhe të

⁶ Haus - Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien, (më tej: HHStA, PA, A), në Arkivin e Institutit të Historisë (më tej: AIH), Vj. 24-31-3154, Raport i konsullit austro-hungarez, drejtuar kont Berthold, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Vlorë, 9 tetor 1914.

⁷ J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 198.

⁸ **Shënim:** Në dokumentin arkivor të shfrytëzuar, emri i ndërmjetësit të Faik Konicës me zyrtarët osmanë nuk është i qartë. Mendojmë se emri i tij duhet të jetë Tefikçjoff, Teufikçjoff ose Tufektioff, por nuk jemi të sigurtë.

⁹ AQSH, F. 13, V. 1916, D. 2, fl. 12-13, Promemorije e hartuar nga Faik Konica për të sjellë në krye të fronit mbretëror shqiptar një princ turk mysliman, Konstandinopël, 9 shkurt 1916.

qëndrueshme, duhej të mbahej parasysh eksperiencia e mëparshme dhe të respektoheshin ndjenjat e popullit shqiptar.

Zgjedhja e një princi mysliman për fronin e një vendi me popullsi në shumicë myslimane, imponohej nga disa arsye të natyrës emergjente dhe utilitare. *Së pari*, në mbështetje të interesave më të larta të atdheut dhe kombit shqiptar, kërkohej rivendosja e menjëhershme e kryetarit të shtetit që të rivendosej disiplina dhe rendi publik brenda vendit. *Së dyti*, vendosja një princi mysliman në krye të fronit të Shqipërisë, do të ndikonte që shumica e popullit shqiptar t'i bindej atij dhe në këtë mënyrë do të arrihej në mënyrë të lehtë rivendosja e autoritetit të shtetit shqiptar¹⁰.

Në këndvështrimin e Faik Konicës, projekti i tij politik do të mund të bënte për vete popullin dhe intelektualët shqiptarë, vetëm nëse merrte një formë të dukshme dhe mishërohej me zgjedhjen e një personaliteti të shquar dhe aktiv. Ai mendonte se zgjedhja sa më parë i emrit të kandidatit për Princ të Shqipërisë nga oborri perandorak osman, do të kontribuonte për popullarizimin e propozimit të tij politik. F. Konica theksonte se propozimi i tij ishte mirëpritur nga qarqet zyrtare të Stambollit dhe pritej miratimi nga ana e sulltanit.

Për realizimin e këtij programi politik, mendohej të krijohej një “Komitet veprimi”, selia e të cilit mund të ishte Stambolli, Vjena ose Sofja, pasi tashmë kjo e fundit për shkak të pozitës gjeografike, kishte avantazhin e vendosjes së një kontakti më të lehtë dhe të shpejtë me Shqipërinë. Faik Konica mendonte që përpara se të krijohej ky komitet, ishte e domosdoshme që ai të konsultohej me disa personalitete politike shqiptare me rëndësi që gjendeshin në Vjenë, Zvicër dhe Greqi. Ai kërkonte që në të njëjtën kohë që punohej për gjetjen e emrit të Princit të Shqipërisë, të fiksohej selia e qendrës së veprimit për zbatimin e këtij programi, si dhe “Komiteti i veprimit” të botonte një organ shtypi në gjuhën frënge, i cili të publikonte herë pas here suplemente në gjuhën shqipe dhe atë turke rreth kësaj çështjeje. Qëllimi i këtij organi do të ishte që të luftohej veprimtaria e “fletushkave” të tilla, si “Shqipëria”, e cila botohej në Lozanë të Zvicrës me ndihmën financiare të Princeshës Sofia bashkëshortes së Princ Vedit¹¹. Sigurimi i besimit dhe i mbështetjes nga ana e qeverisë austro-hungareze për realizimin e këtij projekti, konsiderohej prej tij si një arritje e rëndësishme. Nëse arrihej ky objektivi, ai mendonte se do të krijohej një mundësi e mirë për realizimin e kësaj ideje, sepse pas okupimit të shumicës

¹⁰ *Po aty.*

¹¹ *Po aty.*

së trojeve shqiptare nga Austro-Hungaria, kjo e fundit kishte hapësira të mëdha për të vepruar në Shqipëri. Për këtë qëllim, “Komiteti i veprimit” do të duhej të bënte demarshe pranë personaliteteve të rëndësishme politike të Austrisë. Në këtë kuadër, autoritetet austro-hungareze i kishin të gjitha mundësitë që të organizonin një kongres kombëtar në një krahinë shqiptare. Ky kongres do të zgjidhte sovranin e Shqipërisë si dhe një qeveri të përkohshme kombëtare.

F. Konica mendonte se për zbatimin e këtij programi, do të duhej të gjendej një personalitet shqiptar i përshtatshëm, i cili të plotësonte dy kriteret: *Së pari*, “të donte dhe të ishte i aftë që ta udhëhiqte këtë punë”. *Së dyti*, personaliteti shqiptar, të cilit do t’i besohej organizimi i punës për çështjen e gjetjes së një kandidature të përshtatshme për princ të Shqipërisë, do të duhej të njihte dhe të njihej mirë në qarqet politike të Stambollit. Zgjidhjen e kësaj çështjeje, Faik Konica e kishte konceptuar në dy variante. *Varianti i parë*, parashikonte që personi më i përshtatshëm që mund të kryente këtë detyrë ishte vëllai i tij Mehmet Konica. Ai mendonte se ky i fundit plotësonte disa parakushte. M. Konica mbante detyrën e përfaqësuesit të Shqipërisë në KNK dhe para se Princ Vidi të largohej nga Shqipëria, ia kishte dorëzuar pushtetin e tij KNK-së. Për këtë arsye, M. Konica ishte autoriteti i vetëm ligjor që mund të fliste dhe të vepronte në emër të shtetit shqiptar. Në këtë periudhë M. Konica ndodhej në Korfuz, prandaj prania e tij në rajon, pranë Shqipërisë dhe Stambollit përbënte një avantazh me rëndësi për të çuar përpara këtë projekt. Bashkëpunimi i M. Konicës ishte me rëndësi, pasi ai ishte një personalitet me njohje të gjera politike në qarqet politike të shtetit osman dhe brenda vendit, ç’ka i jepte atij peshë politike e ligjshmëri më të madhe. *Varianti i dytë*, parashikonte që nëse personi me kriteret e lartpërmendura nuk do të gjendej, atëherë Faik Konica shprehej se do të detyrohem “t’i vihem vetë drejtpërdrejt punës në mënyrë që të kryej misionin tim deri në fund”¹².

Pavarësisht vështirësive të shumta për realizimin e këtij projekti, pas kthimit nga Stambolli në Vjenë, Faik Konica shprehej se “unë kam vazhduar pa lëkundje punën e filluar”. Veprimtaria e tij politike për çështjen e caktimit të një princi osman në krye të fronit shqiptar u fokusua në tre drejtime kryesore: organizimin e një mbledhjeje me veprimtarët kombëtarë shqiptarë, për themelimin e “Komitetit të veprimit”; krijimin e kontakteve me autoritetet zyrtare austro-hungareze të fushës politike dhe publicistike;

¹² AQSH, F. 13, V. 1916, D. 2, fl. 12-13, Promemorie e hartuar nga Faik Konica për të sjellë në krye të fronit mbretëror shqiptar një princ turk mysliman, Konstandinopël, 9 shkurt 1916.

dhe zhvillimin e bisedimeve me diplomatë dhe përfaqësues zyrtarë të shtetit osman.

Faik Konica organizoi një mbledhje në Vjenë, ku ishin të pranishëm Nyzhet bej Vrioni, Dervish Hima, Ibrahim Pasha Zade, Rexhep Efendiu, Xhelal Beu dhe figura të tjera shqiptare më pak të njohura, si dhe mjaft studentë e tregëtarë shqiptarë që gjendeshin apo vizitonin Perandorinë Austro-Hungareze. Shumica e personaliteteve shqiptare të mësipërme u bashkuan me projektin e tij politik. Prandaj, ai shprehej me entuziazëm se ndonëse fillimisht “kisha frikë se mos ndonjëri prej tyre më dilte austrofil, por të gjithë u treguan burra fjale”. Për të tërhequr pas vetes personalitete të rëndësishme, ai shkruante se, “unë kam shkuar dy herë në Budapest dhe do të shkoj përsëri për Dervish Himën”. Ai kishte biseduar me mjaft tregëtarë shqiptarë që gjendeshin në Hungari, me qëllim që kur këta të ktheheshin në Shqipëri, të bënin sa më shumë propagandë për çështjen e caktimit të një princi osman për Shqipërinë. Falë këtij përkushtimi, u arrit të krijohej “një lloj Komiteti mbikqyrës”¹³.

Pas kthimit nga Stambolli, Faik Konica vizitoi menjëherë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Luftës në Vjenë, ku paraqiti programin e tij politik për caktimin e një princi osman në krye të fronit të Shqipërisë. Ai shprehet se gjatë këtyre takimeve “më pritën me korrektësi, por edhe me ftohtësi të theksuar. Nuk treguan vullnet për të pranuar shpejt pikpamjen tonë, megjithatë nuk u treguan edhe kundërshtarë”¹⁴. Në të njëjtën kohë, Faik Konica u paraqit edhe në ambasadën osmane në kryeqytetin austriak, ku dorëzoi platformën e tij politike për këtë çështje. Ai shkoi në Budapest, ku u takua me gazetarin mjaft të njohur Armand Sasvari, të cilit i kërkoj të shkruante një broshurë në gjuhën hungareze, për çështjen e princit mysliman. Promovimit të idesë së tij në qarqet publicistike, Faik Konica i kushtonte mjaft rëndësi. Ai i premtoi gazetarit të mësipërm se do t’i paguante të gjitha shpenzimet e nevojshme të shtypit dhe honorarin për të drejtën e autorit. Konica mendonte se më vonë ky botim mund të publikohej edhe në gjuhën gjermane. Pavarësisht përpjekjeve të shumta, ecuria e projektit të Faik Konicës ndeshi në kundërshtime dhe pengesa të pakapërcyeshme. Kundërshtimi dhe vështirësia kryesore u krijua nga qeveria austro-hungareze. Dhjetë ditë pas kthimit nga vizita e tij e dytë në Budapest, autoritetet austro-hungareze i kërkuan Faik Konicës që të

¹³ *Po aty*, F. 13, V. 1916, D. 3, fl. 31-34, Letër në frëngjisht e Faik Konicës, drejtuar një beu të paidentifikuar lidhur me çështjen e princit mysliman turk, Baden afër Vjenës, 25 prill 1916.

¹⁴ *Po aty*.

paraqitej menjëherë në Ministrinë e Punëve të Jashtme për një takim. Gjatë bisedës me funksionarë të lartë të Ballhausplatz-it, F. Konica i njohu të pranishmit me projektin e tij. Ai u shpreh se qëllimi i kësaj platforme ishte që të zgjidhej problemi i mbretit të Shqipërisë, me ndihmën e Austro-Hungarisë dhe aleatëve të saj, por duke u mbështetur në vullnetin e popullit shqiptar. F. Konica theksoi se shqiptarët kërkonin të kishin një princ osman, për shkak të lidhjeve të tyre me turqit gjatë historisë së përbashkët të pesëqind viteve. Shumica e shqiptarëve kishin të njëjtin besim fetar me turqit, si dhe një pjesë e tyre i mbanin sytë nga Stambolli, pasi kishin lidhje familjare dhe krushqie me qytetarë të këtij shteti¹⁵.

Funksionarët austro-hungarezë e qortuan ashpër Faik Konicën lidhur me propagandën e zhvilluar nga ana e tij për caktimin e një princ turk në krye të Shqipërisë. Duke sjellë atmosferën që u zhvillua gjatë këtij takimi, Faik Konica shkruante se “pas fjalëve të bukura, të përziera edhe me ndonjë frikësim të mbuluar, lidhur me të adhmen time në Shqipëri, m’u lutën që unë të hiqja dorë nga ky agjitacion”¹⁶. Zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme pranonin se qeveria austro-hungareze ishte në favor të pavarësisë së Shqipërisë. Por, ata u shprehën prerë se qeveria austro-hungareze nuk parashikonte caktimin e ndonjë princi tjetër për Shqipërinë dhe se ishte në parim kundër propagandimit të idesë së një princi për Shqipërinë. Ata argumentonin se nëse kjo çështje shtrohej në këtë periudhë, ajo do të krijonte një gjendje të trazuar shpirtërore te shqiptarët, nga e cila mund të përfitonin vetëm Italia dhe Antanta.

Garancitë e dhëna nga Faik Konica për projektin e tij, nuk ishin të mjaftueshme sa të bindnin drejtuesit e Ballhausplatz-it. Lidhur me refuzimin nga ana e qeverisë austro-hungareze ekzistonin disa shkaqe. Me shumë mundësi, arsyeja kryesore ishte se Vjena kishte projekte të tjera politike për Shqipërinë, të cilat nuk shkonin përtej autonomisë. Shkak tjetër të cilit “i besonte” me shumë Konica, ishte se qeveria austro-hungareze i druhej faktit se, caktimi i një princi mysliman për Shqipërinë, mund të shërbente si model edhe për Bosnjë-Hercegovinën. Prandaj, shprehej Konica “ndoshta në përfundim të luftës, Austria prët të dërgojë ndonjë princ të zgjedhur prej saj”¹⁷. Mirëpo, është me rëndësi të theksohet fakti se, pas kësaj periudhe, Austro-Hungaria nuk lejoi zhvillimin e veprimtarisë së “Komitetit mbikqyrës”, ndaloi Faik Konicën që të takohej me shqiptarët në territorin e saj dhe organet e policisë austro-hungareze i krijuan atij mjaft

¹⁵ *Po aty.*

¹⁶ *Po aty.*

¹⁷ *Po aty.*

vështirësi. Edhe çështja e botimit të broshurës propagandistike në favor të princit mysliman i shqetësoi së tepërmi autoritetet austriake, të cilat morën masa të shpejta për ndalimin e botimit të saj në Hungari.

Problemi i dytë, ishte reagimi i ftohtë i zyrtarëve turq ndaj kësaj ideje, i cili ndodhi me sa duket pas ndërhyrjes së autoriteteve austro-hungareze pranë Portës së Lartë. Sapo F. Konica paraqiti në ambasadën osmane në Vjenë platformën e tij politike, diplomatët turq nuk pranuan të merrnin në dorëzim dokumentet e personalitetit të shquar shqiptar. Madje, ata demontruan “një sjellje aspak të rregullt” ndaj Faik Konicës. Situata u përkeqësua edhe për shkak të largimit nga Vjena të personit, i cili deri në këtë periudhë kishte patur rolin e ndërmjetësit midis Faik Konicës dhe zyrtarëve osmanë. Kjo gjendje e vështirë që u krijua, shtyri F. Konicën që t’u drejtohej bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë me fjalët se ngjarjet e fundit “më kanë futur frikën se mos ju do të hiqni dorë nga programi jonë”¹⁸.

Problemi i tretë, në lidhje me çështjen e princit osman u krijua në radhët e shqiptarëve. “Komiteti mbikqyrës” i drejtuar nga Faik Konica ndeshi në kundërshtimin e shqiptarëve katolikë që drejtohej nga Princ Vidi dhe veçanërisht të Syrja bej Vlorës, i cili vendosi të bashkohej me grupin katolik shqiptar. Gjatë qëndrimit në Vjenë, Faik Konica ishte takuar rastësisht në rrugë me Princ Vidin, por ky i fundit e kishte vështuar me mjaft urrejtje. Prandaj, Konica ishte ankuar te funksionarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme për qëndrim me dy standarde. Nga njëra anë, ata i kishin kërkuar atij që të hiqte dorë nga projekti për caktimin e një princi mysliman në krye të Shqipërisë, ndërsa nga ana tjetër, grupi i Princ Vidit përmes Syrja bej Vlorës dhe partizanëve katolikë dhe ortodoksë zhvillonin në mënyrë të hapur propagandë në favor të Princ Vidit, pa patur asnjë shqetësim. Zyrtarët vjenezë i premtuan se do të merreshin masa të ashpra, me qëllim që të ndërpritej çdo lloj agjitacioni për këtë qëllim dhe se Princ Vidi do të largohej së shpejti nga Vjena, duke i braktisur mbështetësit e tij¹⁹. Fillimisht, Faik Konica nuk u dorëzua para kërcënimeve të autoriteteve austro-hungareze, por i vazhdoi përpjekjet për realizimin e këtij projekti deri në vjeshtën e vitit 1916. Ai mendonte se qeveria austriake qëllimisht përpiqej ta bënte dramatike këtë çështje, ndonëse “është e sigurtë se në Shqipëri ka një lëvizje që përputhet me programin tonë”²⁰. Faik Konica mendonte se qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj shqiptarëve ishte i gabuar. Ky qëndrim u shpreh më

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ *Po aty*, F. 13, V. 1916, D. 3, fl. 47-48, Letër në frëngjisht e Faik Konicës drejtuar një beu të paidentifikuar lidhur me çështjen e princit mysliman turk, Vjenë, 6 shtator 1916.

qartë gjatë fushatës së çarmatosjes me dhunë të shqiptarëve, fillimit të procesit të rekuizimeve të shumta të banorëve të varfër si dhe krijimit të një administrate shqiptare nën kontrollin e plotë të autoriteteve ushtarake austro-hungareze. Prandaj, ai konkludonte se “në qoftë se austriakëve nuk u ka mbetur më ndonjë mik në Shqipëri, faji është i tyre”²¹. Madje, kundër Austrisë ishin tani edhe shqiptarët katolikë. Ai shprehej se vetëm shfrytëzimi nga ana e Austro-Hungarisë i ndikimit që Perandoria Osmane kishte në Shqipëri, mund ta shpëtonte Monarkinë Habsburge nga gjendja e rëndë që ishte krijuar mes saj dhe shqiptarëve. Por, në të njëjtën kohë, ai mendonte se qeveria austro-hungareze nuk do të lejonte kurrë ndërhyrjen e shtetit osman në punët e saj, pasi drejtuesit austriakë e konsideronin qeverinë osmane të dobët dhe jetëshkurtër.

Gjatë bisedave dhe letërkëmbimeve me miqtë e tij, ai ishte këshilluar prej tyre, që për shkak të natyrës politike të çështjes që mbronte, ai duhej të tregohej i kujdesshëm me autoritetet austriake. Duke iu përgjigjur një prej miqve të tij, Konica i shkruante se “jam dakord me mendimin tuaj që me austriakët duhet të sillemi urtë e butë dhe jo me të egër, pse kështu nuk do të kishim asnjë mundësi suksesi. Por austriakët janë kaq të ndjeshëm lidhur me çështjen e ardhjes së një princi turk në Shqipëri, saqë çfaqja e një mendimi të tillë quhet vepër armiqësore”²².

Qeveria austro-hungareze ndërhyri në dy drejtime kundër F. Konicës dhe projektit të tij politik. Autoritetet policore austriake vendosën F. Konicën nën një mbikqyrje të rreptë. Më 19 korrik 1916, autoritetet austro-hungareze dërguan forcat e policisë për të kontrolluar banesën e tij në Baden afër Vjenës, gjatë të cilit u sekuestruan nga policia të gjitha letrat dhe dokumentet e tij, por nuk arritën të gjenin ndonjë dokument kompromentues, pasi F. Konica i kishte zhdukur dokumentet e dyshimta. Ai shprehej se pas kontrollit të banesës së tij, edhe autoritetet ushtarake në Shqipëri forcuin masat e represionit ndaj shqiptarëve. Madje, Konica e lidhte këtë ngjarje me arrestimin e një numri oficerësh shqiptarë myslimanë, disa nga të cilët u pushkatuan nga komanda e ushtrisë austro-hungareze në Shqipëri²³.

Qeveria austro-hungareze përdori të gjitha mjetet për të realizuar përçarjen e anëtarëve të “Komitetit mbikqyrës” shqiptar. Pavarësisht qëndrimit të rreptë të policisë austriake, të gjithë miqtë dhe bashkëpunëtorët e F. Konicës mbajtën një qëndrim të vendosur, me përjashim të Dervish

²¹ *Po aty.*

²² *Po aty.*

²³ *Po aty.*

Himës, i cili siç shprehej Konica “filloi të devijojë”. Pasi i kishte shpenzuar rreth 200 lira turke që i kishte dhënë këtij të fundit, F. Konica dyshonte se D. Hima kishte shkuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, ku kishte treguar gjithçka për të cilat ishte në dijeni. Për shkak të acarimit të situatës politike, gjendjes së vështirë financiare, dukej se projekti i Faik Konicës për princin osman ishte vënë në pikëpyetje. I gjendur në këto rrethana, Konica shprehej se ndryshe nga më parë, pas kthimit nga Stambolli, gjendja “është bërë e padurueshme. Austria do të më bëjë shembull”. Fondet financiare për këtë qëllim, të cilat ndërmjetësi ia kishte dhënë F. Konicës, ishin shpenzuar. Konica shpresonte se sapo ndërmjetësi të kthehej në Vjenë, ai do të merrte një shumë tjetër. Mirëpo, dukej qartë se të gjendur nën mbikqyrjen e rreptë policore dhe pa fonde financiare, vazhdimi i propagandës ishte bërë i vështirë²⁴. Për këto arsye, projekti i Faik Konicës për caktimin e një princi osman në krye të fronit shqiptar, nga vjeshta e vitit 1916 shkoi drejt harresës.

Linja e dytë, ishte e prirur për rikthimin e Princ Vedit në krye të fronit shqiptar. Ky qëndrim u kushtëzua nga disa faktorë. Shqiptarët mendonin dhe shpresonin se pas fillimit të Luftës Botërore, ishin krijuar kushtet e duhura që Princ Vidi të rikthehej në krye të shtetit shqiptar²⁵. Më 2 nëntor 1914, Rusia i deklaroi luftë Perandorisë Omene, e cila çoi në përfshirjen e shtetit osman në bllokun austro-gjerman. Rumania që ishte treguar aktive në vitin 1913 për kandidaturën e Princ Vedit, dëshironte rikthimin e tij. Ndërkohë, Bullgaria nuk ishte për rikthimin e V. Vedit në Shqipëri, për shkak të aspiratave të saj ndaj territorit të Shqipërisë, dëshirës për caktimin e një monarku bullgar në fronin shqiptar si dhe për të kundërshtuar caktimin e një princi osman në Shqipëri, akt i cili mund t'i shtonte oreksin Perandorisë Osmane për rivendosjen e sundimit të saj në gadishullin e Ballkanit²⁶.

Në shtator 1914, Perandoria Osmane filloi të ndryshonte qëndrimin e saj dhe ishte në favor të rikthimit të Princ Vedit në Shqipëri. Gjatë muajit shkurt 1915, u mbajt një mbledhje e parisë së Elbasanit, e cila me nxitjen e një delegacioni nga Stambolli, formuloi këtë rezolutë. “Duke parë vështirësitë e mëdha për caktimin e një princi të dinastisë perandorake osmane për tu bërë princ i Shqipërisë, Asambleja Kombëtare në marrëveshje me qeverinë osmane vendosi të pranojë një princ jo muhamedan, me kusht që ai të jetë patjetër një princ gjerman. Prandaj, ajo

²⁴ *Po aty*.

²⁵ *Dielli*, nr. 425, Boston Mass., datë 9 prill 1915, f. 1.

²⁶ J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 200.

vendosi që me pëlqimin e Gjermanisë, t'i kërkojë princit Wilhelm ta pranojë përsëri kurorën e Shqipërisë". Ky hap nuk gjeti miratim tek elementët fanatikë, si Haxhi Qamili dhe Musa Qazimi²⁷.

Ndërkaq, në mesin e rretheve nacionaliste shqiptare jashtë vendit, vazhduan përpjekjet për rikthimin e Princ Vidit në krye të fronit shqiptar. Veprimtarë të shquar kombëtarë, si Kristo Dako dhe Themistokli Gërmenji themeluan në Sofje Komitetin "Lidhja Kombëtare". "Lidhja Kombëtare" dërgoi Sevasti Qiriazhi (Dakon) në Waldenburg, ku banonte bashkëshortja e Princ Vidit, Princessha Sofi, që të bisedonte me të dhe përmes saj drejtuesit e Komitetit të hynin në lidhje me Princin Wilhelm von Wied, për të diskutuar me të se ç'mund të bëhej për çështjen shqiptare²⁸.

Pas hyrjes së trupave austro-hungareze në Shqipëri, Korpuskomanda XIX me qendër në Shkodër, synonte të rekrutonte fillimisht, të paktën një forcë prej afro 5600 "vullnetarësh" shqiptarë. Batalionet e formuara me shqiptarë dalloheshin "prej kokardave (stemave) kuq e zi dhe rrypave zi-verdhë tek krahu"²⁹. Mirëpo, autoritetet ushtarake austro-hungareze ndaluan mbajtjen nga shqiptarët të simboleve, si W. W. (Wilhelm Fürst zu Wied) që lidheshin me kujtimin e Princit të Shqipërisë Wilhem von Wied³⁰. Në muajt e parë të vitit 1916, në qytetin e Elbasanit u vendos një administratë lokale nën kontrollin e trupave bullgare, me prefekt Irfan Ohri (të nipin e Aqif Pashës). Pas pak ditësh në Elbasan u mblodhën një grup nacionalistësh shqiptarë nën drejtimin e Aqif Pashë Elbasanit dhe të Ahmet bej Zogut. Megjithatë disa nacionalistë ishin përpjekur të bindnin Aqif Pashën se prania e ushtrisë austriake kishte bërë të paqenë regjimin e Princ Vidit, por ai vazhdonte të shfaqte simpati për Princ Vidin. Për këtë arsye, u vendos që më 7 mars 1916 të festohej dita e ardhjes së Princ Vidit në Shqipërinë e lirë, duke organizuar një miting festiv³¹. Më 18 shkurt 1916, kryetari i Bashkisë së Elbasanit, Xhafer Hilmi Dardha i telegrafoi Bashkisë së Tiranës që me rastin e përvjetorit të pranimit të fronit të Shqipërisë nga Princ Vidi, ishte menduar që në Elbasan të bëhej një festë e madhe dhe do t'i dërgohej një përshëndetje

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *AQSH*, F. 30, D. 39, fl. 254-256 "Kujtime të Grave Veterane", Tiranë: 1962, f. 83.

²⁹ *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-6-616, Shkresë e D. Thurn nr. 10.255, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Teshen, 4 prill 1916.

³⁰ *Po aty*, Vj. 26-15-1531, Relacion i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 25 prill 1916.

³¹ Fejzi Alizoti, *Kujtimet e jetës sime politike, 1891-1921*, Tiranë: "Dea Print", 2012, f. 106; Nikollë Ivanaj, *Historija e Shqipëniës së Re – vuetjtjet e veprimet e mija*, Pjesa e parë, Tiranë: "Atdheu", 1943, f. 68-69.

madhërisë së tij. Ai i kërkoi Tiranës që të bënte edhe ajo një festë të ngjashme³².

Më 3 mars 1916, Ahmet Zogu në cilësinë e kryetarit të komisionit nismëtar njoftoi telegrafisht prefektët e 16 prefekturave dhe nënprefekturave, si: Nexhip Bej Dragën në Mitrovicë, Bajram Currin në Gjakovë, Hasan Prishtinën në Prishtinë, Mehmet Pashë Dërrallën në Tetovë, kolonitë shqiptare në Bukuresht, Sofje, Lozanë, si dhe u dërgoi letra Preng Bibë Dodës në Mirditë dhe disa përfaqësuesve të familjes Toptani në Tiranë, ku thuhej se, më 18 mars 1916 do të mbahej një Kongres kombëtar në Elbasan. Krahas përfaqësuesve të vendeve të mësipërme, edhe shqiptarët e larguar nga zonat e pushtimit grek dhe italian caktuan delegatët e tyre për të përfaqësuar krahinat e tyre në këtë kongres. Programi i Kongresit parashikonte ndër të tjera që shqiptarët t'i shprehnin "Madhërisë së Tij Mbretit", dëshirën e kombit shqiptar për rikthimin e tij në Shqipëri, sa më shpejt që të ishte e mundur si dhe të përcaktohej mënyra me të cilën do të qeveriset Shqipëria deri sa të vijë mbreti". Mjaft telegrame iu dërguan Princ Vidit edhe nga ata që ishin ngritur kundër tij, me të cilat luteshin që ai të kthehej në Shqipëri³³. Siç është e njohur, Austro-Hungaria nuk lejoi mbajtjen e këtij kongresi kombëtar, pasi ajo i përmbahej një qëndrimi tjetër politik. Ajo nuk dëshironte më rikthimin e Princ Vidit në Shqipëri. Kundërshtimi i autoriteteve austro-hungareze për mbajtjen e Kongresit kombëtar të Elbasanit, tronditi themelet e besimit të shqiptarëve tek Austro-Hungaria³⁴. Krahas përpjekjeve politike të shqiptarëve në mbështetje të tij, Princ Vidi ndërmori një fushatë të gjerë për rikthimin e tij në krye të fronit shqiptar. Ai nuk abdikoi dhe nuk hoqi dorë kurrë nga pretendimet për fronin mbretëror të Shqipërisë. Megjithëse ishte këshilluar nga shumë njerëz afër tij, ai nuk pranoi të hiqte dorë vullnetarisht nga kjo e drejtë. Duke mos njohur sa duhet zhvillimet politike, Princ Vidi bëri dy gabime. Princ Vidi vendosi t'i bashkohej ushtrisë gjermane, pa siguruar asnjë premtim të besueshëm, duke shpresuar se me këtë akt do të rifitonte reputacionin e humbur. Në këtë mënyrë, ai harroi se ishte ende "de jure" sundimtar i një shteti asnjës. Ai dhe një pjesë e elitës politike shqiptare nuk arritën të kuptonin se qeveria austro-hungareze nuk e mbështeste rikthimin e tij në Shqipëri, për shkak të qëndrimit të tij të asnjësisë në fillim të luftës³⁵, si

³² J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 215.

³³ *Po aty*, f. 216.

³⁴ Bernd Jürgen Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, botim i tretë në shqip, përkthyer nga Krenar Hajdëri, Tiranë: "Çabej", 2004, f. 25.

³⁵ J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 193.

dhe ndryshimit të situatës në terren, për shkak të okupimit nga trupat austro-hungareze, të rreth dy të tretave të territorit të Shqipërisë.

Princ Vidi i bëri të ditur në Berlin, Gottlieb von Jagow, sekretarit gjerman të Shtetit, se mbante “gjithnjë të gjallë mendimin që të kthehej përsëri në Shqipëri dhe se po vazhdon të okupohej me kandidaturën për fronin e atjeshëm”. Diplomatat austro-hungarezë theksonin se kjo nuk ishte thjesht dëshirë e tij personale, por më tepër e bashkëshortes së tij ambicioze. Në fakt, qeveria austro-hungareze e konsideronte të mbyllur çështjen e Princ Vedit. Ajo dëshironte që ai të hiqte dorë përgjithmonë nga çdo aspiratë që kishte lidhje me Shqipërinë³⁶.

Gjatë vitit 1917, Princ Vidi u përpoq që ta merrte më seriozisht çështjen e pretendimit për t’u rikthyer në krye të fronit shqiptar. Më 27 korrik 1917, Princ Vidi i dërgoi një promemorie Ottokar Czernin, ministrit austro-hungarez të Punëve të Jashtme. Në këtë dokument, ai shkruante se jo vetëm që nuk kishte hequr asnjëherë dorë nga të drejtat e tij për fronin e Shqipërisë, por as në të ardhmen ai nuk kishte ndërmend ta bënte këtë akt. Princ Vidi shprehej se kohët e fundit ishte krijuar përshtypja sikur qeveria austro-hungareze mbante një qëndrim “dashakeqës” kundrejt pretendimit të tij. Ai i kërkoi kreut të diplomacisë austro-hungareze që t’i drejtohej perandorit të Austro-Hungarisë me kërkesën që të aproonte kthimin e menjëhershëm të tij si mbret legjitim të Shqipërisë³⁷. Czernin iu përgjigj se në qeverinë austro-hungareze “nuk ekzistonte as gjurma më e vogël e keqdashjes kundrejt lartësisë suaj”. Por, për shkak të interesave që kishte Austro-Hungaria ndaj çështjes shqiptare, qeveria austro-hungareze detyrohej “të mos merrte përsipër asnjë lloj angazhimi”, i cili mund ta ngarkonte këtë qeveri me detyrime kundrejt tij, në përfundim të luftës gjatë bisedimeve të Konferencës së Paqes³⁸.

Në vjeshtë të vitit 1917 u shtrua çështja e mundësisë së deklarimit të luftës nga ana e Princ Vedit, si drejtues i shtetit shqiptar kundër bllokut të Antantës. Princ Vidi u tregua i gatshëm të pranonte ndërmarrjen e këtij hapi, por jo “pa pëlqimin e monarkisë dhe të Gjermanisë”. Për këtë arsye, Princ Vidi i kërkoi ministrit austro-hungarez të Punëve të Jashtme që të dy së

³⁶ *HHSIA, PA, A, në AIH, Vj. 26-23, Relacion i Th. Larish i Ngarkuari me punë i Austro-Hungarisë, drejtuar baronit Burian, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Berlin, 13 nëntor 1916.*

³⁷ *Po aty, Vj. 27-6, Promemorie e Princit Vedit, drejtuar Ottokar Czernin, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Berlin, 27 korrik 1917.*

³⁸ *Po aty, Vj. 27-10, Shkresë e ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar Princ Vedit dhe G. Hohenlohe, ambasadorit austro-hungarez në Berlin, Vjenë, 17 shtator 1917.*

bashku ta trajtonin këtë çështje me qeverinë gjermane. Sekretari gjerman i Shtetit, Richard von Külmann, ishte përgjigjur se deklarata e luftës do të ishte mirë që të “mos të bëhej vetëm prej Princ Vidit si Princ i Shqipërisë, por me të duhej të bashkohej paria dhe përfaqësuesit e vendit”³⁹. Duke kuptuar se fuqitë austro-gjermane kishin nevojë për ndihmë ushtarake, Princ Vidi parashitroi idenë, që para së gjithash, duhej të krijohet një ushtri shqiptare e cila të garantonte shtetin shqiptar nga rreziku i jashtëm si dhe të impononte vendosjen e rendit publik si dhe zbatimin e ligjeve brenda shtetit shqiptar. Vetëm në këtë mënyrë mendonte V. Vidi, kjo nismë do t’u jepte të gjithë shqiptarëve impulsin e duhur për të luftuar kundër bllokut të Antantës⁴⁰.

Takimi që pati Princ Vidi me ministrin austro-hungarez të Punëve të Jashtme në Berlin, i krijoi atij përshtypjen se qeveria austro-hungareze ishte e gatshme ta ndihmonte për t’u kthyer së shpejti në Shqipëri. Ai e mbështeste këtë shpresë te gatishmëria që tregoi konti Czernin për të pranuar diskutimin e planeve të Princ Vidit për t’u hedhur në luftë përkrah Austro-Hungarisë dhe nga interesimi që tregoi ministri i Jashtëm për këtë çështje dhe për zgjidhjen e çështjes shqiptare⁴¹. Madje, kancelari i Gjermanisë, konti Karl von Hertling ishte personalisht dakord me planin e Princ Vidit. Por, ai kishte shfaqur dyshimin nëse ishte pikërisht kjo periudhë, çasti i duhur për të shpallur deklaratën e luftës, kur nga çdo anë po bëheshin përpjekje për arritjen e një marrëveshjeje paqeje. Në këtë kohë në Gjermani konstatohej një rrymë mendimi kundër Austro-Hungarisë. Duke shqyrtuar çështjen shqiptare, rrethet e larta shoqërore dhe politike shfaqën kritika të ashpra ndaj qëndrimit refuzues të Austro-Hungarisë kundrejt çështjes së rikthimit të Princ Vidit në Shqipëri⁴².

Me kalimin e kohës, autoritetet diplomatike dhe ushtarake austro-hungareze arritën në përfundimin se shpallja në këtë periudhë e luftës kundër Antantës nga Princ Vidi, nuk ishte në përputhje me interesat politike dhe ushtarake të Monarkisë Habsburge. Në kontekstin e zhvillimeve ndërkombëtare, ky qëndrim justifikohet me këto argumente. *Së pari*, akti i shpalljes së luftës së Shqipërisë përmes Princ Vidit kundër fuqive të

³⁹ *Po aty*, Vj. 27-14, Letër e Princ Vidit, drejtuar Ottokar Czernin, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Valdenburg, 9 dhjetor 1917.

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ *Po aty*, Vj. 27-15, Relacion i G. Hohenlohe, ambasadori austro-hungarez në Berlin, drejtuar O. Czernin, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Berlin, 19 dhjetor 1917.

⁴² *Po aty*, Vj. 28-3-312, Relacion nr. 19 prot., drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Mynhen (München), 18 shkurt 1918.

Antantës, nuk ishte i përshtatshëm nga pikëpamja politike, pasi mund të interpretohej “si imponim që i bëhej një kombi të vogël” nga fuqitë e bllokut austro-gjerman. *Së dyti*, nga pikëpamja e strategjisë ushtarake, marrja nën kontroll e skelës së Vlorës nga forcat austro-hungareze ishte i vështirë. Por, edhe nëse arrihej të okupohej Vlora, praktikisht ky vend nuk kishte ndonjë vlerë me rëndësi që të ndikonte në ecurinë e fateve të luftës⁴³.

Në lidhje me qëndrimin që mbanin shqiptarët në këtë periudhë ndaj çështjes së rikthimit të mundshëm të Princ Vidit në Shqipëri, kishte mendime të ndryshme ndërmjet tyre. Në grupimin e parë, përfshihej një pjesë e shqiptarëve, e cila ishte e mendimit për të pranuar pa kushte rikthimin e Princ Vidit në Shqipëri. Njëkohësisht, kjo pjesë e shqiptarëve ishte kundër çdo ndërhyrje të huaj. Në përbërje të këtij grupimi, kishte edhe nga ata shqiptarë që ishin ngritur kundër tij në vitin 1914, por që tashmë ishin penduar për veprimin e tyre. Ky grupim ishte më i madhi në numër dhe përfaqësuesit e tij mendonin se “interesat jetësore të Shqipërisë kërkonin që me Mbretërinë shqiptare duhej të bashkohej Shqipëria e Jugut dhe Kosova”⁴⁴. Grupimi i dytë, ishte për një bashkim të Shqipërisë me Austro-Hungarinë me Princ Vidin në krye, pa përcaktuar se cili do të ishte pozicioni i tij dhe i Shqipërisë në suazat e kësaj perandorie. Grupimi i tretë, ishte më i vogël në numër por përfaqësuesit e tij ishin të mendimit se prania e Princ Vidit në Shqipëri, tashmë nuk ishte e domosdoshme⁴⁵. Nga ecuria e zhvillimeve të mëvonshme politike, rezultoi se në qarqet politiko-ushtarake vjeneze dominonte mendimi se Princ Vidi tashmë konsiderohej një kartë e djegur, i cili nuk mund të përdorej më tej në Shqipëri.

Në fillim të vitit 1918, propozimet e përfaqësuesit bullgar Dr. Rizov, për copëtimin e Shqipërisë, shkaktuan shqetësim të madh në mesin e shqiptarëve. Ky akt nxiti organizimin e një protestë të shqiptarëve në Durrës, më 26 shkurt 1918. Përfaqësuesit e mbledhur në këtë miting të ardhur nga Elbasani, Peqini, Kavaja, Gramshi, Tirana, Fieri, Lushnja Berati dhe Durrësi, argumentuan se trazirat që detyruan largimin e Princ Vidit nga Shqipëria në vitin 1914, nuk mund të përdoreshin si argument për të copëtuar Shqipërinë. Këta përfaqësues kërkuan kthimin e Princ Vidit në krye të fronit të Shqipërisë, pasi Shqipëria e pavarur mund të ekzistonte

⁴³ *Po aty*, Vj. 28-34, Relacion i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Vjenë, 15 mars 1918.

⁴⁴ *Po aty*, Vj. 28-3-323, “Një shqiptar mbi Shqipërinë”, 1918.

⁴⁵ *Po aty*, Vj. 28-3-312, Relacion nr. 19 prot., drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, München, 18 shkurt 1918.

vetëm nën drejtimin e Princ Vedit⁴⁶. Qendra e propagandës në favor të kthimit të Princ Vedit u bë qyteti i Elbasanit, ndërsa fushata në mbështetje të tij drejtohej nga Lef Nosi⁴⁷.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve, A. Kral, Komisar civil i Shqipërisë i kërkoi Vjenës se pavarësisht diskutimeve të deriatëhershme për rolin e ardhshëm të Princ Vedit, duhej që në ditët në vijim, të merreshin masa për ndalimin e manifestimeve në mbështetje të Princ Vedit në territorin e okupuar të Shqipërisë. Sipas këndvështrimit të tij, nga njëra anë, këto masa justifikoheshin nga fakti se interesat ushtarake kishin përparësi në kohë lufte. Nga ana tjetër, ai mendonte se manifestimet e mbështetësve të Princ Vedit mund të dëmtonin sigurinë publike brenda Shqipërisë, për shkak se ato mund të shkaktonin reagimin e ashpër të grupimit që ishte kundër tij⁴⁸. Mbështetur në vendimin politik si dhe duke marrë parasysh sugjerimet e Komisarit civil, Kral, me rastin e përvjetorit të arritjes së tij në Durrës, qeveria vjeneze nuk lejoi Princ Vedin që të shkonte në Shqipëri, si dhe në të njëjtën kohë nuk pranoi që ai të dërgonte në këtë vend as përfaqësuesin e tij personal të atashuar në Vjenë.

Kontributi i Austro-Hungarisë për ndërtimin e sistemit të transportit dhe të komunikacionit në Shqipëri gjatë periudhës së okupimit të saj

Gjatë viteve 1916-1918 shumica e trojeve etnike shqiptare gjendeshin nën okupimin austro-hungarez. Pavarësisht statusit politik të Shqipërisë, pozitës së vështirë në të cilën u ndodhën shqiptarët për shkak të humbjeve dhe pasojave të shkaktuara nga lufta, një nga përfitimet më të rëndësishme që arritën shqiptarët gjatë periudhës së okupimit austro-hungarez ishte ndërtimi i një rrjeti të gjerë të rrugëve të transportit, të cilat u shtrinë në shumicën e viseve etnike shqiptare. Ndërtimi i rrugëve të transportit nga Mitrovica deri në Berat përbënte një nga kontributet më me vlerë.

⁴⁶ Lef Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare*, botim i dytë, përgatitur për botim dhe redaktimi shkencor nga Prof. dr. Marenglen Verli dhe Prof. dr. Ferit Duka, Protestimi kundër Dr. Rizofit nga delegatët e Elbasanit, Kavajës, Peqinit, Gramshit, Tiranës dhe Durrësit, Durrës, më 26 shkurt 1918, Tiranë: Botim i Akademisë së Shkencave, 2007, f. 268-270.

⁴⁷ *HHSIA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 28-39, Shtojca 3 në lidhje me raportin nr. 59/P 3319, Shkodër, 17 mars 1918; J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 218.

⁴⁸ *HHSIA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 28-34, Relacion i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Vjenë, 15 mars 1918.

Së pari, angazhimi i shqiptarëve në ndërtimin dhe riparimin e rrugëve ndikoi drejtpërdrejtë në plotësimin e nevojave më emergjente ekonomike e sociale të tyre. Duke hapur kantiere pune, autoritetet austro-hungareze u siguruan punë shqiptarëve dhe me pagesat e fituara, ata arritën të mbanin familjet e tyre në këtë periudhë të vështirë lufte.

Së dyti, hapja e rrugëve të reja dhe përmirësimi i atyre ekzistuese, lehtësoi komunikimin dhe përhapjen e ideve moderne perëndimore dhe kombëtare, duke ndikuar në zhvillimin e mëtejshëm kulturor të shqiptarëve.

Së treti, ndërtimi i rrugëve me synim lidhjen e trevave të ndryshme shqiptare, ishte një prej veprave më të rëndësishme në plan afatlargët kombëtar, e cila ndikonte në forcimin e unitetit të kombit shqiptar. Për këtë arsye madhore, gjatë asaj periudhe nacionalistët shqiptarë shkruanin në gazetën “Posta e Shqypnies” se “rrugat janë dejt [damarët] n’shtet e paa to, komi s’kaa jetë”⁴⁹.

Gjatë Luftës së Parë Botërore forcat austro-hungareze ishin mjaft të interesuara për përmirësimin e rrjetit të komunikimit rrugor në Shqipëri. Pavarësisht se synimi kryesor i autoriteteve austro-hungareze ishte ai ushtarak, gjatë kësaj periudhe u ndërtuan një rrjet i gjerë rrugësh, urash si dhe një sistem dekovilësh [hekurudha të ngushta, ku lëvizja e mjeteve realizohej me anë të mjeteve motorike apo me kuaj – S. Kadria]. Autoritetet ushtarake austro-hungareze i bënë thirrje popullsisë shqiptare për të ndihmuar për ndërtimin dhe riparimin e rrugëve e urave, pasi ato ishin në dobi jo vetëm të ushtrisë por edhe të popullit shqiptar. Në funksion të këtij qëllimi, fillimisht u angazhuan punëtorë shqiptarë, por për shkak të pagës së ulët, kjo formë pune nuk pati suksesin e dëshiruar. Më pas, ushtria austro-hungareze vendosi detyrimin që meshkujt nga mosha 17 deri në 50 vjeç, duhej të kryenin 8 javë në vit punë për mirëmbajtjen e rrugëve⁵⁰.

Në vitet 1916-1918 në territorin e Shqipërisë që gjendej nën kontrollin e Korpuskomandës XIX të trupave austro-hungareze, u ndërtuan dhe u riparuan 739 km rrugë⁵¹. Ndër rrugët kryesore që u ndërtuan dhe u

⁴⁹ “Shypnia e rrugat”, në *Posta e Shqypnies*, nr. 88, Shkodër, 10 tetor 1917, f. 1.

⁵⁰ *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-7-797, Raporti tepër konfidencial i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 7 qershor 1917; *Po aty*, Vj. 28-4-409, Raport i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 15 qershor 1918.

⁵¹ Koço Miho, *Shqipëria – Vështrim urbanistik (1912-1944)*, Tiranë: “Extra”, 2003, f. 22. K. Miho shkruan se gjatësia e rrugëve automobilistike, e teleferikëve dhe e dekovilëve të ndërtuar dhe të përmirësuar nga ushtria austro-hungareze arrin në 650 km, ndërsa në relacionet e tyre, diplomatët austro-hungarezë theksojnë se në Shqipëri ishin ndërtuar e riparuar 739 km rrugë.

riparuan, në të cilat mund të kalohej me makina ishin: Rruga e riparuar Nanhelm - Hani i Hotit - Ivanaj - Shkodër afro 40 km e gjatë; rruga Shkodër - Shirokë me gjatësi 6 km; rruga Kulla e Lumës - Çam - Orosh - Milot u riparua pjesërisht; rrugët Shkodër - Lezhë dhe Lezhë - Vorë u riparuan pjesërisht; rruga Durrës - Vorë - Tiranë me gjatësi 38 km dhe rruga Durrës - Kavajë me gjatësi rreth 20 km iu nënshtruan riparimit. Gjithashtu, u realizua ndërtimi i rrugës Elbasan - Ura e Haxhi Beqarit - Babje - Dardhë - Xhurrë [Xhyrë] rreth 32 km e gjatë. Po kështu, u ndërtua dhe u riparua në disa segmente të saj rruga Durrës - Kavajë - Harizaj - Divjakë - Kamenicë - Libofshë - Mbrostar - Fier, rreth 85 km e gjatë që shërbente për kalimin e makinave të lehta.

Në këtë hark kohor, u riparua rruga Harizaj-Rrogozhinë-Peqin që shërbente për kalimin e karrocave. Po kështu, rruga Çam - Orosh - Ungrej - Kalimash - Lezhë rreth 70 km e gjatë, që shërbente për kalim të mjeteve dhe pajisjeve ushtarake, u ndërtua e re në disa segmente, ndërsa në pjesë të tjera ajo u riparua. Rruga Tiranë - Elbasan rreth 38 km e gjatë që shërbente për kalimin e kafshëve të ngarkesës si dhe ajo Peqin - Karakolli i Shelgut - Elbasan rreth 32 km iu nënshtruan riparimeve.

Krahas përmirësimit të gjendjes së rrugëve, u ndërtuan katër ura në rrugët e reja që u ndërtuan në Shqipëri. Për të mundësuar kalimin e sigurtë të njerëzve dhe të trupave ushtarake, u vendosën lundra në mjaft pika, pranë brigjeve të lumenjve kryesorë të Shqipërisë⁵².

Gjatë kësaj periudhe, në viset shqiptare u ndërtua edhe një rrjet dekovilësh [hekurudhash]. Gjatësia e linjave të dekovilëve që ishin në funksionim në Shqipëri arrinte në 196.2 km. Ndër rrjetet e dekovilëve që u ndërtuan plotësisht në Shqipëri ishin: 1. Dekovili i ndërtuar për linjën Shëngjin - Lezhë - Shkodër me gjatësi 42.2 km dhe me kapacitet ngarkese që arrinte në 120-300 ton; 2. Dekovili i ndërtuar për linjën Shkodër - Lezhë - Vorë, i cili në segmentin Lezhë- Vorë kishte një gjatësi prej 40 km; 3. Dekovili i ndërtuar i linjës Vorë - Tiranë funksiononte me mjet transporti që punonte me motor; 4. Dekovili i linjës Vorë - Durrës - Rrogozhinë - Lushnjë - Berat, me një gjatësi të përgjithshme prej 475 km. Ndër rrjetet e dekovilëve që u ndërtuan apo funksiononin pjesërisht ishin: 1. Dekovili i tërhequr nga kuajt për linjën Ferizaj - Prizren - Morinë [Kukës] me gjatësi të përgjithshme 80 km, nga i cili u ndërtuan 52 km. Duhet theksuar se ky

⁵² HHSIA, PA, A, në AIH, Vj. 27-7-797, Raporti tepër konfidencial i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 7 qershor 1917; Po aty, Vj. 28-4-409, Raport i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 15 qershor 1918.

dekovil paraqet rëndësi në aspektin ekonomik dhe politik, pasi për herë të parë u synua konkretisht që të realizohej lidhja ekonomike e viseve të Kosovës me ato të Shqipërisë politike të vitit 1913. 2. U ndërtua dekovili i tërhequr nga kuajt për linjën Jankovc - Kaçanik me gjatësi 22 km, nga të cilat 12 km ishin në funksionim.

Zhvillimi i sistemit të transportit, duket edhe në drejtim të ndërtimit të rrjetit të teleferikëve në viset shqiptare. Gjatësia e rrjetit të teleferikëve të ndërtuar në territorin shqiptar që gjendej nën kontrollin e Korpuskomandës XIX me qendër në Shkodër, arrinte në 59 km. Duhet theksuar se teleferikët u ndërtuan kryesisht për qëllime ushtarake, por pas lufte, pavarësisht fatit të tyre, ato mbetën pasuri e shqiptarëve. Ndër teleferikët që u ndërtuan në Shqipëri ishin: 1. Linja e teleferikut Lezhë - Vorë me gjatësi 44 km dhe me kapacitet peshëmbajtjeje që shkonte në 100-180 tonë. Ky dekovil kishte një degë me gjatësi 3 km që arrinte në Mamurras të Kurbinit. 2. Nga linja e teleferikut Mullet - Qafë Kërrabë - Shingjonas me kapacitet 100 tonë u ndërtuan 15 km.

Krahas ndërtimit dhe përmirësimit të rrugëve të transportit, trupat austro-hungareze dhe shqiptarët punuan për thellimin, përmirësimin dhe riparimin e skelave detare dhe liqenore të Shqipërisë. Në këto vite u kryen punime në skelën e Shirokës (Shkodër), në Virpazar (Mali i Zi), në Rrushkull (Durrës), në Divjakë dhe në Durrës. Në Shëngjin u ndërtua një mol afro 105 m i gjatë, i cili lejonte hyrjen e vaporëve⁵³. Në gjirin e Durrësit u ndërtua një bazë e fuqishme detare për nëndetëset austro-hungareze⁵⁴, e cila u shkatërrua në mbarim të Luftës së Parë Botërore nga bombardimet e fuqishme të një skuadre aeroplanësh ushtarakë anglo-italo-amerikanë⁵⁵. Investimet e kryera nga qeveria austro-hungareze në territorin e okupuar të Shqipërisë, gjatë viteve 1916-1917, me fondet e buxhetit të monarkisë Habsburge, arrinin në 62 milionë korona austro-hungareze⁵⁶.

Administrata ushtarake austro-hungareze punoi edhe për hapjen e zyrave postare në disa qendra të rretheve administrative të territorit shqiptar, si në Shkodër, Durrës, Lezhë, Tiranë, Elbasan dhe në Zhur⁵⁷. Për zhvillimin

⁵³ *Po aty*, Vj. 27-7-772, Raporti i A. Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 7 janar 1917; K. Miho, *Shqipëria – Vështrim urbanistik...*, f. 22.

⁵⁴ Miranda Vickers, *Shqiptarët – Një histori moderne*, përkthyer nga Xhevdet Shehu, Tiranë: "Bota Shqiptare", 2008, f. 146.

⁵⁵ J. Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie...*, f. 215.

⁵⁶ *HHStA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 27-2-230, Notë e kryeministrit hungarez i ngarkuar me drejtimin e financave, drejtuar Ministrisë së Luftës, 16 nëntor 1917.

⁵⁷ *Po aty*, Vj. 26-20-2016, Shkresë e Visner, përfaqësuesit të Ministrisë P. dhe Mb. pranë

e këtij shërbimi të rëndësishëm u synua të punësoheshin nëpunës shqiptarë që kishin shërbyer më parë në shërbimin postar, të cilët gjatë asaj periudhe gjendeshin të papunë. Megjithëse, shërbimi postar kishte funksionuar edhe më parë, zyra e parë postare që u vu në funksionim nga autoritetet austro-hungareze gjatë viteve të luftës ishte ajo që u ngrit në Shkodër, ndërsa më pas do të hapeshin zyra të tilla në Lezhë, Tiranë dhe në Durrës⁵⁸. Gjithashtu, në këtë periudhë qytetet e Tiranës, Durrësit dhe Shkodrës u lidhën me linjë telefonike⁵⁹. Në tetor të vitit 1916, Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë austro-hungareze deklaronte se nga autoritetet austro-hungareze ishin hapur zyra postare të klasit të parë në zonat e prapavijave të Lezhës, Tiranës, Durrësit, Elbasanit dhe të Kullës së Lumës, të cilat ishin ngarkuar edhe me detyrën e shërbimit civil, siç ishte detyra e ndërmjetësimit të porosive për shpërndarjen tek lexuesit shqiptarë të gazetës “Vëllazënia” që botohej në Vjenë⁶⁰.

Komandës supreme të ushtrisë, drejtuar Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Teshen, 14 qershor 1916.

⁵⁸ *Po aty*, Vj. 26-8-827, Raport i Kral, konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, drejtuar baronit Stefan Burian, ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 2 tetor 1916.

⁵⁹ Syrja Vlora, *Kujtime – Nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*, përgatitur për botim dhe redaktuar nga Akad. assoc. Marenglen Verli dhe Dr.Ledia Dushku), Tiranë: “Iceberg”, 2013, f. 162.

⁶⁰ *HHSIA, PA, A*, në *AIH*, Vj. 26-19-1971, Shkresë e F. Kinsky, përfaqësuesit të Ministrisë P. dhe Mb. pranë Komandës supreme të ushtrisë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Teshen, 21 tetor 1916.

Sali KADRIA

SUMMARY

THE QUESTION OF ALBANIA'S PRINCE AND THE CONTRIBUTION OF AUSTRO-HUNGARY TO THE COMMUNICATION NETWORK IN ALBANIAN LANDS DURING 1916-1918

In this article we will focus on addressing the question of the Prince of Albania and the contribution of Austro-Hungary to the construction of the transport and communication system in Albania during 1916-1918. In 1916, Faik Konica completely changed his previous position, demanding that Prince Wilhelm von Wied should be abandoned and in his throne to be assigned an Ottoman Prince.

For the realization of this political project, he started talks with several representatives of the Ottoman state. Faik Konica's project faced insurmountable objections and obstacles by the Austro-Hungarian government. Austrian police authorities put F. Konica under strict supervision until in the fall of 1916; when he was forced to give up on this political project. After the entry of Austro-Hungarian troops into Albania, Prince Wied undertook a broad campaign for his return to the head of the Albanian throne. In 1916-1918, Austro-Hungarian diplomatic and military authorities came to the conclusion that Prince Wied's return to Albania was not in the same line with the political and military interests of the Habsburg Monarchy. During 1916-1918, 739 km of transport roads were constructed and repaired in the territory of Albania, which was under the control of the Austro-Hungarian troops. In the Albanian area was also built a network of narrow railways, which reached 196.2 km in length. The network of cable cars built in Albanian territory reached 59 km. Also, it was worked to deepen and improve Albania's naval and lake harbors.

KUD: 94(496.51).085.11 (093.2)
32(496.51)(093.2)

Frashër DEMAJ

**KËRKESA E KOMITETIT MBROJTJA KOMBËTARE E
KOSOVËS DËRGUAR MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
TË ITALISË, MË 1918, PËR BASHKIMIN E KOSOVËS DHE
VISEVE TJERA ME SHQIPËRINË**

Në fund të Luftës së Parë Botërore elita intelektuale e shqiptarëve të Kosovës dhe viseve tjera që jetonin brenda kufijve të shtetit shqiptar, u organizua politikisht për të vazhduar përpjekjet që Kosovën dhe viset tjera t'i ribashkonin me shtetin shqiptar. Ata formuan një organizatë politike të cilën e emëruan Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Komitetiu formua, më 1 maj 1918, në ilegalitet, kurse në nëntor vazhdoi punën e vetë publikisht duke e vendosur edhe selinë në Shkodër.

Në Kuvendin themelues u zgjodhën Kryesia e ngushtë në përbërje të: Hoxhë Kadri Prishtina (kryetar), Hysni Curri (nënkryetar), Halim Gostivari (nënkryetar) dhe Bedri Pejani (sekretar). Anëtarë të Komitetit u zgjodhën: Sali Gjuka, Isuf Veseli, Sadik Ramë Deçani, Neshi Hoxhë Sadiku, Avdush Kastrati, Jahja Begolli, Hamdi Zajmi, Niman Ferizi, Rrok Perolli, Tahir Zajmi, Kahreman Begolli dhe Ibrahim Gjakova-Çausi. Anëtar nderi i Komitetit u zgjodh Hasan Prishtina (mungonte sepse ishte në Vjenë ku kishte shkuar me 36 prijës shqiptarë për ta vizituar familjen e FrancJozefit që kishte vdekur kohë më parë). Ndërkohë, në Komitet bënë pjesë: Bajram Curri, Mehmet Delia, Azem Bejta, Nexhip Draga, Aqif Blyta, Qazim Bakalli, Beqir Vokshi, Niman Ferizi, Murat Gjakova, Zefi i Vogël, Bajram Daklani, Tafil Boletini, Qazim Kajabegolli, Ragip Kajabegolli, Ramë Vllasa, Ilaz Raçaku, Nak Berisha, Dan Doroci

etj.¹ Komiteti miratoi edhe programin e vetë si dokument politik të konceptuar në tri pika kryesore, në të cilat përmbledheshin kërkesat kombëtare të shqiptarëve dhe përfaqësimi i tyre diplomatik përmes një delegacioni që do të mbronte interesat e shqiptarëve në forumet ndërkombëtare.

1. *Me protestua para pushteteve të mëdha të Entantës (Antantës F.D.) e me kërkesa bashkimin e krahinave të Kosovës (Shkup, Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivar, Kaçanik, Ferizovi, Gilan, Prishtinë, Vuçitërnë, Mitrovicë, Jeni Pazar, Rozhajë, Pejë, Plavë, Gusi, Gjakovë, Prizren) në Shqipni të lirë vetëurdhënuese.*²
2. *Me protestua para pushteteve të mëdha të Entantës, kundra mizorive sllave ndër krahinat e Kosovës deri në ditë të sodit e qi munden me u ba dhe mbas sodit.*³
3. *Me zgjedh e me quenji delegacion për me mbrojt në fillim dy pikat e sipërpërmednuna para botës zyrtare e jashtë zyrtare.*⁴

Komiteti në ndërkohë hartoi edhe kërkesa politike dhe rregulloren e veprimt të anëtarëve të Komitetit dhe luftëtarëve shqiptarë që po përpiqeshin për të rikthyer Kosovën brenda kufijve të gjeografisë etnike të shtetit shqiptar.

Në rregulloren e Komitetit thuhej:

1. *As një kryengritës nuk guxon me i damtueshket e vendit veçatyneqi qëndrojnë me armë në dorë kundra qëllimit shqiptar.*
2. *Asnjë kryengritës nuk guxon me djeg shpija, e me rrënue kisha.*
3. *Plaçkitja ashtë jasadik kryengritjes.*
4. *As një kryengritës nuk guxon me banojshëmtrim mbi trupat të vramëvet'anmikut, as me xhveshë ata anmiqkijesindekun e të plagosun ose të xënë rob.*
5. *Veprimi ma i gjallë ka me kanë kundra ushtrisë, xhandarmërisë, kundra komitave të anmikutqikundërshtojnë me armë në dorë edhe në kjoftë se anmikubanmizorina shqiptarëve pa armë vete (I.II.III.IV) kanë për t'iu përmbajtë plotësisht e rreptsisht.*
6. *Një tradhtar që kundërshton luftën me anmikun ose veç asht kundra qëllimit shqiptar, ka për t'u vra pa gjyq e pa afat e kush do që të jetë.*

¹Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar (më tej: AQSH), fondi 846, dosja 1.

²AQSH, fondi 846, dosja 1.

³Po aty.

⁴Po aty.

Por një tradhtar pa armë në dorë ka me u gjykue para gjyqit të kryengritjes e ka me u dënue mbas dokumentesh e jo me pralla të hallkut.

7. *Me të zapumit e një shteti ose të një katundi serbë, shkiet e vendit ashtu edhe qarshia të ruhen të gjitha, besnikija e kryengritsit të ndjekianmikun pa afat e pa bjerë as një dakik nëpër shehre e katunde.*
8. *Kot e pa nevojë as gjaku i popullit tonë as gjaku i anmikut s'ka me mujtë me u derdhë. Por aty ku asht nevoja një kryengritës s'ka me guxue me kursye as pak gjakun e vet.*
9. *Konsullatat e shka ka që i përket këtyne ka për ti ruejt me gjinde me të besnika e ma të marrunvesht.*
10. *Të vramët shqiptar s'kan për t'u shtin në dhe deri sa të vienaj komision i huej. Mizorinat e bame prej anmikutkan për të mbet shenue edhe për me diftue Evropës e Amerikës. Kjo rregullore u aprovua nga Komiteti, më 26 janar 1919.⁵*

Programi kombëtar e demokratik i Komitetit pati ndikim të rëndësishëm në jetën politike të shqiptarëve gjatë viteve 1918-1924, sidomos në Kosovë ku shqiptarët në asnjë mënyrë nuk pajtoheshin me mbetjen e Kosovës jashtë trungut shqiptar. Komiteti shtriu aktivitetin e vet në shumë qytete e fshatra përmes degëve të organizuara dhe tribunëve me autoritet.⁶ Drejtuesit politikë të Komitetit kishin vendosur që krahas me rezistencën e armatosur të organizoheshin aktivitete të dendura diplomatike.⁷ Udhëheqja e Komitetit shumë herë ju drejtua qeverive të Fuqive të Mëdha, përmes ministrave të Jashtëm, ambasadorëve, konsujve dhe përfaqësuesve tjerë diplomatikë, me kërkesa, letra, memorandumë e protesta, me qëllim të sensibilizimit të çështjes shqiptare në diplomacinë ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, Komiteti u bë zëdhënës i aspiratave të popullit të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare që kishin mbetur jashtë trungut kombëtar.⁸ Më 18 dhjetor 1918, Hasan Prishtina i drejtohet me një telegram presidentit amerikan, Wilson, duke kërkuar nga SHBA-ja mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar në Konferencën e Paqes. Ai

⁵AQSH, fondi 846, dosja 2.

⁶Frashër Demaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe kontributi i Isuf Veselit*, kumesë në Akademinë, Kujtesë historike, "Kontributi i Isuf Veseli Demaj në Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe dhuna e ushtrisë serbo-malazeze ndaj Demaliajve të Radavcit 1918-1945", Lidhja e Historianëve të Kosovës, Pejë, më 1 dhjetor 2018.

⁷Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, Prishtinë 1997, f. 75.

⁸Lush Culaj, *Shqipëria dhe problemi kombëtar 1918-1928*, Prishtinë 2004, f. 43.

paraqiti argumente të pakontestueshme duke potencuar padrejtësitë e mëdha me rastin e marrjes së vendimeve në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, ku për pasojë më shumë se gjysma e popullit shqiptar dhe territoret etnike të tyre mbeten jashtë kufijve të shtetit shqiptar.⁹

Pak ditë para se të fillonte Konferenca eVersajës, më 21 dhjetor1918,¹⁰ Hoxhë Kadri Prishtina, kërkoi nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë, që ta përkrahte çështjen shqiptare në Konferencën e Pages.Ai i dërgoi një memorandum me plot argumente historike, etnike, politike, diplomatike e kulturore, ministrit të Jashtëm italian,Sonnino,¹¹ duke kërkuar respekt e përkrahje nga një vend fqinj siç ishte Italia, e cila përbënte njërën nga Fuqitë e Mëdha. Kadri Prishtina në fillim të kërkesës së tij në mënyrë diplomatike kërkonte nga Qeveria italiane në Romë, që të njihej sërish “uniteti kombëtar” i shqiptarëve. “Fuqitë e Mëdha aleate të Antantës kanë deklaruar solemnisht që duan t’i japin fund së shpejti kësaj lufte botërore, me kushte paqeje të bazuar në principe që mund të kënaqin ndjenjat njerëzore duke siguruar padhunshmërinë e të drejtave natyrore dhe politike të kombeve dhe të kërkojnë në të njëjtën kohë vetëm njësinë (unitetin) e tyre kombëtar”,¹² - shprehej Hoxhë Kadriunë fillim të letrës së tij. Duke kritikuar politikat e gabuara ndaj shqiptarëve,ai i rikujtonte diplomacisë italiane se është provuar në mënyrë të pakundërshtueshme nga ngjarjet e së kaluarës, se i pari prej popujve të vegjël në Ballkan që ka humbur të drejtat e tij legjitime dhe që rrezikon akoma sot të robërohet e pastaj të shfaroset, është populli shqiptar.¹³ Prandaj, çështja e tyre nuk duhet lejuar të injorohet e të nëpërkëmbet duke u bërë prej shteteve sllave të Ballkanit, të cilat historikisht kanë copëtuar dhe përvetësuar territore etnike shqiptare. Hoxhë Kadriu u rikujtonte italianëve me shumë argumente të drejtën historike të shqiptarëve, duke nënvizuar se me gjithë pushtimin e territoreve shqiptare që nga koha e romakëve, bizantinëve, bullgarëve, sllavëve, turqve, shqiptarët kanë ruajtur kombësinë, gjuhën, kulturën dhe traditën e tyre. Te pjesa e argumentimit historik, Prishtina e fillonte me

⁹Hasan Prishtina, *Dokumente*, Tiranë, 1983, f. 99-100.

¹⁰*Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë*, (më tej:AQFAMMRSH), Fondi: Komunikata e materialit të shtypit të huaj, dosja nr. 5, f. 1.

¹¹SidnejCostantino, Baron Sonnino (11 mars 1847-24 nëntor 1922) ishte një burrështetas italian me prejardhje hebraike. Kryeministri i 19-tëi Italisë. Ai gjithashtu ishte ministri italian i Punëve të Jashtme gjatë Luftës së Parë Botërore, duke përfaqësuar Italinë në Konferencën e Pages së Versajës, në vitin 1919.

¹²AQFAMMRSH, Fondi: Komunikata e materialit të shtypit të huaj, dosja nr. 5, f. 1.

¹³*Po aty*, f. 1.

pellazgët, të cilët i cilësonte si popullsi para ilire, themelues të civilizimeve të para të Evropës dhe të Azisë.¹⁴ Kadri Prishtina theksonte se populli shqiptar lufton kundër shtypjes së kombeve të huaja për të ruajtur ekzistencën e tij kombëtare. Vetë stërgjyshërit tanë (të parët), banorët e vjetër dhe të vetmit të Gadishullit Ballkanik, kishin dëshiruar gjithmonë marrëdhënie të mira me fqinjët e tyre, por përkundrazi ata gjithmonë u atakuan nga sllavët. Këta të fundit që në fillimet e ardhjes së tyre në Ballkan, pa reshtur kërkonin të zgjeroheshin në kurriz të shqiptarëve dhe të integritetit tokësor shqiptar dhe kjo gjë solli një mori luftërash në mes tyre.¹⁵ Kështu, pasi sllavët erdhën në sajë të ndihmës së Mbretërisë Bizantine, sllavizuan me metodat e tyre sistematike asimiluese e shfarosëse, tokat ilire dhe i pushtuan ato. Sllavët filluan të pushtojnë krahinat e Nishit nga viti 1159 dhe realizuan pushtimin e Kosovës dhe të gjithë Shqipërisë së atëhershme nën mbretërimin e Car Dushanit.¹⁶ Themelimi i kishave të Ipekut (Pejës F. D.) dhe Deçanit, emërtimi i krahinave, qyteteve, fshatrave dhe bile i emrave të familjeve që ndodhi gjatë këtij pushtimi, kishte për qëllim sllavizimin, tjetërsimin dhe shfarosjen e shqiptarëve në mënyrë që tokat shqiptare pastaj të populloheshin me popullsi sllave.

Hoxhë Kadriu duke marrë shembullin e formimit të shtetit serb me ndihmën e Rusisë, kërkonte që të njëjtën ta bënte Italia për shqiptarët duke marrë parasysh edhe lidhjet historike në mes të këtyre dy popujve dhe kontributin e shqiptarëve arbëreshë në luftë për bashkimin e Italisë në kohën e “Risorxhimentos Italiane”. Prishtina kërkesën për përkrahje e mbështeste edhe në interesat italiane në rajon, duke theksuar se përkrahja e italianëve ndaj shqiptarëve në luftën për liri e bashkim do ndihmonte edhe Italinë për t’i përfaqësuar interesat e saj në rajon, sidomos përballë zgjerimit të sllavëve meqë vetëm një Shqipëri e fortë do të ishte garantë e stopimit të interesave pansllave në rajon. Italianët duhet të ndjekin shembullin e rusëve të cilët nga viti 1878 përfituan nga dobësia politike, ushtarake dhe diplomatike e turqve dhe përkrahen malazezët e sidomos serbët në idenë e një Serbie të Madhe, duke konsideruar së kështu do të përfaqësoheshin më së miri interesat e Rusisë në rajon.¹⁷ Prandaj, e vetmja alternativë e mundshme për përfaqësimin e interesave italiane ishte forcimi i shqiptarëve përmes ribashkimit të tyre kombëtar dhe kjo mund të realizohet me përkrahjen fillimisht të diplomacisë italiane dhe pastaj edhe të gjermanëve, austriakëve,

¹⁴*Po aty*, f. 2.

¹⁵*Po aty*, f. 2.

¹⁶*Po aty*, f. 2.

¹⁷*Po aty*, f. 5.

anglezëve dhe francezëve, të cilët nuk kanë asnjë interes të përkrahin zgjerimin e shteteve sllave, sepse me këtë rast do të bënin padrejtësi historike ndaj shqiptarëve, - nënvizonte Hoxhë Kadri Prishtina, në emër të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës.

Bazuar në memorandumën e dërguar në Ministrinë e Jashtme italiane, kryetari i Komitetit të Kosovës kërkonte nga ministri i Jashtëm italian, Sonnino, që të ndërmerre hapa konkretë sikur ish-ministri i Jashtëm rus, Izvolski, i cili ishte emëruar ambasador i Rusisë në Paris, ku kishte qenë shumë aktiv në realizimin e ideve pansllaviste. Përpjekjet e tij të pareshtura për të bindur Francëndhe Anglinë që të përkrahin dhe aprovojnë konceptin politik e diplomatik të Rusisë në rajonin e Ballkanit, cenonin edhe interesat italiane. Prandaj, fuqia diplomatike dhe autoriteti i shkëlqesisë tuaj, mund të bindte edhe ministrat e tjerë të fuqive evropiane të përkrahin çështjen e ribashkimit të shqiptarëve dhe pengimin e depërtimit pansllavist në rajonin ballkanik, - nënvizonte Kadri Prishtina. Ai fajësonte edhe austriakët dhe turqit duke thënë se politika e mbrapshtë e austriakëve dhe inferioriteti i turqve ndikuan që politika ruse të përgatisë për një kohë të gjatë shkatërrimin e dominimit turk në Evropë me anë të luftërave, komiteteve të panumërta, broshurave, gazetave të çdo lloji dhe kështu iu mundësuan serbëve aneksimin e Kosovës.¹⁸

Kadri Prishtina ishte i bindur që ministri Sonnino dhe ministrat anglezëe francezësi burra shteti me kapacitete të larta shkencore, politike e diplomatike, nuk do të mundnin kurrë të injoronin një të vërtetë etnografike, gjeografike, ekonomike të Kosovës dhe t'u besonin pretendimeve absurde të Serbisë.¹⁹

Sipas tij, pretendimet absurde të serbëve mbështeteshin në propagandën a pazakontë dhe të paqëndrueshme mbi:

1. Të drejtat historike të serbëve në Kosovë;
2. Kishat e Deçanit dhe të Ipekut;
3. Islamizimin dhe shqiptarizimin e serbëve nën regjimin turk, dhe;
4. Të drejtat e pushtimit.²⁰

Pretendimet serbe nuk tregojnë gjë tjetër veçse absurditetin e dëshirave të tyre për të pushtuar territore të huaja. Ata duan t'u njihet "e drejta" që kanë pasur në krahinat e Kosovës dhe viseve tjera nën mbretërinë e Car Dushanit. Serbët kanë ndërtuar disa kisha, në numër shumë të vogël,

¹⁸Po aty, f. 6.

¹⁹Po aty, f. 7.

²⁰Po aty, f. 6.

turqit kanë ndërtuar në të njëjtat krahina me qindra xhami, por në Kosovë popullsia në mbi 85 për qind është shqiptare. Serbët, përpiqen për ta populluar dhe kolonizuar Kosovën, duke sjellë popullsi sllave, sikurse turqit në të njëjtat krahina kanë turqizuar popullatën vendase në numër të konsiderueshëm.²¹ Me këto argumente, Hoxha Kadriu dëshironte të bindte diplomacinë italiane se shqiptarët nuk duan të lejojnë që tokat e tyre të pushtohen nga Serbia, por në të njëjtën kohë ata nuk pajtohen as me sundimtarin disa shekullor, siç ishte Turqia (Perandoria Osmane). Shqiptarët, sipas tij, janë popull me histori, kulturë dhe traditë të veçantë që nuk është as sllave as turke, por i takon civilizimit evropian, prandaj diplomacia italiane do t'i bënte shërbim të mirë këtij civilizimi me përkrahjen që do t'u jepte shqiptarëve për ta ribashkuar Kosovën me shtetin shqiptar në Konferencën e Paqes, e cila tashmë ishte bërë publike se do të mblidhej pas disa ditësh për të shqyrtuar kushtet e paqes pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore.

Hoxhë Kadriu nënvizonte se “të sakrifikosh për pretendime absurde dhe për disa kisha të vjetra, qindra mijëra shqiptarë që kanë mundur të ruajnë që nga kohët parahistorike dhe me vuajtjet e persekutimet e panumërta, kombësinë e tyre dhe ruajnë bile me gjithë këto faza të përgjakshme të historisë tyre, një shumicë me më tepër se 85 për qind në krahinat e Kosovës, do të thotë të pranosh t'i shfarosësh ata, t'i mohosh të drejtën njerëzore për të jetuar”.

Prishtina në vazhdim të kërkesës drejtuar diplomacisë italiane radhit një seri argumentesh të cilat i bazon në aspektin historik, etnik, politik, kontribute për civilizimin evropian e deri te argumentet shkencore të bazuara edhe nga autorë e dijetarë të ndryshëm:

1. Popullsia e Kosovës, 85 për qind janë me kombësi shqiptare, me gjithë pushtimet e ndryshme të huaja, revolucionet e shumta dhe masakrat.²²

2. Gjithmonë, duke derdhur gjak, shqiptarët e Kosovës u munduan ta ruajnë zotërimin e tyre nga Perandoria e madhe turke dhe të qeveriseshin nga pashallarët me origjinë shqiptare.²³

3. Shqiptarët e Kosovës kanë marrë pjesë me saktësi, në 54 revolucione të mëdha shqiptare të regjistruara nga historia turke, në mes të të cilave ne po citojmë disa:

a) Më 1667 e gjithë Shqipëria e Veriut duke filluar nga Kosova e deri në kufijtë e Bosnjë e Hercegovinës, u ngritën në revoltë.

²¹*Po aty*, f. 7.

²²*Po aty*, f. 7.

²³*Po aty*, f. 7.

Revolucionarët nuk tentuan të kapnin qafën e Kaçanikut, por marshua drejt jugut dhe pushtuan të gjitha qytetet, me përjashtim të Shkupit. (TarihiEbyl-Faruk, f. 336).²⁴

- b) Gjatë Kongresit të Berlinit, duke parë që Serbia përbënte një mbretëri të pavarur në kurriz të tyre, shqiptarët e Kosovës të ndihmuar nga e gjithë Shqipëria, organizuan “Lidhjen e Prizrenit”, më 1878, iu kundërvunë pjesërisht vendimeve të Kongresit të Berlinit, shpallën Shqipërinë e pavarur dhe luftuan kundër ushtrisë turke dhe malazeze për ruajtjen e interesave të tyre jetësore.²⁵
- c) Shqiptarët e Kosovës u ngritën më 1910 kundër politikës panturke të xhonturqve dhe i dhanë prova gjithë botës që kombësia shqiptare është e pathyeshme e fortë etj.²⁶

Duke nuhatur që Aleanca Ballkanike ishte tashmë e përfunduar me iniciativën shtetërore (zyrtare) të diplomatit rus, Carikof, shqiptarët e Kosovës vendosën të përfitojnë nga një rast kaq i rëndësishëm për të bërë të mundur qëndrimin e një Shqipërie të pavarur në kufijtë etnografikë, morën më 1912 drejtimin e një revolucioni të përgjithshëm shqiptar, shpartalluan ushtrinë turke, çliruan Shkupin, Kumanovën dhe Velesin, duke shënuar kështu kufijtë juglindorë të Shqipërisë, shpërndanë Komitetin, Kabinetin, Parlamentin e xhonturqve, bënë që Porta e Lartë t’i jepte disa privilegje që i siguronin në fakt, pavarësinë e Shqipërisë.²⁷

4. Serbët e Kosovës nuk kanë marrë pjesë, në asnjë mënyrë, në revolucionet kundër turqve, gjë që tregon se me numrin e vogël të tyre s’mund të ishin të zot për çdo veprim të kësaj natyre.²⁸

5. Masakrat e bëra prej serbëve kundër shqiptarëve të Kosovës nga 1912 deri më 1915, nuk vërtetojnë asgjë, veç idenë absurde të reduktimit (pakësimit) të shumicës shqiptare, duke e dërmuar atë gjatë një intervali prej 10 vjetësh (d.m.th. të zbatonin teorinë e tyre).²⁹

6. Pretendimet serbe, për sa i përket kombësisë së shumicës, do të quheshin të drejta (të vërteta) sikur edhe një revolucion ta kishte emrin “revolucion serb”.³⁰

²⁴Po aty, f. 7.

²⁵Po aty, f. 8.

²⁶Po aty, f. 8.

²⁷Po aty, f. 8.

²⁸Po aty, f. 8.

²⁹Po aty, f. 8.

³⁰Po aty, f. 8.

7. Jeta e qetë dhe shekullore e serbëve të Kosovës, ndaj pushtimit otoman, a nuk përbën një provë bindëse për minoritetin e madh të elementit serb në krahinat e Kosovës, gjatë gjithë shekujve?³¹

Sa për dukuritë (fenomenet) e islamizimit dhe shqiptarizimit, ato janë vetëm teori absurde. Në fakt në qoftë se pushtimi turk pati forcë të islamizojë serbët, me këtë forcë sigurisht edhe do t'iturqizonte. Si mundet që shqiptarët e Kosovës, sipas historive serbe të pakta, të pushtuar nga turqit, të shqiptarizojnë serbët? Përse kjo dukuri e shqiptarizimit nuk ndodhi me kroatët e Bosnjës dhe bullgarët e islamizuar?³²

Në ngritjen e këtyre çështjeve të ndjeshme dhe interesante të bazuara në argumente të fuqishme, sipas Kadri Prishtinës, do të nxitej kureshtja e diplomacisë italiane përballë një të drejte elementare që kërkonin shqiptarët e Kosovës të ndarë padrejtësisht nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 1913. Këtyre çështjeve të ngritura në memorandum ai ju përgjigjej me shumë elokuencë, duke bërë sqarimet e duhura dhe brenda tyre duke argumentuar kërkesën për nevojën e përkrahjes nga diplomacia italiane. Krahinat e Kosovës, vlerëson Kadri Prishtina, kanë qenë shqiptare përpara dhe pas ardhjes së rumunëve, serbëve, venedikasve dhe turqve dhe ato mbesin të tilla edhe sot. Po të bëhet një udhëtim në Kosovë do të vihet re se krahinat e Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kumanovës, Preshevës, Kaçanikut, Gjilanit, Prishtinës, Ferizirit³³, Vëlçetrinit³⁴, Mitrovicës, Ipekut³⁵, Gjakovës, Prizrenit, Rozhajit, Plavës dhe të Gucisë, janë plot me shqiptarë. Edhe në shekullin XVII, shqipja ka qenë gjuha e vendit të qyteteve të lartpërmendura (Evlija Çelebi-Miratalem).³⁶

Zotëruesit e Kosovës, nga pikëpamja etnografike dhe ekonomike janë shqiptarët dhe në rast se kjo situatë nuk merret në konsideratë e nuk vlerësohet si duhet dhe krahinat e lartpërmendura i njihen regjimit serb, shqiptarët do të pësojnë këto 3 gjëra:

1. Do të shfarosen nga serbët;
2. Do të shfarosen nga revolucionet (kryengritjet kundër Serbisë, F.D.);

³¹*Po aty*, f. 9.

³²*Po aty*, f. 9.

³³Kështu e shënon emrin e Ferizajt në memorandum Hoxhë Kadri Prishtina.

³⁴Kështu e shënon emrin e Vushtrisë (Vuçiternit përdoret në shumë dokumente të kohës) në memorandum Hoxhë Kadri Prishtina

³⁵Kështu e shënon emrin e Pejës në memorandum Hoxhë Kadri Prishtina.

³⁶*AQFAMMRSH*, Fondi: Komunikata e materialit të shtypit të huaj, dosja nr. 5, f. 9.

3. Emigrimi ipërgjithshëm dhe shkatërrimi i plotë nga varfëria.³⁷

Prandaj, me përkrahjen e Shkëlqesisë Tuaj dhe të shtetit italian, jemi të sigurt që s'do të bëhemi viktimë e një fati antinjerëzor. Kemi nderin t'i lutemi Shkëlqesisë Tuaj të ndërhyjë për bashkimin e Kosovës dhe viseve tjera me shtetin shqiptar dhe krijimin e një Shqipërie etnike dhe të pavarur, - theksonte në fund të memorandumit të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, të firmosur nga kryetari i saj, Hoxhë Kadri Prishtina. Hoxhë Kadriu, në memorandumin e Komitetit të nënshkruar prej tij në kërkesat drejtuar diplomacisë italiane, shprehte mirënjohje të thellë për ministrin e Punëve të Jashtme të Italisë, Sonnino, për të cilin ishte i bindur se do të jetë përfaqësuesi më i lartë i diplomacisë italiane që do të përfaqësonte interesat e shtetit të tij në Konferencën e Paqes në Versajë.

Krerët e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në kërkesat dhe memorandumet e dërguara përfaqësuesve diplomatikë të Fuqive të Mëdha denonconin gjithashtu dhunën, terrorin, plaçkitjen, djegien e shtëpive, arrestimet, burgosjet, vrasjet dhe masakrimet që kishte bërë ushtria serbe dhe malazeze ndaj shqiptarëve gjatë viteve 1914-1918. Komiteti i Kosovës në një reagim dërguar Fuqive të Mëdha që do ta kishin fjalën kryesore në Konferencën e Paqes në mes tjerash gjykonte masakrat serbe ndaj popullit shqiptar në Kosovë dhe ftonte diplomacinë ndërkombëtare të mos mbetej spektator i thjeshtë, por të reagojë ndaj këtyre akteve çnjerëzore.³⁸ Këto argumente ishin të mjaftueshme për t'i bindur diplomatët për kanosjen fizike të shqiptarëve të Kosovës dhe viseve tjera nëse diplomacia ndërkombëtare do të lejonte që këto territore të mbeteshin edhe më tej nën sundimin e Malit të Zi dhe Serbisë.

Mirëpo, pavarësisht përpjekjeve të shumta diplomatike dhe rezistencës së armatosur që organizuan degët e Komitetit, Kosova dhe viset tjera edhe me vendimet e Konferencës së Paqes në Versajë, sërish mbeten jashtë shtetit shqiptar.

³⁷*Po aty*, f. 10.

³⁸*Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920*, Dokumente, vëllimi I, Tiranë 1975, f. 62.

Frashër DEMAJ

SUMMARY

THE REQUEST OF THE KOSOVO NATIONAL DEFENSE COMMITTEE SENT TO THE MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF ITALY IN 1918 FOR THE UNION OF KOSOVO AND OTHER AREAS WITH ALBANIA

At the end of the First World War, the intellectual elite of the Albanians of Kosovo and other areas living within the borders of the Albanian state were politically organized to continue the efforts of Kosovo and other regions to reunite with the Albanian state. They formed the Kosovo National Defense Committee on 1 May 1918 in illegality, and in November it continued its work publicly also establishing the headquarter in Shkodra. Hoxha Kadri Prishtina was elected chairman. The Committee also adopted its program as a political document conceived in three main points, which summarized the Albanian demands of Albanians and their diplomatic representation through a delegation that would protect the interests of Albanians in international forums. A few days before the Conference of Versailles began, on 21.12.1918 Hoxha Kadri Prishtina asked the Ministry of Foreign Affairs to support the Albanian issue in the Peace Conference. He sent a memorandum full of historical, ethnical, cultural, political and diplomatic arguments to the Italian Foreign Minister Sonnino seeking support from a neighboring country like Italy, which was one of the great powers.

Kadri Prishtina taking the example of the formation of the Serbian state with the help of Russia demanded that Italy should do the same for the Albanians, taking into account the historical ties between these two peoples and the contribution of the Albanians the Arbëresh in the struggle for the unification of Italy at the time of the "Italian Risorgimento". Prishtina's support request also backed Italian interests in the region, stressing that Italians support for the Albanians would also help Italy in its interests in the region, especially in the face of the enlargement of the Slavs. The leaders of the Kosovo National Defense Committee denounced on the requests and memoranda sent to the powerful diplomatic representatives the violence,

terror, plundering, burning of houses, arrests, imprisonments, murders and massacres that the Serbian and Montenegrin army had committed against Albanians over the years 1914-1918. The Kosovo Committee demanded that the international diplomacy should not remain a mere spectator of this inhumane act.

Despite numerous diplomatic efforts and armed resistance that were organized by the branches of the Committee, Kosovo and the other areas, with the decisions of the Peace Conference at Versailles, remain still outside the Albanian state.

Halim PURELLKU

KOMITETI I KOSOVËS (1924-1936)
KOMITETI “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS”
(1924 - PRILL 1926)

Historia e Komitetit të Kosovës deri në vitin 1923 ishte tërësisht e lidhur me lëvizjen e përgjithshme çlirimtare shqiptare, por nga fundi i vitit 1923 liderë të caktuar si Zija Dibra, Bajram Curri etj., nën ndikimin e forcimit të luftës revolucionare gjithballkanike, filluan të orientohen kah Fronti i përbashkët revolucionar, ndaj dhe bashkëpunonin me të gjithë faktorët revolucionarë në Ballkan dhe jashtë tij.¹ Gjatë vitit 1924, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, kryetar i të cilit ishte Hasan Prishtina, vazhdonte të ishte faktor i rëndësishëm revolucionar jo vetëm në Kosovë² e Shqipëri, por dhe në Ballkan dhe si gjithherë qëllimi themelor i Komitetit ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë.³ Deri në vitin 1924 fillimi i vitit 1925, selia e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës ishte në Shkodër.⁴

¹) Универзитет „Св. Кирил и Методиј,,, Правен Факултетр,,Јусинијан Први,, Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II, 672-1432, Скопје, 2008, (нë vazhdim: Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II.672-1432..., dok. nr. 300, f. 959.

²) Me emrin (nocionin) “Kosovë”, nënkuptohet trevat shqiptare nën sundimin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, përkatësisht jugosllave, kurse me emrin (nocionin) “kosovar” nënkuptohet pjesa e popullit shqiptar nën sundimin e Mbretërisë Serbe-Kroato-Sllloven.

³) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век, Составувачи: проф. Ленина Жила, Владо Поповски, Свети Николе: Мѓународен центар за славјанска просвета, 2012, (нë vazhdim: Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век...),dok. nr. 25, f. 59 dhe dok. nr. 140, f. 291.

⁴) Државен архив на Република Македонија, Италијански дипломатски документи за

Përballë sulmeve të forcave reaksionare të Ahmet Zogut, të mbështetura nga njësitë serbe e vrangeliste dhe duke mos pasur asnjë mbështetje në shtet, me përjashtim të inteligjencies liberale numerikisht të vogël, qeveria e Fan Nolit ra më 20 dhjetor 1924. Pika 11 (njëmbëdhjetë) e Marrëveshjes së Ahmet Zogut me Qeverinë serbe, të vitit 1924, në Beograd, parashikonte shpërbërjen e Komitetit të Kosovës dhe përndjekjen e anëtarëve të këtij komiteti nga ana Qeverisë shqiptare, kështu dhe ndodhi. Ahmet Zogu e shpërndau Komitetin e Kosovës dhe në mënyrë të pakompromis i përndiqte anëtarët e Komitetit, andaj grupe të caktuara fanolistësh e kosovarësh të cilët ngelën në Shqipëri u ishin ekspozuar përndjekjeve dhe likuidimeve. Një numër i anëtarëve të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, si: Bedri Pejani, Ibrahim Jakova etj., emigruan nga Shqipëria dhe u vendosën në Bari e Brindizi të Italisë. Brenda janarit të vitit 1925 nga Brindizi u larguan pjesa dërmuese e tyre dhe një pjesë u vendosën në Vjenë e pjesa tjetër u vendos në Gjenevë.⁵ Ndërkaq, organizatori dhe kryetari i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës, Hasan Prishtina, me kohë e kaloi kufirin me Greqinë dhe fshihej diku në Selanik te jatakët e Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedone (VMRO-së). Kaçakët e tjerë u shpërndanë në mbarë shtetin shqiptar, më së shumti rreth Shijakut dhe Krujës.⁶ Kurse nga vjeshta e vitit 1925 e deri në pranverë të vitit 1927, Hasan Prishtina jetonte në Zarë dhe ishte kryetar i një Komiteti Revolucionar shqiptar.⁷ Të gjithë emigrantët politikë shqiptarë, ndër ta dhe figura të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, të cilët u degdisën jashtë

Македонија, том I, книга 2, 1925-1927, Избор, превод, вовед и редакција Аленка Лапе, Скопје, 2005), (në vazhdim: Италијански дипломатски документи за Македонија, том I, книга 2, 1925-1927....), dok. Nr. 144, f. 417; Nr. 144, fq. 417.

⁵) Fatmira Rama, "Komiteti i Kosovës në bashkëpunim me organizatat e tjera politike (1925-1939)", *Komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës"*, (Përmbledhje kumtesash), Tiranë, 2004, f. 131; Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 293; Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940) , Документи, Книга II, 672-1432..., dok. nr. 300, f. 957-976; Италијански дипломатски документи за Македонија, том I, книга 2..., dok. Nr. 30, f. 166-167; Државен архив на Република Македонија (нë vazhdim: ДАРМ), Фонд (нë vazhdim: Ф.) Архив Војно историски институт (нë vazhdim: АВИИ, Микрофилм (нë vazhdim: М) 349, Beograd, 11 maja 1952 godine, Shqipëria në periudhën midis dy luftërave.

⁶) ДАРМ, Ф. АВИИ. М. 349, Beograd, 11 maja 1952 godine, Shqipëria në periudhën midis dy luftërave.

⁷) Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990, f. 268.

Shqipërisë dhe jetonin në emigrim, ndiqeshin hap pas hapi nga Tirana zyrtare dhe u qe ndaluar hyrja në Shqipëri.⁸

Kështu, që nga fillimi i vitit 1925, Komiteti i Kosovës, vepronte në kushte të rënda në emigrim, larg Kosovës e shtetit shqiptar. Por, në marrëdhënie me grupimet politike shqiptare dhe ato ballkanike Komiteti vazhdonte të paraqitej si vazhdues i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, përkatësisht si përfaqësues i shqiptarëve nën sundimin e Jugosllavisë.⁹ Gjithashtu, që nga fillim i dhjetorit të vitit 1925 edhe veprimtaria e fuqive të armatosura (çetave kaçake) të Komitetit, ishte në rënie të vazhdueshme si në Shqipëri ashtu dhe në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene. Gjatë dimrit të vitit 1925 e në vazhdim, Lëvizja guerile/kaçake apo çetat kaçake u përballën ma masa energjike permanente që i ndërmermnin kundër tyre si Qeveria shqiptare ashtu dhe Qeveria serbo-kroato-slllovene. Qëllimi i dy qeverive ishte të pengonin strehimin e çetave kaçake në shtetin shqiptar dhe të shfrytëzonin pauzën e dimrit, për të zbuluar vendstrehimet (jatakët) e kaçakëve me qëllim të zhdukjes së kaçakëve.¹⁰

Në kushte të rënies së lëvizjes kombëtare çlirimtare, fanolistë, kosovarë etj., të tubuar në Vjenë, vendosën të krijojnë organizatën unike kombëtare revolucionare. Me shumë vështirësi ata u pajtuan (më saktë gjysma u pajtuan), për një sërë çështjesh themelore të veprimtarisë së tyre në të ardhmen, dhe në mars të vitit 1925 e krijuan “Komitetin Nacional Revolucionar Shqiptar” (KONARE), në përbërje të të cilit hynë përfaqësues thuajse të të gjitha grupeve revolucionare shqiptare; të majta, të djathta, nacionaliste etj., pra edhe Komiteti i Kosovës. Kryetar i organizatës u zgjodh Fan Noli. KONARE veproi deri në 24 prill 1927. Në maj të vitit 1925 Komiteti Nacional Revolucionar Shqiptar (KONARE) shpalli Deklaratën e vet të parë drejtuar popullit shqiptar, ku shpalosi qëllimet e veta. Qëllimi kryesor i këtij komiteti ishte organizimi i kryengritjes së armatosur kundër Ahmet Zogut dhe largimi i tij nga pushteti. Por, përpara masave të ndërmarra nga Zogu, si arrestime në masë etj., KONARE nuk arriti ta shtrijë ndikimin e vet brenda në Shqipëri e as të organizojë kryengritje kundër Ahmet Zogut.¹¹ Nga korriku i vitit 1925 KONARE

⁸) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 133; Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 293.

⁹) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 133-134.

¹⁰) Италијански дипломатски документи за Македонија, том I, книга 2..., dok. Nr. 48, f. 194-195.

¹¹) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 293; Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II 672 1432..., dok. nr. 300, f. 963; Fatmira Rama, *Komiteti i*

d.m.th. dhe Komiteti i Kosovës së bashku botonin në Gjenevë organin e tyre “LIRIA KOMBËTARE” në 1 000 kopje dhe shpërndarja/distribuími i kësaj gazete relativisht ishte i madh. E lexonin kryesisht emigracioni shqiptar në Ballkan, në Turqi, në Evropë dhe në Amerikë, kurse deri në 200-300 kopje hynin dhe në Shqipëri e Kosovë. Ndonëse deri në vitin 1927 nuk ishte mjaftueshëm i qartë profilizim politik i këtij organi (gazete), atë e ndihmuan edhe një grup i të rinjve shqiptarë që studionin në BRSS.¹² Ndërkaq, në përgjigje të krijimit të Komitetit Nacional Revolucionar Shqiptar (KONARE) dhe Deklaratës së tij, Ahmet Zogu e likuidoi revolucionarin shqiptar më popullor (më të famshëm), Luigj Gurakuqin, dhe bëri arrestime masive të personave të dyshuar për simpatitë ndaj emigracionit revolucionar.¹³

Krahas aderimit në KONARE, Komiteti i Kosovës në pranverë të vitit 1925 për motive irredentiste aderonte dhe në Komitetin e Organizatave Nacionale Revolucionare Ballkanike (KNRB), i formuar në pranverën e vitit 1924, i cili komitet që nga fillimi mbështeste opsionin e bashkimit të Kosovës me shtetin shqiptar brenda Federatës Ballkanike eventuale.¹⁴ Ndërkaq, në maj të vitit 1925, Komiteti i Kosovës iu drejtua me një thirrje popullit të Kosovës, me të cilën shpallej Kosova për qendër të veprimtarisë së Komitetit, si dhe kërkohej liria e Kosovës dhe bashkimi i saj me Shqipërinë.¹⁵ Mirëpo, planet e konaristëve për një zgjerim të shpejtë të veprimtarisë masive në Shqipëri nuk u realizuan, për arsye se kuadri kryesor i veprimtarëve (organizatorëve) në Shqipëri ranë në burg ose ishin të detyruar të largohen jashtë vendit. Megjithatë, pavarësisht situatave të pavolitshme, konaristët për çdo pranverë e vjeshtë bënë plane për organizim të kryengritjeve në Shqipëri dhe në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene. Planifikohej që së paku me grupe të vogla të nisen në luftë, me shpresë se do ia dalin të tërheqin pas tyre popullatën e shumë shqiptare në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene, por jo vetëm shqiptarët por dhe masat

Kosovës..., f. 132; *Historia e popullit shqiptar*, III, Tiranë, 2007, 277.

¹²) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 299; Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II, 672 1432..., dok. nr. 300, f. 967-988; *Historia e popullit shqiptar*, III, Tiranë, 2007, f. 278.

¹³) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 293; Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга III, 672 1432..., dok. nr. 300, f. 963.

¹⁴) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 131-132.

¹⁵) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 135.

fshatare në Serbi. Por, këto plane nuk u realizuan kurrë.¹⁶ Realizimi i qëllimeve politike të shqiptarëve asokohe pengohej jo vetëm nga faktorët e brendshëm në tokat shqiptare brenda e jashtë Shqipërisë, por dhe nga Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, Italia, Greqia, Anglia etj.¹⁷

“Komiteti i Çlirimit të Kosovës” apo “Organizata Revolucionare e Kosovës” (pranverë/prill 1926-1930)

Në pranverë të vitit 1926 midis fanolistëve dhe kosovarëve u paraqitën pikëpamje të ndryshme për sa u përkte veprimtarive taktike dhe propagandistike të KONARE. Kosovarët insistonin për një veprim më të vendosur në Kosovë, të cilën e llogaritin si bazë më e rëndësishme momentale. Pas një kohe të shkurtër, KONARE dhe Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës e hoqën nga rendi i ditës çështjen e kryengritjes dhe, ata gradualisht filluan të kalojnë kah veprimtaria e organizuar ilegale e cila kërkonte më shumë kohë.

Mirëpo, në pranverë të vitit 1926, këto përçarje rezultuan me shkëputjen nga KONARE dhe formimi i “Organizatës Revolucionare të Kosovës” (“Komitetit të Kosovës”) në krye me Bedri Pejanin, por Komiteti vazhdoi të mbajë kontakt me KONARE. Objektivi parësor i Komitetit të Kosovës ishte çlirimi i Kosovës, ndaj dhe qendrën e veprimtarisë së vet e barti në Kosovë.¹⁸ Komitetit i Kosovës që në pranverë të vitit 1926 shumë shpejt arriti të ketë ndikim të konsiderueshëm në regionin e Kosovës. Brenda një afati shumë të shkurtër, Komiteti krijoi degët e tij mbi parimin e formës së grupeve të armatosura (çetave/guerile), si: në Gjakovë, Prizren, Krasniqe, Lumë, Jeni Pazar, Gostivar, Rugovë, Has, Mërtur etj. Kryetar të degëve të Komitetit të Kosovës njëherazi ishin prijësit (kryetarët) e çetave. Asokohe numri i përgjithshëm i anëtarëve të degëve (çetave) sillej rreth 500 veta (anëtarë). Por, organizimi dhe strukturimi në këtë formë i Komitetit të Kosovës në çeta shoqërohej me mangësi shumë të madhe, nga të cilat ishte dhe disiplina jo fort e lartë e tyre. Vullneti i çetave ishte që sa më parë, pa ndonjë analizë gjithëpërfshirëse, të hyjë në betejë me forcat kundërshtare,

¹⁶) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 293 dhe 295;

¹⁷) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 295-297.

¹⁸) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 295; Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II, 6721432..., dok. nr. 300, f. 963, 967; *Historia e popullit shqiptar*, III, Tiranë, 2007, f. 277.

siç ishte dhe pjesëmarrja e një pjese të tyre në mënyrë stihike në Kryengritjen e Dukagjinit, nëntor 1926, duke mos pritur direktivë nga qendra e tyre. Ndaj dhe Komiteti i Kosovës ishte i detyruar të punojë më shumë me këto grupe, për edukimin e tyre elementar politik, mirëpo Komiteti kishte në dispozicion shumë pak persona (kuadro) të përgatitura për një veprimtari të tillë politike. Pavarësisht vështirësive në të cilat haste Komiteti i Kosovës, tani ai më ishte ngritur në fuqi autoritative në sy të popullatës vendase. Ai (Komiteti) vazhdonte të qëndrojë në pozita kundër regjimit të Mbretërisë SKS, por pak nga pak mësoi t'i shfrytëzojë dhe mundësitë e veprimtarisë politike legale në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene (Jugosllavisë).

Nga ana tjetër edhe serbët e vlerësonin ndikimin e Komitetit të Kosovës në radhët e popullatës dhe të qarqeve të caktuara, ndaj dhe jo njëherë tentuan që ta përdorin atë në lojërat e veta politike të ndryshme kundër A. Zogut dhe kundër italianëve.¹⁹ Gjithashtu, edhe italianët vepruan njëllë për t'i kthyer kosovarët kundër serbëve. Mirëpo, kosovarët të mësuar nga përvoja përkatëse e deriatëhershme, nuk ranë në gracka të tilla, me përjashtim të Hasan Prishtinës, i cili i vetmi kaloi te italianët.²⁰ Është me interes se nga fundi i gushtit 1926 në Gjermani pati një takim të Hasan Prishtinës me Fan Nolin, e pastaj Hasani, më 6 shtator 1926, u kthye rishtas në Vjenë, nga këtu do të udhëtojë për në Zarë.²¹ Gjithashtu asokohe edhe KONARE e shtriu ndikimin e vet në Shqipëri, nëpërmjet sistemit të tresheve nëpër qytete të ndryshme (Elbasan, Berat, Korçë, Vlorë, Durrës, Shkodër).²² Konaristët dhe kosovarët kishin vënë kontakt edhe me shqiptarët “e asimiluar” në Greqi.²³

Kryengritja e Dukagjinit, në Shqipërinë e Veriut, nëntor të vitit 1926, e cila thuhet filloi papritmas, i befasoi si Komitetin e Kosovës ashtu dhe KONARE. Në kryengritje qenë përfshirë në mënyrë stihike grupe minore të parëndësishme të kosovarëve edhe disa konaristë. Por, kryengritja

¹⁹) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 197; Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга III, 6721432..., dok. nr. 300, f. 976.

²⁰) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 299.

²¹) Hasan Prishtina (Përmbledhje dokumentesh), 1918-1934, Përgatitur nga Kujtim Nuro dhe Neszir Bato, Tiranë, dok. Nr. 123, f. 165166..

²²) Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II, 6721432..., dok. nr. 300, f. 976.

²³) Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II, 6721432..., dok. nr. 300, f. 975.

u përdor nga Italia dhe si një instrument presioni ndaj Qeverisë shqiptare në arritjen e paktit italo-shqiptar (pakti i parë, nëntor 1926), që i detyroi konaristët dhe kosovarët që t'i vënë gishtin kokës dhe ta ndërrojnë taktikën e luftës (veprimtarisë) së tyre për të mos u ndihmuar me veprimtarinë e tyre armiqve të jashtëm të Shqipërisë.

Më 24 prill 1927, KONARE dhe Komiteti i Kosovës dolën me një deklaratë të përbashkët drejtuar popullit shqiptar. Deklarata që nënshkruar nga Fan Noli, Lano Borshi, dr. Omer Nishani, Kostë (Konstandin) Boshnjaku, dr. Nush Bushati dhe kapiten Azis Çami, për Komitetin e Çlirimit Nacional (KONARE), kurse për Komitetin e Çlirimit të Kosovës (për herë të parë shfaqet me këtë emër) kanë nënshkruar Bedri Pejani, Qamil Bala dhe dr. Ibrahim Jakova. Me këtë Deklaratë jo vetëm që paraqitet gjerësisht historia dhe gjendja politike e shqiptarëve, por dhe përfundimisht unifikoheshin qëndrimet e tyre për shumë çështje më të rëndësishme, të cilat më parë ishin kontestuese dhe të padefinuara. Opsioni i përbashkët politik i këtyre dy organizatave ishte çlirimi dhe bashkimi i popullit shqiptar në një shtet shqiptar i cili do ishte anëtar i Federatës Ballkanike.

Marrëveshja e këtyre dy organizatave rezultoi dhe me spastrim e natyrshëm të radhëve të tyre nga elementë të ndryshëm oportunist, të papërgatitur etj., me qëndrime të ndryshme rreth çështjeve të rëndësishme politike e kombëtare. Në vitin 1927 nga KONARE u larguan Koculi, Mustafa Kruja, Tromara, si dhe Hasan Prishtina për shkak të italoofilizmit të tij. Spastrimi i radhëve si duket rezultoi me pak përforsim të radhëve të KONARE dhe të Komitetit të Çlirimit të Kosovës.²⁴ Tani në plan të parë ishte çështja e Kosovës, bëheshin përpjekje për sensibilizimin e faktorit ndërkombëtar ndaj çështjes së Kosovës dhe në përgjithësi ndaj çështjes shqiptare. Në këtë kuadër, ishin intervistat dhe artikujt e shumtë të drejtuesve të Komitetit të Çlirimit të Kosovës dhe të Komitetit të Çlirimit Nacional (KONARE), si: Bedri Pejani, Ibrahim Jakova, Qamil Bala, Fan Noli, Kostë (Konstandin) Boshnjaku etj.²⁵

Por, kundër unifikimit të faktorit politik shqiptar rreth interesave kombëtare shqiptare u ngrit Kominterni. Në vitin 1928 Seksioni Ballkanik i Kominternës, në bazë të vendimeve të marra në mbledhjen e vet, më 2 maj 1928, Komitetit të Kosovës i sugjeronte: pa impenjimin sovjetik mos ta

²⁴) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. nr. 140, f. 295; Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга II, 6721432..., dok. nr. 300, f. 928; Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 137-139.

²⁵) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 140-14..

pranonte propozimin e organizatës Bashkimi Kombëtar për paraqitje të përbashkët gjatë këtij viti kundër qeverisë së Ahmet Zogut; të forcohej agjitacioni në radhët e popullit shqiptar mbi bazë të qëllimeve të platformës politike që ishin pavarësi kombëtare dhe zbatimi i reformës agrare. Të pengohej veprimtaria e Bashkimit Kombëtar dhe KONARES. Në rast të shpërthimit të ndonjë kryengritje në Shqipëri, Komiteti të implikohej maksimalisht në zbatim të programit të vet etj.²⁶

Kthimi në Shqipëri dhe riorganizimi (1930-1936)

Pas shpalljes së Mbretërisë Shqiptare në vitin 1928, në radhët e Komitetit të Çlirimit të Kosovës në emigrim, filloi të shfaqet ideja për t'u kthyer në Shqipëri.²⁷ Kundër kësaj ideje ishte KONARE, e cila në Konferencën e saj të mbajtur nga 22 shkurt e deri në 7 mars 1930 në Berlin, vlerësonte se bashkëpunimi i Komitetit të Kosovës me A. Zogun dha rezultate të këqija dhe rrezikonte që Komiteti të shndërrohej në instrument në duart e Ahmet Zogut. Ndaj dhe qe vendosur që KONARE nëpërmjet shtypit të zhvillojë një fushatë për t'ia sqaruar opinionit se "Komiteti i Kosovës është organizatë e pavarur" (e veçantë dhe vepron si e tillë).²⁸ Megjithatë, afrimi dhe bashkëpunimi i Zogut me emigracionin kosovar, si dhe qëndrimi bashkëpunues i tij ndaj Kosovës, duket se ka rezultuar me një marrëveshje të fshehtë bashkëpunimi të mbretit të shqiptarëve Zogu me Komitetin e Kosovës dhe, me zhvendosjen e selisë së Komitetit në Shqipëri.²⁹ Por, zhvendosja e Komitetit të Kosovës në Shqipëri nuk qe bërë pa ndërlikimin e Kominternës. Kështu, në vitin 1930 Komiteti Revolucionar i Berlinit, Seksioni i Kominternës, e dërgoi në Shqipëri, Bedri Pejanin, që të punojë për vënien e lidhjeve diplomatike midis Shqipërisë e Bashkimit Sovjetik, si dhe për formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Sipas Bedri Pejanit, kjo parti (PKSH) u formua gjatë viteve 1930-1931. Do theksuar se për të fshehur qëllimet e vërteta të shkuarjes së Bedri Pejanit në Shqipëri, propaganda komuniste trumbetonte se ai ishte shitur te Ahmet Zogu.³⁰ Pos,

²⁶) Македонското прашање во советската надворешна политика (1922-1940), Документи, Книга III, 6721432..., dok. nr. 309, f. 1005.

²⁷) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 143.

²⁸) Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. "prilog"/(kontribut. nr. 2, f. 343, 345.

²⁹) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës*..., f. 143-144;

³⁰) Hakif Bajrami, *Bedri Pejani, Një jetë dhe një vdekje për Shqipërinë etnike (1885-1946)*, Prishtinë, 1994, f. 63; Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. prilog 1 Nr. 1, 341.

Bedri Pejanit në Shqipëri që kthyer edhe Ali Kelmendi me instruksione dhe detyra të marra nga Seksioni Ballkanik i Kominternës, por edhe Ibrahim Jakova, Asllan Beja, Loro Gazlluri etj. Kthimi i një pjese të emigracionit politik shqiptar në Shqipëri që vlerësuar edhe si likuidim i Komitetit të Çlirimit të Kosovës.³¹

Në qershor të vitit 1930, sipas Ministrisë së Jashtme jugosllave, Mbreti Zogu kishte shprehur gatishmëri për riorganizimin e Komitetit të Kosovës, i cili do të ndahej në dy komitete dhe atë: Komiteti kryesor do të jetë me seli në Tiranë dhe Komiteti i dytë do të jetë me seli në Vjenë, në krye të të cilit do ishte Hasan Prishtina, të cilin nuk e konsideronte për armik. Gjithashtu, Mbreti Zogu i ftonde të gjithë emigrantët të kthehen në Shqipëri dhe të punojnë në interes të atdheut.³²

Që nga fillimi i vitit 1931, Komiteti i Kosovës veç më “ekziston në Shqipëri”, për këtë ishte në dijeni edhe Ministria jugosllave e Punëve të Jashtme. Mbi bazë të analizës së vet, 1 prill 1931, kjo ministri i njoftoi legatat jugosllave në Parisë, në Londër dhe Delegacionin e Përhershëm pranë Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, se qëllimi i kthimit të Komitetit të Kosovës është “përgatitja e çlirimit dhe e bashkimit të të gjithë shqiptarëve...” Për arritjen e këtij qëllimi Komiteti i Kosovës kishte hartuar një “PLAN PUNE” të veprimit të faktorit shqiptar në botë, në Jugosllavi dhe në Shqipëri, dhe atë:

-Në botën e jashtme: Të ndërmerret një aksioni agjitacioni (propagandimi) në botën e jashtme për revidimin e Traktatit të paqes (Versajit); për të drejtën etnike dhe historike të shqiptarëve për Kosovën; të akuzohet Mbretëria jugosllave para Evropës për moszbatimin e Traktatit mbi pakicat (minoritet), si dhe për zhdukjen fizike të elementit shqiptar dhe kolonizimin e trevave shqiptare me element joshqiptar.

- Në Jugosllavi: Të bëhet agjitacion ndër shqiptarë për dashuri ndaj Shqipërisë; për forcimin (ngritjen) e vetëdijes kombëtare; për forcimin e besimit ndër shqiptarët për çlirimin e shpejtë; të zhvillohet veprimtari antijugosllave në të gjitha fushat.

- Në Shqipëri: Të veprohet për përhapjen dhe zhvillimin e iredentës shqiptare; mbështetje për emigrantët; forcimi ushtarak i Shqipërisë; propagandë dhe angazhim për aleancë me Italinë dhe me Bullgarinë.

³¹) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës...*, f. 143-144; Советско-Албанските односи во 20-тите и 30-тите години на XX век..., dok. prilog (kontribut) 1 Nr. 1, 341; “prilog” nr. 2, f. 343, 345.

³²) Hakif Bajrami, *Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi*, (Dokumente), Prishtinë, 1996, f. 105.

Mbështetje morale e materiale për arritjen e këtyre qëllimeve jepnin Shqipëria, Italia dhe sipas të dhënave të paverifikuara edhe Bullgaria, Rusia Sovjetike dhe “muratorët e lirë”.³³ Në vitet 1930-1933 Komiteti i Kosovës vepronte aktivisht, në bashkëpunim me figura të tjera drejtuese publike të lëvizjes kosovare dhe me rrymën e quajtur “irridenta kosovare prozogiste”. Saqë legata italiane në Vjenë në vitin 1934 Komitetin e Kosovës e vlerësonte si “organizata më e shquar e brendshme revolucionare”.³⁴ Nga fillimi i gushtit të vitit 1934 burimet dokumentare jugosllave njoftojnë se tanimë Komiteti i Kosovës ekzistonte jo vetëm në Shqipëri, por dhe në Jugosllavi. Si duket, Komiteti i Kosovës ishte organizuar në dy komitete në Shqipëri e Jugosllavi, sipas projektit të Mbretit Zogu, të qershorit të vitit 1930. Ndërkaq, gjatë viteve 1934-1936 Mbreti Ahmet Zogu, Komitetin e Kosovës e administronte me anë të instruksioneve që i jepte nëpërmjet Beqir Rexhës, kapiten i xhandarmerisë shqiptare, me origjinë nga Kërrnjina e Burimit (Istogut), i cili për momentin llogaritej si njeriu më i besuar i tij.³⁵ Figurat kryesore në Komitetin e Kosovës, dhe mbase ato të cilët përbënin kryesinë e re të tij në periudhën nga viti 1934 e deri në prill të vitit 1939, ishin: Sali Vuçiterni, ish-ministër i Qeverisë së parë mbretërore, Ismet bej Kryeziu, ish-deputet në Parlamentin e Mbretërisë SKS dhe një person i besueshëm i Oborrit mbretëror shqiptar, dhe Bedri bej Pejani.³⁶ Në vitin 1936 Bedri Pejani lider shumëvjeçar i Komitetit të Kosovës, ndodhej në Shqipëri, përkatësisht në Tiranë, i cili ishte jo fort i dëshirueshëm për Romën dhe Bullgarinë. Për kohën e nënshkrimit të Paktit italo-shqiptar (19 mars 1936) pushteti për hir të Italisë e largoi për një kohë Pejanin nga Tirana dhe e izoloj, do të thotë nuk e arrestoi, por e vendosi në një hotel në Berat, dhe nga mesi i qershorit ai sërish u kthye në Tiranë.³⁷

³³) *Po aty*, f. 113.

³⁴) Fatmira Rama, *Komiteti i Kosovës...*, f. 147.

³⁵) Arhiv Vojnoistorijskog instituta, Beograd (në vazhdim: AVII), popisnik XVII, kut. 95-A, fasc. 2, dok. br. 1, list 29, За досије: Косовски комитет, У Београду, 10 и 12.08.1934 год.

³⁶) АИНИ, Скопје, Ф. Главен генералштаб (në vazhdim: ГГШ), Кутија (К.) XXXVI/7, Ред. бр. 741, Стр. Пов.Б. Бр. 1699, у Београду, 23.10.1937, Raport tremujor (korrik, gusht, shtator 1937) mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij kroat, f. 10

³⁷) Централен државен архив (në vazhdim: ЦДА), Софија, Фонд (në vazhdim: Ф.) 325К. 1. 73., Legati bullgar, ministrit të Jashtëm bullgar, Tiranë, 26 qershor 1936, Rezervat.

Burimet ushtarake jugosllave që nga janari-prilli i vitit 1936 bëjnë fjalë rreth përpjekjeve për riorganizimin e Komitetit të Kosovës në Vlorë, me kryetar Sali Hoxhë Vuçiternës, nënkryetar Arilla nga Ohri, sekretar Jusuf Beshiri, anëtarë: Abdurrahman Krosi, Rexhep Jella, Hysen bej Selmani, Kadri efendiu nga Gjakova. Gjithashtu bëhet fjalë dhe për aktivitetin për forcimin e propagandës shqiptare dhe ndërmarrjen e ndonjë aksioni të kaçakëve në të ashtuquajturën “Serbia e Jugut”.³⁸ Mirëpo, përfaqësuesi ushtarak jugosllav në Tiranë, në një raport të tij, më 10 maj 1936, mohon kategorikisht se është kryer riorganizimi dhe zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së Komitetit të Kosovës, por pohon se është e mundur që personat e përmendur të jenë anëtarë të Komitetit të Kosovës.³⁹

Mirëpo, lidhur me këtë, legati bullgar në Shqipëri J. Peev, në një raport të datës 29 nëntor 1936, drejtuar ministrit të Jashtëm bullgar, njofton se në qershor të vitit 1936, Sali Hoxhë Vuçiternë ishte zgjedhur kryetar i Komitetit të Kosovës, të cilin e karakterizon si i besuar i Mbretit Zog. Është indikative se zgjedhja (emërimi) i Sali Vuçiternës ndodhi në kohën e izolimit në Berat të Bedri Pejani. Peevi, Komitetin e Kosovës e karakterizonte si gjysmëlegal, gjysmëkonspirativ.⁴⁰

Si duket, pas riorganizimit të Komitetit të Kosovës filloi riorganizimi dhe riaktivizimi i çetave kaçake (guerile). Në shtator të vitit 1936, burimet arkivale serbe bënin fjalë dhe për formimin e çetave kaçake në Mbretërinë Shqiptare. Një çetë e tillë prej 25 vetash kaloi kufirin shtetëror shqiptaro-jugosllav dhe bëri një aksion të armatosur në fshatin Duf të Rekës së Dibrës.⁴¹

³⁸) ДАРМ, Скопје, Ф. АВИИ, М. 346, Пов. Ђ. Об. Бр. 2624, 29.1.1936 год. Београд, Шкresë e Zyrës së informimit të Shtabit të Përgjithshëm në Beograd; *Po aty*, М. 346, Пов. Ђ. Об. Бр. 4403, 4.04. 1936, у Београду.

³⁹) ДАРМ, Скопје, Ф. АВИИ, М. 346, Пов. Бр. 95, 10 maj 1936, у Тирани.

⁴⁰.) ЦДА, Софија, Ф.325К.1.158.200-201, Ј Peev, ministrit të Jashtëm bullgar, Tiranë, 21 nëntor 1936, Rezervat; *Po aty*, Ф.325К.1.157.214; *Po aty*, Ф.325К.1.158.218-224, Ј Peev, ministrit të Jashtëm bullgar, Tiranë, 22 qershor 1936, Rezervat; *Po aty*, Ф.325, К. 1. 73., Legati bullgar, ministrit të Jashtëm bullgar, Tiranë. 26. Qershor 1936, Rezervat; Pajazit Nushi, “Në vend të parathënies, në veprën e Hakif Bajramit”, *Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi*, (Dokumente), Prishtinë, 1996, f. 34.

⁴¹.) ДАРМ.Ф. АВИИ. М.346. Пов. Бр.320.29 Септембра 1936 год. у Тирани

Halim PURELLKU

SUMMARY

KOSOVO COMMITTEE (1924-1936)

The Kosovo National Defense Committee during 1924 continued to be an important revolutionary factor in the Albanian political scene and beyond. By the beginning of 1925 his headquarters were in Shkodra. But after Ahmet Zogu's return to power in December 1924, the activity of the Committee was stopped in the country, and most of the members emigrated Albania and settled in Vienna and Geneva. Meanwhile, chairman of the Committee Hasan Prishtina, in time crossed the border with Greece and settled in Thessaloniki.

But, and now in relation to the Albanian and Balkan political groups, the Committee continued to appear as a representative of Albanians under the rule of Yugoslavia. In March 1925, in Vienna, was founded "National Revolutionary National Committee" (KONARE), in which The Kosovo Committee also adhered. The main purpose of this committee was to organize an armed uprising against Ahmet Zogu and his departure from power. Besides adhering to KONARE, the Kosovo Committee in the spring of 1925 for iridious motives also adhered to the Committee of National Balkan Revolutionary Organizations (ICRBs) formed in the spring of 1924.

Meanwhile, in May 1925, the Kosovo Committee proclaimed Kosovo for center of its activity, as well as seeking the freedom of Kosovo and its union with Albania. In the spring of 1926, the Committee broke out of KONARE and formed a "Revolutionary Organization of Kosovo" ("Kosovo Committee"), headed by Bedri Pejandin and the center of its activity was carried out in Kosovo. Within a short deadline, the Committee established its branches in Kosovo on the principle of the form of armed groups (guerrilla warlords / guards), led by leaders of the huts. So, in 1927 the committee appeared with the name of the Kosovo Liberation Committee. After a secret cooperation agreement between the Albanian King Zogu and The Kosovo Committee, the committee headquarters moved to Albania. In the years 1930-1933, the Kosovo Committee acted actively, in cooperation with other public figures of the Kosova movement and with

the stream called "Kosovar pro-Zogist irridenta". Meanwhile, the main figures in the Kosovo Committee, perhaps those that made up his new leadership in the period from 1934 to April 1939, were: Sali Vuçiterni (head), Ismet Bej Kryeziu and Bedri bej Pejani. After the reorganization of the Kosovo Committee in 1936, began the reorganization and reactivation of the Kacake (guerrilla) chets.

Mrika LIMANI-MYRTAJ

**NJË VËSHTRIM MBI PËRZGJEDHJEN GJENETIKE TË
POPULLIT NË NACIONALSOCIALIZËM DHE SHQIPTARËT
BRENDA KËTIJ BOTËKUPTIMI GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE**

Duke marrë për bazë burimet arkivore gjermane dhe literaturën ndërkombëtare dhe kombëtare, të cilat shtjellojnë temat e eugjenikës në kontekst të ideologjisë nacionalsocialiste, dhe pjesërisht brenda asaj fashiste, punimi tenton të shtjellojë pozitën e shqiptarëve brenda kësaj tabloje ideologjike. Duke vënë në pah elementet raciste që bartnin konceptet eugjenike, punimi e bën një analizë kronologjike të zhvillimit teorik dhe më vonë aplikimit praktik të darvinizmit social, higjienës racore dhe eugjenikës në kontekst amerikan, anglez, gjerman, dhe më tej e vazhdon diskutimin rreth aplikimit të këtyre mendësive tek shqiptarët.

Hyrje

Gjykimit me mendësinë kolonialiste të nacionalsocializmit nuk i shpëtuan as vendet të cilat formalisht mbanin status të sovranitetit, posaçërisht siç ishte rasti i Shqipërisë, apo siç quhet me eufemizëm në korrespondencat gjermane si “sovranitet relativ”. Politikat e zgjerimit të territorit gjerman në Evropën Lindore si pjesë e procesit për të zgjeruar *Lebensraum* (tokat për jetesë) nuk u aplikuan në territoret shqiptare, meqë këto të fundit përkitnin në grupin e territoreve të cilat Rajhu i Tretë i konsideronte si ndihmesë ekonomike që do të kontribuonte në procesin ekspansionist të tij. Për më tepër, meqë Evropa Juglindore nuk bënte pjesë në skicat e *Lebensraum*, dhe meqë deri në vitin 1943 një pjesë e mirë e atij

territori bënte pjesë në sferën e influencës së Italisë,¹ nacionalsocialistët nuk i zgjeruan politikat e tyre eugjenike në këto territore. Shqipëria në këtë rast bënte pjesë në këtë të fundit, ngaqë politikat e puritanizmit racor ishin të kufizuara vetëm deri tek spastrimi i tokave nga hebrenjtë, por jo spastrimi nga shqiptarët apo grupet e tjera etnike që banonin në këto territore.

Për t'i dhënë kuptim pozitës që i ishte atribuuar shqiptarëve brenda botëkuptimit të nacionalsocializmit, duhet t'i kushtojmë vëmendje kontekstit historik brenda së cilit kanë lindur idetë pseudoshkencore të pastërtisë racore dhe koncepteve eugjenike. Ngjashëm është e një rëndësie po aq të madhe t'i kushtohet vëmendje edhe politikave të jashtme të zbatuara nga gjermanët gjatë shekullit XX (por gjithëherë brenda kontekstit të historicizmit, ngaqë kolonializmi gjerman i nacionalsocialistëve kishte vazhdimësi me kolonializmin perandorak gjerman). Këto politika të zgjerimit ishin në thelb kolonialiste, dhe ato u cytën para posaçërisht pas Traktatit të Versajës, ku Gjermania u obligua të heqë dorë nga tokat në Lindje, dhe siç vëzhgon edhe Bernhard, një humbje e tillë duket të ketë qenë shumë traumatike për gjermanët.² Këto rrjedha historike mbase i dhanë një shtysë tjetër mbështetëse popullatës për politikat radikale të nacionalsocializmit. Brenda viteve të '30 të shekullit XX, këto këndvështrime, të vëna në funksion nga një arsenal i tërë i vetëlegjitimizimit përmes institucioneve shkencore³, patën ndikim të theksuar në zgjerimin e politikave pushtuese, duke justifikuar këtë dominancë si e drejtë e natyrshme e qytetërimit gjerman të vendosur në pedestal karshi kulturave të tjera.

Një preambulë e shkurtër e gjenezës moderne të eugjenikës dhe higjienës racore brenda kontekstit amerikan, anglez, dhe gjerman

¹ John Connelly, "Nazis and Slavs: From Racial Theory to Racist Practice", *Central European History* (Cambridge University Press, 1999), 32: 1, 1-33, 9.

² Patrick Bernhard, "Hitler's Africa in the East: Italian Colonialism as a Model for German Planning in Eastern Europe", *Journal of Contemporary History* (March 2015), 51: 1, 61-90, 11.

³ Siç ishte Instituti për Historinë e Gjermanisë së Re (i themeluar më 1935), pjesë e së cilit ishte Departamenti për Hulumtime rreth Çështjes Judaikë. Hulumtime të ngjashme bëheshin edhe në Institutin Kaiser Wilhelm për Antropologji, Trashëgimi Njerëzore dhe Eugjenikë me bazë në Berlin (i themeluar më 1927), Instituti për Studime dhe Çrënjësje e Ndikimit Judaik në Jetën Fetare Gjermane (i themeluar më 1939). Alan E. Steinweis, *Studying the Jew: Scholarly antisemitism in Nazi Germany* (Cambridge, Mass: Harvard University Press, 2008), 12-13.

Koncepte që trajtonin tiparet fizike të grupeve etnike në mënyrë të strukturuar brenda kornizave shkencore u shfaqën në formë graduale në nivel ndërkombëtar gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Pikërisht sepse përkonin me këto periudha, çfarëdo karakteristike fizike që i atribuoheshin një apo tjetër grupi, ishte patjetër i kufizuar brenda marginave të identiteteve kombëtare dhe përçapeshin me po këto parime nacionaliste. Koncepti i shtetit komb ishte në fakt një pikë referuese për inxhinierët socialë, për të cilët politikatat që promovonin programe për të krijuar një popullatë të shëndoshë me tipare kombëtare (si anglezët, amerikanët, gjermanët) do të legjitimonin dhe forconin më tutje shtetin komb, siç vëren Kühl.⁴ Këtë qasje e shohim posaçërisht të theksuar te Wilhelm Schallmayer, i cili ishte ndër të parët që kishte artikuluar idenë e përmirësimit të “efikasitetit kombëtar” përmes menaxhimit racional të popullatës.⁵

Andaj, kur më datën 16 maj 1904, Francis Galtoni, që ishte atëkohë hulumtues i shkencave natyrore dhe njëkohësisht themelues i lëvizjes së eugenikës, i kallëzoi Shoqërisë Britanike të Londrës për Sociologji për qëllimet e të ashtuquajturës trashëgimi natyrore, ai ishte posaçërisht i kujdesshëm të theksonte karakterin kombëtar të këtij koncepti. Sipas Galtonit, eugenika rrjedhtë nga fjala *eugenes* që do të thotë “i lindur mirë”, e cila nënkuptonte shkencën për përmirësimin e qenieve njerëzore, dhe shërbente për ndërhyrjen e qëllimshme të njerëzve në evolucionin njerëzor.⁶ Siç e vëzhgon edhe Weiss më vonë, në bazë të këtij definicioni eugenika u shndërrua në vegël për të ushtruar kontroll social mbi riprodhimin njerëzor.⁷

Si ilustrues i përkryer i racizmit të Galtonit mund të jetë edhe fakti që ky i fundit e promovonte idenë që njerëzit me talente mbi mesataren duhej të kishin numër më të madh fëmijësh (që e quante eugenikë pozitive),

⁴ Kiran Klaus Patel and Sven Reichardt, “The Dark Side of Transnationalism Social Engineering and Nazism, 1930s-40s,” *Journal of Contemporary History* (January 2016), 51: 1, 3-21, 9.

⁵ Sheila Faith Weiss, *Race Hygiene and National Efficiency: The Eugenics of Wilhelm Schallmayer* (1987), 4.

⁶ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 11. Mark B Adams, *The Wellborn Science: Eugenics in Germany, France, Brazil, and Russia* (Oxford University Press, USA, 1990), 3.

⁷ Sheila Faith Weiss, *Race Hygiene and National Efficiency: The Eugenics of Wilhelm Schallmayer* (1987), 1.

dhe në të kundërtën njerëzit e “padenjë” nuk duhej lënë të kishin fëmijë (eugenikë negative).⁸

Ky koncept do të shtjellohej më vonë si inxhiniering social (që u përdor si term për herë të parë nga William Tolman në 1909), e që do të ishte thelbësor për politikën e nacionalsocializmit në Gjermani. Dy terme kryesore ndërlidhen me temën e inxhinieringut social, të cilat në kontekste të ndryshme kulturore morën kuptime të ndryshme, sa më pak e sa më shumë raciste. Kështu, në Gjermani mbretëronte më shumë termi higjienë racore, ndërsa në vendet e tjera mbretëronte termi eugenikë. Në thelb, që të dy termet nënkuptonin përmirësimin e grupit etnik (kombit) përmes përzgjedhjes natyrore.

Mirëpo, për dallim nga ato koncepte që mbretëronin në Gjermani, në Britaninë e Madhe lëvizjet e eugenikës meqë buronin brenda kontekstit të kohës, do të vendoseshin më tepër në kontekst të marrëdhënieve sociale dhe ekonomike që mbretëronin në rendin industrial. Idetë për inxhiniering social kishin për qëllim të merrnin nën kontroll zhvillimet demografike duke shtyrë përpara politika që përkrahnin ide raciste,⁹ dhe që në vetvete paraqisnin racizëm shkencor, siç vëren Aldrich.¹⁰

Për t'i shpjeguar këto marrëdhënie ekzistuese sociale të industrializmit, Tolmani argumentonte se duhej të ekzistonte një marrëdhënie ideale ndërmjet kapitalit dhe punës, ku përvoja shkencore do t'i ndihmonte punëtorët që të edukoheshin më mirë, gjë që sipas Tolmanit, kjo do t'i ndihmonte ata t'i tejkalonin problemet e paternalizmit ndërmjet punëdhënësve dhe punëtorëve.¹¹ Këto vëzhgime Tolmani i bënte brenda diskursit të darvinizmit social, ku përfituesit e revolucionit industrial i trajtonin shtresat punëtore si të paafte për të mbijetuar - dhe se kjo ishte forma e natyrshme e shuarjes së tyre - ku si pasojë do të vinte mbijetesja e të denjtit. Nuk është e habitshme që mendime të ngjashme mbretëronin edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku magnatë si John D. Rockefeller dhe

⁸ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 12.

⁹ Kiran Klaus Patel and Sven Reichardt, “The Dark Side of Transnationalism Social Engineering and Nazism, 1930s-40s,” *Journal of Contemporary History* (January 2016), 51: 1, 3-21, 10.

¹⁰ Mark Aldrich, “Capital Theory and Racism: From Laissez-Faire to the Eugenics Movement in the Career of Irving Fisher,” *Review of Radical Political Economics* (1975), 7: 3, 33-42, 33.

¹¹ Kiran Klaus Patel and Sven Reichardt, “The Dark Side of Transnationalism Social Engineering and Nazism, 1930s-40s,” *Journal of Contemporary History* (January 2016), 51: 1, 3-21, 7.

Andrew Carnegie e përdorën teorinë e Darwinit të “luftës për mbijetesë” si pjesë të promovimi të doktrinë së laissez-faire të liberalizmit të Mançesterit, dhe njëkohësisht si tentativë për të shpjeguar e justifikuar si rrjedha të natyrshme të evolucionit problemet sociale që po lindnin si pasojë e një tregu të parregulluar e të padrejtë karshi shtresave të varfra.¹² Kështu vërehet që për darvinistët amerikanë dhe anglezë, seleksionimi natyror kishte demonstruar epërsinë industriale të kapitalizmit si proces që përfshinte në vetvete konkurrencën për më të mirin dhe që në këtë formë këto procese trajtoheshin si të natyrshme.¹³

Një ndryshim thelbësor në mendime ngjau në fund të shekullit XIX, kur u vërejt që kapitalizmi përpos që po kontribuonte në zhvillimin e problemeve sociale, ai gjithashtu po ndikonte në krijimin e një sistemi të paqëndrueshëm ekonomik. Kjo posaçërisht u vërtetua kur ato shtresa shoqërore që konsideroheshin si të padenja për mbijetesë nuk po shuheshin prej seleksionimit natyror, ashtu siç parashihte logjika e darvinistëve socialë.¹⁴ Kjo shkaktoi që qarqet eugjenike të drejtonin shikimin kah darvinizmi biologjik, gjë që nxori në sipërfaqe një racizëm sistematik kolonial. Megjithatë premiset kryesore ishin pothuajse të njëjta në nivel global, një qasje pak më ndryshe mbretëronte në Gjermani sa i përket çështjeve të eugjenikës dhe seleksionimit natyror.¹⁵ Siç vëzhgon Weiss, gjermanët ishin që nga fillimi të mendimit se doktrina e liberalizmit të Mançesterit solli një çekuilibrim të rendit shoqëror dhe ishte shkaktar i

¹² Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 13.

¹³ Robert N. Proctor, *Racial Hygiene: Medicine Under the Nazis* (Harvard University Press, 1988), 14. Instituti i Carnegie kishte financuar ‘Stacionin për Evolucion Eksperimental’ në 1902. Mirëpo, idetë eugjenike kishin tërhequr vëmendjen edhe të elitës intelektuale dhe akademike në universitete, si: Harvard, Yale, Columbia e Stanford. Mark Aldrich, “Capital Theory and Racism: From Laissez-Faire to the Eugenics Movement in the Career of Irving Fisher”, *Review of Radical Political Economics* (1975), 7: 3, 33-42. Frank Dikötter, “Race Culture: Recent Perspectives on the History of Eugenics”, *The American Historical Review* (Oxford University Press, American Historical Association, 1998), 103: 2, 467-478, 471.; Michael Mann, *Fascists* (Cambridge University Press, 2004), 82.

¹⁴ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 22, 30, 152.

¹⁵ Ndër titujt e parë që adresonin këtë çështje ishin: Alfred Ploetz, *Die Tüchtigkeit unserer Rasse und der Schutz der Schwachen* (Grundlinien einer Rassen-Hygiene, Bd. I), Berlin, 1895; Ernst Haeckel, *Natürliche Schöpfungsgeschichte*, 3. Auflage, Berlin 1902; Francis Galton, *Genie und Vererbung*, Leipzig, 1910; Karl Binding, Alfred Hoche, *Die Freigabeder Vernichtung lebensunwerten Lebens*, Leipzig, 1922; Erwin Baur, Eugen Fischer, Fritz Lenz, *Menschliche Erblchkeitslehre und Rassenhygiene*, München, 1932; Rudolf Benhe (Hrsg.), *Deutsche Schulerziehung*, Berlin, 1940.

drejtpërdrejtë në degjenerimin e popullatës.¹⁶ Aty darvinistët synonin të justifikonin një formë të rregullit politik përmes shpjegimit të rregullit natyror.¹⁷ Këto mendime vërehen që kanë mbretëruar edhe te politikanët nacionalsocialistë, ku e kujtojmë që Rudolf Heß, asistenti i Hitlerit, kishte deklaruar që “nacionalsocializmi në thelb nuk është asgjë më shumë se biologji e aplikuar”, të cilën shprehje e kishte deklaruar i pari Fritz Lenz.¹⁸

Wilhelm Schallmayer dhe Alfred Ploetz, që ishin prijësit e darvinizmit social në Gjermani¹⁹, ngjashëm me darvinistët në Amerikë dhe Angli, vënin theksin që duhej të ekzistonte një luftë për ekzistencë ndërmjet njerëzve në mënyrë që më i denji të mbijetojë. Por, për dallim nga darvinistët socialë në Amerikë dhe Angli, rrethanat politike ndikuan që në Gjermani darvinistët të mos mbështesnin konceptin e kapitalizmit *laissez-faire*, por që i vënë theksin më tepër nevojës që shteti të ndërhyjë në treg dhe që të ndalojë atë që darvinistët e konsideronin degjenerim të popullatës, siç vëzhgon Proctori.²⁰ Këtë qasje Ploetzi e quajti higjienë racore (Rassenhygiene), qëllimi i së cilës nuk ishte të kontribuonte vetëm në të mirën e individit, por edhe në të mirën e përgjithshme të racës.²¹ Ideja e higjienës racore ndërlidhej ngushtë me implementimin e politikave racore (Sozialpolitik) për përmirësimin e kombit gjerman duke ofruar një zgjidhje biomedicinale për problemet shoqërore dhe politike që mbretëronin në Gjermani.²² Për të shtjelluar këto tematika, ai e themeloi revistën për biologji racore dhe shoqërore (*Archiv für Rassen - und*

¹⁶ Sheila Faith Weiss, *Race Hygiene and National Efficiency: The Eugenics of Wilhelm Schallmayer* (1987), 11.

¹⁷ Kjo qasje ndërlidhej me gjetjen e një zgjidhjeje për të ashtuquajturin problem social, dhe rrjedhimisht përzgjedhja e një politike që do të adresonte këtë problematikë. Kjo çështje e *Sozialpolitik* filloi të ngritej në fund të shekullit të XIX, kur edhe u themelua Shoqëria për Politikë Sociale (Verein für Sozialpolitik). Sheila Faith Weiss, *Race Hygiene and National Efficiency: The Eugenics of Wilhelm Schallmayer* (1987), 12.

¹⁸ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 94. Robert N. Proctor, *Racial Hygiene: Medicine Under the Nazis* (Harvard University Press, 1988), 62.

¹⁹ Sheila Faith Weiss, *Race Hygiene and National Efficiency: The Eugenics of Wilhelm Schallmayer* (1987), 3.

²⁰ Robert N. Proctor, *Racial Hygiene: Medicine Under the Nazis* (Harvard University Press, 1988), 274.

²¹ Robert N. Proctor, *Racial Hygiene: Medicine Under the Nazis* (Harvard University Press, 1988), 15.

²² Mark B. Adams, *The Wellborn Science: Eugenics in Germany, France, Brazil, and Russia* (Oxford University Press, USA, 1990), 12.

Gesellschaftsbiologie)²³ në mënyrë që të studiojë format më të mira të mundshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e racës.²⁴ Ploetzi ishte edhe i pari që e themloi Shoqërinë për Higjienë Racore (*Gesellschaft für Rassenhygiene*).²⁵

Meqë Ploetz e konsideronte racën si “një grup njerëzish të cilët përgjatë gjeneratave kanë pasur të njëjtat karakteristika fizike dhe mendore”, ky definicion linte hapësirë të mjaftueshme për interpretim liberal. Pavarësisht që definicioni ishte shumë i gjerë, shumë darvinistë gjermanë mbështesnin idenë se njerëzit kaukazianë ose ata që i quanin të racës nordike, ishin superior karshi grupeve të tjera etnike ose racore.²⁶

Kjo qasje kishte rëndësi thelbësore edhe në formimin e politikave të Partisë Nationalsocialiste në Gjermani - çështja e trashëgimisë dhe mbijetesës së racës superiore në botëkuptimin eugenik dhe antropologjik ishin ato ide që shtynë përpara planet për holokaust dhe spastrim etnik të sllavëve. Mendësia e përmirësimit të racës gjermane kishte qenë thelbësore

²³ Përgjatë viteve revista u shndërrua në medium për propagandë antihebraike. Alan E. Steinweis, *Studying the Jew: Scholarly Antisemitism in Nazi Germany* (Cambridge, Mass: Harvard University Press, 2008), 132-137.

²⁴ Robert N. Proctor, *Racial Hygiene: Medicine Under the Nazis* (Harvard University Press, 1988), 17.

²⁵ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 14.

²⁶ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 15. Nuk është se kishte pajtueshmëri të plotë në këto çështje, madje kishte një spektër të tërë mendimesh sa i përket superioritetit të njërit grup karshi tjetrit. Nationalsocialistët i trajtonin temat e “inferioritetit” apo “superioritetit” racor kryesisht në bazë të arritjeve ushtarake dhe kulturore të një populli. Këtë transformim të mendimeve e shohim edhe duke u nisur nga një broshurë që ishte botuar në vitin 1938 që bënte thirrje për tubimin e Nurembergut, ku ilustrohet qartazi pozita që zinte e ashtuquajtura raca nordike - por dhe njëkohësisht pozita e racës sllave - në ideologjinë e nationalsocialistëve: “Evropa Qendrore dhe Veriore janë vendlindja e racës nordike. Në fillim të më së vonës Periudhës së Akullit, rreth vitit 5000 p.e.s., ekzistonin një Urvolk (njerëz autoktonë) të racës nordike, që flisnin të njëjtën gjuhë dhe kishin të njëjtat doke, por që ishin të ndarë në grupe sa më të vogla e sa më të mëdha. Nga këta dolën gjermanët, keltët, romakët, grekët, sllavët, persianët dhe indianët arianë”. John Connelly, “Nazis and Slavs: From Racial Theory to Racist Practice”, *Central European History* (Cambridge University Press, 1999), 32: 1, 1-33. Shumë studiues gjermanë që i trajtonin çështjet racore, e konsideronin racën ariane superiore karshi racave të tjera, përfshirë këtu themeltar të fushës si Alfred Ploetz, Max von Gruber, Ernst Rüdin, Fritz Lenz. Mark B. Adams, *The Wellborn Science: Eugenics in Germany, France, Brazil, and Russia* (Oxford University Press, USA, 1990), 10. Patrick Bernhard, “Hitler’s Africa in the East: Italian Colonialism as a Model for German Planning in Eastern Europe”, *Journal of Contemporary History* (March 2015), 51: 1, 61-90, 3.

në të gjithë ideologjinë që propagandonte Hitleri, i cili thërriste në “promovimin e pjellshmërisë të bartëseve të karakteristikave të shëndosha” dhe sterilizimin e “njerëzve defektiv”.²⁷ Në këtë kontekst, nuk është i habitshëm roli që pati Hitleri në formësimin e ideologjisë nacionalsocialiste gjermane dhe në instrumentalizimin e saj për të arsyetuar dhe ekzekutuar krimet në masë, duke i trajtuar ato si pjesë e natyrshme e përmirësimit të popullatës botërore duke promovuar koncepte që aludonin në superioritet biologjik të gjermanëve (gjegjesisht nordikëve) dhe duke u thirrur në teori të pastudiara mirë shkencërisht. Në vazhden e kësaj logjike, nacionalsocialistët i konsideronin hebrenjtë dhe aziatikët si raca inferiore, e zezakët si raca më inferiore e njerëzimit.²⁸ Në këtë kuptim, pjesëmarrja e darvinistëve gjermanë brenda Partisë Nacionalsocialiste ishte thelbësore në zbatimin e këtyre politikave raciste. Eugen Fischeri dhe Fritz Lenzi (Lenz duke qenë që ishte profesori i parë në Gjermani që u caktua për ligjërimin e higjienës racore në Universitetin e Mynihut në 1923), ishin ata që kontribuan në planifikimin e rivendosjes së popullatës gjermane dhe politikave pasuese në Evropën Lindore.²⁹ Zbatimi i praktikave eugenike në nivel shtetëror u mbikëqyrën edhe nga darvinistë si Friedrichv Burgdörfer, Otmar Freiherrvon Verschuer dhe Ernst Rüdin.³⁰ Mirëpo, përkundër faktit që shumica e darvinistëve socialë besonin në të njëjtat parime, ekzistonin edhe ndryshime mendimesh brenda grupeve të ndryshme të darvinistëve. Këto ndryshime kryesisht kishin të bënin me etiketimin se cila racë ishte më superiore karshi tjetrës. Diferenca në mendime ekzistonin edhe ndërmjet këtyre darvinistëve që zinin pozita të larta në Partinë Nacionalsocialiste e në pozita shtetërore, siç ishte rasti me Fischerin për shembull, i cili më 28 janar të 1933, e dha një fjalim në Shoqërinë e Kaiser Wilhelmit, ku tha se përzierja racore ndërmjet nordikëve dhe njerëzve jonordikë të Evropës (si alpinët, dinarikët dhe mesdhetarët) kontribuan në avancimin e arritjeve të sotme të qytetërimit evropian. Nuk është larg mendsh që këto mendime u konsideruan heretike në periudhën e

²⁷ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 92.

²⁸ Robert N. Proctor, *Racial Hygiene: Medicine Under the Nazis* (Harvard University Press, 1988), 25, 53.

²⁹ *Po aty*, 48.

³⁰ Stefan Kühl, *For the Betterment of the Race: The Rise and Fall of the International Movement for Eugenics and Racial Hygiene* (Palgrave Macmillan US, 2013), 94. Për përfshirjen e studiuesve në politika të spastrimit shih edhe Mark B. Adams, *The Wellborn Science: Eugenics in Germany, France, Brazil, and Russia* (Oxford University Press, USA, 1990), 3-4.

mëvonshme të mbretërimit të nacionalsocializmit, dhe Fischeri u shkarkua nga redaksia e Revistës për Biologji Racore dhe Shoqërore. Fischeri kishte hasur edhe në probleme me Walter Grossin, i cili ishte atëbotë udhëheqës i Zyrës Racore-Politike të Partisë Nacionalsocialiste, kur Fischeri kishte diskutuar parimisht vetëm për tiparet racore të hebrenjve, por pa i vënë ata në kontekst të “inferioritetit karshi nordikëve”.³¹ Ai i ndryshoi mendimet përgjatë viteve vijuese duke i lavdëruar nacionalsocialistët dhe duke thënë se kultura e një populli nuk është vetëm produkt i historisë apo vendit ku ata jetojnë por edhe “produkt i cilësive të racës që i ka dhënë shkëlqim kulturës”.³² Ngjashëm ndodhi edhe me Lenzin në raste, për të cilin hebrenjtë bënë pjesë në të ashtuquajturën racën e Lindjes së Afërt, ku bënë pjesë grekët dhe armenianët, gjë që më vonë do të binte ndesh me doktrinën nacionalsocialiste.³³

Eugenika në kontekst të shqiptarëve

Studimet antropologjike shqiptare kishin zënë fill relativisht me vonesë krahas studimeve në vendet e tjera. Si pasojë e një sërë rrethanash që e pamundësuan zhvillimin e shkencës në trojet shqiptare, një studim antropologjik i quajtur “Raca Shqiptare” ishte botuar për së pari në vitin 1944 me autorësi të Jakov Milajt. Shikuar nga konteksti i sotëm historik dhe social, libri mund të konsiderohet si vepra e parë shqiptare që promovon trajtesa eugenike si pjesë e *Zeitgeist* të kohës. Nën influencë të dukshme të Fishcerit, Milaj trajton tiparet e trashëguara gjenetike nën parimet mendeliane, dhe në këtë formë e vë në pedestal racën shqiptare duke e trajtuar atë si të pastër gjenetikisht.³⁴ Tematika e pastërtisë racore të shqiptarëve është konstante brenda librit, të cilën Milaj e trajton si racë tipike dinarike.³⁵

³¹ Në vitin 1938 Fischeri kishte dhënë një ligjëratë me titull: “Origjina racore dhe historia antike racore e hebrenjve” në Mynih, ku kishte folur për hebrenjtë brenda vijave ideologjike të Partisë Nacional Socialiste, duke e cilësuar racën hebreje si një racë me karakteristika të “pasionit, urrejtjes, vrazhdësisë (...), dinakërisë dhe me një etje për pushtet”. Alan E. Steinweis, *Studying the Jew: Scholarly antisemitism in Nazi Germany* (Cambridge, Mass: Harvard University Press, 2008), 48.

³² Robert N. Proctor, *Racial Hygiene: Medicine Under the Nazis* (Harvard University Press, 1988), 40.

³³ *Po aty*, 53.

³⁴ Jakov Milaj, *Raca shqiptare* (Tiranë: Ismail Mal’Osmani, Botonjës, 1944), 12.

³⁵ *Po aty*, 23.

Sa i përket diskutimi të racës ariane³⁶ (dhe superioritetit teorik që i kishin atribuuar nacionalsocialistët), përkundër darvinistëve gjermanë, Milaj me kujdes të shtuar e vendos diskursin e tipologjisë së saj në kontekst të politikës kohore: *“Mbrenda kësaj suaze së pjesëshme të racavet njerzore, nuk është përmendur një emër që dëgjohet e shkruhet më dendur se cilido tjetër në kohë të sotëshme: raca arjane. Pa dashur të hyjmë në theorit raciste që ndryshojnë dita ditës e prej shteti në shtet, për të mos lënë lexonjsin n’errësirë, por përmendim vetëm se ky skaj i ri është krijuar në këta vjetët e fundit ndër popujt evropjanë në të cilët është ngjallur ndërgjegja e racës dhe urrejta për popullin ebraik”*.³⁷

Në vazhdë me këtë qasje, ai mban qëndrim shqiptaro-centrik duke thënë: *“(…) Por, çfarëdo drejtimi të marrin në t’arthmen këto mendime, për ne nuk ka asnjë rëndësi. Idiomës që flasim shtëpia e gjuhvetindogjermane ia ka hapur të dy kanatat; traditat e bukura e bestytnit janë mbeturi të një qytetrimi që nuk na ndan nga popujt arjanë; studimet anthropologjike racën t’onë e mbajnë si një nga racat më të pastra e më të bukura t’Evropës me fizionomi somatike e shpirtrore që na përmbledh në gjirin e racës arjane, në kuptimin e matur e shkencor që i jep kësaj Biasutti”*.³⁸

Tematikat që kishin për thelb racën shqiptare, dhe në një formë a tjetër aludonin në epërsinë e saj gjenetike, nuk ishin të pazakonta që nga koha e fashizmit italian. Këtë e shohim si zhvillim të natyrshëm nga ideologjia fashiste që ishte importuar te shqiptarët - me të cilin rast rikthehet tematika e nacionalizmit në shtetin-komb brenda një ideologjie në thelbracistë. Në këtë rast duhet theksuar se caqet parësore të fashizmit nuk ishin domosdoshmërisht pastërtia racore, por modernizimi teknokratik³⁹, parime që pjesërisht ishin përvetësuar nga fashistët shqiptarë.⁴⁰ Te Shqipëria fashiste shohim koncepte eugenike të përziera me nacionalizëm modern, që propagandoheshin në mënyrë sistematike nga organet fashiste.⁴¹

³⁶ Termi “racë ariane” dhe “racë nordike” përdoret si sinonim në pjesën më të madhe të trajtesave eugenike.

³⁷ Jakov Milaj, *Raca shqiptare* (Tiranë: Ismail Mal’Osmani, Botonjës, 1944), 22.

³⁸ *Po aty*, 23.

³⁹ Robert O. Paxton, *The Anatomy of Fascism* (Knopf New York, 2004), 13.

⁴⁰ “Nga Jeta e Partisë në Kosovë - Mbritja e Autokinesasë”, *Fashizmi* (1939).

⁴¹ “Mëkëmbësi i Përgjithshëm asiston në ushtrimet e reparteve të Rinis së Liktorit Shqiptar”, *Fashizmi* (1939); “Partija Fashiste Shqiptare”, (Rinija fashiste, 1940); “Milicia Fashiste Shqiptare për ditën XXVIII Tetorit”, *Fashizmi* (1939); “Milicia Fashiste, I. Origina e saj”, *Fashizmi* (1939). Sa i përket fashizmit dhe nacionalizmit shqiptar shih Besnik Pula, “Becoming Citizens of Empire: Albanian Nationalism and Fascist Empire, 1939-1943,” *Theory and Society* (2008), 37: 6, 567-596.

Në këtë frymë, mund të argumentohet që *Opera Nazionale Dopolavoro* (ekuivalente e së cilës ishte “Mbas Puna”⁴² në Shqipëri) u formuan në parimin e punës për përmirësimin e biotipologjisë.⁴³ Ndërkaq, sa i përket sinergjisë së fashizmit me nacionalsocializmit rreth eugenikës, Paxton e shpjegon atë përmes teknokracisë - ai argumenton që sikur mos të kishin përvetësuar nacionalsocialistët konceptin e modernizmit teknokrat, atëherë Holokausti do të kishte marrë vite për t’u kryer.⁴⁴ Këtu gjithashtu duhet vënë re që koncepti i epërsisë së të ashtuquajturit njeri modern, në këtë rast italian, ishte i pranishëm edhe në fashizmin italian të cilët e konsideronin kulturën italiane si vazhduesin e kulturës romake dhe mbrojtësin e kulturës evropiane karshi “botës barbare” të jashtme,⁴⁵ gjë që flet për tematikat e përbashkëta të të dy ideologjive sa i përket koncepteve të epërsisë qoftë kulturore qoftë racore karshi vendeve të tjera, dhe posaçërisht karshi vendeve që i kishin kolonizuar. Ky racizëm sistematik është posaçërisht evident po të shikohen ligjet racore që i kishte vënë në funksion Italia në

⁴² Sa i përket themelimit të Dopolavoros shqiptare më 1942, e shohim që Lugini e komenton atë si: “*Angazhimi i masës së punëtorëve, për të organizuar ngritjen materiale dhe morale, për të organizuar shpłodhjen dhe argëtimin, është qëllimi për të cilin këmbëngul Partia, e që mund të arrihet nëpërmjet ‘Dopolavoro’.* (...) Detyrat e ‘Dopolavoro’, në vija të përgjithshme janë që të organizojnë aktivitete pas orarit të punës për qytetarët. Çdo aktivitet që nuk ka të bëjë me punën dhe me funksionet që rrjedhin prej saj, duhet të organizohen e kontrollohen nga ‘Dopolavoro’.” Andrea Di Nicola, *Ngritja dhe rënia e Partisë Fashiste Shqiptare 1939-1943* (Tiranë: Botart, 2013), 58-59.

⁴³ Francesco. Cassata, “Building the New Man” (S. L.: Central European University Press, 2011), 204. Sipas statutit të saj, Dopolavoro merrej me ngritjen morale dhe fizike të popullit, nëpërmjet sportit, eskursionizmit, turizmit, edukimit artistik, kulturës popullore, asistencës sociale, higjienës, shëndetësisë dhe perfeksionimit profesional. Andrea Di Nicola, *Ngritja dhe rënia e Partisë Fashiste Shqiptare 1939-1943* (Tiranë: Botart, 2013), 14. Qasje të ngjashme sa i përket diskursit eugenik i shohim edhe në Jugosllavi. Jovan Zubović promovonte idenë e krijimit të “njeriut të ri jugosllav” ku biotipologjia do të përmirësohej përmes martesave ndërmjet kombeve jugosllave. Rory Yeomans, *Blood and Homeland: Eugenics and Racial Nationalism in Central and Southeast Europe, 1900-1940*, ed. Marius Turda; Paul J. Weindling (Central European University Press, 2007), 91.

⁴⁴ Robert O Paxton, *The Anatomy of Fascism* (Knopf New York, 2004), 13. Kjo është dhe premisa kryesore e Zygmunt Bauman kur flet për inxhinieringun social. Shih Zygmunt Bauman, *Modernity and the {Holocaust}* (Ithaca, N.Y.: Cornell University Press, 1989).

⁴⁵ Stanley G Payne, *A History of Fascism, 1914-1945* (1995), 379. Mussolini duket të ketë ndryshuar mendim rreth epërsisë së racës italiane pas disfatës së pësuar nga Metaxas në Greqi, ku më pas kishte deklaruar se italianët janë akoma një “racë inferiore” që duhej pastruar përmes vuajtjes. Stanley G. Payne, *A History of Fascism, 1914-1945* (1995), 385. Aristotle A. Kallis, *Fascist ideology: territory and expansionism in Italy and Germany, 1922-1945* (London: Routledge, 2000), 33.

kolonitë e saja afrikane.⁴⁶ Për më tepër, Bernahrd argumenton që këto ligje frymëzuan Hitlerin sa i përket çështjes së zbatimit të praktikave kolonialiste në Evropën Lindore.⁴⁷

Ndërkaq me të dhënat që i posedojmë, fashizmi italian nuk duket të ketë pasur qëndrim specifik sa i përket vendit të shqiptarëve në spektrin inferioritet/superioritet racor. Ndryshe nga fashistët italianë, nacionalsocialistët gjermanë i vendosnin zyrtarisht shqiptarët në të njëjtin tabor me myslimanët e Bosnjës.⁴⁸ Megjithatë, të dhënat arkivore e vejnë në pah që të tilla qëndrime nuk mbanin të gjithë oficerët gjerman, madje disa prej tyre kishin qëndrime plotësisht raciste. Shembulli më tipik i këtij qëndrimi mund të konsiderohet raporti që komandanti i Divizionit SS Skënderbeu, August Schmidhuber, kishte shkruar për divizionin në tetor të vitit 1944:

(...)

Urdhri i lëshuar (për themelimin e Divizionit SS, M.L.) u nis me supozimin se Shqipëria me civilizim dhe kulturë është më pak e zhvilluar në të gjithë nivelin evropian. Nuk mund të mohohet në këtë kontekst se deri kohëve të fundi, njohuritë për Shqipërinë në Gjermani nuk ishin shumë më të mëdha se sa për ndonjë shtet të vogël të Amerikës së Jugut. Në këtë injorancë “zyrtare” ishte zhytur edhe princi Wied. Shqipëria, si një provincë 400-vjeçare turke, ka mbetur më “turke” në çdo aspekt sesa vetë Turqia, nisur nga ferexhetë që bartin gratë e deri te gjuha të cilën e flasin.⁴⁹

Paragrafi ilustron faktin që Schmidhuberi kishte qenë shumë mirë i informuar për historinë e Shqipërisë, dhe këtë ai e vendos në diskurs kolonial kur rikujton mbretërimin kohëshkurtër të princit Wied, dhe siç nënkuptohet nga raporti, dështimin e tij ia atribuon prapambetjes që mbretëronte tek shqiptarët që kishte shkaktuar pamundësinë në të vepruar për Wiedin. Referenca historike Schmidhuberi bën edhe në paragrafin pasues, ku më e spikatur është toni përcëmues që përdor për shqiptarët:

⁴⁶ Giulia Barrera, “Mussolini’s colonial race laws and state-settler relations in Africa Orientale Italiana (1935-41)”, *Journal of Modern Italian Studies* (January 2003), 8: 3, 425-443.

⁴⁷ Patrick Bernhard, “Hitler’s Africa in the East: Italian Colonialism as a Model for German Planning in Eastern Europe”, *Journal of Contemporary History* (March 2015), 51: 1, 61-90, 3.

⁴⁸ Franziska A. Zaugg, *Albanische Muslime in der Waffen-SS: Von “Großalbanien” zur Division “Skanderbeg”* (München: Ferdinand Schöningh, 2016), 195.

⁴⁹ Bundesarchiv-Militärarchiv Freiburg (më tej: BArchF) RS 3-21/1, f. 1.

Shqiptarët nuk janë zhvilluar që nga vdekja e heroit të tyre të lirisë, Skënderbeut (1468), por përkundrazi kanë vegjetuar. Ata ende nuk kanë ndonjë ndërgjegje të theksuar kombëtare dhe politike, por ata ende jetojnë ashtu siç jetonin gjermanët një kohë, në klane dhe në të menduar fisnor. Fati i popullit të Shqipërisë pas vdekjes së Skënderbeut mund të krahasohet më mirë me atë sikur Gjermania të mos kishte prodhuar më asnjë udhëheqës tjetër pas Princit Hermann të Çeruskëve.⁵⁰

Ndërkaq Schmidhuberi nuk le pa përmendur edhe vëzhgimet e tij sa i përket funksionimit shoqëror e ekonomik të shqiptarëve dhe organizimin ushtarak të ushtrisë shqiptare:

Sa i përket aspektit shoqëror, populli është kryesisht rural (që përbën 85-90% e popullsisë), të cilët janë nën sundimin mesjetar feudal të bejlerëve dhe agallarëve. Qiradhënësit jo vetëm që duhet të japin një pjesë të mirë të frytit të punës së tyre që e vjelin në natyrë, por duhet gjithashtu të dalin në mbrojtje të territorit të (zotëve të) tyre. Po aq sa shqiptarët shfrytëzohen nga pronari i tyre, ata lejojnë po aq shumë të ndikohet dhe abuzohet nga [bejlerët dhe agallarët] në politikën vendore të popullit; ai nuk ka zgjedhje të tjera, sepse ai nuk mund të bëjë gjë "kundër-goditëse".

Nga pikëpamja thjesht ushtarako-organizative, rendi ishte bazuar në kushte të gabuara: Shqiptarët nuk kishin trupa të rregullt në kuptimin gjerman. Formacionet ushtarake në Shqipërinë e sotme përbëhen nga milicitë që ishin themeluar nga italianët, të cilëve edhe iu kishin vënë uniforma që nga jashtë i ngjasonin formacioneve ushtarake të italianëve vetëm. Çdo strukturë mirëfilli e brendshme mungonte. Mosdisiplina si veti kryesore e shqiptarëve nuk u shtyp ngadalë në milicitë italiane, por përkundrazi u ushqye. Disiplina do të thotë për shqiptarët një kufizim i dukshëm i lirisë së tij. Shqiptari jeton në liri natyrore dhe bën çfarëdo që ai dëshiron. Ai ka kohë.⁵¹

Ndërkaq toni kolonial dhe racist sa vjen e spikatet më shumë në përshkrimin e vëzhgimeve të tij rreth komandimit të ushtarëve shqiptarë:

Ai nuk donë të luftojë në një strukturë ushtarake, por me bandën e tij. Në këtë bandë nuk ekziston vetëdisiplina. Kur bie shi, shqiptari largohet prej pozicionit të tij; kur errët, ai ikën nga

⁵⁰ Është fjala për Ariminiusin (18-17 p.e.s.-21 e.s.) që udhëhoqi një koalicion të fiseve gjermanë në fitore kundër legjioneve romake në betejën e Pyllit të Teutoburgut në vitin e 9 të erës sonë. *BArchF*, RS 3-21/1, f. 1.

⁵¹ *BArchF*, RS 3-21/1, f. 1.

pozicioni i tij dhe vete në fshat ku pinë raki; Nëse rrinë 12 orë në pozicionin e tij, ai ikën në shtëpi pa pyet udhëheqësin e tij dhe rri aty për 4-5 orë, dhe mbase kthehet ose jo prapë te grupi i tij.

Ai nuk din dhe nuk donë të mësohet të shtijë me pushkë. Aftësitë e tij të supozuara në gjuajtje janë vetëm një mit. Por ai parapëlqen të shtijë, mundësisht nëse është i shtrirë prapa një barrikade, dhe duke gjuajtur lart me dedikim dhe vazhdimësi. Këtë pasion dhe përgjegjësi e mbajnë edhe të ashtuquajturit pjesëmarrës të ushtrisë shqiptarë, të cilët e kanë vetëm një batalion. Andaj, uria e shqiptarit për municion është e pashtershme. Paraqitet shtytja që të mos i jepet kaq shumë municion, kur kihet parasysh që municioni prodhohet në fabrikat gjermane nga gratë dhe vajzat, teksa meshkujt e fortë kotën nëpër kafe dhe pazare.⁵²

Raporti i Schmidhuberit ndërkaq merr tone edhe më raciste në përshkrim të shqiptarëve:

Guximi heroik i shqiptarëve është gjithashtu pjesë e një miti, ngaqë me një granatë të lehtë mund t'i ndjekësh shqiptarët rreth e përqark globit. Nëse sulmon, ai e bën këtë vetëm deri në atë pikë sa të mund të vjedhë ose plaçkitë. Nëse e ka zënë ndonjë dash, plug apo ndonjë makinë qepjeje, atëherë lufta ka mbaruar për të, dhe ai ikën vetvetiu në shtëpi. Në mbrojtje të tij, shqiptari është shumë i ndjeshëm ndaj zjarrit.

Sa i përket veshjes, stërvitësit hasnin në vështirësi të njëjta me zezakët. Rekrutët vendas u pajisën me këpuca për herë të parë në jetën e tyre. Ata ishin shumë krenarë me këtë gjë dhe nuk dilnin natën. Në anën tjetër, ata i zbathnin këpucët e tyre sapo paraqitej nevoja të marshonin për më gjatë. Përndryshe, sapo shqiptarit i paraqitet nevoja të ikën, i kallëzon dashuri këpucëve të tyre duke i hedhur tutje në mënyrë që të ikën më shpejtë zbathur. Për ata që mësohen të bartin uniformën në të plotë, aty ku ka sukses, në vetvete paraqet një arritje të jashtëzakonshme në Shqipëri.⁵³

Në aspektin historik, ky raport nuk paraqet politika zyrtare të Rajhut të Tretë karshi shqiptarëve, por hedh dritë mbi opinionet, qofshin ato personale, që mund të kenë pasur oficerët gjerman për shqiptarët. Në anën tjetër, raporti është i rëndësishëm ngaqë nga ky mund të deduktohet që formimi ideologjik nacionalsocialist kishte lënë mbresa të thella në

⁵² *BArchF*, RS 3-21/1, f. 2.

⁵³ *BArchF*, RS 3-31/1, f. 2.1.

formimin e një vetëdije kolonialiste tek gjermanët, dhe që këta i kishin përbrendësuar në të plotë teoritë mbretëruese eugenike që flisnin për superioritetin racor arian/nordik dhe dukej që i aplikonin ato sa herë vinin në kontakt me një grup tjetër etnik. Duke qenë që raporti ishte shkruar në tetor të vitit 1944, mund të vijmë në përfundimin që asnjë sasi propagande për “shqiptarët evropianë dhe dinarikë” që ishte bërë gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk kishte arritur ta bindte Schmidhuberin për denjësinë e shqiptarëve në sy të “arianëve superiorë”.

Mrika LIMANI-MYRTAJ

SUMMARY

AN OVERVIEW ON NATIONAL-SOCIALIST GENETIC SELECTION AND ALBANIANS WITHIN THIS WORLDVIEW DURING THE SECOND WORLD WAR

The eugenic movement was a defining approach that marred a substantial number of intellectuals and geneticists in the United States, Great Britain and Germany at the beginning of the 19th century and during the first part of the 20th century within the context of the reigning nationalist states. While initially the movement did not propound an internalization of racist overtones, by promoting the idea that reproductive selection ought to work in favor of the species that the eugenists deemed more worthy (meaning the Caucasians, as the movement was essentially Euro-centric), the movement swiftly became a supporting net for radical politics that flourished in the 20th century.

It is worth noting that some essential variation existed between the eugenists in the United States and Great Britain as opposed to those in Germany. For example, in the former case, powerful and wealthy individuals sought to legitimize their social and economic position and simultaneously justify the unjust stratification of social classes and rising social problems caused by uncontrolled capitalism. The latter were more preoccupied with class eugenics, as opposed to the German eugenists who became more occupied with biological (racial) eugenics.

National Socialism was greatly influenced by German eugenists, even going as far as to claim that National Socialism essentially represents applied biology by promoting the idea that the Aryan/Nordic race was the most biologically supreme. These ideas attracted other non-German scholars as well, who all within their capabilities, attempted to argue that their own specific race was just as pure and superior as the Aryans. A similar case occurred in Albania, where Jakov Milaj published his book 'Raca Shqiptare', which essentially claimed that the Albanians pertained to the so-called Dinaric race, and that in that sense they were just as pure and superior as the Aryan race themselves. These ideas, however, seemed to not

fare so well with the SS Division Commander August Schmidhuber, who upon completing his task in commanding the division, wrote a lengthy report that contain numerous contemptuous observations and racist undertones.

Erjon PAPAGJONI

**SHTETI KOMUNIST DHE INSTITUCIONET FETARENË
SHQIPËRI 1944-1949**

Raporti i shtetit komunist me komunitetet fetare në vitet 1944-1949 ka qenë i ndërlikuar, kufizues, diskriminues dhe shkatërrues, falë politikës sektare të ashpër e mohuese që regjimi komunist ndoqi ndaj tyre qysh në kryeherë. Një varg masash të rrepta u ndërmorën ndaj klerit të lartë dhe institucioneve fetare, të cilat u paraprinë nga akuzat politike, për t’u vazhduar më tej me masat ekonomike. Ata u akuzuan si tradhtarë, si bashkëpunues me pushtuesin, si armiq të pushtetit e të rendit kushtetues. Komunitetet fetare u dëmtuan rëndë sidomos nga reforma agrare e cila u mori një pjesë të rëndësishme të pronave të tyre. Masat e marra kundër besimeve në Shqipëri patën efekte të drejtpërdrejta mbi pozitën e tyre institucionale, sociale e ekonomike, por edhe morale e shpirtërore në raport me besimtarët. Masat ndëshkuese e kufizuese të shtetit komunist e zbehën “pushtetin” hyjnor të klerikëve shqiptarë në sytë e besimtarëve dhe kryerjen normalisht të veprimtarisë religjioze. Politika e shekullarizimit e keqkuptuar dhe e keqinterpretuar në thelbin e saj e kufizoi ndjeshëm arsimin fetar, shkollat dhe stafet mësimdhënëse, botimet dhe literaturën fetare. Dënimet, presionet dhe politika e përçarjes së shtetit komunist, ndikuan dhe nxitën në konvertimin dhe shndërrimin e funksioneve shpirtërore të klerit shqiptar në funksione sociale, madje dhe politike. Një kalvar i gjatë persekutimesh, ndalimesh, burgosjesh dhe shfarosjesh ranë gjatë këtyre viteve mbi klerin shqiptar. Për t’i pasur nën kontroll dhe për të shmangur çdo mundësi ndikimi e komunikimi me institucionet simotra në botë, shteti shqiptar në vitin 1950 u imponoi komuniteteve fetare hartimin e statuteve të tyre në përputhje me synimet e tij politike.

Argument hyrës

Përpara se të cekim argumentet kryesore të këtij artikulli, duhet të përmendim jo paqëllim situatën juridike të raportit të shtetit me fenë në periudhën e konsolidimit të shtetit shqiptar pas Kongresit të Lushnjës si dhe në periudhën e Republikës e të Monarkisë në vitet 1925 -1938. Kjo për disa arsye:

Arsyeja e parështë ajo *historike*, çka na detyron të pohojmë specifikën e fenomenit dhe të marrëdhënieve shtet-fe në Shqipëri në vitet '20-'30 të shekulli XX. Komunitetet fetare në Shqipëri, qofshin ato myslimane, katolike, ortodokse, bektashi dhe protestante (ungjillore), si dhe një morie sektesh të përfshira në to, përbëjnë një histori më vete me strukturat institucionale, me jetësimin e tyre në aspektin kohor, me premisat zhvillimore, me demografinë e besimeve, me rekapitulacionet historike dhe juridike pas shembjes së Perandorisë Osmane dhe daljes së tyre nga tutela e saj etj.

Arsyeja e dytë, ajo *juridike*, ka të bëjë me statusin e komuniteteve fetare në raport me shtetin dhe shoqërinë shqiptare në tërësi, me varësinë apo pavarësinë e tyre funksionale e hierarkikenga qendrat klerikale botërore. E rëndësishme këtu është që të ndriçohen aspektet formale e ligjore të këtyre marrëdhënieve komplekse midis dy entiteteve juridike, herë me pranim e herë dhe refuzim, duke krijuar hapësira sa më të përligjura (juridikisht) në raport me ligjin themeltar të shtetit, Kushtetutën, si dhe me karakterin e këtij shteti: demokratik apo monarkik qoftë ai.

Arsyeja e tretë, është sigurimi dhe konsolidimi i *sekularizmit* të shtetit, një atribut vështirësish i realizueshëm në kushtet e një Shqipërie që sapo kishte dalë nga zgjedha e rëndë disa shekullore nën Perandorinë Osmane, ndërkohë që kombet dhe shtetet e tjera i kishin jetësuar më parë këto formula juridike ndërvepruese të shtetit me fenë. Shteti i ri shqiptar në vitet 1920-1939 ndoqi paradigmen e krijimit të një shteti laicist, gjegjësisht modeleve të sprovuara evropiane. Regjimi komunist që pasoi në vitin 1945 ndërtoi njëfushatë të egër kundër fesë, pikërisht duke përdorur sloganin e laicizmit dhe sekularizmit. Por, e gjitha kjo s'që veçse një keqkuptim dhe keqinterpretim i këtyre parimeve, e cila çoi në asgjësimin e shumësisë së pikëpamjeve mbi botën, njeriun dhe të menduarit e tij, ndër to edhe të botëkuptimit fetar.

Arsyeja e katërt, ka të bëjë *mespecifikën* e Shqipërisë: praninë e katër komuniteteve të ndryshme fetare brenda hapësirës së një kombi dhe të një shteti, çka krijon një rast thuajse unik në ndërveprimin e këtyre tri

hallkave a kompozitave sa social-politike, aq dhe historike, e më tutje shpirtërore e antropologjike. Ndonëse me identitete të mëvetësishme historike e fetare, asnjë prej komuniteteve fetare në Shqipëri nuk e ka superuar kombin, as dubluar, dhe as zëvendësuar atë. Përkundrazi, në projektet politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare u përcaktua fare qartë apelacioni: “Feja e shqiptarit ështëshqiptaria”, duke nxjerrë në plan të parë kombin, atdheun dhe lirinë. Këtu gjejmë të pleksura raportet në aspektin kombëtar dhe atë universal të fesë e të komuniteteve fetare. Kombi dhe feja kanë ecur në të njëjtat shina, që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar dhe me pas, me qeveritë e krijuara pas Kongresit të Lushnjës dhe më tej gjatë qeverisjes së Mbretit Zog. Njohja e kësaj trashëgimie na ndihmon që të ndriçojmë më tej raportet kontroverse dhe armiqësore të shtetit komunist ndaj fesë dhe komuniteteve fetare, sikurse raportin midis ideologjisë kombëtare dhe ideologjisë komuniste.

Arsyeja e pestë, ka të bëjë me *ndërveprimin racional dhe harmonik* midis shtetit dhe komuniteteve fetare për krijimin e kohezionit social dhe kombëtar, gjë e cila u sabotua dhe u dëmtua rëndë nga regjimi komunist gjatë viteve 1944-1960, për t’u likuiduar plotësisht në vitin në vitin 1967, me ndalimin e fesë dhe shpalljen e Shqipërisë si vendi i parë ateist në botë. Lufta e klasave si parimi bazë i partisë-shtet, i llojit totalitar e diktatorial, e identifikoi fenë si një “armik” të përbetuar të ideologjisë komuniste, duke sjellë përçarje e ndasi midis njerëzve.

Arsyeja e gjashtë, është ajo e *tolerancës fetare*, një realitet shembullor i shqiptarëve që kanë jetuar në paqe, vëllazëri, harmoni, solidaritet me njëri-tjetrin, në një hapësirë gjithsesi të ngushtë dhe me besime të ndryshme, të vjetra dhe të reja. Kjo traditë e konsoliduar nëpër shekuj ka shmangur përçarjet, urrejtjet dhe luftërat fetare. Ajo ka sjellë një nga përvojat më pozitive e më unike në botën e stome, të “habitshme” për vështirimet konservatore dhe tradicionaliste, por frymëzuese dhe e jashtëzakonshme për realitetet me natyrëkonvertuese e për bashkëjetesën e komuniteteve të ndryshme fetare.

Ndarja e shtetit nga feja, laicizmi dhe shekullarizimi, si dukuri substanciale të progresit social e politik në vendet e Evropës Perëndimore, pati një shtrembërim flagrant qysh me vendosjen e regjimit komunist menjëherë pas Luftës II Botërore. Krahës qëndrimeve të qarta politike dhe administrative, ky raport dhe ky model i ri u kushtëzuan në mënyrë të ndjeshme, pos të tjerash, edhe nga kundërshtia ideologjike midis doktrinë teologjike që frymëzonte institucionet fetare dhe doktrinën marksiste-leniniste që frymëzonte shtetin e “diktaturës së proletariatit”.

Karl Marksi, ideatori, filozofi dhe projektuesi i shoqërisë komuniste, lidhur me fenë, ndër të tjera ka thënë: “Kritika e fesë është premisë e çdo kritike tjetër... Baza e kritikës ateiste është: njeriu e krijon fenë, kurse feja nuk e krijon njeriun dhe pikërisht: feja është vetëdija dhe vetëndjeshmëria e njeriut, i cili ose nuk e ka gjetur akoma vetveten, ose e ka humbur veten përsëri... Heqja e fesë, si lumturi iluzore e popullit, është kërkesa e lumturisë së tij të vërtetë... Pra, kritika e fesë është në embrion kritikë e asaj lugine lotësh, aureolë e shenjtë e së cilës është feja”.¹

Dhe në një formë më sintetike, më ironike e cinike, e shoqëruar me një metaforë që e bën të mprehtë stilin e shkrimit, Marksi theksonte: “Feja është psherëtimë e krijesës së shtypur, zemra e një bote pa zemër, ashtu sikurse ajo është shpirti i një sistemi pa shpirt. Feja është opium për popullin”.²

Si dy identitete përjashtuese -feja dhe shteti komunist shqiptar u thirrën në një “duel politik” të imponuar e intolerant, pasi dihej se ky i fundit nuk e pranonte fenë, e çdo forme qoftë ajo. Sipas optikës së tij, feja nuk konsiderohej aspak faktor i shëndoshjes së shoqërisë, i shpjegimit dhe artikulimit të së vërtetës “shkencore” mbi zhvillimin e historisë dhe të vetë shoqërisë nga pozitat e “materializmit historik” dhe e “luftës së klasave”. Përkundrazi, doktrina marksiste e cilësonte çdo strukturë fideiste dhe çdo religjion në vetvete si një pushtet obskurantist, okult dhe i gënjeshtërt, i cili mbulonte kontradiktat social-klasore dhe synonte t’i pajtonte ato. Si rrjedhojë, feja legjitimonte pushtetin shtypës të “klasave shfrytëzuese”!...

Baza teorike e shteteve komuniste në lidhje me raportet e tyre me fenë është e njëjtë, por politikat dhe marrëdhëniet juridike në praktikë janë shoqëruar me ndryshime. Rasti i Shqipërisë komuniste duket se përbën një përjashtim. Fenomeni shqiptar në raport me fenë dhe besimet fetare, përbën një risi edhe për vetë botën komuniste, sepse askund tjetër nuk ndodhi sikurse në Shqipëri, ku besimet fetare u kufizuan, u luftuan dhe u likuiduan me ligj. Lënia qëllimisht në dekadencë e enteve fetare dhe lufta ideologjike shpallur ndaj besimit dhe botëkuptimit fetar, kishte si instancë të fundit shkëputjen e strukturës institucionale të fesë nga struktura juridike e shtetit, rrjedhimisht përjashtimin nga korpusi ligjor kushtetues, duke e kthyer në inekzistent një realiteti shekullor, me ndikim të gjerë shpirtëror. Ky fenomen shqiptar ishte i veçantë, sa në aspektin social, aq dhe në atë kombëtar.

¹Karl Marks e F. Engels, *Mbi fenë*, Tiranë, Shtëpia Botuese: “8 Nëntori”, 1970, f. 44-56.

²*Po aty*, f. 45.

Vendosja e pushtetit komunist fill pas Luftës II Botërore u përball edhe me nevojën e një përcaktimi të qartë të qëndrimit ndaj fesë, forumeve të saj dhe më gjerë ndaj lirisë së ndërgjegjes. Qeveria e dalë nga Mbledhja e Beratit miratoi liritë dhe të drejtat e njeriut si pjesë të programit të saj. Por, me kalimin e kohës ajo nuk iu përmbajt atij programi, ndonëse synonte të bëhej anëtare e Kombeve të Bashkuara që në krijimin e kësaj organizate. Më 10 dhjetor të vitit 1948, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, nxori dhe shpalli *Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut*, një dokument me rrezatim të gjerë në gjithë shtetet dhe kombet e botës, e ardhur si apel për emancipim të mëtejshëm të shoqërisë dhe një shkallë të re të qytetërimit. Qysh në nenin 2, Deklarata shprehej: “Secilit i përkasin të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë, pa kurrfarë dallimesh në pikëpamje të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, të prejardhjes kombëtare a shoqërore, të pasurisë, të lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër juridike”.³ Dhe më tej, në nenin 18, ajo përcakton edhe më qartë lirinë e besimit fetar. “Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë; kjo e drejtë përfshinë lirinë e ndërrimit të fesë a të bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht fenë a bindjen e vet, nëpërmjet arsimit, praktikës, kryerjes së kultit dhe riteve fetare”.⁴

Në kushtet e Shqipërisë si vend me disa besime fetare, liritë e shpallura në *Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut*, do të ishin më se të mirëpritura dhe në përputhje me realitetin e saj. Pra feja, në gjendjen e saj juridike, që do të përkthehej tek format e organizimit të saj si komunitete fetare, si forume, si struktura institucionale, si ente e gjer te infrastruktura e logjistika me godinat, faltoret dhe asetet e ndryshme, si një e drejtë dhe liri themelore e njeriut. Liria fetare përfshinte jo vetëm të drejtën e shprehjes lirisht të identitetit fetar të personit, të organizimit të tyre në bashkësi, të ushtrimit të ritualeve fetare sipas besimit përkatës, por ajo shkonte edhe më tej, kur i referohej të drejtës për të ndërruar fenë si individ, apo kolektivisht, ndërkohë që përfshinte edhe të drejtën për të mos besuar, pra për të qenë ateist. Në përplasjen e këtyre kaheve dhe realitetin specifik shqiptar, atë të trashëguar nga historia dhe atë të jetuar së fundmi fill pas luftës, u shëstuan edhe marrëdhëniet midis fesë dhe shtetit në vitet 1944-1990.

³<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>

⁴*Po aty.*

Vendosja e pushtetit komunist, feja dhe komunitetet fetare

Qysh në zanafillë, struktura e pushtetit të ri komunist e konsideroi fenë dhe institucionet fetare jo si një forcë bashkëpunuese, paqësore, me frymë pajtuese, por armiqësore e destruktive. Pikërisht kjo qasje paraqet interes të vazhdueshëm në studimet tona historike, pasi aty nyjëtohen dukuri e procese të një rëndësie të madhe e me ndjeshmëri shoqërore, të cilat reflektojnë po aq edhe disa specifika sociale, e më gjerë, të vetë realitetit historik të shqyrtuar, duke mundësuar kështu ndriçimin e tij nga një optikë sa më pranë të vërtetës.

Periodha e shkurtër prej gati 5 vjetësh (nëntor 1944-nëntor 1949) paraqet interes për raportet e shtetit me institucionet fetare, të cilat pas kësaj periudhe u bënë më të qarta e të më të dukshme. Nga njëra anë shteti i ri komunist i bazuar në doktrinën marksiste e afishonte veten si një shtet afetar, që nxiste ateizmin dhe qëndrimet refraktare ndaj fesë dhe institucioneve fetare, ndërsa nga ana tjetër, nisur nga interesa pragmatiste e populiste bëri përpjekje që të mos binte ndesh në mënyrë të vrazhdët me besimet dhe me institucionet e tyre. Në të kundërtën, duke luajtur dinakërisht dhe me shkathtësi në shilarësin e koniunkturave që krijoheshin dhe duke u rrekur të kufizojë sa të qe e mundur më shumë ndikimin e fuqishëm që feja ushtronte në popull, ai u soll me takt ndaj traditave dhe trashëgimisë fetare vështirë të tejkalueshme në këtë lami shpirtërore. Kjo e detyronte shtetin komunist të ndiqte në hapat e parë një politikë fleksible, të thyeshme, tërhiq e mos këput. Më së shumti ai bënte diferencime politike tinëzare midis klerikëve të ndryshëm, duke iu referuar qëndrimeve të tyre ndaj Luftës Nacionalçlirimtare dhe pushtuesve, por duke mos lënë pa përmendur flirtet dhe impaktet “negative” të tyre, (posaçërisht Kisha Katolike) me italianët dhe gjermanët. Shteti komunist anatemoi në mënyrë të veçantë raportet e Kishës Katolike me Selinë e Shenjtë, si një nga simbolet e mëdha të botës perëndimore, duke përfshi edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (kjo e fundit armiku kryesor i kampit socialist!).

Përzierja e qëllimtë e fesë me politikën dhe shndërrimi në *casusviventis* i marrëdhënieve të ngushta të Kishës Katolike shqiptare me Selinë e Shenjtë, bëri që kjo e fundit të shihej qysh në kryeherë si “armike e shtetit”. Po kështu, refuzimi i heshtur që komunitetet e tjera fetare kishin ndaj komunizmit si doktrinë, e cila nxiste, përligjte dhe aplikonte “luftën e klasave”, urrejtjen civile, konfliktin, diferencimin dhe përçarjen politike, nuk mund të mos shkaktonte dyshime dhe keqkuptimenë marrëdhëniet e tyre me shtetin komunist. Përkundrazi, doktrinën fetare dhe shkrimet e

shenjta, *Bibla* dhe *Kur'ani* predikonin dashurinë, solidaritetin ndaj të varfrit, ndihmën ndaj të munduarit, paqen dhe mirësinë. Ky qëndrim u thellua dhe u bë më armiqësor nga viti në vit.

Një vijë ndarëse të qartë në marrëdhëniet e shtetit me besimet fetare e shënoi Kongresi i Parë i Partisë Komuniste të Shqipërisë (8-22 nëntor 1948). Feja dhe institucionet fetare këtej e tutje do të shikoheshin vetëm si forca konservatore, arkaike, çoroditëse, madje të rrezikshme dhe armiqësore nëse i kundërviheshin sistemit të ri socialist. Zoti si krijues, fatpërcaktues, ngushëllues, shpëtimtar dhe shpresëdhënës, suprimohej. Në vend të tij u ngrit një Zot tjetër: Partia Komuniste dhe lideri i saj Enver Hoxha, kulti dhe miti i të cilëve tejkalonte gjithçka.

Në mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, mbajtur më 20 deri 30 tetor 1944 në Berat, krahas vendimeve të shumta që parapërgatitnin ardhjen e pushtetit të ri të komunistëve fill pas Luftës II Botërore, u përfshi edhe një deklaratë e të drejtave të qytetarëve, ku garantohej liria e besimit duke u njohur të drejta të barabarta gjithë komuniteteve fetare që vepronin në Shqipëri si dhe ushtrimin e riteve dhe praktikave religjioze të besimtarëve. Afërmendsh se qysh në krye të herës pushteti komunist do të shestonte vektorët e tij politikë të qëndrimit ndaj fesë dhe institucioneve të kultit, duke u orientuar gjithnjë e më shumë drejt një kufizimi e ngushtimi të shkallëshkallshëm të drejtave, funksioneve, fuqisë dhe pavarësisë ekonomike të tyre, pronës dhe kompetencave ligjore të ushtrimit e ndikimit në popull⁵, por pa mundur, nga ana tjetër, të shfaqet në forma të ashpra, agresive e përjashtuese, të cilat do të pasonin më vonë. Në rrafshin politik është për t'u theksuar se qysh në kapitullin XIII të Kushtetutës së re të Republikës së Shqipërisë, e 14 marsit 1946, në nenin 7 të saj ndaloheshin partitë me sfond fetar, çka u sanksionua në mënyrë eksplicite në dekretin nr. 24, i 6 dhjetorit 1946, ku shkruhej se ndaloheshin formimi i partive, ndër të tjera, ato që “organizoheshin në bazë të fesë duke mbjellë urrejtje mes kombësive të ndryshme, racave dhe besimeve fetare”.⁶

Dy-tre vitet e para pas Luftës II Botërore dhe vendosjes së pushtetit komunist pati një lloj “dualizmi” apo lojë me dy fytyra të shtetit në raport me fenë, çka siç shprehet me të drejtë studiuesi italian Giovanni Cimbalò, “nga njëra anë kërkohej përhapja e shkollave për formimin e personelit fetar, nga ana tjetër synohej futja e lëndës së mësimi fetar në shkollat

⁵Dilaver Sadikaj, *Pozita e fesë në Shqipëri në kushtet e sistemit komunist*, Tiranë, 1972, f. 504.

⁶*Mbi formimin e partive politike*, Gazeta zyrtare nr. 115, 23 dhjetor 1946, f. 2.

publike, në përputhje me dispozitat e statutit të vitit 1929⁷, i cili nuk u shfuqizua ndonjëherë. Pas kësaj faze të parë që karakterizohej nga njëfarë lirie relative, në fillim të vitit 1954 nisi përndjekja edhe kundrejt klerit mysliman”.⁸

Tuk Jakova, një nga figurat kryesore të Partisë Komuniste, më 20 dhjetor 1946, në gazetën “Bashkimi” shkruante se kleri kishte luajtur një rol shumë të madh armiqësor, duke qenë i lidhur ngushtë me regjimin feudal të Zogut. Sipas tij, priftërinjtë katolikë “kanë qenë vazhdimisht bashkëpunëtorë të ngushtë të okupatorëve dhe pushtuesve që kanë skllavnuene shtypun popullin. Kanë qenë agjenta spiritualë të Italisë fashiste, kanë qenë agjentat më aktivë të Italisë fashiste që kanë punuem me të gjitha mjetet dhe mënyrat për përgatitjen e 7 prillit”.⁹ Akuza e Tuk Jakovës shkonte edhe më tutje, duke i konsideruar klerikët e lartë të kishës katolike mirëfilli si armiq politikë të pushtetit popullor, si potencial të krijimit të trazirave politike gjer dhe të goditjes me armë nga malësorë të pakënaqur dhe antikomunistë. “Këta elementë reaksionarë të klerit katolik janë kundërshtarë të independencës së Shqipërisë, kundërshtarë të rrugës që po ecën populli ynë, lumturisë së popullit, ata gëzojnë kur populli vuan dhe qeshin kur populli qan. E tillë është përmbajtja esenciale e politikës së pandryshueshme të kishës: autoritet, hierarki, pabarazi. Kjo politikë është reaksionare në parim dhe në natyrën e saj”.¹⁰ Kleri katolik shqiptar këqyret vetëm në kontekstin politik dhe jo në kontekstin religjioz. Në artikullin redaksional të gazetës “Bashkimi”, Selia e Shenjtë dhe shteti i Vatikanit, vlerësohet si fole e reaksionit dhe bashkëpunëtor i forcave pushtuese nazifashiste të bushtit Berlin-Romë-Tokio. “Vatikani është ndihmës i imperialistëve. Imperialistët kanë nevojë jo vetëm për mitraloza që të shtypin popujt që janë nën sundimin e tyre, por edhe për një influencë të

⁷Mbreti Zog I, më 8 gusht 1929 miratoi vendimin e Këshilli të Ministrave mbi Statutin e Komunitetit Mysliman. *Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar* u miratua në Kongresin III të myslimanëve, 8 gusht 1929. Më 26 shtator 1929 u miratua edhe *Statuti i Komunitetit Bektashian Shqiptar*; “Gazeta zyrtare”, nr. 53, 24 gusht, 1939, 6.

⁸Cimbaldo, Giovanni, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri*, Studime të së drejtës së krahasuar, E DREJTA KISHTARE DHE TË DREJTAT NJERËZORE, Raporti i fesë me shtetin në Shqipëri, Naimi, 2013.

⁹Gazeta “Bashkimi”, 20 dhjetor 1946.

¹⁰*Po aty*.

përshtatshme ideologjike mbi ta, influencë të përforcuar me autoritetin e besimit dhe të kishës”.¹¹

Një gjuhë e tillë bënte një akuzë mirëfilli politike ndaj Vatikanit si pjesë e bekimit të fashizmit italian dhe boshtit Berlin-Romë-Tokio, çka ishte një gënjeshtër e hapur. E një kahu tjetër duket marrëdhënia e shtetit të ri ndaj komunitetit mysliman dhe atij ortodoks. Ai ngjan disi më tolerant, jo armiqësor deri në fund. Akuza politike nuk janë thuajse tërësore si ndaj klerit katolik. Kjo sepse edhe pjesëmarrja e besimtarëve myslimanë dhe ortodoksë në Luftë ishte më masive dhe më e drejtpërdrejtë. Madje disa nga klerikët e lartë fetarë të komunitetit mysliman, bektashi e atij ortodoks, ishin të përfshirë dhe në rrethet drejtuese të shtetit. Por asgjë s’mund të thuhet në mënyrë përfundimtare.

Më 21 janar të vitit 1945, Këshilli Drejtues i Shoqatës së Rinisë Myslimane, vendosi t’u propozojë organeve përgjegjëse shtetërore abrogimin e Dekretit Mëkëmbësor nr. 123, datë 9 qershor 1942 dhe rivënien në fuqi të Statutit të Kongresit III Mysliman të vitit 1929. Një muaj më vonë, më 17 shkurt, Ministria e Drejtësisë, duke marrë parasysh, në njërën anë, dorëheqjen nga detyra të kryetarit të Këshillit të Ulemave, Hafiz Sherif Langut, dhe në anën tjetër, konfliktin që ekzistonte në mes Këshillit të Ulemave dhe Medresesë së Përgjithshme, shkarkoi nga detyra të gjithë anëtarët e Këshillit të Ulemave dhe formoi një Këshill të Përkohshëm, të përbërë nga Hafiz Musa Aliu, titullar, me anëtarë kryemyftiun e zonës së Tiranës, Muharrem Mullajn, Hamdi Këlliçin, profesorin e Medresesë së Përgjithshme, Vexhi Demirajn dhe Selim Stërmasin. Ky Këshill ngarkohej edhe me administrimin e pasurisë vakëfnore, si dhe me mbledhjen e Kongresit Mysliman. Titullari Hafiz Musa Aliu, së bashku me anëtarët e Këshillit, u ftuan në Ministri dhe pasi morën njoftimin, filluan nga puna. Në përputhje me statutin, më 10 mars të po atij viti, Kryesia e Këshillit të Përkohshëm autorizojë që të organizonte zgjedhjet për Këshillin e Përgjithshëm, autoritetin më të lartë të Komunitetit, i cili duhej të mblidhej më 1 maj 1945. Kandidatët për anëtarë të këtij Këshilli duhet të ishin simpatizantë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe, që të shmangeshin shpenzimet për udhëtime e dietë, ata duhet të banonin, mundësisht, në Tiranë; në të kundërtën, shpenzimet duhet të siguroheshin nga ndihmat e besimtarëve të çdo qyteti a fshati.¹²

¹¹Raport, Komiteti qendror i Partisë së Punës së Shqipërisë, *Çështje të agjitacionit dhe propagandës. Detyrat e organizatës bazë për punën ideopolitike dhe mbi ndihmën për propagandistët*, Tiranë, 1949, f. 24.

¹²*Arkivi Qendror i Shtetit* (me tej: AQSH), Fondi nr. 482 (Komuniteti Mysliman), Dosja

Gjendjes së vështirë financiare fill pas luftës e kishte detyruar Këshillin e Ulemave që të ndërpriste marrëdhëniet financiare për gjithë personelin e Medresesë së Përgjithshme, por, më 1 maj 1945, Këshilli i Përkohshëm mori vendim për rikthimin në punë të një pjese të personelit arsimor, çka mundësoi rihapjen e Medresesë. Kushtet qenë të vështira, mjetet financiare mungonin, si rrjedhojë studentëve u siguroheshin vetëm shtrojat dhe mbulojat, ndërsa ushqimin duhej ta siguronin vetë. Në këtë periudhë u rikthyen në detyrat e tyre: Hafiz Ismet Dibra, drejtor i Medresesë; Jonuz Bulej, drejtor i brendshëm; Qazim Hoxha, myderriz; Haki Sharofi, profesor; Hasan Tahsini, mësues dhe Hafiz Doraci, mësues. Përveç tyre u emëruan myderrizë në Medrese edhe Sulejman Kadiu, për gjuhën arabe; Haxhi Mahmud Dashi, për besimin; prof. Vexhi Demiraj, për mësimet filozofike; Ihsan Qereshniku, për mësimin e gjuhës angleze dhe Munir Hatibi, kujdestar magazinier. Pranë Medresesë së Përgjithshme u hap edhe një kurs fillestar për imamë. Drejtor i këtij kursi u emërua Hafiz Ibrahim Dalliu.¹³

Madje kalohej deri aty se vetë misioni fetar i këtij komuniteti komprometohej me porositë që u jepeshin instancave të ulëta për përkrahjen e pushtetit popullor dhe kandidatëve të Frontit Demokratik, kur thuhej: “Asht... detyra e të gjithëve neve... me rastin e predikimeve fetare në Xhamija, me ftue besnikët që me rastin e votimeve të 2 Dhëtorit 1945, votat t’i përqendrojnë të gjitha për njerëzit e Frontit, tek të cilët si në luftë e në paqe janë të mbështetura punët për mbarëvajtjen e këtij populli”.¹⁴ Ose shfaqej haptazi simpatia për liderin komunist Enver Hoxha si “birin më të denjë të popullit shqiptar”, duke i premtuar pushtetit besnikëri, mbështetje¹⁵ dhe duke u bërë thirrje besimtarëve për mbështetjen e planeve pesëvjeçare¹⁶, të porositnin përmes qarkoreve dhe rezolutave që të mbështesnin aksionet politike të qeverisë dhe PPSH¹⁷, si dhe akte të tjera që ishin në kundërshtim me misionin dhe funksionin e tyre si klerikë të lartë të komuniteteve fetare.¹⁸

Një nga fushat e ndjeshme të identitetit të institucioneve fetare në Shqipëri, i sigurimit të vijimësisë, integritetit dhe karakterit të ritualit sipas rregulloreve ishte ajo e statuteve të komuniteteve fetare fill pas Luftës II

73, Viti 1945, f...

¹³*Po aty.*

¹⁴*Po aty.*

¹⁵*AQSh*, Këshilli i Ministrave, F. 890, D. 1137, datë 16 prill 1964.

¹⁶*AQSh*, Komuniteti mysliman, D. 26, viti 1956.

¹⁷*AQSh*, Këshilli i Ministrave, F. 890, D. 1137, datë 29. 1. 1954, f. 38.

¹⁸*AQSh*, Komuniteti mysliman, D. 42, vitit 1950.

Botërore. Ndonëse jo në mënyrë radikale, gjithsesi modifikime që preknin gjer dhe aspekte të përmbajtjes nisin të shfaqen në raportet e ndërlikuara midis shtetit dhe klerit. Madje, ato pasohen me ndërhyrje edhe në statuset e tyre për t'i përshtatur me karakterin e ri të regjimit, i cili në të nesërmen e afërt do të bëhej më i qartë, më kufizues dhe më i prerë.

Sikurse dihet, Lufta Nacionalçlirimtare përfshiu në gjirin e vet, nën sloganin e luftës për çlirim nga pushtuesit italianë e gjermanë, edhe mjaft besimtarë myslimanë e të krishterë, madje edhe emisarë të njohur të institucioneve fetare, të cilët u bënë thirrje besimtarëve për pjesëmarrje në luftë dhe për mbështetjen e saj. Ndihmesa e dhënë e bëri shtetin e ri të komunistëve të tregohej më i thyeshëm, sidomos me klerin mysliman, atë bektashi, por dhe me atë ortodoks, ndërsa me klerin katolik, duke pasur marrëdhënie të acaruar për shkak të mbështetjes që ky i dha segmenteve politike antikomuniste dhe antisovjetike, qëndrimi ishte shumë më i ashpër.

Ndarja e shtetit nga feja gjithsesi nuk e bëri këtë të fundit indiferent kundruall mbështetjes ekonomike e financiare që lypsej t'u jepte institucioneve të katër besimeve kryesore: myslimanëve, ortodoksëve, katolikëve, bektashinjve.¹⁹ Paçka se jo radikale, disa ndryshime nisën të shfaqen qysh në fillim. Në vitin 1945 pëson një ndryshim jo parëndësi statuti i Komunitetit Mysliman, duke i shtuar dhjetë kapituj, si dhe disa modifikime krahasuar me atë të vitit 1929 të miratuar nga qeveria e Ahmet Zogut. Në disa syresh flitej për një organizim të ri të komunitetit, për mënyrën e bërjes së *Hytbeteve*, lutjeve, përveç Perëndisë, edhe për “Kryetarin e Shtetit, Kombin, Ushtrinë”, tashmë në gjuhën shqipe.²⁰ Ka një ndryshim të formës së betimit. Dikur ai bëhej përpara mbretit, tani duhej bërë përpara kryetarit të shtetit dhe Këshillit të Përgjithshëm. U ndryshua edhe formula e njëhershme për besnikëri ndaj mbretit duke kërkuar besnikëri ndaj atdheut. Siç shikohet, në të tilla formulime futen elemente të brendisë politike të regjimit. Ndërkohë ndryshime të ndjeshme ndodhën në trajtimin dhe qëndrimin ndaj *vakëfeve*. Organi i dikurshëm kolegjal i administrimit të këtyre vakëfeve u zëvendësua nga një administrator që kishte fuqi ekzekutuese (kapitulli V, neni 17). Nënkuptohej këtu prania e një

¹⁹Sikurse dihet, shumica e popullsisë shqiptare në vitin 1945, nga sondazhi i kryer, rezultonte të ishte: 68-70% myslimanë, 17% ortodoksë dhe 10% katolikë. Në komunitetin mysliman shumicën e besimtarëve e përbënin ata të sektit *sunî*, dhe fill më pas numëroheshin edhe pesë vëllazëri myslimanësh të tjerë në sektet: *haleveti*, *rufai*, *kadri*, *tixhandhesadi*. Në besimin mysliman një degë tejet e rëndësishme në Shqipëri ishte sekti i *bektashinjve*, i cili kishte një mënyrë të vetën të organizimit. Shyqry Hysi, *Myslimanizmi në Shqipëri 1945-1950*, Tiranë, “Mësonjëtorja e parë”, 2000.

²⁰Statuti i Komunitetit Mysliman Shqiptar, “Gazeta zyrtare”, nr. 53, 22 dhjetor 1945, 1-6.

ndikimi dhe varësie nga shteti dhe fuqia e tij ndërhyrëse, sado e fshehur qoftë kjo.

Komuniteti fetar mysliman kishte rreth 1500 njerëz me tituj fetarë, nëpunës apo ndihmës, më së shumti me arsim 7-vjeçar, nga të cilët 1269 qenë hoxhë, klerikë të thjeshtë të shërbimit ndaj besimtarëve dhe kryerjes së praktikës së rëndomtë liturgjike. Kishte nga ky personel edhe klerikë që kishin mbaruar studimet teologjike.

Nga pikëpamja strukturore dhe e përputhshmërisë së riteve me doktrinën islame universale, komuniteti mysliman shqiptar vijoi në traditën tashmë të krijuar të *Medh'hebi*, falë të cilës, si shkollim juridik islam, përcaktonte dhe orientonte zbatimin e riteve fetare prej këtij komuniteti. Ky shkollim a mësim juridik për kryerjen e riteve fetare ishte *hanefi*, pra, dije që mbështeteshin në mësimet e *Kur'anit*, suret e tij, si libër i shenjtë i islamit, sikundër merrte parasysh dhe zbatonte me përpikëri traditën profetike ose *sunnet*. Në strukturën e komunitetit mysliman si organe drejtuese përfshiheshin: Këshilli i Përgjithshëm, Kryesia e Komunitetit Mysliman, kryetari i Komunitetit Mysliman, Këshilli Drejtues.

Njësitë më të ngushta administrative që përgjigjeshin për veprimtarinë dhe mbarëvajtjen e punëve të ndryshme të komunitetit, qenë ato të arsimit, të burimeve njerëzore, të financës, administrimit të pasurive dhe fondeve monetare, ajo e pelegrinazhit, e haxhit dhe e marrëdhënies me qendrat islame, njësia e marrëdhënieve me jashtë, me xhematin, ajo e raporteve me komunitetet e tjera fetare në Shqipëri, e botimeve dhe e medias, njësia e vakëfeve dhe ajo e personelit.

Nga data 2 deri në 5 maj të vitit 1945, u mbajt Kongresi i Katërt i Bektashinjve, ku morën pjesë edhe disa figura qendrore të shtetit të ri komunist, si: Bedri Spahiu, Myslim Peza, çka fliste qartë për një përkrahje të hapur të këtij komuniteti nga ana e regjimit dhe anasjelltas. Shkaku ishte i njohur tashmë: pjesëmarrja masive e bektashinjve shqiptarë në mbështetje të Luftës Nacionalçlirimtare, ku spikati edhe njëri prej udhëheqësve të kësaj lufte, kleriku Mustafa Xhani (Baba Faja Martaneshi), i cili drejtoi edhe punimet e kongresit. Më 25 qershor 1945, u miratua një statut i ri, i “thyeshëm”, jo i ngurtë, çka e bënte të dukshme simpatinë e komunitetit fetar të bektashinjve ndaj pushtetit të ri të dalë nga lufta. Kjo u vu re te nënshtrimi me dashje ndaj ligjeve të tij, sikundër me Ministrinë e Drejtësisë u sendërtua një raport shumë më i afërt dhe më funksional nga pikëpamja legislative. Ndikimi dhe ndërhyrja e partisë komuniste në karakterin e punës së komunitetit bektashian në Shqipëri, ishte themelimi, më 14 mars 1947, i një Komiteti të ashtuquajtur “Bektashinjtë progresistë”, në formën

e një fraksioni, i cili, nëvështimin e pjesëstjetër të komunitetit, vlerësohej si një zgjatim pragmatist i ndikimeve politike të partisë komuniste në punët e tij me besimtarët e shumtë që kishte. Ky Komitet mbajti qëndrime kritike ndaj ritualit fetar dhe praktikave të deriatëhershme të ushtrimit të fesë, madje duke i quajtur ato si të prapambetura dhe frenuese të zhvillimit shoqëror të vendit. Përplasjet mes këtyre dy kaheve të besimit bektashi përcollën një tension të fortë, i cili i shkaktoi krisje të thella harmonisë brenda këtij komuniteti duke u shoqëruar, madje, edhe me vrasje.²¹

Kisha katolike - shënjestër e zgjedhur e pushtetit të ri

Shteti i ri shqiptar i ashpërsoi marrëdhëniet me Selinë e Shenjtë, rrjedhimisht me Kishën Katolike në Shqipëri, duke shënjuar, në fakt, një “diferencim” në raport me entet e tjera fetare. Ndryshe nga tre komunitetet e tjerë fetarë - mysliman, bektashi dhe ortodoks - me komunitetin katolik, shteti komunist shqiptar i mëshoi enkas dhe një raporti mirëfilli politik, që buronte dhe lidhej direkt me Luftën Nacionalçlirimtare, jo rrallëherë me përfshirjen e klerit katolik në politikat e shtetit fashist italian, ardhur si linjë vertikale nga qëndrimet shpesh tolerante të Selisë së Shenjtë ndaj pushtimit italian të Shqipërisë. Shqipëria si “tokë misioni” e Selisë së Shenjtë, zgjoi idenë e hershme të kishës uniate me urdhrat e benediktinëve, françeskanëve etj., qysh nga skizma dhe “Vija e Teodosit” thua njëmijë vjet më parë, për të ribashkuar të krishterët në një dogmë e rit unik, dhe më tutje konvertimin e myslimanëve si qëllim i përhershëm i saj. Paçka se kisha dhe forumet e saj, ofruan një politikë gjysmë të heshtur e gjysmë pranuese ndaj ekspansionit italian, besimtarët e thjeshtë katolikë nuk e pranuan pushtimin dhe si gjithë shqiptarët u bashkuan me rezistencën për dëbimin e ushtrisë fashiste nga vendi i tyre.

Partia Komuniste e Shqipërisë arriti ta dominonte lëvizjen çlirimtare përmes rinisë, duke i ofruar asaj një utopi të bukur të mbushur me mirëqenie, punësim, barazi, të drejta, përparim ekonomik dhe emancipim qytetar. Gjithsesi, faktor kryesor i bashkimit ishte lufta kundër pushtuesve italianë e gjermanë. Duhet pohuar se pozitat e kësaj partie në zonat veriore të vendit, ku komuniteti katolik kishte ndikim të ndjeshëm, qenë të dobëta në krahasim me krahinat e tjera. Është po kjo arsyeja përse nga popullsia katolike pati mosbesim në programin e pritshëm të komunistëve pas mbarimit të luftës dhe vendosjes së pushtetit, çfarë karakteri do të kishte

²¹A. B. Tomorri, *Historia e bektashizmit*, Urtësia, nr.3, Tiranë, 1994.

regjimi. Njerëzit i tuteshin komunizmit qoftë për qëndrimin ndaj pronës private, qoftë për hegjemoninë e pushtetit të tij, qoftë për qëndrimin ndaj fesë. Eksperiencia e Bashkimit Sovjetik nuk ishte e huaj për inteligjencien shqiptare. Doktrina katolike përbënte një pushtet rival dhe shumë të fuqishëm kundruall ideologjisë komuniste, e cila në thelb ishte tërësisht ateiste, tërësisht materialiste. Për këtë shkak udhëheqja e partisë komuniste që e vetëdijshme për pushtetin e kishës ndaj njerëzve. Pushteti komunist në Shqipëri, sikundër edhe në Jugosllavi e akuzoi dhe e goditi Kishën Katolike për sjelljen e saj deri diku pajtuese, tolerante dhe për njëfarë simpatie që ajo shprehu ndaj italianëve dhe pranisë së tyre në Shqipëri, si me ekspansionin ekonomik, ashtu edhe me praninë ushtarake. Kjo i dha argumentin për ta akuzuar kishën dhe klerin e saj si bashkëpunëtorë me fashizmin. Nga ana tjetër, prania e emisarëve katolikë të dërguar nga Selia e Shenjtë në Shqipëri, gjatë Luftës Italo-Greke dhe më pas, u konsiderua nga komunistët si diversion politik dhe “çerdhe” e agjentëve të huaj të veshur me petkun e klerikut.

Armiqësia e shtetit komunist e shprehur ndaj Kishës Katolike kulmoi me takimin e zhvilluar mëdatën 2 janar 1945, midis Enver Hoxhës në cilësinë e kryeministrit të Shqipërisë dhe të dërguarit apostolik në Shqipëri, Shkëlqesisë së tij, Leone G. B. Nigris, i cili kërkoi respektim të të drejtave të komunitetit dhe mosndërrhyrje në statusin e Kishës Katolike. (Ai u shpall “persona nongrata” nga Qeveria shqiptare për faktin e mospranimit të projektit të saj për shkëputjen e Kishës nga varësia e Selisë së Shenjtë, kinse për të ndërtuar Kishën Katolike Kombëtare Shqiptare, gjë e cila binte në kundërshtim me frymën dhe mënyrën e ndërtimit të hierarkisë kishtarë në botën katolike).²² Kësodore, Kishës Katolike në Shqipëri iu vendos

²²Të ashtuquajturat “kisha kombëtare” apo tipe kishash të vendeve të ndryshme që gjakonin shkëputjen nga varësia e Selisë së Shenjtë u shfaqën si fenomene specifike në botën komuniste, në disa vende të kampit socialist pas Luftës II Botërore, të eksperimentuara në Hungari, Çekosllovakia, Lituani e vende të tjera. Ato patën karakter diversiv dhe krijuan probleme në besimtarët e tyre dhe vetëfunksionimin si kisha që kishin njohur pushtetin e Papatit dhe vepronin gjegjësisht kanoneve të shenjta të aplikuara në mijëvjeçarë. Synimi ishte që të shkëputej ndikimi i vendeve të Evropës Perëndimore dhe përgjithësisht të botës së lirë e antikomuniste. Futja e kësaj nënshtrese diversive e me brendi politike krijoi shqetësime sociale dhe kundërshti, gjëe cila më vonë nga vetudhëheqja sovjetike u refuzua, duke kërkuar rrugë të tjera përmes marrëveshjeve me Selinë e Shenjtë. I një forme tjetër është realiteti dhe statusi i Kishës Katolike në Kinë, ku përmes një gjendjeje pavarësie nga Selia e Shenjtë, nga ana tjetër, janë mbajtur hapur kanalet e komunikimit me të. E gjithë kjo përpjekje e bërë nga partitë komuniste të vendeve satelite të Bashkimit Sovjetik, për të këputur hallkën e varësisë së kishave të tyre nga Selia e Shenjtë me krijimin e kinse “kishave kombëtare”, në fakt rezultoi si eksperiencë e dështuar, prandaj dhe u hoq dorë

alternativa përjashtuese: ose të shndërrohej në një kishë “kombëtare” e shkëputur nga varësia e Selisë së Shenjtë, rrjedhimisht të përfitonte edhe gjithë mbështetjen financiare, buxhetet dhe benefitet e tjera nga shteti, ose të shpallej si institucion fetar i vetëpërjashtuar, që nënkuptonte mospranimin e regjimit komunist, për pasojë të përballonte masat shtrënguese të tij. Duke luajtur një politikë “as pranim, as refuzim”, shteti shqiptar nuk ndërmori masa ekstremisht refuzuese në raportin me Selinë e Shenjtë, prandaj dhe herë pas here hynte në dialog me të, duke e ditur se pas kishës kishte njerëz që mund të bëheshin të pakënaqur dhe armiq të pushtetit. Për këtë arsye u ndoq një politikë separatiste, dinake, diferencuese. Për të veçuar prelatët dhe njerëzit me identitet politik e moral të lartë nga kisha dhe besimtarët e saj, organet e drejtësisë i akuzuan ata si bashkëpunëtorë të fashizmit dhe të ushtrisë gjermane.

Në mars të vitit 1945 Enver Hoxha thirri në një takim at Vinçenc Prennushin, i cili mori me vete edhe imzot Gaspër Thaçin. Lideri komunist kërkoi prej tyre, si drejtues të lartë të Kishës Katolike në Shqipëri, shkëputjen nga Vatikani, por kërkesa e tij u konsiderua e paarsyeshme, prandaj edhe refuzua. Refuzimi i hierarkisë së lartë kishtarë të katolicizmit në Shqipëri me qëndrimin e vendosur të at Vinçenc Prennushit si kryepeshkv dhe primat katolik i Shqipërisë, solli një seri pasojash për prelatët e Kishës Katolike, e cila u shoqërua shumë shpejt me internime, persekutime, burgosje dhe pushkatime. Kështu, në vitin 1946 imzot Thaçi vdiq i sëmurë, i izoluar në banesën e tij, i mbytur në pezëm. Po atë ditë maji kur ai vdiq, u arrestua dom Mikel Koliqi, famullitar i Katedrales Shën Stefani të Shkodrës, i cili pas viteve 1990 u shpall kardinal nga Papati i Romës. Më 19 maj 1947, u arrestua edhe at Vinçens Prennushi, pas një fjale tejet të ashpër e akuzuese të Enver Hoxhës për mospranimin e propozimit të tij. Ai u dënua me 20 vjet burg, por vdiq më 19 mars 1949 në qeli, i sflitur nga torturat më mizore.²³ Me largimin e klerikëve fetarë të huaj, masat represive të shtetit komunist kundrejt emisarëve dhe hierarkisë së Kishës Katolike u shtuan ndjeshëm. Goditja ishte veçanërisht e rëndë kundër shoqatës “Bashkimi shqiptar” me seli në Seminarin Papnor të Shkodrës, e

prej saj. Por, nëse në këto vende ndodhi kështu, në Shqipëri, siç dihet, marrëdhëniet e shtetit me kishën u ashpërsuan vit pas viti edhe më shumë, gjersa në vitin 1967 ajo u nxor jashtë ligjit.

²³ Albert Fashëri, *Magjia e Rilindjes Kombëtare, esse*. Udha e shkronjave, Tiranë 25 maj 2015, f. 59-60.

cila u akuzua për veprimtari subversive kundër shtetit, ndërsa disa nga figurat e shquara të saj u ndëshkuan rëndë me burgime e pushkatime.²⁴

Politikat përçarëse e tinëzare për të veçuar dhe akuzuar krerët e institucioneve fetare si bashkëpunëtorë të pushtesve dhe përçarës të unitetit të popullit etj., u bë me të gjitha besimet, jo vetëm me atë katolik. Në besimin ortodoks, ani pse gjatë Luftës Nacionalçlirimtare udhëheqësit e saj shpirtërorë kontribuan me thirrjet e tyre drejtuar besimtarëve për çlirimin e vendit nga pushtesit dhe për rrokjen e armëve në kryengritjen e armatosur, fill pas çlirimit u fabrikuan akuza për bashkëpunim me armikun ndaj disa prej prelatëve më në zë të kësaj kishe, siç qe rasti i at Aleksandër Lipes, i cili u pushkatua, më 4 korrik 1946, ose prifti Aleksandër Koçiu, që pësoi po të njëjtin fat. Edhe mitropoliti i Tiranës, Kristofor Kisi, u izolua në Kishën e Shën Prodhomit dhe vdiq aty në rrethana të dyshimta e të pasqaruara.²⁵

Arsimi fetar

Një nga problemet e mprehta që shteti i ri komunist në raport me institucionet fetare dhe qëndrimin ndaj fesë hasi në përgjithësi me kufizimin e gjer në asgjësimine mësimdhënies së njohurive fetare dhe i rrjetit të shkollave fetare. Kjo ishte e nënkuptuar nga vetë karakteri i regjimit, i cili e përjashtonte nga pikëpamja ideologjike ndikimin dhe formimin fetar të njerëzve pasi ideologjia komuniste, në thelbin e vet, nuk e pranonte shpjegimin ateist të botës dhe fenomeneve shoqërore e historike, duke e konsideruar atë një mashtrim, iluzion, shtrembërim dhe kamuflim të së vërtetës. “Laicizmi i procesit të mësimdhënies dhe ndarja e shkollës nga feja ishin dy elemente themelore të kësaj reforme, të vlerësuara si thelbësore për zhvillimin e vendit, - vinte në dukje studiuesi italian Giovanni Cimbalo. Në ligj projektohej një sistem shkollor koherent me linjat kryesore të qeverisë”.²⁶

Qysh në dispozitat kushtetuese të *Statutit të Republikës Popullore të Shqipërisë*, të miratuar më 11 mars 1946, neni 58 i saj sanksiononte në mënyrë eksplicite se “shkolla është e ndarë prej fesë”.²⁷ Për këtë shkak, qysh

²⁴Simoni, *Persekutimi i kishës katolike në Shqipëri 1944-1990*, Shkodër, 1998, f. 271-273.

²⁵A. Dalipaj, *Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me kishën ortodokse*, Tiranë, 1992, f. 36-37.

²⁶Cimbalo, Giovanni, *Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri*, Studime të së drejtës së Krahësuar, E DREJTA KISHTARE DHE TË DREJTAT NJERËZORE, Raporti i fesë me shtetin në Shqipëri, Naimi, Tiranë, 2013, f. 111.

²⁷*Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë*, 11 mars 1946.

në krye të herës, në vitin 1945, përmes një qarkoreje qeveria e bëri të qartë përparësinë e shkollave publike dhe kufizimin drastik të mësimit të fesë, duke lënë për këtë çështje një hapësirë të ngushtë: vetëm një orë mësim në javë mbi fenë.²⁸ As një vit më vonë, dhe pikërisht me një urdhër të Ministrisë së Arsimit të 13 marsit 1946, edhe kjo orë u hoq nga programi në shkollat publike.²⁹ Tanimë porositej që mësimet e fesë të zhvilloheshin në mjediset e shkollave publike, duke shmangur sa më shumë të qe e mundur shkollat fetare që funksionin pranë institucioneve të kultit.

Rrjeti i institucioneve fetare pranë Kishës Katolike kishte krijuar tradita të pasura dhe një trashëgimi të admirueshme, ku u përgatitën me dije një aradhe e gjerë nxënësish, sidomos në Shkodër. Në këtë qytet funksiononin së paku disa institucione arsimore të drejtuara nga Kisha Katolike, si: Seminari Papnor i Shkodrës, Kolegji Saverian, Grupi Salezian me themelues DonBoskon, Instituti i Motrave Stigmatine, Motrat e Shërbëtorëve, Motrat Vinçenciane, institucionet shkollore e të edukimit të Urdhrit Françeskan dhe Urdhrit Jezuit. Ky sistem i gjithë shkollimi dhe edukimi, i udhëhequr nga Kisha Katolike, nëpër vite pati luajtur një rol të jashtëzakonshëm e të pazëvendësueshëm në arsimimin, kulturimin dhe diturinë e njerëzve, sidomos në misionin e shenjtë aq sa ajo pati për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe kultivimin e elementeve qytetëruese të kombit para dhe pas shpalljes së Pavarësisë.

Kleri katolik, përveç rrjetit të shkollave dhe enteve të ndryshme arsimore me karakter edukativ e kulturor, kishte edhe një rrjet të fuqishëm botimesh, të cilat, në të shumtën e rasteve, përtej kumtimeve dhe publikimeve me natyrë fetare, botonin mjaft literaturë të pasur nga studimet e ndryshme historike, estetike, letrare, antropologjike, juridike. Këto botime ndriçonin aspekte dhe problematika me karakter të thukët albanologjik mbarëshqiptar. Të tilla qenë gazetatat dhe revistat mjaft të njohura për kohën si “Hylli i dritës”, “L.E.K.A.”, “Zani i ShnaNdout”, “Bijat e Zojës”. Shtëpitë botuese të klerit katolik u mbyllën vetiu pasi atyre iu ndalua botimi i literaturës fetare, po ashtu librat e tjerë me brendi historike, letrare, enciklopedike që përgatiteshin, financoheshin dhe botoheshin nën kujdesin e kishës, gjer edhe letrat pastorale, të cilat i nënshtroheshin një kontrolli e censure të rreptë. Lejoheshin vetëm botime fletushkash, proklamimesh e lajmërimesh të kalendarit të datave e festave të shënuara të krishtera. Pak nga pak, me politikën kufizuese e asfiksuese të funksioneve që kryenin më parë lidhur me shkollimin, edukimin dhe promovimin e veprimtarive të tyre,

²⁸AQSH, Fondi nr.890, 1945, dosja 9, f. 2.

²⁹AQSH, *Qarkorja e Ministrisë së Arsimit*, Fondi nr.882, dosja 438, IX, maj 1945, f. 63.

mjaft asete që kisha zotëronte u shtetëzuan. Një numër i madhi institucioneve dhe enteve fetare të Kishës Katolike u mbyllën, ndërruan destinacion dhe u zëvendësuan tanimë me punishte, fjetore, muze, biblioteka, kinema, klube kulture dhe mjedise të tjera me karakter shërbimi e prodhimi. Ky ndërrim destinacioni dhe shndërrimi që pësuan, e bëri veprimtarinë e institucioneve fetare të pamundur, thuajse inekzistente, çka solli për pasojë katandisjen e tyre në shërbime të kufizuara me natyrë thjesht ritualistike, gjersa u përgatitën kushtet që në vitin 1967 shteti t'i nxirrte jashtë ligjit, duke zbatuar programin e tij të njohur të një ateizmi ekstrem, si i vetmi vend në botë që pamundësoi ushtrimin e besimit fetar ndër njerëzit (si një e drejtë themelore).

Ngjashëm me Kishën Katolike paraqitet gjendja edhe në komunitetin mysliman. Qysh në fundin e vitit 1945 u mbyll Medreseja e Shkodrës, pavarësisht ankesave dhe kundërshtimit të Myftinisë së këtij qyteti. Ajo u rrek ta ndiqte procesin e shkollimit të besimtarëve të vet nëpër objektet e kultit, siç qenë xhamitë. Por, edhe aty haseshin pengesa nga trysnia që ushtronte pushteti lokal. Falë ekstremizmit dhe militantizmit, ngjante që ky i fundit e detyronte pushtetin qendror të ndërhynte për të frenuar efektet negative që pasonin syresh. Qeveria bënte lojë të dyfishtë. Për arsye propagandistike dhe përputhur një politike elastike e dinake, ajo lëshonte qarkore ose jepte porosi në organet vendore të atyre fshatrave, ku dhe shfaqeshin qëndrime të skajshme që të mos pengohet me dhunë mësimi i fesë, ndërsa nga ana tjetër sillej krejt ndryshe.³⁰ Në vitin 1947 u mbyll edhe Medreseja e Madhe e Tiranës. Kjo erdhi pas një trysnie të vazhdueshme nga ana e Qeverisë, fillimisht për të dorëzuar godinën e saj dhe për ta vijuar veprimtarinë mësimdhënëse në hotelin Colombo, dhe pas mosmarrëveshjes, u mor vendimi për ta ndarë atë në dy pjesë duke e reduktuar në mënyrë të dukshme si procesin mësimor me përgjysmimin e programit shkollor, ashtu dhe devijimin e përmbajtjes dhe ideve, ku u zëvendësuan shumë lëndë me përmbajtje fetare me lëndë të tjera me përmbajtje kulturore. Kjo zhvendosje, në fakt, e dobësoi së tepërmi brendinë e shkollës duke e larguar atë nga destinacioni i saj si shkollë që transmetonte mësimet fetare. Mësimi i *Kur'anit* u reduktua nga 14 orë në 4 orë, pjesën tjetër të programit e plotësuan lëndë me natyrë formuese, didaktike e shkencor, si: gjuha shqipe, matematika, historia, gjeografia etj. Pas kundërshtimit të udhëheqësisë së klerit mysliman për mosdorëzimin e Medresesë së Tiranës për shkak të pamundësisë së saj për ndërtimin e një medreseje të re, Ministria e

³⁰AQSH, Fondi nr.882, dosja 31, IX, 1947, 32.

Drejtësisë urdhëroi evakuimin e personelit nga gjithë mjediset e saj brenda dy ditëve. Pamundësia e ushtrimit të një veprimtarie shkollore normale bëri që medreseja ta përgjysmonte brenda një viti numrin e përgjithshëm të nxënësve. Gjysma e mjediseve u shfrytëzuan për shkollën publike dhe gjysma për shkollën fetare, gjersa me kohë funksioni i saj u zbeh dhe u asfiksua duke ndaluar përfundimisht së funksionuari.

Erjon PAPAGJONI

SUMMARY

THE COMMUNIST STATE AND THE RELIGIOUS INSTITUTIONS IN ALBANIA 1944-1949

The communist state exercised its pressure on religious institutions through several ways. First, it pursued the restriction policy of a gradually limitation through legal acts and decisions that it made, up to open threats,³¹ by outmaneuvering them and making different vital functions and opportunities useless for basic activities that these institutions first carried out to the vast extent to their believers. Secondly, it has regarded and identified a significant part of the clergy of the three faiths as alleged servants of the country's occupiers, Italians and Germans, and after the liberation also as "agents" of the Western countries and the United States.

Thirdly, it "disciplined" the religious communities by putting them completely under control through drafting and approving statutes, which received the "ok" of the government. Fourthly, the communist state created a divisive and differentiating policy among the clergy, thus humiliating them, and consequently weakening the influence of the religious institutions in the nation through arrests, deportation, imprisonment and shootings of their leadership and people of great influence.

Fifthly, the government pursued the policy of economic weakening of religious communities through seizures, confiscations and expropriations of the wealth of the bodies and religious institutions, Stakes, vakfs, school facilities, which were allegedly made "bases" of political and military activity, by the invaders or imperialist powers. Fifthly, the state pursued economic weakening of religious communities through seizures, seizures and expropriations of institutions and institutions of worship, edifices, and campuses, school premises, which were allegedly "cracked" in political, military and military activity, of invaders or imperialist powers. Sixthly, the

³¹ It is known, for example, the case where the Muslim religious community followed by its tradition of teaching progress in a religious school in its jurisdiction and the prosecution threatened that all teaching and didactic base was under government control. See: AQSH, Fund no. 882, Circular of the Ministry of Education , file 35, IX, May 1945, 20-22.

Communists exerted influence over the leadership of religious institutions through their infiltrated people, who followed the restrictive guidelines and policies of the communist state, according to the political platform and the decisions made by the high forums of the Albanian Communist Party.

Seventh, sometime with administrative orders, sometimes with instructions and messages and sometimes in direct pressure from people with party duties, a large number of religious clergymen were forced to give up through fear of punishment. Eighth, the state struck at the root of the vast network of schools and institutions of educational, cultural, teaching and training character that were supported and subsidized by religious institutions. The announcement of the atheistic and hostile attitude of the state against the religious beliefs, and consequently the omission of the edifices and environments in which religion was exercised and applied, quickly destroyed their life-giving activities, among them the education and teaching of believers with doctrines, sacred canons and religious teachings.

MATERIALE DHE DOKUMENTE

Alban DOBRUNA

TARIKATI ISLAM SAADI NË QYTETIN E GJAKOVËS

Është njëri prej tarikateve më të përhapur në trojet shqiptare në përgjithësi dhe në qytetin e Gjakovës në veçanti. Është rrugë brenda islamit, ku edhe ka zanafillën¹. Ky tarikat u themelua nga Sadedin Xhibaviu (1172-1279),² në fshatin Xhibë, në luginën e Haranit afër Damaskut.³ I ati i tij ishte Sheh Junuz Shebani El Huseini el Meki, i cili rridhte nga familja e Profetit Muhamed.

Xhibaviu gjatë moshës rinore kishte një karakter të ashpër, dhe ushtronte profesionin e djerritjes (punimi të pëlhurave)⁴, dhe këtë natyrë të tij ai e shfrytëzoi në mbrojtje të pronës së familjes së tij duke i penguar njerëzit të kalonin afër saj. Babait të tij, Sheh Jonuzit, kjo nuk i pëlqente, sepse dëshironte që ai të zgjedhte rrugën e ndjekjes së sufizmit⁵, sepse shihte tek ai se kishte cilësi të larta si në retorikë edhe në trimëri. Sipas gojëdhënave, babi i tij një ditë iu lutë Zotit për të birin, që ta drejtonte në rrugën e drejtë të devotshmërisë ndaj Allahut, brenda shtatë ditëve, ose ta

¹ Arkivi Qendror Shqiptar (më tej: AQSH), f. 149, 1923, D.VI-689, fl. 2; Statuti legal i komuniteteve fetare dërguar nga Parlamenti kryeministrit, Tiranë 05. VI. 1923; Organizata “Drita Hynore”, dhe Festa Madhështore, me rastin e ditës së Ashures”, *Kultura Islame*, 6-7/1940, 464-265; Baba Rexhebi, *Mistiçizma Islame dhe Bektashizma*, (Tiranë: 2006), 119.

² Sheh Muhamed Shehu, *Sheh Shefqeti dhe Teqeja e Madhe në shërbim të Zotit në shërbim të popullit*, (Gjakovë: 1414/1998), 70.

³ Haki Kasumi, *Bashkësi të fetare në Kosovë*, (Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1988), 66.

⁴ J. Thomai, M. Samara, P. Haxhillazi, H. Shehu, Th. Feka, V. Memisha, A. Goga, *Fjalori i Gjuhës Shqipe*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2006), 203.

⁵ Analiza etimologjike e nxjerr si më të besueshme fjalën sufi nga fjala arabe suf, që do të thotë *lesh*, e cila aludon për veshjen tradicionale me rroba leshi të sufive të parë, dhe karakterizohet nga një xhybe e gjerë prej leshi - suff - dhe prej kësaj fjale vjen edhe tesavuf ose në formën e latinizuar *sufizëm*. Mirëpo, prejardhja e fjalës sufizëm mund të jetë edhe nga fjalët: saffa, që d.m.th. pastërti dhe çiltërsi; siffat që d.m.th. cilësi fisnike dhe pastërti e thellë shpirtërore (suffa - banka/bench; safa - pastërti; saff - shkalla, rangu).

merr në pranin e Tij. Kjo lutje e të atit u pranua dhe Sadedin Xhibaviu u kthye pranë të tij duke i dhënë premtimin se do të merrte obligimet për të udhëzuar njerëzit drejt devotshmërisë në fenë islame⁶. Sipas traditës dhe rrëfimeve në teqetë e tarikatit saadi, mënyra e hyrjes së tij në radhët e sufizmit dhe tarikatit tregohet se: “Sadedin Xhibaviu duke shëtitur nëpër fushë i takon tre persona. Ata ishin: Profeti Muhamed, Ebu Bekiri, dhe Imam Aliu. Me t’u, afruar atyre, Profeti Muhamed filloi të lexojë një pjesë nga *Kur’ani* i shenjtë: “Zemrat e atyre që bëjnë të binden në Allahun, a thua vallë për to nuk ka ardhur koha e lavdërimit”. Xhibaviu duke i dëgjuar këto versete iu rrëqethë i tërë trupi dhe sytë filluan t’i lotonin. Duke gjëmuar dhe duke kërkuar ndihmë u rrëzua nga kali. Në këtë rast njëri nga ata të tre, Ebu Bekri duke iu afruar pranë e godet në gjoks dhe i kërkon që të pendohet. Papritmas Xhibaviu duke u këndellur kërkoj ndjesë nga Zoti për të gjitha gabimet që kishte bërë deri atë ditë. Në atë moment Imam Aliu e nxjerrë nga xhepi një hurma dhe ia jep Profetit Muhamed dhe i thotë duke iu lutur: “O i Dërguari i Zotit, shuaja urinë”, dhe ai duke e marrë këtë hurme e duke e lagur më buzët e Tij të bekuara i thotë të veprohet njëjtë si në rastin e dytë: “Merre këtë hurma si shenjë udhëzimi, si dhe le të jetë i yti udhëzimi deri në ditën e gjykimit, dhe le të jenë bekimet për ata që kanë mbështetjen dhe besimin në ty”. Duke i thënë këto fjalë, ia dha hurmën në gojë. Menjëherë, pas kësaj ai shpejton drejt të atit të tij Sheh Junuzit dhe i tregon për atë që i kishte ndodhur. Sheh Jonuzi e falënderon Zotin për mëshirën e Tij të madhe duke i bërë përlulje Madhërisë së Tij”⁷. Sheh Sadedin el Xhibaviut i atribuohen shumë mrekulli (keramete) të cilat sot e çdo ditë përcillen dhe tregohen brez pas brezi ndër ndejat dhe bisedat e dervishëve të këtij tarikati. Pas vdekjes së të atit, Sadedin Xhibaviu u vendos në teqenë e tij në fshatin Xhibë, ku qëndroi deri në fund të jetës së tij. Tyrbja (varri) e tij qëndron ende e hapur për vizituesit e shumtë⁸. Disa hulumtues, në mesin e tyre Mosinjoni, e konsideron tarikatin saadi degë të tarikatit rifai. Mirëpo, disa të tjerë, prej tyre orientalisti Braun, e shohin se ky tarikat është i pavarur⁹.

Tarikati i themeluar nga Sadedin Xhibaviu, gjatë jetës dhe pas tij, është përhapur në Siri dhe Egjipt, ndërsa në shtetin osman ky tarikat

⁶ Arkivi i Teqesë së Sheh Eminut, Gjakovë, më 16 gusht 2009, (më tej: *ATSHEGJ*), Dorëshkrimet e postmbajtësit të Teqesë së Sheh Ruzhdi Shehut.

⁷ *ATSHEGJ*, Dorëshkrimet e postmbajtësit të Teqesë së Sheh Ruzhdi Shehut.

⁸ Sheh Sadedin Xhibavi, *Tarikati sa’di*, (Dardanë: Teqeja e Tarikatit Sa’di-Krahu Harabati, 2017), 35-36.

⁹ Bajrush Ahmeti, *Vështrim kulturorohistorik mbi formimin dhe përhapjen e disa fraksioneve në historinë islame*, (Prishtinë: 2007), 342.

depërtoi në fillim të shekullit XVIII¹⁰. Është shumë i përhapur në qytetin e Gjakovës¹¹, bile historiani anglez, Noel Malcolm, e konsideron Gjakovën si: “Qendra e saadijve, të cilën e zgjeroi ndikimi i saj tërë Kosovën Jugperëndimore”¹².

Teqeja e parë e themeluar dhe njëherit historikisht më e vjetra në trevën e Gjakovës, është Teqeja e Madhe e saadive, e themeluar nga Sulejman Efendi Axhiza Baba, me origjinë nga një fshat afër Shkodrës. Pasi kreu studimet në medrese në Stamboll, iu përkushtua mistikës islame. Nga Stambolli erdhi në Gjakovë dhe me ndihmën e djalit të Adem Pashës mytesarif i Shkodrës, Murat Begu ndërtoi në vitin 1732-33 Teqenë e Madhe të saadive,¹³ e cila gjatë gjithë historisë pati ndikim shumë të madh në të gjitha sferat jetësore në qytetin e Gjakovës dhe në rrethinën e saj. Axhize Baba ka shkruar divan në të cilin shumica e vjershave janë turqisht, e më pak arabisht e persisht, po ashtu ka lënë të shkruar edhe disa trajtesa mbi moralin dhe mistikën islame¹⁴. Në brendësinë e teqesë gjendet mesxhidi me mihrab dhe mafil, që e quajnë semahane. Teqeja e Madhe kishte në të kaluarën edhe imareti (kuzhina për të varfër A. D.)¹⁵.

Në bazë të dokumenteve të quajtura silsilname, nën përkujdesjen e profesor Nehat Krasniqit, hedhet dritë rreth shtrirjes së tarikatit saadi në trevat shqiptare, dhe siç thotë autori: “Duke hulumtuar gjurmë të kulturës sonë gjatë periudhës së sundimit osman, më kanë rënë në dorë dy dokumente (silsilname) të tarikatit saadi. Këto silsilname hedhin dritë në historinë e shtrirjes institucionale të kësaj vëllazërie të dervishëve, si në trojet e sotme etnike, ashtu edhe në trojet etnike të djeshme, si: Vranja, Leskovci, Nishi etj., të cilat pushteti serb në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me metoda çnjerëzore i spastroi nga elementi shqiptar. Dokumentet e përmendura, sjellin të dhëna biografike modeste edhe për 67 udhëheqës shpirtërorë (shehlerë) të tarikatit saadi, disa nga të cilët luajtën

¹⁰ Metin Izeti, *Kllapia e Tesavvufit*, (Shkup: Bashkësia Fetare Islame e RM, 2004), 169; Mustafa Kara, *Tarikatet e përhapura në tokat osmane*, (Shkup-Prishtinë-Tiranë: Civilizimi Osman: Politikë-Ekonomi-Art, Përgatiti: Coşkun Çakir, “Logos A”, 2014), 234.

¹¹ *AQSH*, F. 482, V. 1944, D. 80, f. 18: Letër e zëvendësinsektorit të Kryesisë së Këshillit t’Ylemave, Tiranë, 27. VI. 1944.

¹² Neol Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, (Prishtinë: Koha, 2001), 184.

¹³ Nahat Krasniqi, “Dy dokumente gjenealogjike të rëndësishme”, *Dituria islame*, 59/1994, 14.

¹⁴ Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve në “Diturinë islame”*, (Prizren: 1411/1991), 40.

¹⁵ Pleurat Krasniqi, *Aspekte kulturoro-historike të Gjakovës dhe ixhazetlinjtë 1870-1940*, (Gjakovë: Litografia, 2002), 57.

rol të rëndësishëm në jetën kulturore, shpirtërore dhe politike në mjediset ku jetonin dhe vepronin si dhe më gjerë”¹⁶.

Teqeja e Madhe e tarikatit saadi në Gjakovë

Duke u bazuar në kronologjinë e saj, dha më se 16 gjenerata të shehlerëve, të cilët përkundër të gjitha vështirësive, vazhduan njëri pas tjetrit traditën duke kontribuar në përhapjen masive të këtij tarikati në mbarë trevat e banuara me shqiptarë.

Pas zhvendosjes së Sulejman Efendi Axxhiza Babës në Prizren në teqenë në Marash, të cilën e themeloi vetë¹⁷, si sheh në postin e Teqesë së Madhe të saadive në Gjakovë, u vendos i biri i tij Danjoll Efendi Baba, i cili e vazhdoi traditën e zhvillimit dhe të përhapjes së tarikatit të lartë saadi. Silsilja e shenjtë apo zinxhiri i shenjtë shpirtëror, i cili përfshinë të gjithë shehlerët të cilët e trashëguan Sulejman Axxhiza Babën dhe birin e tij Danjoll Efendiun, në rolin e udhërrëfyesit shpirtërorë vazhdon me këtë renditje: Sheh Abdylvehabi (1575), Sheh Esadi (1615), Sheh Sulejmani II (1655), Sheh Ahmedi I (1695), Sheh Abdylvehabi (1715), Sheh Zejnullahu (1740), Sheh Senullahu (1780), Sheh Lutfullahu (1825), Sheh Ahmedi (1858), Sheh Hamdiu (1863), Sheh Qamili (1885), Sheh Shefqeti (1900), Sheh Abdylvehabi (1927), Sheh Musa Efendi (1954). Kurse në postin e Teqesë së saadive në Marash të Prizrenit, si prijës shpirtërorë (shehlerë), shërbyen: Sheh Ahmedi II (1788), Sheh Hyseini (1830), Sheh Sulejmani III Baba HU (1875), Sheh Hyseini (1912), Sheh Muhammedi (1929). Ndër personalitetet më të njohura të Teqesë së Madhe të saadive në shekullin XX, që lanë gjurmë jo vetëm në qytetin e Gjakovës, por edhe më gjerë, vlen të përmenden figura e ndritur e dijetari dhe udhëheqësit të denjë shpirtëror

¹⁶ Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2011), 51.

¹⁷ Haxhi Sheh Xhemali Shehu, “Teqeja e rendit dervish-saadi Prizren”, *Buletin “HU”*, 2/1983, 7-8; Jashar Rexhepagiqi, *Dervishët dhe teqetë në Kosovë, në Sanxhak dhe në rajonet tjera përreth*, (Pejë: Dukagjini, 2003), 76; Hysen Ibra, “Teqeja e Madhe e Gjakovës dhe Teqeja Marash-Hisar në Prizren, meritojnë të vihen nën mbrojtjen shtetërore”, *Edukata islame*, 80/2006, 158.

Sheh Shefqetit¹⁸, dhe patriotit të shquar të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Musa Shehzade Shehut¹⁹.

Teqja e Sheh Eminit (Zejnel Abidin Tebdil Baba) – saadi

Themelimi i kësaj teqeje u bë nga Sheh Zejnel Abidin Esh Shejbani El Husein Meki²⁰, me origjinë nga Drenoci i Vokshit nga fisi Thaç. Ishte i biri i Muhamedit, i frymëzuar, i edukuar, i graduar me hilaftename (diploma

¹⁸ **Sheh Shefqeti (1900-1952).** U lind në Gjakovë, në vitin 1900¹⁸. Ishte djali më i vogli (i katërti) i Aqif Efendiut, nga familja e njohur Shehu. Mësimet e para i nisi në Gjakovë, ndërsa studimet në Medresenë e Madhe të Gjakovës, pranë myderrizit më të njohur të kohës, Hafiz Iljaz Efendiut. Diplomoi në Prizren në medresenë e “Mehmet Pashës”, tek dijetari, Nusret Efendi, që ishte edhe myfti i Prizrenit¹⁸. Në vitin 1928¹⁸, në moshën 43-vjeçare, ndërroi jetë në Gjakovë, Sheh Qamili, vëllai i madh i Sheh Shefqetit, duke mos lënë pasardhës. Teqja e Madhe e Gjakovës për disa vjet mbeti pa sheh. Në muajin nëntor 1929¹⁸, në Teqenë e Madhe në Gjakovë, Sheh Shefqeti, në një ceremoni madhështore drejtua nga Sheh Muharrem Mitrovica, u gradua sheh ku i dha edhe hilaftename. Sheh Shefqeti ndërroi jetë, më 11 mars 1952¹⁸. U varros me nderime të mëdha, me përcjellje madhështore jo vetën nga Gjakova, por nga mbarë Kosova. Në varrimin e Sheh Shefqeti, morën pjesë mbi 12 000 vetë¹⁸. Trupi i pajetë i Sheh Shefqetit u bartë deri në “Xhaminë e Sefës” ku u falë namazi i xhenazes, nën drejtimin e hoxhës së nderuar, Hafiz Ymer Efendi Guta.

¹⁹ **Musa Shehzade Shehu (1870- 1944).** U lind në vitin 1870 në qytetin e Gjakovës. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes, për t'i vazhduar në Prizren, Selanik, dhe Stamboll. Musa Shehzade kishte një diapazon të gjerë të kulturës fetare me ç'rast mbante edhe titullin e nderuar Dervish Nakib të tarikatit saadi. Krahas veprimtarisë kombëtare, fetare, sociale dhe humanitare, për dyzetë vite me radhë zhvilloi aktivitet politik. Musa Shehzade kishte qenë deputet në Parlamentin e fundit Osman. Kishte marrë pjesë në Kongresin e Manastirit. Nënshkrues i Memorandumit të Junikut 1912, dhe komandant për çlirimin e Shkupit. Delegat i Prizrenit në Shpalljen e Pavarësisë në Vlorë. Si një besimtar i devotshëm dhe shumë arsimdashës kontribuoi në mënyrë të veçantë midis dy luftërave botërore në ndihmë të të varfërve dhe sidomos nxënësve me anë të shoqatave “Gajret” dhe “Merhamet”. Më 26 prill 1941, bëhet prefekti i parë shqiptarë në Prizren. Ishte një ndër iniciatorët për formimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Musa Shehzade ishte pjesëmarrës aktiv i kësaj organizate duke u zgjedhur si kryetra i Kuvendit. Për shkak të veprimtarisë së tij, Musa Shehzade u pushkatua nga OZNA-ja, më 28 nëntor 1945, pikërisht në ditën e flamurit. Disa muaj pas pushkatimit pushteti sllavo-komunist ia konfiskoi tërë pasurinë, duke përfshirë edhe Teqenë e Marash Hisarit. Më 1950 pushteti komunist e rrënoi objektin e bukur sakral të Teqesë së Marash Hisarit në Prizren, ku Musa Shehzade e kaloi një pjesë të madhe të jetës dhe veprimtarisë së tij. Teqja u rrënuar e tëra duke u përfshirë edhe semanhanja dhe dhoma e ziqrit. Shpëtoi tyrbja dhe rripi shekullor që gjendej në mes të kompleksit.

²⁰ *ATSHEMGJ*, Dorëshkrimet e postmbajtësit të Teqesë së Sheh Ruzhdi Shehut.

e shehut)²¹ nga Sheh Ibrahim Ebu El Vefa El Dimishk El Shami (Tekia El Kajmerie).²² Postmbajtës i vazhdimësisë së teqesë së themeluesit të tarikatit saadi, Sadudin Xhibaviu. Sipas gojëdhënave, në teqe ai u ngrit në gjendjen tebdil, ku sipas terminologjisë së tarikatit saadi është “ndërrimi i gjendjes shpirtërore me anë të shikimit”²³, që ishte posedues i kerameteve (mrekullive) të dukshme dhe padukshme.

Sheh Zejnel Abidinini e emëroi si pasardhës të birin e tij Sheh Mehmed - tebdil²⁴. Sheh Mehmed - tebdil e mësoi ziqërin²⁵ dhe evradin²⁶ nga ustai i tij, shehu i tij dhe babai i tij. Një ditë e xhuma (e premte) vendosi që haptazi ta bëjë ziqërin dhe atë xhehri (të jashtëm) apo me zë, dhe kalbim (të brendshëm) apo me zemër në këmbë dhe me lëvizje të trashëguara sipas rregullit (usullit) Sadudin Xhibavi. Kjo bëri që përfaqësuesit e ulemasë, konservatorë të kohës, në qytetin e Gjakovës të mbajnë një mbledhje, ku të kundërshtojnë ziqërin haptas dhe dërguan dy përfaqësues me kërcënimin se do të mbyllin veprimtarinë e tyre, me arsyetimin se veprimet me të cilat merreshin, pra praktikimi i ziqërit, bie në kundërshtim me sheriatin. Dervishët, që ishin të pranishëm, reagues menjëherë, por shehu nuk lejoi të ndërmerrenin ndonjë veprim, duke bërë shenjë nga një i deleguar, i cilit i shkaktoi një thyerje në krahë. Ata u larguan për të mbledhur njerëz të tjerë që ta sulmojnë teqenë dhe të gjithë ata që ndodheshin në të, mirëpo shehu i qetësoi dervishët, ku pas pak filloi një stuhë dhe një fërfëllizë, një pluhur i ngritur, i cili i befaso i ata që deshën të sulmonin teqenë, duke u larguar në heshtje. Pas kësaj ngjarje, vazhdoi ziqëri haptazi deri në ditët e sotme²⁷.

Sheh Mehmedi e emëroi të birin e tij Sheh Ahmedin si pasardhës, dhe i dha lejen e përgjithshme për të gjitha rregullat e tarikatit dhe e pajisi me hilaftenamë, duke vazhduar rrugën e ndjekjes së paraardhësve të tij, e

²¹ Iljaz Metaj, *Orientalizmat shtrirja leksiko-semantike në gjuhën shqipe*, (Prishtinë: Drenusha), 108.

²² *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotsme të Sheh Zejnel Abidinit Baba - tebdil në Teqenë e Sheh Eminut në Gjakovë.

²³ Sipas Shehzade Valdin Shehut, më 27 qershor 2016.

²⁴ *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotsme të Sheh Mehmed - tebdil në Teqenë e Sheh Eminut në Gjakovë.

²⁵ *Ziqri* është një ndër aktivitetet më kryesore me anë të të cilit bëhet përkujtim i Zotit, rituali më i preferuar në teqe, i cili e aftëson pjesëmarrësin me gjendjen e meditimit dhe kontemplimit.

²⁶ *Evradi* është një përmbledhje speciale me lutje, e cila kryesisht lexohet në mëngjes. Secili rend i dervishëve e ka evradin e vet. Shehlerët thonë se evradin e ka përpiluar themeluesi i tarikatit.

²⁷ Sipas Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, pasardhësit të Sheh Mehmetit, më 16 gusht 2009.

transmetoi me përpikëri tek i biri Sheh Mehmedi II - tebdil, i cili po ashtu iu përmbajt me përpikëri kësaj vazhdimësie.

Pas Sheh Mehmedit II, vjen Sheh Ahmedi II, i cili hilafetnamen e mori nga Sheh Mehmedi II - tebdil²⁸. Mirëpo, Sheh Ahmedi II - tebdil, vdiq shumë i ri dhe i biri i tij Emini ishte në moshë shumë të re kur shkoi në Stamboll në vitin 1850²⁹. Për gjashtë vite ai i përfundon studimet në Fakultetin e Sheriatit dhe Arkitekturës, njëherit edhe bëri shumë udhëtime në vende të ndryshme të botës islame, si në: Siri, Egjipt, Iran dhe Irak. Gjatë këtyre udhëtimeve ai pati rastin të takohet me shumë pjesëtarë të sufizmit dhe posedues të teqeve të ndryshëm, një ndër ta edhe Sheh Sali Esh Shazeli në Egjipt si dhe Esh Shejh Ali Saadi, postmabjtës në dergjahn Teklebie. Thuhet se gjatë qëndrimit të tij në Stamboll ka pasur kontakte edhe me Hoxha Hasan Tahsinin, nga i cili u pajis me dije në aspektin kombëtar³⁰.

Gjatë kohës së Sheh Ahmedit II - tebdil, kemi edhe dy dervishë të devotshëm, si nakib³¹ Myftarin, i cili i shërbeu Sheh Ahmedit II. Ai për një kohë u thellua në ibadet (lutje) dhe asketizëm. Ishte i tërhequr nga kjo botë, dhe ishte i përkushtuar në shërbim të teqesë gjatë, kohë kur Emini, i biri i tij, ishte në shkollim në Stamboll. Sheh Emini e kishte edhe vëllain e tij të njohur me emrin Baba Din, i cili ishte po ashtu i dhënë shumë pas jetës asketike dhe që shërbente me ibadetet e tij vetëm brenda tyrbes. Vlen të përmendet se me konfliktin në mes bejlerëve në Gjakovë, Baba Din vendosi të ndërhynte dhe ta ndalonte këtë konflikt dhe me lejen e shehut hyri në mes të dy taborëve. Ai kishte thënë se një pushkë do të krisë dhe atë do ta qëllon në ballë dhe konflikti do të ndërpritet. Ashtu ndodhi. Amaneti i tij ishte që të mos kishte më konflikte vëllavrasëse dhe të varrosej në oborrin e Xhamisë së Kryepazarit dhe varri i tij të jetë përdhese, sepse turpërohej nga Baba tebdil. Sheh Emini pas kthimit në qytetin e Gjakovës, morri hilafetname nga Sheh Muhamed Hysein Kylizade³², (i njohur më shumë me emrin Sheh Qyli). Gjatë kohës së Sheh Eminut u rrënuar teqeja e vjetër dhe u ngrit teqeja e re, që ekziston ende edhe sot, e që njihet si teqeja e Sheh Eminut.

²⁸ *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Ahmedit II - tebdil, në Teqenë e Sheh Eminut në Gjakovë.

²⁹ Sipas Sheh Ruzhdi Shehu - tebdil, pasardhësit të Sheh Eminut, më 17 gusht 2009.

³⁰ Nuredin Ahmeti, *Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vilajetin e Kosovës (1878-1912)*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011), 60.

³¹ *Nakib* - mbikëqyrës i ekzekutimit të ritualeve të dervishëve. Nakib ka edhe domethënie më të gjerë, si p.sh.: vendi i punës me kohë të caktuar, zëvendësseh.

³² *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Eminut - tebdil në Teqenë e Sheh Eminut në Gjakovë.

Sheh Emini në bazë të dokumenteve ishte njëri prej arkitektëve të parë në trojet shqiptare³³, i cili kontribuoi në rregullimin e infrastrukturës së qytetit të Gjakovës dhe të trashëgimisë historike, kulturore dhe arkitektonike. Ka projektuar ndërtimin e Kullës së Mic Sokolit - Sokol Ramës dhe objekte të tjera në Malësinë e Gjakovës dhe shumë prej kullave të fshatit Nivokaz, e në veçanti kullën e njohur të Hamëz Zeqirit³⁴. Sheh Emini ishte aktiv në ngjarjet me rëndësi të kombit shqiptar, siç ishte: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, dega në Gjakovë, dhe në Lidhjen Shqiptare të Pejës³⁵.

Sheh Emini për anëtar të teqesë së tij e kishte ministrin e Mbrojtjes së Lidhjes së Prizrenit, Sulejman Vokshin, dhe ishte pjesëmarrës gjatë ekzekutimit të Mehmet Ali Pashë Maxharit te konaku i Abdullah Pashë Drenit³⁶. Pas arrestimit të Sulejman Vokshit, Sheh Emini iu imponua që të kaloi në ilegalitet dhe qëndroi në Kullën e Hamëz Zeqirit në Nivokaz, dhe pasi mori informacione Bajram Aga i Botushës në Gjakovë, i dërgoi përfaqësuesit e tij në Nivokaz te Hamëz Zeqiri, duke i thënë se Sheh Eminin gjallë ose vdekur duhet ta dorëzoni. Hamëz Zeqiri iu përgjigj se ju në Gjakovë keni farkëtarë, porositni pykat e çelikta dhe futni mbrapa vetit dhe ejani e merrni Sheh Emini. Vlen për t'u përmendur se Hamëz Zeqiri ka pasur shtatëdhjetëdy njerëz të armatosur që Bajram Agës nuk ia ka mbajtur të hyjë në konflikt me të.

Sheh Emini kur u kthye në teqenë e tij pas gjashtë viteve, në post e kishte vendosur si nakib të birin e tij Hamdiun dhe e gradoi sheh më 1908³⁷. Po në këtë kohë, e emëroi edhe nakib në Rekën e Keqe dhe Malësi, Dervish Danën (Ramadan Mullatahirin), i cili në atë kohë ishte me profesion rrojtat në qytetin e Gjakovës. Ai hoqi plotësisht dorë nga kjo botë dhe u përkushtua me devotshmëri për thirrje në islam në misionin e tij të daveitit (thirrjes) drejt rrugës së përsosmërisë njerëzore. Sheh Emini e la këtë botë, më 21 gusht 1918³⁸. Pasardhësi i tij Sheh Hamdiu ishte njëri prej poseduesve të

³³ Sipas Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, pasardhësi i Sheh Eminin, më 17 gusht 2009.

³⁴ Sipas Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, pasardhësit të Sheh Eminin, më 17 gusht 2009.

³⁵ Muhamet Pirraku, "Gjurmë të veprimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë", *Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike*, IX-1979, 1980, 206; Hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjve*, (Tiranë: Uegen, 2010), 221.

³⁶ Sheh Ruzhdi Shehu, "Teqeja e Sheh Eminin në Gjakovë-Kosovë, vatër shembullore e besimit dhe çështjes kombëtare shqiptare", *NJERIU*, Sesion shkencor i tarikateve islamike në Kosovë dhe Shqipëri, (Tiranë :Eurorilindja, 2000), 317-329.

³⁷ *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Hamdiut -tebdil në Teqenë e Sheh Eminin në Gjakovë.

³⁸ *ATSHMGJ*, Dorëshkrimet e postmbajtësit të Teqesë së Sheh Ruzhdi Shehut, më 17 gusht 2009.

edukatës së lartë, njohës i gjuhëve orientale (arabe, persiane dhe osmane) dhe me përpikëri e vazhdoi edukatën në transmetim të ashikit (dashurisë) tek muridit deri në vitin 1921 kur e la këtë botë³⁹.

Teqeja e Sheh Eminut u ndodhë e papërgatitur që të përballoi humbjen e dy shehlerëve të devotshëm. Mbeti pa sheh edhe pse Sheh Hamdiu kishte dy djem Fejzi Efendiun dhe Shyqeri Efendiun. Ishin ngjarjet politike ato që ndikuan që teqeja të mbetet pa sheh për tre vjet, kështu që Sheh Shukriu (Shyqeriu), hilafetnamen e mori nga Sheh Qamili, i biri i Babës Aqif i Teqesë së Madhe në Gjakovë⁴⁰. Sheh Shukriu kaloi nga kjo botë më 1940⁴¹. Ishte situatë lufte dhe lëvizja sllavo-komuniste ndikoi negativisht në vazhdimësinë e postit të teqesë.

Pas Sheh Shukriut në post erdhi i biri i tij Sheh Zijaja, i cili hilafetnamen e kishte marr nga Sheh Muharrem Mitrovica⁴². Sheh Zijaja në rrethana të vështira ekonomike ishte në shërbim të plotë i përkushtuar, i denjë dhe i devotshëm ndaj rrugës së tarikatit saadi, derisa ndërroi jetë në vitin 1949⁴³. Pas Sheh Zijasë në post erdhi i vëllai i tij Sheh Abdul Azizi. Sheh Abdyl Azizi ishte aktivist gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe ishte zënë rob, ku edhe u internua në Vjenë për tre vjet. Kur u kthye në vendlindje nuk u pajtua me pushtimin jugosllav të Kosovës, për shkak se kishte ide antisllavo-komuniste. Pas kalimit të vëllait të tij Sheh Zijasë, dha dorëheqje në mënyrë demonstrative nga vendi i punës, ku e kishin emëruar si shef i tregtisë së brendshme të Komunës së Gjakovës.

Sheh Abdyl Azizi ishte i pajisur me dituri dhe përkushtim. Hilafetnamen e mori nga Sheh Shaban Xhemaili, më 21 mars 1950⁴⁴ në Durrës të Maqedonisë. Aktiviteti i mëparshëm nationalist i Sheh Abdyl Azizit ishte i respektuar tek popullata e qytetit të Gjakovës, mirëpo jo i pëlqyer nga pushteti i atëhershëm. Ata e gjykuan si tradhtar të komunizmit dhe e distancuan edhe nga shoqëria. Gjatë kohës së reprezaljeve të Rankoviqit, Sheh Abdyl Azizi ishte në shënjestër, duke ia ndaluar veprimtarinë e tij sidomos në Rekën e Keqe, ku gjatë kësaj periudhe u

³⁹ Sipas Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, nipi i Sheh Hamdiut, më 17 gusht 2009.

⁴⁰ *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Shukriut - tebdil. E premte, fundi i muajt Rexheb 1342/1924, në Teqenë e Sheh Eminut në Gjakovë.

⁴¹ Sipas Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, nipi i Sheh Shukriut, më 17 gusht 2009.

⁴² *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Zijahsë - tebdil, në Teqenë e Sheh Eminut në Teqenë në Gjakovë.

⁴³ Sipas Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, më 18 gusht 2009.

⁴⁴ *ATSHMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Abdyl Azizi - tebdil, në Teqenë e Sheh Eminut në Gjakovë.

burgos tri herë, më 1962, 1964 dhe 1966⁴⁵. Ai për tridhjetekatër vjet ishte në shërbim të rrugës së tarikatit saadi, të cilën e transmetoi në të gjithë Kosovën, Maqedoninë, Serbinë e Jugut dhe Malin e Zi. Sheh Abdyl Azizi kaloi nga kjo botë, më 19 dhjetor 1984, dhe u varros në tyrbe pranë vëllait, babait, xhaxhait dhe gjyshit.

Pas Sheh Abdyl Azizit në post erdhi i biri i tij, Sheh Ruzhdiu, i lindur më 14 shkurt 1954. Hilafetnamen e mori në vitin 1985 nga zëvendësi i Sheh Abdyl Azizit, Sheh Veli Çoshkyn në Izmir⁴⁶. Sheh Ruzhdiu ishte i punësuar në shtabin e mbrojtjes territoriale të Komunës së Gjakovës, mirëpo për shkaqe të situatës politike jep dorëheqje nga vendi i punës në mënyrë demonstrative, duke mos i përfillur kërcënimet e pushtetmbajtësve të atëhershëm, dhe vazhdoi veprimtarinë e duhur përkrah të atit dhe rrethit të dervishëve.

Sheh Ruzhdiu veprimtarinë humanitare dhe atdhetare e shfaqti në forma të ndryshme, si pajtimin e gjaqeve. Me organizimin e Këshillit të Pajtimit të Gjaqeve, më 1989-1990, mbledhja kryesore u mbajt në Teqenë e Sheh Eminut, ku mori pjesë edhe Anton Çetta, kryetar i po këtij Këshilli. Me propozimin e Sheh Ruzhdiut, paraqitur këtij Këshilli, kërkohet që të mos lypej besë nga familjet në gjakmarrje, por kërkohet një strategji që direkt të shkohej në pajtim gjë që u miratua nga të gjithë të pranishmit.

Sheh Ruzhdiu veprimtarinë e vet të ngjeshur e filloi qysh në vitet '90, si në shërbim të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, ku ra në sy të shërbimit sekret serb UDB-së, e cila e detyron të largohet nga Kosova në mars të vitit 1991 së pari në Azi, pastaj në Perëndim (Zvicër dhe Gjermani) dhe gjatë kësaj periudhe veproji në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës në mërgim, ku pas nëntë muajsh mori urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm që të kalojë në Maqedoni. Në vitin 1993 u kap nga shërbimi sekret maqedonas, u mbajt për gjashtë ditë duke u torturua dhe u deportua në Kosovë. Pas një periudhe në ilegalitet u burgos në grupin e Gjakovës, duke vuajtur për një vit burg. Pas daljes nga burgu, veprimtaria e tij ishte në vazhdimësi për organizimin e luftës mbrojtëse dhe verifikimin e kandidateve për kyçjen në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Sheh Ruzhdiu ende edhe sot vazhdon të ushtrojë detyrën e postëmbajtësit dhe udhërrëfyesit shpirtëror pranë Teqesë së Sheh Eminut të saadive në Gjakovë, duke e thelluar aktivitetin e tij në shtimin e numrit të muridëve dhe aderuesve të rrugës së saadive.

⁴⁵ Deklaratë e Sheh Ruzhdiut, i biri i Sheh Abdyl Azizit, më 17 gusht 2009.

⁴⁶ *ATSHEMGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, në Teqenë e Sheh Eminut në Gjakovë.

Teqeja e sheh Banit - tarikati saadi

Gjatë ardhjes së Sulejman Axxhiza Babës për në Gjakovë, tregohet një legjendë se me vete kishte edhe dy dervishë të quajtur Baba Ahmet dhe Baba Sadik. Rrugës për në Gjakovë kaluan nëpër Pashtrik. Sipas legjendës thuhet se është bërë një luftë, për çlirimin e Pashtrikut, ku ra dëshmor Baba Ahmet, atëherë Sulejman Axxhiza Baba e urdhëron Babën Ahmet që të shkon me krye nën sqetull që të varroset në Gjylmahall në qytetin e Gjakovës. Në rrugë e sipër takon tri vajza të cilat i thonë: “Shikojeni këtë njeri pa kokë”, kurse Baba Ahmeti iu përgjigjet: “Unë pa kokë dhe ju pa sy”, dhe vajzat menjëherë verbohën. Baba Ahmet u varros në lagjen e Qylit që sot quhet Teqeja e Sheh Banit në Gjakovë⁴⁷. Për Babën Ahmet është thurur kjo poezi (ilahi):

*Baba Muhamed,
Zotni Baba Ahmet,
Merr rrugën për Gjakovë,
Kjo asht një e vërtetë për ne.*

*Në shtëpinë e Perëndisë,
Të jesh si një Engjëll,
Kjo rrugë është e gjerë,
Dhe qëndron lartë.*

*Na shpie në atë derë,
Që s'ka shije më të mirë⁴⁸.*

Në shërbim pranë varrit të Babës Ahmet vjen Baba Sadik me dy bijtë e tij, i cili ishte edhe sanxhaktar (flamurtar) i Sulejman Axxhiza Babës. Me vdekjen e Babës Sadik dhe të dy bijve të tij, të cilët nuk lanë pasardhës⁴⁹, posti i teqesë mbetet pa trashëgimtar. Kështu, në postin e kësaj teqeje ulet Ali Kolçi, i cili ishte student i medresesë, ku menjëherë merr për detyrë të shkojë në Damask për të marrë hilafetnamen nga Sheh Halil - E-Saadi⁵⁰, për t'u kthyer në teqenë në Gjakovë dhe vazhduar aktivitetin në shërbim të

⁴⁷ Sh. J. Efendiu, *Islamizmi, Shi'izmi, sufizma dhe tarikatet*, 1984, f. 221.

⁴⁸ Sheh Lutfillah Shehu, *Teqeja në kujtimet e mia*, (Prishtinë: 2005), 25.

⁴⁹ Sipas Sheh Neki Shehut, më 24 gusht 2009.

⁵⁰ Arkivi i Teqesë së Sheh Banit në Gjakovë, më 24 gusht 2009, (më tej: *ATSHBGJ*). Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Ali Kolçit, më 8 Rebljul-Evel të vitit 1263 Hixher.

tarikatis. Pasi banorët e lagjes e nuhatën devotshmërinë e tij vendosën që të ndihmonin në ngritjen e teqesë në afërsi të kësaj tyrbe.

Pas kalimit nga kjo botë të Sheh Ali Kolçit në post vjen Sheh Shabani I, i cili hilafetnamen e mori nga i ati, Sheh Ali Kolçi⁵¹. Pas Sheh Shabanit I, vjen i biri i tij Sheh Murtezai, që qëndroi në post vetëm tre vjet⁵², dhe pas Sheh Murtezait në post vjen i vëllai i tij Sheh Ali Efendiut, i graduar nga Sheh Shabani I⁵³. Pas Sheh Ali Efendiut, në post vjen i biri i tij, Sheh Shabani II, i njohur me emrin Sheh Bani, i graduar sheh nga Sheh Muhamed Kumanova⁵⁴.

Sheh Bani ka qenë një njeri shumë human dhe i gjithë preokupimi i tij ishte ndihma ndaj të varfërve, sidomos ndërtimi i shtëpive të skamnorëve, ku flitet se ka ndihmuar në ndërtimin e trembëdhjetë shtëpive në qytetin e Gjakovës⁵⁵. Sipas gojëdhënave, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ushtarët italianë tentuan të hyjnë në teqe pa lejen e Sheh Banit, por me të kuptuar shehu i bënë lutjet e tij dhe papritmas dalin të gjithë nga teqeja të trishtuar. Nga tronditja e teqesë, ushtarët italianë i rrëfyn komandantit se nuk mund të vendoseshin aty⁵⁶. Pas kalimit të Sheh Banit, në post vjen Baba Xajë, i cili nuk la pasardhës. Pas tij, postin e trashëgoi Sheh Myhedini, i pajisur me hilafetname nga Sheh Muhamed Alia i Shkupit.⁵⁷ Sipas legjendës, flitet se Sheh Myhedini kishte një kalë që e quante Mica, i cili fliste me të dhe e urdhëronte që ta sillte deri në dhomë duke i treguar edhe kohën se kur mund të vinte ta merrte⁵⁸.

Pas Sheh Myhedinit postin e trashëgoi Sheh Aliu III, po edhe ky i pajisur me hilafetnamen nga Sheh Muhamed Aliu në Shkup⁵⁹. Sipas legjendës flitet se Sheh Aliu III, gjithmonë freskohej rreth rrjedhës së lumit dhe shishen e tij e mbronin gjarpërinjtë, që i jepte fuqi shpirtërore të shëronte njerëzit nga helmimi i gjarpërinjve, ku flitet se gjarpri ka fjetur në

⁵¹ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Shabanit I në Teqenë e Sheh Banit në Gjakovë.

⁵² Sipas Leonard Shehut, pasardhës i Sheh Murtezait, më 24 gusht 2009.

⁵³ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Ali Efendiut në Teqenë e Sheh Banit në Gjakovë.

⁵⁴ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Shabanit II në Teqenë e Sheh Banit në Gjakovë.

⁵⁵ Deklaratë e Leonard Shehut nipit të Sheh Shabanit II, më 24 gusht 2009.

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Myhedinit në Teqenë e Sheh Banit në Gjakovë.

⁵⁸ Deklaratë e Sheh Neki Shehut, vëllai i Sheh Myhedinit, 24 gusht 2009.

⁵⁹ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Aliut III në Teqenë e Sheh Banit në Gjakovë.

gjoksin e tij duke e mbrojtur atë⁶⁰. Pas Sheh Aliut III, në postin e teqesë vjen Sheh Mehmeti, i graduar sheh nga Sheh Hysen Shehu në Prizren⁶¹, e në popull njihej se shëronte njerëzit nga sëmundja e epilepsisë.

Pas Sheh Mehmeti në post vjen Sheh Shabani III, i njohur edhe ky si Sheh Bani dhe Sheh Neki, me dy teqe të ndara. Sheh Neki hilafetnamen e mori nga Sheh Hyseni i Prizrenit⁶². Sheh Neki ka qenë për një kohë të gjatë profesor i nderuar në gjimnazin e Gjakovës. Ai e vazhdon veprimtarinë e tij deri në ditët e sotme duke e shtuar numrin e besimtarëve dhe muridve. Kontributi i tij më i madh ka qenë gjatë luftës së vitit 1998-1999, ku kjo teqe ka shërbyer si frymëzim për shumë djem nga Gjakova për kycje në radhët e UÇK-së, si dhe ka dhënë një kontribut të pallogaritshëm humanitar në strehimin e mbi 120 refugjatëve nga fshatrat e ndryshme të komunës së Gjakovës.

Teqeja e Sheh Salihut - tarikati saadi

Themelimi i teqesë u bë nga Sheh Sulejman Sabri Sabriu, para afro 300 vjetëve më parë, me prejardhje nga Juniku.⁶³ Sulejman Sabriu ishte vizitues i rregullt i Teqesë së Madhe në Gjakovë, në kohën që në post ishte Sheh Danjoll. Sulejman Sabriu shprehi dëshirën të marrë bejat (anëtarësim në teqe), por shehu nuk pranoi duke i thënë se nuk e kishte vendin këtu, kurse Sulejman Sabriu e kishte pyetur se ku e kishte vendin, ndërsa ai i përgjigjet se vendin e kishte tek Sheh Hasani i Teqesë së Madhe të Leskovcit në Vranjë. Sulejman Sabriu nisët për Leskovc ku merr bejat dhe më vonë hilafetname⁶⁴. Pasi merr hilafetnamen kthehet në Gjakovë për të themeluar teqenë e tij. Sheh Sulejmani për një kohë ka shërbyer edhe si imam në Xhamin e Kusarëve.

Pas Sheh Sulejmanit në post vjen Sheh Sherafudini, i cili hilafetnamen e kishte marrë nga Sheh Sulejmani I. Pas Sheh Sherafudinit në post erdhi Sheh Ejubi, i njohur si dijetar i madh, i cili ka lënë disa vepra, por fatkeqësisht nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe. Pas tij vjen Sheh Salihu, i cili ka qenë po ashtu dijetar i madh. Hilafetnamen e morri nga Sheh

⁶⁰ Sipas Leonard Shehut, nipit të Sheh Aliut III, më 24 gusht 2009.

⁶¹ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshmen të Sheh Mehmetit në Teqenë e Sheh Banit në Gjakovë.

⁶² *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Nekiut, më 17 dhjetor 1987, në Teqenë e Sheh Banit në Gjakovë.

⁶³ Sipas Sheh Reshat Shehu - saadi, më 9 gushtë 2009.

⁶⁴ *Arkivi i Teqesë së Sheh Salihut saadi, Gjakovë*, më 9 gushtë 2009, (më tej: *ATSHSGJ*). Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Sulejmanit.

Syla i Vranjës. Sheh Salihu ka pasur autoritet të madh në qytetin e Gjakovës dhe tërë kohën ia kushtonte studimit dhe meditimit. Tregohet se vetëm dy festat e bajramit dilte për vizita. Pas Sheh Salihut postin e trashëgoi Sheh Ibrahim, i pajisur me hilafetnamen në qytetin e Nishit. Pas Sheh Ibrahimit në postin e teqesë vjen Sheh Sahiti, i graduar sheh nga Sheh Syla i Vranjës. Sheh Sahiti ka qenë i dhënë shumë pas sufizmit. Vendin e Sheh Sahitit e zuri Sheh Vehbiu. Sheh Vehbiu shkollimin fillor e filloi në Medresenë e Ulët në Gjakovë dhe e përfundoi në Shkup. Hilafetnamen e morri nga Reiz-Meshahi Sheh Xhaferi në Shkup. Sheh Vehbiu ka qenë njeri me autoritet në qytetin e Gjakovës dhe i dhënë shumë mbas sufizmit. Pasardhës në teqe pas Sheh Vehbiut, vjen i biri tij Sheh Qamili, i lindur në Gjakovë, më 1905. Kreu Medresenë e Ultë në Gjakovë, ndërsa të lartën në Shkup. Hilafetnamen e morri në Shkup tek Sheh Xhaferi. Sheh Qamili ka vdekur më 1963⁶⁵. Teqeja prej kësaj kohe ka mbetur pa sheh për një kohë të gjatë, derisa i biri i tij Reshati u gradua sheh nga Sheh Ruzhdi Shehu dhe u vendos në postin e të atit.

Teqeja e Sheh Fetahit - tarikati saadi

Këtë teqe e themeloi Sheh Ali Neshpalla në vitin 1800⁶⁶. Ai fillimisht ka punuar në sektorin e blegtorisë në fshatin Neshpall afër Rahovecit. Tregohet se Sheh Aliu pasi e ka sjellë mjaltin në Gjakovë, i ka mbledhur të gjithë fëmijët e lagjes duke iu dhënë mjaltë dhe ujë, dhe për shkak të bamirësisë së tij, banorët e quajtën lagjen “Ruga e Sheh Alisë në prehen të Perëndisë”⁶⁷.

Pas Sheh Aliut, në post erdhi i biri i tij Sheh Fetahu, i cili hilafetnamen e mori nga Sheh Hyseni, i biri Sheh Sulejmanit.⁶⁸ Sheh Fetahu pas vdekjes është varrosur në tyrbe në periferi të Gjakovës, ku në hyrje të tyrbes shkruan “Nuk din baba”. Sipas gojëdhënës, thuhet se kur gruaja e tij ka gatuar petulla iu ka dhënë fëmijëve dhe fëmijët kanë pyetur po babës, ajo u është përgjigjur se nuk din baba. Ndërkohë, pasi ka ardhur Sheh Fetahu i ka thënë të shoqes: “Ah zogës, zogës, iu ke thënë fëmijëve se nuk din baba”. Pas Sheh Fetahut, në postin e teqesë e pasoi Baba Xajë, mirëpo ky nuk la trashëgimtarë. Atëherë Teqeja e Sheh Eminit në Gjakovë e dërgon në postin e Sheh Fetahut, Sulejman Dervishin, i graduar sheh nga Sheh Emini -

⁶⁵ Deklaratë e Sheh Reshat Shehut, i biri i Sheh Qamilit, më 9 gusht 2009.

⁶⁶ Arkivi i Teqesë së Sheh Fetahit, Gjakovë, më 21 gusht 2009, (më tej: *ATSHFGJ*).

⁶⁷ Sipas Marica Shehut, më 21 gusht 2009.

⁶⁸ Sipas Dervish Zejnel Lota, më 22 nëntor 2009.

tebdil⁶⁹. Sulejman Dervishi është njohur me emrin Baba Mon, dhe pas Babës Mon pozitën e shehut e trashëgoi i biri i tij Sheh Muharremi, i pajisur me hilafetnamen nga Sheh Abdyl Azizi i Teqesë së Sheh Eminut në Gjakovë⁷⁰. Sheh Muharremi ka kaluar nga kjo botë, më 12 janar 1978⁷¹.

Sot veprimtarinë e përhapjes së takatit saadi pranë kësaj teqe e vazhdon Sheh Aliu, i biri i Sheh Muharremut, i graduar si sheh nga Sheh Abdul Azizi i Teqesë së Sheh Eminut në Gjakovë, më 21 mars 1978⁷².

Teqeja e Sheh Beqirit - tarikati saadi

Këtë teqe e themeloi Sheh Beqiri, me prejardhje nga fshati Baballoç. Sheh Biqiri shkollimin e kreu në Damask ku qëndroi katërmbëdhjetë vjet dhe mori hilafetnamen e tarikatit kaderi. Pas kthimit në vendlindje ndërtoi një xhami në fshatin Baballoç duke shërbyer si imam, por njëkohësisht ndërtoi edhe teqenë në qytetin e Gjakovës⁷³. Pas Sheh Biqirit në post vjen Sheh Ramadani, i cili kishte marrë hilafetnamen në Damask në tarikatin kaderi. Pas Sheh Ramdanit vjen Sheh Biqiri II, pasi shkoi të merrte hilafetnamen në Damask, shehu i dëftoi se tash e mbas mund të shkojnë të marrin hilafetnamen tek tarikati saadi në Teqenë e Madhe të Gjakovës⁷⁴.

Pas Sheh Beqirit në post vjen Sheh Abedini. Atë e trashëgoi Sheh Nuredini I, i pajisur me hilaftenamen në Teqenë e Madhe saadi⁷⁵. Postin e Sheh Nuredinit në teqe e trashëgoi Sheh Abedini II. Pas Sheh Abedinit, në postin e teqesë vjen Sheh Xhemailia. Me vdekjen e Sheh Xhemailiut vazhdimësinë e teqesë e vazhdoi Sheh Xheladini⁷⁶. Postin e kësaj teqeje pas Sheh Xheladinit e vazhduan tre djemtë e tij: Sheh Dini, Sheh Abidini dhe Sheh Ramadani. Sot veprimtarinë e kësaj teqe e vazhdojnë: Sheh Beqiri, i biri i Sheh Dinës dhe Sheh Xheladini, i biri i Sheh Ramdanit.

⁶⁹ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sulejman Dervishit - Baba Mon në Teqenë e Sheh Fetahit - saadi në Gjakovë.

⁷⁰ *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Muharremut në Teqenë e Sheh Fetahut - saadi në Gjakovë.

⁷¹ Sipas Marica Shehut, më 21 gusht 2009.

⁷² *ATSHBGJ*, Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Aliut në Teqenë e Sheh Fetahut - saadi, në Gjakovë.

⁷³ Sipas Sheh Ramadan Shehut - saadi, pasardhësi i Sheh Beqirit, më 23 gusht 2009.

⁷⁴ Sipas Sheh Beqir Shehut - saadi, pasardhësi Sheh Beqirit, më 23 gusht 2009.

⁷⁵ Shih hilafetnamen e përbotshme të Sheh Nuredinit në Teqenë e Sheh Biqirit - saadi, në Gjakovë.

⁷⁶ Sipas Sheh Biqir Shehu - saadi, nipi i Sheh Xheladinit, më 23 gusht 2009.

Teqeja e Babës Danë - tarikati saadi

Themelimi i kësaj teqeje u bë nga Ramadan Mullatahiri, i njohur më shumë si Baba Danë⁷⁷. Baba Danë ishte me prejardhje nga Geci i Llukës. Ai u lind në Gjakovë. Babai i tij ishte Imam Mulla Ibrahim, kurse gjyshi Mulla Muhamedi. Ramadan Mullatahiri kreu medresenë e lartë në Egjipt, ndërsa kur u kthye në Gjakovë punoi si berber. Baba Danë vizitonte vazhdimisht Teqenë e Sheh Eminit në Gjakovë, ku edhe morri hilafetnamen nga Sheh Emini, i cili e caktoi si misionar në përhapjen e tarikatit saadi në Rekën e Keqe⁷⁸. Baba Danë ka pasur aktivitet të madhe patriotik, duke marrë pjesë në Luftën për mbrojtjen e Shkodrës më 1913, me ç'rast edhe u plagos.⁷⁹ Pasi u kthye në vendlindje e vazhdoi veprimtarinë në shërbim të Zotit, derisa ndërroi jetë, më 1919, në fshatin Smolic, tek familja Gjoshi.

Pas kalimit të Babës Danë, ku si pasardhës i la dy djem të mitur: Eminin dhe Dervishdanën (Dervishdanën e la tri javë pa emër, duke thënë se vetë do të ndërron jetë dhe i biri i tij do të mbante emrin e tij). Dervishdana ka qenë pjesëmarrës i Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare, ku u zu nga forcat gjermane dhe u var në qendër të qytetit së bashku me Ganimete Tërbeshin⁸⁰.

Teqeja për një kohë ka mbetur pa sheh, derisa Emini e ka përfunduar Medresenë e Madhe në Gjakovë dhe në fillim ka marr gradën nakib, në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, kurse hilafetnamen e mori nga Sheh Zijaja i Teqesë së Sheh Eminit në Gjakovë.

Dervish nakib Emin Dervishdana, para se t'i varej i vëllai, ka rrëfyer se nuk mundet të nxjerr gjakun, por i premton se pas gjashtë muajsh do vijë tek ai dhe tek babai. Pas kalimit të Dervish nakib Emin Dervishdanës, e la të birin Zejnel Abidinin në moshën katërvjeçare, i cili u rritë me virtyte të larta njerëzore duke u edukuar në frymën e edukatës islame. Sheh Zejnel Abidini hilafetnamen e mori nga Sheh Abdyl Azizi i Teqesë së Sheh Eminit në Gjakovë. Sheh Zejnel Abidini përveç udhës së tarikatit zhvilloi një veprimtari aktive patriotike në rend të parë në edukimin e familjes e pastaj edhe në teqe. I biri i tij, Nesimiu, ra dëshmor më 27 korrik 1981, gjatë një konflikti me ushtarët e oficerët serbë që provokonin, në qendër të Gjakovës. Por, kontributin më të madh e dhanë gjatë viteve 1998-1999, kur teqeja u bë një qendër e rëndësishme për celulat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në

⁷⁷ Arkivi i Teqesë së Babës Danë, Gjakovë, më 18 gusht 2009, (më tej: ATBDGJ).

⁷⁸ Sipas Sheh Ruzhdi Shehut - tebdil, më 22 gusht 2009.

⁷⁹ Sipas Nesim Dervishdanës, pasardhësi i Babës Danë, më 18 gusht 2009.

⁸⁰ Po aty.

Rrafshin e Dukagjinit. Të dy bijtë e tij, Fahriu dhe Emini, ishin pjesëmarrës aktiv të luftës së UÇK-së. Fahriu aktivitetin e vetë e zhvillonte më shumë në ndihmat humanitare si me medikamente dhe veshmbathje, kurse Emini ishte pjesëmarrës direkt në luftën kundër armikut.⁸¹ Sheh Zejnel Abidini u vra nga forcat paraushtarake serbe së bashku me të dy djemtë, dhe me dy mysafirë që ndodhën aty, më 26 mars 1999⁸², në kompleksin afër teqesë në Gjakovë. Traditën e familjes Dervishdana në kultivimin e tarikatit saadi sot e vazhdon i biri i Fahri Dervishdanës, Sheh Nesim Dervishdana.

Teqe të tjera të tarikatit saadi ka edhe në fshatrat: Bec, Brovinë, Doblibare, Molliq, Duzhnje dhe Baballoq. Shehlerët e teqeve të tarikatit saadi, ishin pjesëmarrës në ceremoni fetare e kombëtare, që nga themelimi i tyre deri në ditët e sotme, duke iu predikuar të varfërve, besnikëve dhe vizituesve, urdhrat e larta sipas librave të shenjtë fetarë, për lartësimin e moralit nga pikëpamja kombëtare, fetare e sociale dhe në këtë mënyrë ngulitjen në zemrat e tyre ndjenjat e dashurisë dhe besnikërisë ndaj fesë dhe kombit. Tarikati saadi në Gjakovë, pas vitit 1912 e vazhdoi aktivitetin e vetë fetar, në gjysmë ilegalitet duke u orientuar vetëm brenda për brenda teqeve, për shkak se pushtuesi serb nuk i lejonte në nivel përfaqësimi, por ata njëkohësisht nuk e ndalen veprimtarinë e tyre duke ju dal në ndihmë popullatës së shtypur nga shteti policor i Serbisë, të cilët ju mohuan shqiptarëve të drejtat nacionale dhe shoqërore.

Tarikati saadi është ndër tarikatet më të hershme, teqetë e së cilit tarikat ndodhen në qytetin e Gjakovë, në tërë Kosovën dhe në trevat tjera shqiptare. Prej themelimit të tyre e deri në ditët e sotme, luajnë një ndikim shumë të madh, si: në pastrimin shpirtëror të njerëzve, përpjekjet e largimit nga veset e këqija dhe stolisjes me vetitë e mira, siç janë: butësia, durimi, sinqeriteti, thënia e së vërtetës, dhe cilësi të tjera të mira të këtij lloji, synimi final i të cilëve është përsosmëria e njeriut në të gjitha pikëpamjet e tij, materiale dhe shpirtërore, duke u vënë në shërbim të kauzës së paqes⁸³. Por, ndikimi i saj qëndron edhe sot e kësaj dite tek popullata e kësaj ane. Në Gjakovë kanë qenë të ndërtuara monumente të ndryshme të karakterit të tillë. Ato diku më shumë e diku më pak, luajnë një ndikim shumë të fuqishëm. Ndërsa, më vonë në disa qytete, kanë filluar të shkatërrohen duke mos thënë që nuk ekzistojnë fare.

⁸¹ Sipas Nesim Dervishdanës, nipi i Nesmiut, më 18 gusht 2009.

⁸² Stephen Schwartz, *Kosova prejardhja e një lufte*, (Prishtinë: Printing-Press, 2006), 178.

⁸³ *Arkivi i Institutit të Historisë - Tiranë* (më tej: *AIHT*), Fondi: Ferid Vokopola; Mendime dhe studime historike hurufit, hurufit shqiptar burmi dhe doktrina e tyre, dos. A-III-233. f. 1.

Kosovar BASHA

**DOKUMENT MBI BASHKËPUNIMIN NDËRMJET AKADEMISË
SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË DHE ASAJ TË KOSOVËS
GJATË VITEVE 1981-1982**

Marrëdhëniet kulturo-arsimore ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në vitet 1968-1981 dhanë rezultate të shkëlqyera. Dokumentet arkivore që po i prezantojmë janë të vjela në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Materiali arkivor na njofton për bisedat dhe marrëveshjet ndërmjet dy akademive të shkencave, të Shqipërisë dhe Kosovës, më 1981. Ky bashkëpunim i dy institucioneve nuk u realizua në tërësi, pasi që pak muaj më vonë, në Kosovë do të shpërthenin Demonstratat e marsit të vitit 1981, dhe bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve në fushat kulturo-arsimore do të ndërpritej.

**RELACION MBI QËNDRIMIN NË VENDIN TONË TË
DELEGACIONIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE E
ARTEVE E KOSOVËS, QË ERDHI PËR NËNSHKRIMIN E
PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-
SHKENCOR MIDIS DY AKADEMIVE PËR VITET 1981-1982**

Delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve e Kosovës që erdhi në vendin tonë për nënshkrimin e Protokollit të bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis dy akademive për vitet 1981-1982 përbëhej nga kryetari i Akademisë, prof. Idriz Ajeti, sekretari i përgjithshëm i Akademisë, prof. Syrja Pupovci dhe sekretari teknik i Akademisë Zija Bylykbashi. Ky delegacion erdhi në vendin tonë më 27.01.1981. Ai u prit në Qafëthanë nga prof. Luan Omari, sekretar i Akademisë dhe Nuri Çausi,

kryetar i Degës së Jashtme të Akademisë. Në mbrëmjen e po asaj dite, prof. Aleks Buda shtroi një darkë për nder të delegacionit. Darka kaloi në një atmosferë të ngrohtë dhe vëllazërore.

Më 28.01.1981 delegacioni u prit në selinë e Akademisë nga kryetari prof. Aleks Buda. Në pritje merrnin pjesë edhe disa nga drejtuesit e instituteve tona kërkimore-shkencore. Gjatë pritjes u bisedua për realizimin me sukses të Protokollit të parë dhe u fol për dobinë e dyanshme të forcimit të marrëdhënieve me Protokollin që do të nënshkruhej. Pala kosovare shprehu kënaqësinë për realizimin e Protokollit të mëparshëm dhe vuri në dukje se ata e shohin këtë bashkëpunim si një faktor me rëndësi dhe një shtytje për zhvillimin e punës shkencore në Kosovë. Rëndësi të veçantë ata i kushtuan bashkëpunimit në fushat e shkencave që lidhen me vendin dhe me popullin tonë, si p.sh. në fushën e gjuhësisë, të historisë, të kulturës popullore etj. Delegacioni u interesua për aktivitetet kombëtare në këto fusha, duke shprehur dëshirën që grupe studiuesish të tyre të ftohen për të marrë pjesë me kumtesa në këto aktivitete. Ata theksuan se studiuesit e Kosovës tani gjithnjë e më shumë mund të marrin pjesë jo vetëm për të dëgjuar, por edhe për të mbajtur kumtesa në këto aktivitete. Syrja Pupovci tha se “do të marrin pjesë në të gjitha këto aktivitete, në vartësi nga rëndësia e tematikës dhe nga mundësia për të kontribuar”. Ai theksoi se do të ishte mirë që të merrej iniciativa nga Akademia e Shkencave e Tiranës për të përkujtuar edhe figura të tilla të së kaluarës, si: Pjetër Budi, Pjetër Bogdani etj. Në qoftë se ne do ta marrim iniciativën për këtë, kjo mund të keqkuptohet, - theksoi Syrja Pupovci. Ai shtoi se do të propozojnë një kalendar për përkujtim figurash patriotike që lidhen me Kosovën, por edhe për figura të tjera. Ndër to mund të ishin albanologë të shquar e dashamirë të popullit tonë, si Hahni, Edit Durham, por edhe të tjerë, si: Kosta Novaković, Dimitrie Tucović etj. Në bisedat, prof. Idriz Ajeti, shtroi nevojën e një bashkëpunimi më të gjerë të studiuesve kosovarë për problemet e formimit të popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij. Lidhur me këtë u shtrua si nevojë që të intensifikohen kërkimet arkeologjike në territorin e Kosovës, por në këtë fushë në Kosovë ka pak quadro shqiptarë, por edhe ato janë pa përvojë. Shoku Aleks Buda shprehu gatishmërinë për të ndihmuar në kualifikimin e arkeologëve shqiptarë nga Kosova, duke marrë pjesë edhe në gërmime në vendin tonë bashkë me arkeologët tanë. Përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, na vunë në dijeni se Akademia e tyre “do të organizojë 2-3 tubime për gjendjen në shkencat e caktuara. Në shkencat e natyrës do të mbahet një sesion për mbrojtjen e ambientit, si edhe një tjetër për ushqimin e popullsisë.

Do të mbahet gjithashtu një konferencë shkencore mbi dardanët, ku ka shumë lajthime, për të luftuar disa tendenca të gabuara të historianëve dhe të arkeologëve të huaj”.

Ata thanë se kishte lindur nevoja që brenda Akademisë të ngriheshin dy institute, Instituti i Etnologjisë dhe Instituti i Arkeologjisë. Na vunë në dijeni gjithashtu se ka lindur nevoja që të bëhen disa ndryshime në organizimin e vet Akademisë. Akademia do të përfshijë në gjirin e saj disa institute, kryesisht të shkencave shoqërore, midis të cilave edhe Institutin e Historisë dhe atë të Albanologjisë. Duke folur për problemet e gjuhës, për hapat e rëndësishëm që janë bërë e po bëhen lidhur me gjuhën e përbashkët letrare kombëtare e me drejtshkrimin e saj, Syrja Pupovci shtroi problemin: “U morëm vesh për drejtshkrimin, por po na kanoset një rrezik i madh në terminologji. Në këtë fushë na kanoset dallimi semantik i madh pa qenë nevoja. Nuk është fjala këtu vetëm për nocione që lidhen me dallime ideologjike, por bile edhe për fusha të tjera ku dallime të tilla s’ka. Termet po na hyjnë prej gjuhëve të ndryshme dhe gjendja është shqetësuese edhe në shkencat ekzakte. Prandaj u shtrua detyra për të bërë përpjekje për një njësim sa më të madh të kësaj terminologjie me konsulta e komisione të përbashkëta.

Delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, u prit nga zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, shoku Manush Myftiu, ministria e Arsimit dhe Kulturës, shoqja Tefta Cami. Delegacioni bëri vizitë në Krujë dhe në Korçë. Në Korçë kryetari i Komitetit Ekzekutiv të rrethit për nder të tyre shtroi një darkë.

Më datën 02.02.1981, ambasadori i Jugosllavisë në Tiranë, dha një darkë në selinë e Ambasadës, ku morën pjesë edhe kryetari i Akademisë sonë, prof. Aleks Buda, përfaqësues nga Ministria e Jashtme dhe grupi i punës. Më datën 31.01.1981 u bë takimi përfundimtar i grupeve të punës për të hartuar projektin përfundimtar të Protokollit. Takimi u bë në frymë mirëkuptimi dhe nuk pati probleme. Në dallim nga Protokollin i mëparshëm i viteve 1979-1980, në këtë Protokoll, siç dihet, krahas shtimit të aktiviteteve që përbëhen kryesisht prej ekspeditash në terren, u vu një paragraf i ri: kërkime arkivore dhe botime të përbashkëta me interes të dyanshëm. Lidhur me kërkimet arkivore jashtë territorit të Kosovës, pala kosovare u zotua që këto t’i realizojë, megjithëse nuk u futën në Protokoll, për arsye se delegacioni këto porosi i kishte marrë. Në këtë takim, si dhe në takime të tjera, Syrja Pupovci theksoi se është i gëzuar që po bëhet një hap përpara në marrëdhëniet midis akademive. Me rëndësi të posaçme për ne, theksoi ai, është që të ndërmarrim dhe hartimin e veprave të përbashkëta

si dhe botime të përbashkëta. Gjithashtu edhe për kërkimet arkivale në arkiva të huaja të bëjmë një ndarje pune: ato materiale që marrim ne t'ua japim juve dhe ju gjithashtu të na jepni tuajat. Lidhur me Arkivin Qendror të Shtetit, Syrja Pupovci në emër të delegacionit, shprehu pakënaqësinë e tij. Arkivi nuk jep pothuaj asgjë, - tha ai, edhe dokumente që historianët tuaj i kanë shfrytëzuar e i citojnë, Fondi i Komitetit të Kosovës, nuk na jepen.

Ai përmendi raste studiuesish kosovarë që Arkivi ynë i ka nxjerrë duarbosh, “në kohën që ne ju kemi dhënë gjithçka kemi pasur, edhe të pashfrytëzuara. Ju keni marrë prej nesh mbi 100 000 faqe të kseroksuara e në mikrofilma”. Në emër të delegacionit, Syrja Pupovci tha gjithashtu se lidhur me gjendjen ekonomike të Jugosllavisë, fondet për shkencën dhe arsimin janë pakësuar. Ai vuri në dukje gjithashtu se nga pala e tyre ka vjedhje të mëdha nga restorantet, hotelet etj. Prandaj tha se janë duke menduar një rregullim tjetër për të mënjanuar vjedhjet. Nga konstatimet e tyre del se vetëm 1/3 e të hollave që i ngarkohen Akademisë së Kosovës për shpenzimet e punonjësve tanë harxhohen efektivisht prej tyre.

Syrja Pupovci tha gjithashtu se në zgjedhjen e botimeve të studiuesve të Shqipërisë që ribotohen në Kosovë, shpesh ka subjektivizëm. Prandaj, këtë punë do ta marrë në dorë Akademia për të parë përparësinë e këtyre botimeve, për të botuar në fillim studiuesit më të vyer dhe për këtë kërkoi që të konsultohesh dhe me Akademinë tonë të Shkencave. Syrja Pupovci shtroi edhe mendimin që për artikujt e studiuesve kosovarë që botojnë në revistat tona të merrej mendimi i Akademisë së Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Në këtë kuadër tha se në revistën “Kultura Popullore” 1980, nr.1 është botuar artikulli i Hivzi Sulejmanit “Shtrirja dhe numri i shqiptarëve”. Do të ishte më mirë të botohej ndonjë artikull nga Mark Krasniqi që ka shkruar për këto probleme. Ky mendim i Syrja Pupovcit që ne të marrim (lejen) e tyre për artikujt që i marrim për revistat e tyre shkencore dhe i ribotojmë në revistat tona nuk na u duk i drejtë, sepse çdo redaksi ka të drejtë të zgjedh artikujt që i duken më të përshtatshëm për të botuar. Propozimi i tij mbante erë censurimi dhe nuk u pranua, megjithëse këtë ai kërkonte t'i vinte mbi baza reciprociteti. Delegacioni kosovar kërkoi që studiuesit kosovarë që vijnë në vendin tonë për kërkime arkivore, ekspedita etj., të mos mbajnë ligjërata, pa miratimin e palës së tyre, sepse shpesh ata s'e kanë përgatitjen e nevojshme. Syrja Pupovci vuri në dukje gjithashtu se qëndrimi i punonjësve tanë në Kosovë është shumë korrekt dhe kjo ka bërë të mundur që marrëdhëniet midis nesh të zhvillohen e të zgjerohen edhe pse ka forca që s'e shohin me sy të mirë këtë forcim. Por, ai u lut që porositen punonjësit tanë të mos bëjnë asnjë lëvizje pa njoftuar

shoqëruesit ose drejtuesit e Akademisë. Këtë problem tha e shtronte, meqë ka raste që kolegë të tyre kosovarë insistojnë t'i ftojnë nëpër shtëpi ose në ndonjë shëtitje. E tha shkoqur që lëvizjet dhe takimet e punonjësve tanë regjistrohen, prandaj edhe drejtuesit e Akademisë duhet të jenë në dijeni. Tha se nuk është i mendimit që të mos bëhen vizita ndër kolegë, por për këtë duhet të vejë njoftimi aty ku duhet.

Syrja Pupovci foli gjithashtu për nderimin që kanë njerëzit në Kosovë për figurën e Eqrem Çabejt dhe veprën e tij. Tha se do t'i kushtojnë një numër përkujtimor të revistës "Gjurmime albanologjike" Eqrem Çabejt. Ndër të tjera, anëtarët e delegacionit thanë se në Kosovë për nder të studiuesit tonë, fëmijëve që lindin u janë vënë e po u vihen emra Çabej. Ndërkohë Akademisë sonë të Shkencave i ka ardhur ftesë për të bashkëpunuar edhe studiuesit tanë me artikujt në këtë numër përkujtimor. Kësaj ftese ne do t'i përgjigjemi pozitivisht. Lidhur me këtë problem ai tha gjithashtu se në Kosovë është biseduar që emri i Eqrem Çabejt t'i vihet ndonjë shkolle dhe ndonjë rruge. Por theksoi ai, për këtë ndoshta do të duhej që më parë kjo të bëhej në Shqipëri, pastaj në Kosovë, përndryshe do të kuptohej keq (d.m.th. sikur ne s'e vlerësojmë). Syrja Pupovci theksoi gjithashtu se marrëveshjet midis dy akademive tona nuk duhet të kenë pamjen e marrëveshjeve që lidh Kosova me vende të tjera, sepse jemi një popull e një komb. Prandaj, në të ardhmen do të duhet të vemi edhe më shumë në kërkimet e përbashkëta në terren, në kërkime arkivale e në studime të përbashkëta në ato fusha ku kjo është e mundshme të bëhet. Syrja Pupovci na u lut që Akademia jonë t'i sigurojë disa botime që s'i kanë, ndër të cilat revistat "Hylli i dritës", "Leka" etj. Këto ne edhe mund t'i blejmë vetë nga individë nga Shqipëria, por kjo s'do të ishte mirë. Nga ana e vet u zotua të dërgojnë rregullisht botimet e tyre dhe sa të jetë e mundur botimet jugosllave që kanë të bëjnë me vendin tonë.

SHOQËRUESIT

(Nuri Çausi)
(Anastas Dodi)
[*nëshkrimi*]
[*nëshkrimi*]

Tiranë, 09. 03. 1981

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: MPJ), Viti 1981, Dosja, 1229, f. 124-129.

KPI ARKIVI

VITI: 1981

DOSJA: 12. FLETA: 12.4/

R E L A C I O N

MBI QËNDRIMIN NË VENDIN TONË TË DELEGACIONIT TË AKADEMISË
SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS, QË ERDHI PËR NËN-
SHKRIMIN E PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT KËRKIMOR-SHKENCOR
MIDIS DY AKADEMIVE PËR VITET 1981 - 1982

Delegacioni i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që erdhi në vendin tonë për nënshkrimin e Protokollit të bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis dy Akademive për vitet 1981-82 përbëhej nga kryetari i Akademisë, prof. Idriz Ajeti, sekretari i përgjithshëm i Akademisë prof. Syrja Pupovci dhe sekretari teknik i Akademisë Zija Bylykbashi.

Ky delegacion erdhi në vendin tonë më 27.1.1981. Ai u prit në qafëthasë nga prof. Luan Qmari, sekretar shkencor i Akademisë dhe Nuri Çausi, kryetar i degës së jashtme të Akademisë.

Në mbrëmjen e po asaj dite prof. Aleks Buda shtroi një darkë për nder të delegacionit. Darka kaloi në një atmosferë të ngrohtë dhe vëllazërore.

Më 28.1.1981 delegacioni u prit në selinë e Akademisë nga kryetari prof. Aleks Buda. Në pritje marrnin pjesë edhe disa nga drejtuesit e instituteve tona kërkimore-shkencore. Gjatë pritjes u bisedua për realizimin me sukses të Protokollit të parë dhe u fol për dobinë e dyanshme të forcimit të marrëdhënive me Protokollin që do të nënshkruhej.

Pala kosovare shprehu kënaqësinë për realizimin e Protokollit të mëparshëm dhe vuri në dukje se ata e shohin këtë bashkëpunim si një faktor me rëndësi dhe një shtytje për zhvillimin e punës shkencore në Kosovë. Rëndësi të veçantë ata i kushtuan bashkëpunimit në fushat e shkencave që lidhen me vendin dhe me popullin tonë, si pah në fushën e gjuhësisë, të historisë, të kulturës popullore etj.

MPJ ARKIVI

VITI: 1981

DOSJA: 114 FLETA: 118 6

...për figurën e Eqrem Çabejt dhe veprën e tij. Tha se do t'i kushtojnë një numër përkujtimor të revistës "Gjurmime albanologjike" Eqrem Çabejt. Ndër të tjera, anëtarët e delegacionit thanë se në Kosovë për nder të studiuesit tonë, fëmijëve që lindin u janë vënë e po u vihen emra Çabej. Ndërkohë Akademisë sonë të Shkencave i ka ardhur ftesë për të bashkëpunuar edhe studiuesit tanë me artikuj në këtë numër përkujtimor. Kësaj ftese ne do t'i përgjigjemi pozitivisht. Lidhur me këtë problem ai tha gjithashtu se në Kosovë është biseduar që emri i Eqrem Çabejt t'i vihet ndonjë shkolle dhe ndonjë rruge. Por, theksoi ai, për këtë ndoshta do të duhej që më parë kjo të bëhej në Shqipëri, pastaj në Kosovë, përndryshe do të kuptohej keq (dmth sikur ne s'e vlerësojmë).

Syrja Pupovci theksoi gjithashtu se marrëveshjet midis dy Akademive tona nuk duhet të kenë pamjen e marrëveshjeve që lidh Kosovën me vende të tjera, sepse ne jemi një popull e një komb. Prandaj në të ardhmen të ecim më shumë në rrugën e studimeve të përbashkëta e me interes të përbashkët. Theksoi në të ardhmen do të duhet ta vëmë edhe më shumë në kërkimet e përbashkëta në terren, në kërkime arkivale e në studime të përbashkëta në ato fusha ku kjo është e mundshme të bëhet.

Syrja Pupovci na u lut që Akademia jonë t'i sigurojë disa botime që s'i kanë, ndër të cilat revistat "Nylli i dritës", "Leka" etj. Këto ne edhe mund t'i blejmë vetë nga individë në Shqipëri, por kjo s'do të ishte mirë. Nga ana e vet u zotua të dërgojnë më rregullisht botimet e tyre dhe se të jetë e mundur botimet jugosllave që kanë të bëjnë me vendin tonë.

SHOQËRUESIT

(Nuri Çausëk)

(Anastas Dodi)

Tiranë, 9.3.1981

RECENSIONE

SHQIPTARËT GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE - ARKIVAT KOMBËTARË BRITANIKË

(Sabit Syla & Hamit Kaba, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore - Arkivat Kombëtarë Britanikë*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 2018, f. 532.)

Instituti i Historisë-Prishtinë, botoi vëllimin: *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore - Arkivat Kombëtarë Britanikë*, përgatitur nga studiuesit: prof. dr. Hamit Kaba dhe prof. asoc. dr. Sabit Syla. Publikimi i përmbledhjes së dokumenteve nga Arkivat Kombëtarë Britanikë mbi *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore* nga studiuesit dr. Sabit Syla dhe dr. Hamit Kaba, paraqet një kontribut të çmuar për të ndriçuar shumë aspekte mbi veprimet politike, diplomatike, të lëvizjes së rezistencës antifashiste shqiptare dhe raportet e kësaj me lëvizjet e rezistencës së vendeve fqinje si dhe të rolit që kanë pasur fuqitë aleate në Shqipëri gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Botimi i kësaj monografie dokumentare vjen në një kohë të duhur, pikërisht kur ka filluar të shkruhet një edicion katërvëllimesh i historisë së Kosovës. Shumë nga këto dokumente në mënyrë të drejtpërdrejtë apo kontekstuale do të jenë në funksion të hedhjes dritë më të plotë mbi zhvillimet kryesore ushtarake, politike dhe socio-ekonomike gjatë Luftës së Dytë Botërore, përveç tjerash edhe në trevën e Kosovës dhe të Maqedonisë. Rrjedhimisht materialet dokumentare të papublikuara të sjella në këtë edicion do të jenë një kontribut i drejtpërdrejtë në funksion të projektit shkencor *Historia e Kosovës*.

Dokumentet e ofruara në këtë përmbledhje janë korrespondenca diplomatike të drejtuara Foreign Office nga rajoni i Ballkanit, por ka edhe shumë direktiva, instruksione vështirë dhe analiza që FO britanik ka shpërndarë për përfaqësuesit e tij politikë, diplomatikë dhe misionet e veta ushtarake në Ballkan dhe në Shqipëri. Vend me interes në këtë përmbledhje zënë edhe korrespondencat midis FO dhe Uashingtonit lidhur me zhvillimet

politike dhe ushtarake në Shqipëri. Provenienca dokumentare e sjellë në këtë përmbledhje i takon harkut kohor, nëntor 1940-maj 1945, dhe përmban mbi 450 faqe material dokumentar të papublikuar. Duke analizuar me vëmendje këtë përmbledhje, mund të konstatojmë se secili dokument më tepër se tjetri, konfirmon fokusin e lartë dhe angazhimet konkrete të politikës dhe diplomacisë britanike, përmes misionit ushtarak, për të përcjellë dhe ndikuar lëvizjet politike dhe të rezistencës antifashiste në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Dokumentet e para të kësaj përmbledhje janë korrespondenca të FO dhe Ministrisë së Informacionit britanik me diplomatët e tyre në Athinë, në të cilat pasqyrohen marrëdhëniet shqiptaro-greke, veçmas pas nëntorit të vitit 1940, kur forcat e greke arritën të mundnin italianët edhe brenda kufirit shqiptar dhe të hyjnë në Korçë. Një deklaratë e gjeneralit grek, Metaxa, u bë objekt i këtyre letërkëmbimeve britanike. Ai përmendi synimet e forcave greke për çlirimin edhe të Shqipërisë, por mediat britanike e përkthyen gabimisht, si përkrahje greke për pavarësinë e Shqipërisë, që nënkuptonte edhe njohjen e kufijve jugorë të Shqipërisë së pas Luftës së Parë Botërore. Janë rreth 11 dokumente që trajtojnë relacionet shqiptaro-greke dhe qartësojnë politikën britanike karshi këtyre marrëdhënieve, e në të cilat pala britanike është në mbështetje të linjës greke. Dokumentet në vijim kanë përmbajtje analizimin e rrethanave dhe nxitjen e një lëvizjeje antiitaliane në Shqipëri. Sugjerohej kryesisht mbështetja në forcat e Abaz Kupit, si forcë që kishte kundërshtuar invadimin italian në Shqipëri. Dokumentet në vijim përmendin çështje që lidhen më përpjekjen e Mbretit Zog për të siguruar një status më të privilegjuar dhe përgjigjen negative të Qeverisë britanike për shkak të faktit se Mbreti Zog gëzonte mbështetje të kufizuar në mesin e shqiptarëve dhe ideja e krijimit të një Qeverie të përkohshme shqiptare në ekzil, nuk u mor seriozisht nga autoritetet britanike.

Përmbajtja e dokumenteve vijuese të periudhës 1941-1943, përgjithësisht janë dëshmi për ruajtjen e fokusit të diplomacisë britanike për të vëzhguar nga afër zhvillimet që kishin të bënin edhe me angazhimet e autoriteteve shqiptare në ekzil, kryesisht në Britani dhe në SHBA, por edhe për veprimet e forcave të rezistencës në terren. Një vend të rëndësishëm këtu shohim se i kushtohet rritjes së propagandës aleate për të inkurajuar lëvizjen e rezistencës antifashiste nga të dy krahët e saj, edhe nacionaliste edhe komuniste. Në këtë pjesë të dokumenteve zënë vend edhe disa raporte dhe letra diplomatike jugosllave dhe greke për të denoncuar sjelljet e Italisë në Shqipëri dhe qëndrimet proitaliane të Qeverisë shqiptare.

Është me rëndësi të theksohet se nga tetori i vitit 1943 kur forcat gjermane zëvendësuan ato italiane në Shqipëri, vëmendja e Qeverisë dhe Parlamentit britanik për Shqipërinë dhe lëvizjen e rezistencës atje, u shtua. Për herë të parë kryeministri britanik u pyet nëse mund të bëjë ndonjë deklaratë për guerilët në Shqipëri dhe politikën e Qeverisë së Madhërisë së Tij ndaj tyre, ai u përgjigj: “Po zotëri, mijëra guerilë shqiptarë po luftojnë nëpër male për lirinë dhe pavarësinë e vendit të tyre. Nga përvoja e vendeve të tjera të pushtuara, ata kanë mësuar që e ashtuquajtura pavarësi e dhënë nga gjermanët është tërësisht e gënjeshtërt” (dok. 53. *TNA, FO 371/37144, Viti 1943*). Dokumentet pasuese janë kryesisht raporte dhe analiza mbi situatën dhe rrjedhat e luftës në Shqipëri, kryesisht të dërguara FO nga Misioni Ushtarak britanik në Shqipëri.

Në këtë përmbledhje të dokumenteve britanike jo rrallë del edhe Kosova. Ajo përmendet në kontekste dhe pikëpamje të ndryshme, varësisht cila është prejardhja e informacionit. Por, është me interes së aleatët britanikë, Kosovën e përmendin në fillim të vitit 1944 në kontekstin e lidhjeve të saj etnike dhe ekonomike me Shqipërinë, duke pohuar se Kosova gjatë luftës kontrollohet nga Shqipëria dhe se kjo e fundit është shumë e varur ekonomikisht nga furnizimet që vijnë nga Kosova. “Pjesa e furnizimeve nga Uashington në të cilën bazohet Plani i Shtabit Aleat (për Shqipërinë) është në masë të konsiderueshme më e vogël se nevojat e llogaritura për vendin. Prandaj, nëse nuk rritet sasia e këtyre furnizimeve për të plotësuar nevojat e llogaritura, shqiptarët do të kërkojnë përsëri ndihmë nga Kosova” (dok. 66. *TNA, HS 5/66, Viti 1943-44*). Në dokumentin nr. 72, në këtë përmbledhje jepet një vlerësim “mbi të ardhmen e Kosovës dhe vlerën e saj ekonomike, të shoqëruar me shtojcën ‘A’ dhe ‘B’”. Dokumenti nis me këtë përkufizim: “Krahina iu aneksua Shqipërisë prej Jugosllavisë nga italianët në gusht 1941, ku përfshihej edhe Lugina e Plavës dhe Gucisë, fusha e Metohisë, pjesë të fushës së Kosovës, Mali i Sharrit dhe lugina e Sipërme e Vardarit”. “Sa i përket popullsisë, vazhdon dokumenti, nuk ekzistojnë shifra të sakta. Në vitin 1918, pjesa më e madhe ishte padyshim shqiptare. Kjo shumicë vazhdon pothuajse me siguri megjithëse është reduktuar shumë gjatë sundimit jugosllav 1918-‘41 (dok.72. *TNA, HS 5/66, Viti 1943-44*). Përqendrimi më i madh i diplomacisë britanike, referuar dokumenteve të kësaj përmbledhje ishte në pjesën e fundit të luftës, fillimi i vitit 1944 deri në maj të vitit 1945. Gjatë vitit 1944, deri më 5 tetor 1944, britanikët teorikisht përkrahnin, të gjitha forcat e rezistencës në Shqipëri, por praktikisht më shumë i adresoheshin LNÇ. Kjo u pa me faktin se pjesa më e madhe e furnizimeve aleate iu akordua lëvizjes partizane.

Politika britanike e mbështetjes për rezistencën partizane ndonëse me një lloj hezitimi siguroi mbështetjen e politikës amerikane. Por, asnjëri nga të dy Aleatët Perëndimorë të Luftës nuk pranoi që ta njihte Qeverinë e krijuar në Berat. Ata e shihnin me shumë dyshim karakterin komunist të Qeverisë shqiptare dhe me të drejtë konstatonin se një regjim totalitar po projektohej për t'u vendosur në Shqipëri. Në mbarim të vitit 1944 britanikët vendosën të dërgonin në Shqipëri një Mision Ushtarak, ndërsa amerikanët një Mision Civil, të cilët do të studionin situatën në Shqipëri dhe do të procedonin më tej me njohjen e Qeverisë shqiptare.

Pjesa përmbyllëse e kësaj përmbledhje përfshinë një numër të konsiderueshëm dokumentesh, të cilat hedhin dritë mbi situatën politike-ushtarake dhe socio-ekonomike në Shqipëri në prag të çlirimit nga pushtuesit gjerman, duke përshkruar natyrisht, rritjen e forcave partizane, moralin, pajisjet, por edhe të dhëna interesante mbi shkallën e dëmtimeve që la lufta, problemet e varfërisë, të papunësisë dhe problemet financiare të autoriteteve vendore. Ka në mesin e këtyre dokumenteve informacione për aspekte të veçanta të situatës që nga fillimi i vitit 1944. Me interes janë vështrimet që i bëjnë përfaqësuesit diplomatikë dhe ushtarakë britanikë, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe marrëdhëniet shqiptare-greke, të cilat janë përmbledhur në një vështrim të titulluar: "Marrëdhëniet me vendet fqinje" (dok. nr. 212, *TNA, HS. 7/70*). I një rëndësie të veçantë për përmbajtjen e tij është edhe dokumenti i fundit i kësaj përmbledhje, Raporti i ambasadorit britanik në Beograd, Ralph Skrine Stevenson, drejtuar Sekretarit të Jashtëm, Anthony Eden, ku autori jep një informacion të gjerë mbi rezistencën e shqiptarëve në Kosovë e Maqedoni kundër Ushtrisë jugosllave dhe ripushtimit të këtyre territoreve (dok. 233, *TNA, FO 371/48090, Viti 1945*).

Shikuar nga aspekti i përmbajtjes dhe faktografisë që sjellin dokumentet, me të drejtë mund të themi se bëhet fjalë për një monografi dokumentare me vlera të konsiderueshme shkencore. Si e tillë, ajo përbënë një impuls të rëndësishëm në trajtimin shkencor të ngjarjeve dhe zhvillimeve kryesore të Luftës së Dytë Botërore në hapësirën shqiptare. Autorët, Sylja dhe Kaba me këtë përmbledhje të dokumenteve, po i bëjnë një shërbim të jashtëzakonshëm historiografisë shqiptare dhe gjithë studiuesve të shkencave sociale në trajtimin e temave nga Lufta e Dytë Botërore. Kjo përmbledhje dokumentesh shquhet për një nivel solid të organizimit dhe strukturimit të dokumenteve të bëra me një akribi të veçantë, duke i gërshetuar në mënyrë logjike kriterin kronologjik dhe përmbajtjesor.

Në fund, dua të përgëzoj autorët që na sollën një libër të punuar me një metodologji të avancuar shkencore, të saktë nga ana intelektuale, brilant dhe impresiv. Një libër të rekomanduar jo vetëm për audiencat profesionale, por për të gjithë ata që pretendojnë ta njohin të vërtetën historike.

Ibrahim GASHI

EPOKA E LAVDISHME E GJERGJ KASTRIOTIT- SKËNDERBEUT PARË NËN PRIZMIN E FONDEVE TË ARKIVIT SHTETËROR TË DUBROVNIKUT

***(Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të
Dubrovnikut: dokumente. Hulumtoi dhe përgatiti, prof. asoc. dr. Gjon
Berisha, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 433 f.)***

Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë në kuadër të aktiviteteve kushtuar Vitit Jubilar të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, botoi vëllimin me dokumente *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut: dokumente*, hulumtuar dhe përgatitur për botim nga prof.asoc.dr. Gjon Berisha. Botimi i këtyre dokumenteve është një përfundim me sukses i punës hulumtuese disavjeçare në Arkivin Shtetëror të Dubrovnikut nga studiuesi i periudhës së mesjetës, Berisha, i cili si rezultat i punës hulumtuese në arkivin në fjalë, pati rastin që të hulumtoj dhe grumbulloj rreth 35 000 faqe dokumente që ndërlidhën me Arbërinë dhe arbërorët në mesjetë, të cilat dokumente për nga përmbajtja e tyre ju takojnë fushave të ndryshme si: ekonomike, politike e kulturore. Nga këto dokumente të hulumtuara dhe grumbulluara gjatë katër viteve të fundit, një pjesë e tyre, që i kushtohen epokës së Gjergj Kastriotit, gjejnë vend në këtë përmbledhje me dokumente.

Një përmbledhje e tillë me dokumente tematike, kushtuar Gjergj Kastriotit, dhe që na vijnë vetën nga një arkiv, siç është Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut (DAD), nuk ka ekzistuar më herët, prandaj është e mirëseardhur për studiuesit e mesjetës në veçanti dhe lexuesit në përgjithësi. Edhe në aspektin metodologjik, vëllimi është i punuar me kujdes të veçantë, ku krahas tekstit të dokumentit origjinal, gjendet përkthimi në gjuhën shqipe. Kurse, për kureshtarët dhe studiuesit që dëshirojnë të bëjnë krahasime me dokumentet origjinale, studiuesi Berisha, në fund të vëllimit ka radhitur faksimilet e shumicës së dokumenteve të botuara, të shoqëruara

me shënime plotësuese për vendndodhjen e tyre dhe datën e dokumentit. Thënë ndryshe, fondet arkivore kushtuar Gjergj Kastriotit që gjenden në DAD, tani i kemi në një vend, në një libër dhe në gjuhën shqipe.

Botimi i burimeve historike të cilat në vete përmbajnë një pjesë të rëndësishme të historisë sonë, përbën një punë sa të çmuar dhe të rëndësishme aq edhe të mundimshme, sidomos për periudhën e mesjetës në përgjithësi e në rastin konkret për periudhën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, kur merret parasysh fakti se dokumentet që i referohen periudhës në fjalë janë të shpërndara nëpër arkiva të shteteve të ndryshme me të cilat Gjergj Kastrioti-Skënderbeu kishte raporte qoftë ekonomike, politike e më gjerë. Vëllimi me dokumente i cili jo rastësisht po i prezantohet lexuesit në Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, përmban 228 dokumente që nga pikëpamja kronologjike përfshijnë periudhën kohore nga 21 marsi i vitit 1413 deri më 1 mars të vitit 1468, kohë kjo kur krahas kryengritjes së Gjon Kastriotit në pranverën e vitit 1430, pasuan edhe kryengritjet në viset e tjera të Arbërisë. Gjithashtu, në periudhën në fjalë, Arbëria u përball me luftërat e vazhdueshme të Skënderbeut kundër ushtrive osmane. Fondi dokumentar për këto kryengritje pararendëse, vërteton realitetin historik të kohës, se vitet '30 të shek. XV, rezultojnë për Arbërinë, vite kryengritjesh antiturke dhe betejash të rrepta kundër tyre. Në këtë sfond, në veprimtarinë politike të Kastriotëve, si një nga ngjarjet më të rëndësishme, është shpërthimi i kryengritjeve antiturke të Gjon Kastriotit të viteve 1428-1430. Në veçanti, në këtë fond janë të pasqyruara kryengritjet e fisnikëve: Topia, Arianiti, Kastrioti, Dukagjini, Muzaka etj. Dokumentet arkivore raguzane i referohen, në radhë të parë, kryengritjes së Gjergj Arianitit, e cila tërhoqi vëmendjen, qoftë për nga përmasat, qoftë për nga sukseset e saj të mëdha e të qëndrueshme.

Materialet nga Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut që po botohen në këtë vëllim vijnë nga fondet: *Acta Consilii Maius*, *Acta Consilii Minoris*, *Acta Consilii Rogatorum*, *Diversa Notariae*, *Diversa Cancellariae*, *Lamenta de Foris*, *Lettere e Comissioni di Levante*, *Procurae Notariae*, *Reformationes* dhe *Testamenta Notariae*, dhe në ndonjë seri tjetër.

Vlen të theksohet se Gjon Berisha duke përgatitur për botim këto dokumente, ka treguar kujdes të veçantë në radhë të parë, duke i dhënë të plota fondet e Arkivit të Dubrovnikut prej nga edhe i ka marrë dokumentet që po botohen, pastaj vëmendje e veçantë i është kushtuar dokumenteve me rastin e transkriptimit dhe përkthimit të tyre, që ka qenë një punë mjaftë e mundimshme, por falë punës këmbëngulëse të tij dhe redaktimit profesional të bërë nga redaktori Fajton Balliu, kanë bërë që këto dokumente, po e themi

në kuptimin figurativ, të flasin për një ndër periudhat më të lavdishme të historisë sonë.

Për t'i bërë sa më të lehta për lexuesin të gjitha dokumentet, studiuesi Berisha, i ka shoqëruara me një kokë apo fjali, që tregon përmbajtjen e dokumentit, shënime sqaruese në fund të faqes, në raste kur e ka konsideruar të nevojshme, si dhe fondin ku gjenden dokumentet origjinale dhe në rastet kur është i botuar, krahas origjinalit është dhënë edhe referenca e dokumentit të botuar. Gjithashtu për hir të së vërtetës dhe korrekhtësisë, Gjon Berisha nuk lë pa përmendur se autorë të huaj ashtu edhe shqiptarë, në periudha të ndryshme kohore kanë botuar dokumente arkivore për tematikën që mbulon ky vëllim, por ato janë të pjesshme, dhe se në formë dokumenti apo përmbajtjeje, janë botuar vetëm në gjuhët e origjinalit, e që tani lexuesit po i prezantohen të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Vëllimi me dokumente *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*, fillon me dokumente të cilat pasqyrojnë veprimtarinë e paraardhësve të Skënderbeut përkatësisht babait të tij duke përfshirë periudhën kohore prej 21 marsit të vitit 1413 e deri më 2 maj 1437 (dok. I-LXIX), të cilat japin të dhëna me interes për veprimtarinë e Gjon Kastriotit kryesisht në raport me Raguzën, duke filluar nga dhënia e qytetarisë raguzane, për të vazhduar me marrëveshje tregtare midis Gjon Kastriotit dhe tregtarëve të Raguzës; sulmet e turqve kundër Gjon Kastriotit.

Krahas tyre janë përfshirë edhe dokumente ku flitet për tregti si dhe për taksat doganore, e po ashtu përmenden edhe disa letra të dërguara nga Ragusa për Gjon Kastriotin. Informatat që na sjellin këto dokumente për veprimtarinë e Gjon Kastriotit përfundojnë me dokumentin që mban datën 2 maj 1437, me lajmin për vdekjen e tij. Në dokumentet pas vdekjes së Gjon Kastriotit e deri me kthimin e Skënderbeut në Arbëri, pasqyrohet veprimtaria e Gjon Gazullit dhe vëllezërve të tij, vazhdimi i lidhjeve dhe marrëdhënieve tregtare të Raguzës me zotërimet e Kastriotëve, në vazhden e të cilave përmendet edhe vendimi i Senatit të Raguzës që t'u jepet e drejta e qytetarisë edhe bijve të Gjon Kastriotit, përmenden edhe raste të importimit të artikujve të ndryshëm nga Ragusa në zotërimet e Kastriotëve.

Sipas tematikave, dokumentet e botuara në këtë vëllim që i referohen periudhës së Skënderbeut, i takojnë kryesisht luftërave antiosmane të Skënderbeut, qëndrimit të Raguzës, si dhe tregtisë në kohën e Skënderbeut, kur themi në kohën e Skënderbeut e kemi fjalën pas vitit 1443, pas kthimit të tij në Arbëri. Luftërat antiosmane kanë një përfshirje të gjerë në këtë përmbledhje me dokumente. Ragusa i informonte për sulmet e ushtrive osmane apo përgatitjet e tyre për të sulmuar Gjon Kastriotin,

gjithashtu Senati i Raguzës i raportonte Janosh Huniadit, për sulmin e sulltanit turk në Krujë dhe për rezistencën heroike të Skënderbeut, për pushtimin e Novobërdës, duke e informuar për veprimet e ushtrisë turke, e cila po masakronte popullsinë dhe po shkatërronte vendin. Krahas këtyre lajmeve materialet e këtij vëllimi pasqyrojnë edhe raportet mes Skënderbeut dhe Raguzës, të cilat kryesisht kishin të bënin me ndihmat (mjetet) financiare që Skënderbeu kërkonte për t'i përballuar sulmet osmane dhe për t'i përmbushur nevojat ushtarake. Krahas disa ndihmave në të holla të cilat Senati i Raguzës kishte vendosur që t'i jepte Skënderbeut për luftën antiosmane, dokumentet në fjalë përshkruajnë edhe situatën kur fuqitë e krishtera evropiane të asaj kohe e përkrahnin Skënderbeun vetëm me përgëzime të ngrohta, kurse ndihma ushtarake dhe në të holla ishin shumë të pakta.

Përveç ndihmës financiare, dokumentet në fjalë dëshmojnë edhe për forma tjera të ndihmës të ofruar nga ana e Raguzës për Skënderbeun, siç është rasti kur Raguzë shprehë gatishmërinë për të strehuar Gjergj Kastriotin dhe familjen e tij në rast rreziku nga turqit. Me interes nga ky vëllim janë edhe dokumentet ku përmenden vizitat e Skënderbeut në Raguzë, diskutimet që bëhen rreth heqjes së shpenzimeve për Skënderbeun gjatë qëndrimit të tij në Raguzë, delegacionet që caktohen për shoqërimin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut gjatë kthimit nga Pulja për në Raguzë, e shumë çështje që ndërlidhën me këto vizita dhe qëllimin e tyre. Është me interes të theksohet fakti se në këto dokumente vend meritore zënë edhe ato ku pasqyrohet fama që mori Skënderbeu si rezultat i qëndresës së tij në luftën antiosmane, Skënderbeu me qëndresën e tij quhet i ngritur përkrah Huniadit si mbrojtës i krishterimit, madje ka raste ku në dokumente hasim të dhëna kur Qeveria e Raguzës vlerëson dhe lartëson meritat e Skënderbeut në mbrojtjen e vlerave të civilizimit evropian përballë pushtimeve turko-osmane. Marrëdhëniet ekonomike midis Arbërisë së Skënderbeut dhe Republikës tregtare të Raguzës, të cilat ishin dinamike dhe shumë të hershme, përfaqësohen me një pjesë të konsiderueshme të dokumenteve në këtë vëllim. Gjatë gjithë shek. XV, Raguzë vazhdoi të importonte nga Ballkani jo vetëm minerale, por edhe drithëra, bagëti, dyllë, lesh, lëkurë dhe lëndë drusore. Republika e Raguzës, e cila kishte nevojë të vazhdueshme për prodhimet bujqësore e industriale (drithëra, perime, lëndë drusore), në të shumtën e rasteve, përveçse me vendet italiane, ato i plotësonte dhe në viset e Arbërisë. Në anën tjetër, tregtarët raguzanë, eksportonin për në Arbëri: stofra, verë, prodhime argjendarie, veshmbathje etj.

Në vëllimin me dokumente nga Arkivi i Dubrovnikut dedikuar epokës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, një pjesë e dokumenteve i dedikohen një çështjeje mjaft të rëndësishme siç është ajo e shërbimit bankar që Raguzë i ofronte Skënderbeut, ku dëshmohet për lidhje të ngushta që mbante Skënderbeu me bankat *Pazzi*, *Strozzi* dhe *Albizzi*, si dhe për tërheqjen e dukatëve nga depozitat që kishte në Raguzë. Të shumta janë edhe dokumentet lidhur me misionet diplomatike me shtetet evropiane si në kohën e Gjon Kastriotit ashtu edhe në atë të Skënderbeut. Nga ambasadorët e Gjon Kastriotit përmendet Nikollë Suma, ndërsa nga ambasadorët në kohën e Skënderbeut përmendët veprimtaria e Gjon Gazullit, Pal Gazullit, Andrea Gazulli, Andrea Suma dhe Paladino de Gondola, etj.

Kjo përmbledhje dokumentare përfundon me lajmin për vdekjen e Skënderbeut më 1468, më dokumentin që ambasadori Mantovan në Raguzë, Giovanni Francesco de Maffei, i shkruan markezit të Mantovas, më 1 mars 1468, duke e njoftuar për vdekjen Skënderbeut, që është edhe njëri nga versionet e njohura për shkakun e vdekjes së heroit tonë kombëtar. Ndonëse këto që i përmendëm janë vetëm disa nga rastet më specifike sa ju takon pasqyrimin të luftës antiosmane të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, si dhe çështjeve tjera të cilat ndërlidhën me kohën e tij.

Duke ju referuar përmbledhjes me dokumente *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*, mund të konstatojmë se libri në fjalë për nga përmbajtja, mënyra se si studiuesi i është qasur përzgjedhjes së dokumenteve, të cilat pasqyrojnë një sërë problemesh duke filluar nga aspekti politik, diplomatik, social, ekonomik, kanë vlerë dhe rëndësi të veçantë si për opinionin shkencor, ashtu edhe më gjerë, ngase janë burime të dorës së parë, të rëndësishme për Arbërinë dhe arbërorët në kohën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Andaj e themi me bindje të plotë se botimi i këtyre dokumenteve jo vetëm që ndriçon, por edhe e nderon dhe lartëson epokën dhe figurën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Teuta SHALA-PELI

Franziska A. Zaugg, *Albanische Muslime in der Waffen-SS: Von 'Großalbanien' zur Division 'Skanderbeg'*, Ferdinand Schöningh: Paderbon, 2016, f. 346.

Botimi i librit: “*Albanische Muslime in der Waffen-SS - Von 'Großalbanien' zur Division 'Skanderbeg'*”, shënon një hap të ri në histori, shkrimin e historisë shqiptare nga bota gjermanofone. Risitë shkencore të mbështetura në një hulumtim serioz arkivor të kryer nga autorja, ndihmojnë të sjellin perspektiva të reja mbi ngjarjet e tejshkruara të historisë së Luftës së Dytë Botërore tek shqiptarët. Duke filluar shtjellimin historik në mënyrë kronologjike, Zaugg së pari vendos ritmin e analizës mbi bazën e pyetjeve të cilat ajo i ngrit - gjegjësisht procedurën e rekrutimit të ushtarëve shqiptarë dhe myslimanë në njësitet SS - nga e cila pyetje rrjedhin edhe ato të tjerat që kanë të bëjnë me ndryshimet dhe ngjashmëritë mes pushtimit italian dhe atij gjerman tek shqiptarët, dhe raportet ndërmjet këtyre dy të parëve dhe shqiptarëve (f. 15). Zaugg, duke qenë e vetëdijshme që një valë historianësh kanë vënë veç themelet (madje disa do të thoshin se ia kanë vënë edhe kapakun), studimeve për njësitet jogjermane të SS, e vë atë në avantazh të saj in kur shpjegon që shumë pak studime bashkëkohore trajtojnë çështjen e dhunës dhe ekzekutimit të saj nga njësitet SS, por para së gjithash janë të kufizuara në trajtimin e përbërjes dhe natyrës ideologjike të njësiteve SS (f. 16-17).

Duke i qëndruar besnike shkollës së analeve, Zaugg bën trajtesë historike afatgjatë. Me këtë nënkuptohet se ajo merr në konsideratë edhe rrethanat sociologjike dhe ekonomike të formësimit të identitetit shqiptar në shekullin XX, këtu duke përfshirë në analizë si një preambulë historike që i parapriu pushtimit italian më 1939, edhe mbretërimin e Zogut (f. 40-46, 46-54). Pushtimi italian në Shqipëri është relevant për analizën, sepse ardhja e një fuqie imperialiste në vend mund të ketë qenë nismëtar i një varg

ngjarjesh të dhunshme që e kapluan regionin shqiptar në Luftën e Dytë Botërore. Por, ardhja e italianëve, siç analizon Zaugg, përkundër premtimit për një hap pakëz më të madh të avancimit të mirëqenies sociale dhe ekonomike dhe në përgjithësi themelimit të një shteti të mirëqenies (Wohlfahrstaats), në fakt solli të shoqëria shqiptare elemente qartazi negative dhe të padobishme (u vërejt madje një ngritje e rasteve të malaries në 50-60 përqind më shumë, f. 55). Kjo qasje mund të karakterizohet që i përket natyrës së studimeve post-koloniale në fushën e historisë. Më tutje duhet vërejtur që ndodhitë e kësaj periudhe ishin thelbësore në formësimin e marrëdhënieve shqiptaro-gjermane në katër vitet gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Por, nuk ishte vetëm ndërtimi i një shteti të mirëqenies në të cilën dështuan italianët, por edhe në rekrutimin e suksesshëm të luftëtarëve vendas brenda radhëve të milicëve në ndihmë të karabinierëve (në ushtrinë e rregullt shërbyen diku 12 000 shqiptarë, ndërkaq në karabinieri 2 500, f. 57). Meqë studimi i rekrutimit dhe themelimit është prapavijë e përhershme e tematikës bosht të Zaugg, ajo arrin ta analizojë atë duke përfshirë në trajtesën e saj burime arkivore pak të qasshme për historianët vendas, të cilët janë marrë me studimin e SS Skënderbeut.

Por, përkundër historianëve të tjerë, Zaugg nuk e kufizon studimin e saj vetëm tek shqiptarët, por e zgjeron këtë gamë duke i përfshirë edhe myslimanët e tjerë të rajonit. Pse e bën këtë, i qartësohet lexuesit në faqet brenda librit, dhe madje e shpjegon në mënyrë të detajshme qasjen e oficerëve gjermanë ndaj myslimanëve dhe vegëlsimin e ideologjive të tyre fetare dhe etnike për t'i vënë në funksion të interesave ushtarake gjermane në Ballkan (f. 194-240). Në këtë kontekst, e udhëhequr nga burimet arkivore, Zaugg i trajton njësitet myslimane SS si koncepte ushtarake të krijuara njëtrajtshëm nga oficerët gjermanë, dhe me këtë i qëndron besnike koncepteve historike. Analiza e saj përfshinë kontekstin kulturor, shoqëror dhe politik të formimit të Divizionit SS Skënderbeu.

Ajo çka është tejetkarakteristike për hulumtimin e Zaugg, është fakti që sjell në pah të reja historike edhe sa i përket debateve ndërmjet oficerëve gjermanë për themelimin e Divizionit SS Skënderbeu. Në këtë vazhdë, Zaugg e nxjerr argumentin që prejardhja e divizionit dhe etapat e formimit të tij ishin komplekse. E vë në pah edhe rëndësinë që kishte Julius Kaesdorf për të bindur oficerët gjermanë se si do të mund të funksiononte një Divizion shqiptar SS në mënyrë hipotetike. Është karakteristike që sipas Kaesdorf, në mënyrë që shqiptarët të merrnin urdhra nga një jomysliman, do të duhej që udhëheqësi të paktën të ofronte një ndjesi të bashkësisë, ose përkitjes të

një vëllazërie (si vëllezër gjaku - Blutsbrüderschaft), dhe se, duke parafrazuar, shqiptarët do ta shihnin udhëheqësin jo mysliman si të huaj dhe si të tillë do ta kundërshtonin (f. 225, 226). Këtu vihen në pah dy aspekte kryesore të cilat Zaugg i trajton përgjatë librit të saj: ipari është fakti që shqiptarët - posaçërisht ata të Kosovës - duket të jenë perceptuar nga gjermanët si një grup myslimanësh fanatikë ku, në një formë a tjetër, traditat e tyre konservatore janë përputhur me dogmat islame; dhe e dyta se, themelimi i Divizionit SS në troje të populluara me myslimanë, paraqitej të ishte një nismë e vështirë për oficerët gjermanë me të cilët vendasit nuk përputheshin shumë në kontekstin kulturor, e as në atë fetar.

Në po të njëjtin referat të cilin Julius Kaesdorf e kishte përpiluar për përvojat me ushtarët shqiptarë, ai e thekson fuqishëm rëndësinë e vendosjes së një udhëheqësi në krye të njësitit të cilit shqiptarët do të mund t'i besonin, sepse përndryshe hierarkia e urdhrave nuk do të funksiononte (f. 226).

Në anën tjetër, edhe Phleps kishte shkruar se vetë mungesa e gjermanishtfolësve paraqiste një problem pothuajse të pakapërcyeshëm në hapat e themelimit të divizionit (f. 227). Në anën tjetër, burimet arkivore të vjela nga Zaugg, tregojnë se edhe rekrutët potencialë ishin të vetëdijshëm për drejtimin që po merrte lufta në disfavor të gjermanëve (f. 228). Një temë e njohur për studiuesit që merren me këtë periudhë të cilën e trajton edhe Zaugg, është strategjiagjermane e përfshirjes së bandave nacionaliste në luftë përkrah gjermanëve. Kjo vjen si pasojë e përparësisë që kishin ata në njohjen e terrenit lokal - por edhe kryesisht si pasojë e interesit të përbashkët për t'i luftuar partizanët - të cilat sipas Schmidhuberit, që nga tetori i vitit 1944 i kishin shkatërruar fshatrat e tyre (f. 232). Megjithatë, edhe kjo nismë dështoi siç e vë në pah shefi i shtabit të armatës së 21-të, Franz von Klocke, i cili nga bandat nacionaliste priste shumë në ofensivën "Fuchsjagd", por e cila në luftë kundër komunistëve nuk pati sukses (f. 233).

Zaugg, i vë shumë theks korrespondencave ushtarake rreth taktikave të përfshirjes së grupacioneve të huaja si njësi ndihmëse në luftë kundër komunistëve, duke i dhënë atyre në shkëmbim armë dhe municion, madje duke e vënë në pah edhe faktin që pasidështuan pjesërisht me organizimin e bandave nacionaliste shqiptare, gjermanët u vunë në bashkëpunim me çetniket. Zaugg nuk e len pa theksuar që të gjithë 500 çetnikë që u përfshinë në njësitet e luftimit për gjermanët patën reagim plotësisht negativ si pasojë e sentimenteve kombëtare të lënduara duke luftuar krah për krah me shqiptarët (f. 234). Një aspekt që nuk është diskutuar deri më tash në literaturën lokale (si pasojë e mungesës së burimeve arkivore), prek çështje teknike të organizimit të divizionit. Kjo konkretisht ka të bëjë me sigurimin

e municionit për secilin rekrut, të cilat fillimisht i bije të kenë qenë së paku 145 plumba për secilin ushtar (që për ushtrinë gjermane paraqet municion skajshmërisht të vogël për të zhvilluar luftë të mirëfilltë), dhe problemin serioz të transportimit të municionit në mungesë të rrugëve adekuate në terren (f. 236), një situatë që e shtyu Kokalarintë marrë hua municion nga serbët, të cilat më pastaj ia dërgoi përmes mushkave Kremplerit dhe grupit të tij. Kjo i kishte irrituar gjermanët tejmasë meqë kishte mungesë të municionit për grupet ushtarake gjermane në Kosovë, e ishte përshtypja që shqiptarët gjuanin “në qiell plumba më kot”, siç rrëfëhet Schmidhuberi. (f. 237). Por, nuk ishte vetëm mungesa e municionit ajo që e solli dështimine divizionit, por edhe mungesa e mjeteve teknike, ilaçeve, uniformës adekuate dhe ushqimit (f. 238-239).

Kapitulli i shtatë i librit trajton më në detaje formimin dhe operacionet e Divizionit SS Skënderbeu. Në hyrje, Zaugg ka përzgjedhur një shkëputje të raportit të Maximilian von Weichs (shef i Grupit F), në të cilën flet për luftën që kishin zhvilluar gjermanët në Ballkan, dhe për të cilin, kjo luftë nuk ishte “luftë e vogël” (në kuptimin e luftës guerile), po luftë kaotike që po zhvillohej si vazhdim i hasmërive qindravjeçare të popujve vendas të kësaj zonë (f. 249). Siç e sqaron në vijim, Zaugg ka përzgjedhur këtë shkëputje, ngaqë ajo flet në thelb për problematikën e luftës ndëretnike që definoi natyrën e Luftës së Dytë Botërore në Ballkan (f. 250).

Faqet në vijim japin detaje arkivore për aeroportet e kontrolluara nga SS Skënderbeu dhe oficerët përgjegjës në Shqipërinë e Re, dhe tentativat e divizionit për të vënë kontroll mbi minierat e kromit në Gjakovë (f. 252-253). Zaugg prek edhe çështjen e arrestimeve të hebrenjve, komunistëve dhe “armiqve të tjerë”, dhe nga burimet arkivore gjermane, si të tjerë studiues, nxjerr shifrën e 510 të arrestuarve që ishin dërguar në burgun e Prishtinës, nga të cilët 249 ishin dërguar në Gjermani për “të kryer punë të detyrueshme” (f. 255).

Burgu i Prishtinës është gjithashtu relevant, sepse njësitet gjermane e shndërruan në burg të përqendrimit - Konzentrationslager (KZ), nën udhëheqjen e një oficeri me mbiemrin Otter (f. 256). Për gjermanët u paraqit problemi që burgu u shndërrua në arenë për larjen e inateve ndëretnike (f. 257), ngaqë numri më i madh i të arrestuarve si komunistë, ishin sllavë. Në faqet në vijim, Zaugg flet për organizimin e luftës kundër partizanëve, këtu duke përmendur detaje për ofensivën “Junikäfer”, “Falkenauge”, “Draufgänger”, “Fuchsjagd” dhe “Rübezahl” (f. 268-268). Ndërkaq, dy nënkapitujt në vijim flasin për zvogëlimin e divizionit dhe shndërrimit nga

divizioni në grup luftues, dhe përfundimisht në dezertimet në masë nga ana e shqiptarëve (f. 272-283).

Pjesa e tretë e librit i kushtohet një historiku të studimeve shqiptare nga bota gjermanofone, duke përmendur këtu qëndrimet e studiuesve mbi tezat kryesore të prejardhjes së shqiptarëve dhe vazhdimësisë iliro-shqiptare (f. 293-298). Një qasje tejet interesante jep Zaugg edhe në vijim, ku flet për librin e Karl May (Durch das Land der Skipetaren) dhe ndikimin që e pati ky roman në formimin e opinionit të përgjithshëm gjerman për shqiptarët, dhe në përgjithësi rreth vendit që i takonte shqiptarëve në ndarjen Perëndim-Lindje, këtu sërish duke vërtetuar që Zaugg përvetëson qasjen post-koloniale.

Zaugg më tutje e tërheq paralelin ku i krahason njohuritë e Karl May për këtë vend të skajshëm të Evropës të njëjta me ato të Schmidhuberit në tetor të 1944 - pra që përfundimisht, botëkuptimi i gjermanëve për shqiptarët dhe territoret e tyre kishte mbetur i kufizuar (f. 300-301). Zaugg e ngreh këtu hipotezën se është pikërisht kjo përshtypje e gjermanëve për shqiptarët si popull luftarak dhe me karakter të fortë që i kishte shërbyer idesë së formimit të Divizionit SS shqiptar (f. 301). Reputacionin e shqiptarit si luftëtar i madh, Zaugg e trajton edhe në nënkapitullin vijues, ku flet për këtë identitet të konstruktuar në diskurset bashkëkohore të studimeve historike (f. 303-307).

Ndërkaq, përmes vëzhgimeve arkivore, Zaugg e hedh poshtë këtë konstrukt identiteti, ngaqë sipas dokumenteve dhe korrespondencave ushtarake, shqiptarët e Divizionit SS nuk kallëzuan guxim, por e shfaqën të kundërtën (f. 307-310). Në përfundim, Zaugg flet për rëndësinë e Divizionit SS Skënderbeu në kontekst politik dhe historik, dhe ajo përkritazi nuk e trajton atë si projekt ushtarak me karakter fetar, por përkundrazi si një produkt përfundimtar që e përmbloodhi ndërlikueshmërinë e situatës në të cilën u gjendën gjermanët në raport me shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (f. 313-316). Mirëpo, përtej çështjeve praktike të themelimit dhe veprimit të Divizionit SS, Zaugg e hedh në shesh një vëzhgim tjetër teorik që paraqet rëndësi të theksuar për studimet historike bashkëkohore - gjegjësisht, ajo flet për konceptin e “hapësirës së dhunës” dhe rishikimin e historisë brenda këtyre kornizave, ndërkaq më tutje e shtron mundësinë e studimit të kësaj “vije të dhunës” në mënyrë të gjatë kohore deri në vitet e ‘90 të shekullit të kaluar.

Në përgjithësi, libri i Zaugg sjell një frymë të re në studimet shqiptare të botës gjermanofone, edhe pse e trajton një temë kontroverse që sjell debate të vazhdueshme në hapësirat e opinionit publik shqiptar. Zaugg,

në fakt, ka arritur që t'i tejpërshkojë këto kufij të shablloneve dhe etiketimeve historike, duke ndërtuar më tepër mbi hipotezën e studimit të Divizionit SS Skënderbeu si produkt i “hapësirës së dhunës”, dhe jo të kundërtën.

Mrika LIMANI-MYRTAJ

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË GJATË VITIT 2018

I. Aktivitetet shkencore

Gjatë vitit 2018 Instituti i Historisë “*Ali Hadri*”-Prishtinë, në bashkëpunim me institucionet tjera shkencore në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, arriti që të organizojë pesë konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, duke shënuar ngjarje dhe përvjetorë të rëndësishëm, të cilat ndërlidhën me historinë e popullit tonë. Si rezultat i kësaj pune, Instituti i Historisë “*Ali Hadri*”-Prishtinë, gjatë këtij viti arriti që t’i shënojë këto jubile të rëndësishme: *20-vjetorin e luftës së familjes Jashari, 100-vjetorin e themelimit të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, 140-vjetorin e themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 550-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, si dhe 50-vjetorin e Demonstratave të vitit 1968.*

1. Konferenca shkencore: “JASHARAJT DHE LUFTA ÇLIRIMTARE”

Më 6 mars të vitit 2018, Instituti i Historisë “*Ali Hadri*”-Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë-Tiranë dhe ITSHKSH-Shkup, organizuan Konferencën shkencore: *Jasharajt dhe lufta çlirimtare*, me rastin e 20-vjetorit të luftës së familjes Jashari. Fjalën e hapjes e mbajti prof. asoc. dr. Sabit Sylja, drejtor i Institutit të Historisë “*Ali Hadri*”. Me fjalë rasti punimet e Konferencës i përshëndeti Jahja Lluka, këshilltar i kryeministrit z. Ramush Haradinaj. Në këtë Konferencë u lexuan këto kumtesa: Jakup Krasniqi, *Kontributi i Jasharajve të Prekazit në luftën çlirimtare të Kosovës, (1991-1999)*; Marenglen Verli, *Jasharajt produkt i një vatre patriotike*; Paskal Milo, *UÇK-ja në agjendën diplomatike të Shqipërisë, në pranverë 1998*; Anna Di Lellio, *Motivimi i luftës së*

Jasharajve përmes tregimit të ngjarjes; Beqir Meta, Lufta e Kosovës në kancelaritë perëndimore dhe vendin që zë familja Jashari në këtë luftë; Ramë Buja, Rrugëtimi i Kosovës për liri, pavarësi dhe shtetndërtim; Sabile Keçmezi-Basha, Qëndresa e grave të familjes Jashari, 1998; Skënder Asani & Isak Sherifi, Adem Jashari në kujtesën e bashkëveprimtarëve nga trojet shqiptare të Maqedonisë; Hysen Matoshi, Adem Jashari ndërmjet legjendës dhe historisë; Bujar Dugolli, Universiteti i Prishtinës dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës; Kamil Bitiş, Aktiviteti i shqiptarëve të Turqisë për çështjen e Kosovës; Nuri Bexheti, Kujtime nga ushtrimet ushtarake në Shqipëri; Hamit Kaba, Politika amerikane dhe ligjshmëria e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë; Sabit Syla, Dimensioni historik i familjes Jashari; Ibrahim Gashi, Lufta e Kosovës, realpolitikë e sendërtimit të idesë së shtetit të pavarur; Bekir Yüksel Hoş, Faktorët dinamikë në rrugën e pavarësisë së Kosovës; Qerim Lita, Njësitë e para ushtarake në trevat lindore shqiptare dhe roli i Adem Jasharit, 1990-1993; Hakif Bajrami, Shkolla kombëtare e Prekazit deri në pavarësi (Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Adrian Krasniqi); Proletar Hasani & Marenglen Kasmi, Ndhimesa e ushtrisë shqiptare në organizimin dhe përgatitjen e forcave çlirimtare të Kosovës; Afrim Krasniqi, Evoluimi i qëndrimeve të partive politike në Shqipëri ndaj rezistencës në Kosovë dhe ndikimi në to i ngjarjeve të vitit 1998; Sevdail Demiri, Qëndrimet në Maqedoni për marsin e vitit 1998 në Kosovë; Mrika Limani, UÇK-ja në kontekst të luftërave guerile të shekullit XX; Myrvete Dreshaj, Shëmbëlltyra e familjes Jashari në poezinë shqipe; Adem Zejnullahu, Figura e Adem Jashari në këngët popullore. Fjalën e mbylljes në këtë Konferencë e mbajti akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë-Tiranë. Më 7 mars 2018, u organizua vizitë te Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, në Prekaz.

2. Konferenca shkencore: “KOMITETI “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS” DHE KOHA E TIJ”

Instituti i Historisë-Tiranë në bashkëpunim me Institutin e Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë dhe ITSHKSH-Shkup, organizuan më 2 maj 2018, në Tiranë, Konferencën shkencore: *Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” dhe koha e tij*, me rastin e 100-vjetorit të themelimit të këtij Komiteti. Fjalën e hapjes e mbajti akademik Marenglen Verli, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Në këtë Konferencë me kumtesa u paraqitën këta studiues: Marenglen Verli, *Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" - refleksion*; Sabit Sylja, *Trajtimi i Lëvizjes Çlirimtare (Kaçake) dhe Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" në historiografinë shqiptare*; Ledia Dushku, *Konteksti historik i krijimit të Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës"*; Gazmend Shpuza, *Sali Nivica, anëtar i Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës"*; Qerim Lita, *Burimet policore jugosllave rreth veprimtarisë së Lëvizjes Kaçake, 1919-1922*; Lush Culaj, *Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" dhe Paqja e Versajës*; Sabile Keçmezi-Basha, *Karakteret kombëtar i programeve të Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës"*; Ibrahim Gashi, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në dritën e burimeve diplomatike serbe 1918-1928*; Halim Purellku, *Aksionet e armatosura të çetave guerile/kaçake në trevat lindore shqiptare (1919-1925)*; Skënder Asani & Sevdail Demiri, *Bashkëveprimi dhe koordinimi mes krerëve të Xhemijetit dhe Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës"*; Sali Kadria, *Zhvillimet brenda nacionalizmit shqiptar në vitet 1920-1921*; Beqir Meta, *Implikimet ndërkombëtare të veprimtarisë së Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" në vitet 1921-1924*; Albana Mema, *Marrëdhëniet mes Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" dhe qeverive shqiptare gjatë viteve 1921-1924*; Fatmira Musaj, *Raportet e Ahmet Zogut dhe Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" në vitet 1924-1925*; Fatmira Rama, *Pikëpamjet e Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" dhe revista "Federata Ballkanike"*; Liman Rushiti, *Organizimi i luftës çlirimtare nga ana e Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" dhe udhëheqja e krahut ushtarak*; Skënder Lutfiu, *Ndikimi i Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Fjalën e mbylljes e mbajti akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë-Tiranë.*

3. Konferenca shkencore: "LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT"

Më 10 qershor të vitit 2018, Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë në bashkëpunim me Instituti i Historisë-Tiranë dhe ITSHKSH-Shkup, nën patronatin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, organizuan në Sallën e Kuvendit Komunal në Prizren, Konferencën shkencore: *Lidhja Shqiptare e*

Prizrenit, në 140-vjetorin e themelimit. Fjalën e hapjes e mbajti prof. asoc. dr. Gjon Berisha, u.d. i drejtorit të Institutit të Historisë-Prishtinë.

Me fjalë rasti punimet e Konferencës i përshëndeti, Jahja Lluka, këshilltar i kryeministrit z. Ramush Haradinaj, akademik Marenglen Verli, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike si dhe prof. dr. Skënder Asani, drejtor i ITSHKSH. Në këtë Konferencë u lexuan këto kumtesa: Beqir Meta, *Profili i nacionalizmit shqiptar në foshnjërinë e tij: shqiptarët në betejat për mbrojtjen e Plavës e Gucisë (dhjetor 1879-1880)*; Paskal Milo, *Thelbi evropian i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*; Marenglen Verli, *Çështja shqiptare në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe qëndrimet e Austro-Hungarisë dhe Italisë*; Skënder Asani & Isak Sherifi, *Jashar Bej Shkupi në burimet e kohës*; Gazmend Shpuza, *Pashko Vasa - shkodrani në Lidhjen e Prizrenit*; Fehari Ramadani, Fati Iseni, *Aspekte të veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në kazanë e Tetovës*; Nail Draga, *Ulqini dhe Ymer Prizreni*; Hakif Bajrami, *Ymer Prizreni dhe Vaso Pashë Shkodrani, promotor i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*; Gjon Berisha, *Argjipeshkvia e Tivarit dhe çështja "Primas Serbiae" pas Kongresit të Berlinit*; Parim Kosova, *Arrestimet, burgosjet, internimet dhe dënimet e veprimtarëve të Lidhjes së Prizrenit nga ana e Perandorisë Osmane*; Fatmir Sulejmani, *Lidhja e Prizrenit dhe beteja e Konicës për jetësimin e saj*; Nebi Dervishi, *Trevat lindore në LSHP 1878-1881 në dokumentet anglo-franceze*; Besnik Emini, *Sheh Mustafë Tetova në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*; Shemsi Ajvazi, *Korrelacioni i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me Pavarësinë e Kosovës: Qëndrimi i historiografisë më të re ruse*; Iljaz Rexha, *Programi i Parë i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*; Zeqirja Rexhepi, *Raportet midis Fuqive të Mëdha dhe ndikimi i tyre në Lidhjen e Prizrenit*; Selver Islamaj, *Raportet e konsullit austro-hungarez në Prizren 1878-1881*; Albнора Musa, *Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit në raportet konsullore të huaja*; Hiri Ziberi, *Disa aspekte të traditës popullore shqiptare në Lidhjen e Prizrenit*; Edmond Malaj, *Situata social-kulturore dhe politike gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit*; Sali Kadria, *Mbrojtja e Plavës dhe Gucisë - Kalimi i Lidhjes së Prizrenit nga diskursi politik në qëndresën e armatosur*; Ardian Muhaj, *Rilindje mes dhimbjesh. Dobësi dhe defaktorizimi i shqiptarëve në Ballkan nga pashallëqet autonomiste tek Lidhja e Prizrenit*; Anelmo Spahija, *Komiteti Ndërkrahinor i Shkodrës*; Eduart Caka, *Lidhja e Prizrenit dhe formësimi i identitetit shqiptar brenda Perandorisë Osmane*; Paulin Marku, *Politika e Italisë ndaj çështjes shqiptare që prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit deri në pavarësinë e Shqipërisë*; Nexhat Çoçaj, *Kontributi i hasjanëve në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*; Agron Islami, *Politikat përafruese të Abdylhamitit II karshi shqiptarëve*; Rezehana Hysa, *Programi*

politik dhe arsimor i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; Shkodran Imeraj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit në botimet dhe periodikun e Institutit të Historisë së Kosovës; Adem Ademi, Kush pësoi pas qershorit 1878.

Fjala e mbylljes e mbajti akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë-Tiranë.

4. Konferenca shkencore: “GJERGJ KASTRIOTI-SKËNDERBEU NË 550-VJETORIN E VDEKJES”

Më 16 tetor të vitit 2018, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë në bashkëpunim me Institutin e Historisë-Tiranë dhe ITSHKSH-Shkup, nën patronatin e Qeveris së Republikës së Kosovës, organizuan në Prishtinë, Konferencën shkencore ndërkombëtare: *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes*. Fjalën e hapjes e mbajti prof. asoc. dr. Sabit Syla, drejtor i Institutit të Historisë “Ali Hadri”. Me fjalë rasti punimet e Konferencës i përshëndeten: ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqiri Bytyqi; z. Jahja Lluka, këshilltar i kryeministrit z. Ramush Haradinaj; akademik Marenglen Verli, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike të Shqipërisë; dr. Skender Asani, drejtor i ITSHKSH-Shkup; si dhe Don Lush Gjergji, përfaqësues i Kishës Katolike të Kosovës, Dioqezës së re, Prizren-Prishtinë.

Në Konferencën kushtuara 550-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, u prezantuan këto kumtesa: Pranvera Bogdani, *Balshajt dhe Kosova*; Jakup Krasniqi, *Porosia e fundit e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe vlerat e saj për kohën tonë*; Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe pozicioni Modus Vivendi i Republikës së Raguzës*; Muhamet Mala, *Arti luftarak dhe karakteri kombëtar dhe fetare i luftës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*; Tamás Pálosfalvi, *Janosh Huniadi i lutet Perëndisë në Kishën e Janjevës*; Ksenofon Krisaf, *Politika e jashtme dhe diplomacia e Skënderbeut*; Qerim Dalipi & Besim Morina, *Rrethanat socio-etnike në nahijen e Tetovës, sipas regjistrimit të viteve 1467-1468*; Antal Molnár, *Kujtimi i Skënderbeut dhe fillimi i ndërtimit të kombit shqiptaro-katolik*; János Szabó, *Kusarët në Hungari - një përhapje ushtarake mesjetare nga Ballkani Perëndimor në lindje të Evropës Qendrore*; Teuta Shala-Peli, *Përpyjekjet për çlirimin e Drishtit nga sundimi venedikas në kohën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut*; Eduart Caka, *Aspekte të situatës politiko-ekonomike të hapësirës shqiptare gjatë shek. XV, bazuar në regjistrat kadastrale osmane të kësaj periudhe*; Etleva Lala & Musa Ahmeti, *Beteja e Dytë e Kosovës në burimet arkivore hungareze*; Krisztián Csaplár, *Si u shfaq Janosh Huniadi në historiografinë shqiptare (1896)?*; Dénes Sokcsevits, *Skënderbeu dhe Huniadi në letërsinë*

kroate; Ștefan Andreescu, *Prania e rumunëve gjatë Betejës së Dytë të Kosovës*; Evalda Paci, *Vepra e Marin Barletit në pikëpamje vëzhgimesh ndërdisiplinore. Interpretime e hollësi studimore rreth një ndërmarrjeje lapidare*; Mirie Rushani, *Gjeografia politike e Evropës në shek. XV dhe ideja për mbrojtje të përbashkët nga invazioni turk*; Adem Bunguri, *Të dhëna të reja arkeologjike mbi disa fortifikime të panjohura të Skënderbeut në rajonin e Dibrës*; Bedri Muhadri, *Beteja e Dytë e Kosovës sipas biografëve shqiptarë: Marin Barletit, Anonimi i Tivarit, Dhimitër Frangu dhe Gjenealogjia e Muzakajve*; Myrvete Dreshaj-Baliu & Begzad Baliu, *Skënderbeu dhe koha e tij në letërsinë botërore*; Enver Rexha, *Historiografia serbe për Betejën e Dytë të Kosovës, 1448*; Muhamet Bela, *A ishte Skënderbeu nga Hasi? (Mendime rreth origjinës së Skënderbeut)*; Dominik Qerimi, *Marrëdhëniet e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Selinë e Shenjtë, klerin dhe Kishën Katolike*.

Fjala e mbylljes e mbajti akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë-Tiranë.

5. Konferenca shkencore: “DEMONSTRATAT E VITIT 1968”

Më 26 nëntor 2018 Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, në bashkëpunim me Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Institutin Albanologjik-Prishtinë, organizuan Konferencën shkencore: *Demonstratat e vitit 1968*. Në këtë Konferencë fjalën e mirëseardhjes e mbajti Hydajet Hyseni, fjalë përshëndetëse mbajti prof. dr. Marjan Dema, rektor i Universitetit të Prishtinës, ndërsa fjalën e hapjes e mbajti prof. dr. Zymer U. Neziri. Në Konferencë kushtuar 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968, u lexuan këto kumtesa: Hydajet Hyseni, *Gjashtëdhjeteteta shqiptare - pjesë autentike e Pranverës Evropiane '68*; Selatin Novosella, *Viti 1968 - vit i kthesës së madhe historike*; Abdullah Zymberi, *Efektet e Lëvizjes së vitit 1968 në botë dhe në Kosovë*; Arben Arifi, *Demonstratat e vitit 1968 në botë dhe refleksionet në zhvillimet e vitit '68 në Kosovë*; Arben Hoxha, *Vëllimet politike në Evropën e fundviteve '60 dhe demonstratat në Kosovë*; Dilaver Goxhaj (Shpëtim Golemi), *Demonstratat e vitit 1968 ishin përshëndritja e vetëdijes së shqiptarëve*; Fatmir Arifi, *Ndikimi i Adem Demaçit në Demonstratat e vitit 1968*; Hasan Ukëhaxhaj, *Rreth disa mendimeve të Ukshin Hotit për vitin 1968*; Haxhi Ademi, *Ndikimi i Demonstratave të vitit 1968 në avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Kosovë*; Hysen Matoshi, *Kontributi socio-kulturor i Demonstratave të vitit 1968*; Memli Krasniqi, *J. B. Tito dhe statusi i Kosovës 1968-1974*; Muhamet Rogova, *50-vjetori i Demonstratave më 1968 dhe Republika e Kosovës sot*;

Nebih Jashari, *Gjenerata e vitit 1968 sot*; Rifat Blaku, *Dimenzioni antikolonial i Demonstratave më 1968*; Kudusi Lama, *Një vështrim gjeopolitik mbi Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë*; Qerim Lita, *Demonstratat e vitit 1968 të Tetovës në dokumente*; Sabit Syla, *Reflektimi i Demonstratave të vitit 1968 në diplomacinë e shtetit shqiptar*; Somanta Rose Simpson, *Një çrregullim i ngjashëm? Demonstratat në Kosovë dhe në Irlandë*; Zeliqe Shala, *Qëndrimi i Komitetit të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë për Kosovë ndaj Demonstratave të vitit 1968*; Binak Ulaj, *Jehona e Demonstratave të vitit 1968 dhe solidarizimi i shqiptarëve të Plavës e të Gucisë*; Irfan Shaqiri, *Dëshmi historike për Demonstratat e 27 nëntorit 1968 në Gjilan*; Ismail Gashi, *50-vjetori i Demonstratave më 1968 në Kosovë dhe kontributi i veprimtarëve të Lipjanit me rrethinë*; Mehmet Bardhi, *Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë: pjesëmarrja dhe jehona e tyre te shqiptarët në trojet e veta, sot në Malin e Zi*; Muharrem Musliu, *Situata në Prishtinë më 1968 dhe Demonstratat e 27 nëntorit*; Nehat Selimi & Selver Bekteshi, *Ngritja e flamurit kombëtar në Llopat të Kumanovës, më 28 Nëntor 1968*; Ramadan Blakaj, *Peja më 1968 dhe Demonstratat e 19 tetorit*; Rexhep Ferizi, *Demonstratat e vitit 1968 dhe kontributi i Shkollës Normale të Pejës*; Rexhep Hasani, *Roli i rinisë në Demonstratat e vitit '68 në Tetovë*; Sabit Syla, *Evokim kujtimesh për Brezin '68 të Llapit*; Skënder Lutfiu, *Demonstrata e 27 nëntorit 1968 në Ferizaj*; Ukë Thaçi, *50-vjetori i Demonstratave në Therandë, më 8 tetor 1968*.

Fjalën e mbylljes e mbajti prof. dr. Hakif Bajrami.

II. Veprimtaria botuese:

Gjatë vitit 2018 Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, në kuadër të veprimtarisë botuese nxori këto vëllime:

1. Teuta Shala-Peli, *Days of the proud pain* (Ditët e dhembjes krenare), Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 179 f. Thelbi i trajtimit të temës në këtë monografi është masakra e 14 majit 1999, në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq, masakra këto të cilat lanë gjurmë të pashlyera të dhembjes dhe të trishtimit në kujtesën e të gjithë atyre që e përjetuan. Libri *Ditët e dhembjes krenare*, prezanton një pjesë të historisë më të re të Kosovës, e cila fatkeqësisht karakterizohet me dhunë, vrasje, masakrime, dëbime, kidnapime e forma të tjera të dhunës, nga forcat serbe në prag të shekullit XXI.

2. Sabile Keçmezi-Basha, *Ballafaqimi me dëshmitë historike*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 590 f. Ky libër përfshinë punime të

cilat autorja i ka botuar në gazeta të ndryshme si dhe në revista shkencore që përfshinë periudhën kohore 2012-2018.

3. Sabile Keçmezi-Basha, *Ngjarje, dëshmitë dhe identiteti kombëtar*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 561 f. Ky libër përfshinë punimet që autorja i ka botuar në revista, periodik dhe gazeta të kohës. Gjithashtu, në këtë libër janë përfshi edhe vështrimet e recensionet e ndryshme që autorja i ka shkruar për librat e historianëve të tjerë, por edhe vështrime të historianëve që i kanë shkruar për librat e botuara të prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha.

4. Sabile Keçmezi-Basha, *Procesi gjyqësor i Prizrenit, 1946 (Dokument)*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 701 f. Ky libër ka për objekt studimi procesin gjyqësor të Prizrenit, të vitit 1946. Libri është i ndarë në pesë kapituj, ku janë përfshirë procesverbalet nga procesi i gjykimit të anëtarëve të Organizatës Ilegale Nacional Demokratike Shqiptare, pastaj ankesat e të dënuarve si dhe aktgjykimet.

5. Marenglen Verli, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (shtator 1878-nëntor 1879)*, vëllimi II, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 684 f. Ky vëllim me dokumente përfshinë dokumentet nga fundi i shtatorit 1878 deri në fund të nëntorit 1879, duke na ofruar informata për sfidat me të cilat u përball Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Gjithashtu, dokumentet e botuara në këtë vëllim na ofrojnë të dhëna edhe për raportet mes Lidhjes së Prizrenit dhe shtetit osman, si dhe me shtetet fqinje.

6. Beqir Meta, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (dhjetor 1879-qershor 1880)*, vëllimi III, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 856 f. Në këtë vëllim janë përfshi dokumentet nga fillimi i dhjetorit 1879 deri më 30 qershor 1880. Dokumentet e këtij vëllimi na njoftojnë për qëndrimin e diplomacisë vjeneze ndaj çështjes shqiptare, për qëndrimin e Fuqive të tjera të Mëdha, për përpjekjet e mëdha që bëri Lidhja Shqiptare dhe shqiptarët e veriut për të mbrojtur territoret kombëtare si dhe për raportet e Lidhjes Shqiptare me Qeverinë osmane.

7. Jusuf Osmani, *Djaloshi me shikim lirie, Ahmet Alush Pantina*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 300 f. Ky libër i kushtohet dëshmorit Ahmet Pantina. Aty paraqitet sakrifica dhe kontributi i dëshmorit të kombit Ahmet Pantina për lirinë e Kosovës.

8. Jakup Krasniqi, *Skënderbeu dhe porositë për shekullin XXI*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 288 f. Tema bosht e librit janë komentimet e fjalimeve të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Në këtë libër autori ka bërë përpjekje që vizioni historik i Skënderbeut për shtetin t’u

shërbejë gjeneratave të shekullit tonë dhe shekujve në vazhdim, dhe ta përdorin si mësuese jete për të ardhmen e kombit.

9. *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut (dokumente)*, për të cilin vëllim hulumtoi dhe përgatiti, Gjon Berisha, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 433 f. Ky botim përfshinë harkun kohor prej viteve ‘30 të shekullit XV deri në vitin 1468. Të dhënat që na ofrojnë këto dokumente fillojnë me kryengritjet e Gjon Kastriotit në pranverën e vitit 1430, me shpërthimin e kryengritjeve në viset e tjera të Arbërisë, për të vazhduar me periudhën e Skënderbeut, dhe përfundojnë me lajmin për vdekjen e tij 1468. Dokumentet e botuara në këtë vëllim, grupohen në tri kategori: dokumentet për paraardhësit e Skënderbeut, dokumente për tregtinë në kohën e Skënderbeut si dhe dokumentet për luftërat antiosmane të Skënderbeut dhe qëndrimin e Raguzës.

10. *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, Arkivat Kombëtare Britanikë*, hulumtoi dhe përgatiti, Hamit Kaba & Sabit Syla, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2018, 532 f. Ky vëllim përmban dokumente që i takojnë harkut kohor nëntor 1940 - maj 1945 dhe përqendrohen në këto tematika kryesore: pozicioni i shqiptarëve në kuadër të Luftës së Dytë Botërore; diskutimet mbi të ardhmen e Shqipërisë si shtet i pavarur e sovran, apo në kuadër të një federate/konfederate ballkanike; çështja e kufirit shqiptaro-grek dhe shqiptaro-jugosllav; çështja e të ardhmes së shqiptarëve të Kosovës dhe viseve Lindore, të cilët ishin bashkuar me Shqipërinë londineze etj.

Dokumentet e ofruara janë korrespondenca ndërmjet Misionit Ushtarak Britanik në Shqipëri dhe Shtabit të Forcave Aleate në Itali, ndërmjet këtij të fundit dhe Ministrisë së Jashtme britanike, studime të FO dhe Institutit Mbretëror të Studimeve Ndërkombëtare mbi të ardhmen e Shqipërisë dhe territoreve që iu bashkuan asaj në vitin 1941, korrespondenca ndërmjet BLO-ve dhe OSS [Office of Strategic Services-Zyra e Shërbimeve Strategjike] së Shteteve të Bashkuara, por ka edhe shumë direktiva, instruksione vështime dhe analiza që FO ua ka përcjellë përfaqësuesve të vet për Ballkanin e Shqipërinë. Vend me interes në këtë përmbledhje zënë edhe korrespondencat midis FO dhe Departamentit të Shtetit lidhur me zhvillimet politike dhe ushtarake në Shqipëri. Në këtë përmbledhje një vend të konsiderueshëm zë Kosova. Interesi i Aleatëve për Kosovën shtohet sidomos në vitin 1944. E ardhmja e saj brenda apo jashtë Shqipërisë gjen vend në disa dokumente.

III. Promovimet:

Më 25 shtator të vitit 2018 Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, organizoi promovimin e librit *Djaloshi me shikim lirie, Ahmet Alush Pantina*, të autorit Jusuf Osmani. Në këtë promovim, për vlerën, rëndësisë dhe përmbajtjen e librit, folën: kryeredaktori i librit, njëherësh drejtor i Institutit të Historisë, prof. assoc. dr. Sabit Syla, pastaj recensentët e librit: dr. Nuri Behxheti, prof. dr. Ibrahim Gashi, prof. dr. Sali Bashota, si dhe autori i librit dr. Jusuf Osmani. Në fund të promovimit në emër të familjes foli, Xhevdet Pantina, vëllai i dëshmorit Ahmet Pantina, i cili shprehu falënderime për të gjithë ata që kontribuan për botimin e librit *Djaloshi me shikim lirie, Ahmet Alush Pantina*.

Më 17 tetor 2018, në kuadër të aktiviteteve kushtuar 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë në bashkëpunim me Instituti i Historisë-Tiranë, organizuan promovimin e librave kushtuar Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe mesjetës, ku me këtë rast u botuan këto monografi:

- Jakup Krasniqi, *Skënderbeu dhe porositë për shekullin XXI (Skanderbeg and the messages for the 21st century)*, II, Prishtinë 2018;
- Pranvera Bogdani, *Balshajt (The Balshaj)*, ASA, Tiranë 2018;
- Aleks Buda, *Studime për Skënderbeun (Studies about Skanderbeg)*, ASA, Tiranë 2018;
- *Regjistri i Sanxhakut Arvanid (The Registry of the Arvanid Sandzak)*, ASA, Tiranë 2018;
- Konstantin Jireček, *Nga Shkodra gjer në Vlorë (studime mesjetare) (From Shkodra to Vlora (medieval studies))*, ASA, Tiranë 2018.

Në këtë promovim fjalën e hapjes e mbajti prof. asoc. dr. Sabit Syla, drejtor i Institutit të Historisë “Ali Hadri”. Ndërsa, një fjalë përshëndetëse e mbajti, ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqyri Bytyqi.

Për librin *Skënderbeu dhe porositë për shekullin XXI*, folën recensenti i librit, akademik Marenglen Verli, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike të Shqipërisë, si dhe dr. Jakup Krasniqi autor i librit.

Për librin *Balshajt*, foli vetë autorja e librit dr. Pranvera Bogdani, kurse për librat: *Studime për Skënderbeun*; *Regjistri i Sanxhakut Arvanid*; *Nga Shkodra gjer në Vlorë (studime mesjetare)*, foli dr. Eduart Caka.

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

KOSOVA

43/2018

Redaktore gjuhësore: Shqipe Doda

Rezimetë në gjuhën angleze: Selver Islamaj

Tirazhi 350 copë